**Lidhja ajrore-** Shërbimi i transportit ajror konsiderohet si shërbim indirekt dhe perdoret kryesisht për turistët ndërkombëtarë- kryesisht nëpërmjet aeroportit të Tiranës dhe së dyti nëpërmjet aeroportit të Korfuzit- Greqi. Aeroporti i Tiranës, duke qenë i vetmi aeroport ndërkombëtar në vend, është i vendosur në një distancë prej rreth 200km larg nga Himara, i cili nuk është konsideruar adekuat dhe i pershtashem për të mbuluar nevojat e udhëtimit të flukseve turistike ndërkombëtare të rajonit. Nga ana tjetër, aeroporti i Korfuzit- Greqi, edhe pse gjeografikisht shumë më afër se aeroporti i Tiranës, nuk duket vlere e vecante për aksesueshmërinë e Himarës për një sërë arsyesh, ketu duhet përfshirë si pengesa e detit midis Korfuzit dhe Sarandes, frekuenca e pamjaftueshme e lidhjeve detare përkatëse. Duke pasur parasysh faktin se një pjesë e konsiderueshme e fluksit turistik ndërkombëtar, mund të vijë nga distanca mjaft te largeta me Shqipërinë, ku fluturimeve ajrore janë alternative e vetme e udhëtimit,nevoja për një aeroport në afërsi të Himarës, për të shërbyer kryesist ne menyre sezonale (me fluturime çarter), është e dukshme. Prandaj ne kete shtate eshte i nevojshem studimi ne lidhje me mundësinë e zhvillimit të një aeroporti të ri në jug të Shqipërise. Një aeroport i ri në afërsi të Sarandës tashmë është identifikuar në studimet e mëparshme dhe duket si alternative më e përshtatshme se ndertimi i nje një aeroporti në Vlorë. Mundesia e parë është më e dobishme për Himarën për shkak të rritjes se interesit te saj me zonën e Sarandës kundrejt zonës se Vlorës.

**Lidhja Rrugore-** Aksesit rrugor i zonës së studimit nëpërmjet korridoreve rrugore te jugut te Shqipërisë është përmirësuar ndjeshëm kohët e fundit,kryesisht për shkak të zgjerimit të dukshem dhe të programit të përmirësimit te infrastruktures zbatuar në të gjithë vendin (Fig.3- Zhvillimi i Rrjetit Rrugor shqiptar). Pas përfundimit të korridorit kryesor Tiranës- Durrës- Lushnje- Fier- Vlore i cili aktualisht është përmirësuar pjesërisht dhe pjesërisht eshte në proces modernizimi pritet qe Himara te kete nje aksesueshmeri me te larte me Shqipërinë Qendrore dhe Veriore, Kosoven, Malin e Zi dhe bregdetin Dalmat.

Permirësimi i rrjetit infrastrukturor te jugut të Vlorës deri në Orikum e ka dhene efektin pozitiv tashmë, ne segmentin tjetër ndjekes Himare - Qeparo.Kjo Lidhje e rrugës nga Orikumi në Qeparo mund të kategorizohet e përshtatshme për aksesin e zonës së Himarës, duke pasur parasysh karakterin malore të rajonit dhe përhapjes së vendbanimeve përgjatë këtij segmenti rrugor. Ky lloj kategorizimi do të konsiderohet i vlefshëm per sa kohe do te kemi fluks te ulët të qarkullimit rrugor përgjatë këtij segmenti, shpejtësia e ulët eshte tjtër kusht i pranueshm për udhëtarin (veçanërisht turistë) dhe më e rëndësishme mbetet perqindja e ulët e automjeteve të rënda qe aktualisht qarkullojne .



Kjo është më se e qartë se segmenti rrugor ekzistues malor, të paktën që nga Dukati e deri në qytetin e Himarës duhet të përdoret vetëm për të hyrë në zonën e Himarës, ndërsa një rrugë alternative (bypass) që anashkalon zonën e studimit duhet të sygjerohet në mënyrë që ti shërbejë trafikut të lëvizjes përgjatë bregdetit në drejtim të Sarandes, Gjirokastrës dhe rrethëve të Delvinës, si dhe për vendkalimet kufitare të kufirit shqiptaro-grek të Konispolit dhe Kakavijës. Në rast të mungesës së një rruge anashkaluese (bypass) për Himarën, perspektivat e zhvillimit turistik të zonës së Himarës do të pengohen seriozisht, duke pasur parasysh varësinë thuajse ekskluzive të aksesit të zonës së studimit dhe lidhjes rrugore ekzistuese ndërmjet Himarës dhe Qeparo. Aksesin rrugor të zonës së studimit në drejtimin jugor mund ta konsiderojmë të mjaftueshëm pa probleme të veçanta, përgjatë rrugës së sapomodernizuar Qeparo në Sarandë, kjo sigurohen lidhjen me rrethet e Delvinës, Sarandës, Gjirokastrës, si dhe Rajonin e Epirit të Greqisë.



Figura 3: Rrjeti rrugor shqiptar

## III. PROFILI DEMOGRAFIK & MUNDESITE PER ZHVILLIMIN E TURIZMIT NE HIMARE

### III | 1. PROFILI DEMOGRAFIK

#### 1.1 Popullsia

Rajoni ku shtrihet Bashkia Himare pergjithesisht ka perjetuar te njejtat fenomene demografike si i gjithë territori i Shqiperise pas viteve 90. Ne dhjetevjecarin e fundit te shekullit te kaluar nje pjese e madhe e popullsisë sidomos ajo aktive emigroi per qellime ekonomike jashte vendit, kryesisht ne Greqi.. Ndersa ne fillim te viteve 2000 kemi nje stabilizim te ritmeve te emigracionit, duke sjelle nje stabilitet dhe qendrushmerise se popullsisë vendase me tendence rritje per 10 vjecarin 2000/2010. Keshtu Tabela 1 tregon se popullsia residente dhe jo residente e te gjitha njesive qe perbejne Bashkine Himare eshte rritur nga 10,057 banore ne 12,347 ne fund te vitit 2010 me nje rritje respektive 23% ne dhjete vjet.

|   |               | 2000        |             |              | 2010        |             |              | Ndryshimi ne % |            |            |
|---|---------------|-------------|-------------|--------------|-------------|-------------|--------------|----------------|------------|------------|
|   |               | M           | F           | Total        | M           | F           | Total        | M              | F          | Total      |
| 1 | <b>HIMARE</b> | 2505        | 2397        | <b>4902</b>  | 2933        | 2882        | <b>5815</b>  | 117            | 120        | <b>119</b> |
| 2 | <b>PILUR</b>  | 239         | 218         | <b>457</b>   | 292         | 290         | <b>582</b>   | 122            | 133        | <b>127</b> |
| 3 | <b>KUDHES</b> | 403         | 432         | <b>835</b>   | 463         | 498         | <b>961</b>   | 115            | 115        | <b>115</b> |
| 4 | <b>QEPARO</b> | 741         | 702         | <b>1443</b>  | 888         | 879         | <b>1767</b>  | 120            | 125        | <b>122</b> |
| 5 | <b>VUNO</b>   | 236         | 219         | <b>455</b>   | 286         | 238         | <b>524</b>   | 121            | 109        | <b>115</b> |
| 6 | <b>ILIAS</b>  | 53          | 52          | <b>105</b>   | 66          | 76          | <b>142</b>   | 125            | 146        | <b>135</b> |
| 7 | <b>DHERMI</b> | 275         | 310         | <b>585</b>   | 397         | 418         | <b>815</b>   | 144            | 135        | <b>139</b> |
| 8 | <b>GJILEK</b> | 442         | 442         | <b>884</b>   | 627         | 609         | <b>1236</b>  | 142            | 138        | <b>140</b> |
| 9 | <b>PALAS</b>  | 184         | 207         | <b>391</b>   | 239         | 263         | <b>502</b>   | 130            | 127        | <b>128</b> |
|   | <b>TOTALI</b> | <b>5078</b> | <b>4979</b> | <b>10057</b> | <b>6191</b> | <b>6153</b> | <b>12344</b> | <b>122</b>     | <b>124</b> | <b>123</b> |

Burimi, Bashkia Himare

Tabela 1 tregon gjithashtu se ne Himare banojne rreth 50% e popullsisë rezidente dhe jo rezidente qe perfshin Bashkia Himare, njesi e cila eshte rritur rreth 19% gjate dhjete vjeteve te fundit. Rritje te popullsisë kane shenuar te gjitha fshtrat qe perbejne kete rajon, por rritjen me te madhe duket se e kane fshtarat qe jane me afer bregut si Dhermiu, Gjileka dhe Himara qytet. Shperndarja e popullsisë sipas gjinise eshte pothuajse e njejte me shperndarjen qe ka Shqiperia ne nivel kombetar.

Ne dy regjistrimet e fundit te popullsisë, 1989 dhe 2001 nuk eshte evidentuar shperndarja e popullsisë sipas besimit dhe identitetit kombetar, por eshte evidente qe ne kete rajon banojne nje numer i konsiderueshem popullsisë qe e identifikojne veteveten si minoritet Grek, kryesisht ne Himare, Dhermi dhe Qeparo. Regjistrimi i ri popullsisë qe parashikohet te zhvillohet ne vjeshte te ketij viti, parashikon numerimin e popullsisë dhe sipas deklarimit te fese dhe identitetit kombetar. Megjithate regjistrimi i popullsisë se vitit 2001 tregon te dhena te rendesishme persa i perket popullsisë rezidente ne te gjithë Bashkine Himare qe paraqiten ne tabelen 2 te meposhtme.

Tabela 2 tregon se meshkujt jane ne raport prej 95.47 per 100 femra ne rajonin e Himares, gje qe tregon se nje pjese meshkujve tashme jane jo me rezidente ne Himare ne raport me femrat. Moshë mbi 65 ze rreth 29% te popullsisë rezidente ne Himare, e cila eshte dy deri ne 3 here me e larte se kjo perqindje ne rajonet e tjera te Shqiperise,

ndersa grup moshë 0-14 vjeç ze 17.6% të popullsisë e cila është gjithashtu afërsisht dy here më e vogël se ky raport në nivel kombëtar. Të dy këta tregues tregojnë për një plakje të popullsisë së Himarës që ka ardhur krejtësisht nga fenomeni i migracionit që do të trajtohet më poshtë.

| <b>Tabela 2: Shpërndarja e popullsisë rezidente në Himarë në vitin 2001</b> |              |              |              |          |
|---|--------------|--------------|--------------|----------|
| <b>Indeksi</b>  | <b>Total</b> | <b>Qytet</b> | <b>Fshat</b> | <b>%</b> |
| Meshkuj   | 1,601        | 695          | 906          | 95.47    |
| Femra   | 1677         | 695          | 982          |          |
| 0-14 vjeç   | 578          | 336          | 242          | 17.6     |
| 15-64 vjeç  | 1,747        | 788          | 959          | 53.3     |
| 65+   | 953          | 266          | 687          | 29.1     |
| Burimi, INSTAT, Census, Repoba, Prefektura Vlorë                            |              |              |              |          |

Në tetor të këtij viti u zhvillua numërimi i ri i popullsisë, i cili do të japë një pasqyrë të saktë të popullsisë rezidente aktuale në bashkinë e Himarës dhe shpërndarjen e saj. Këto të dhëna do të jenë mjaft të vlefshme për zhvillimin perspektiv të rajonit, por natyrisht që mbi bazën e të dhënave që aktualisht janë në dispozicion nga ana e Bashkisë apo Qarkut, siç është numri i familjeve që konsumojnë dhe paguajnë rregullisht faturat e energjisë dhe ndryshimin e tyre në vite, na le të besojmë se popullsia rezidente e Bashkisë Himarë, do të rritet me një rritje prej 0.3-0.4% në vit duke arritur në rreth 10.000 banorë rezidente në fund të vitit 2020, nga rreth 4,500 banorë që janë aktualisht, si dhe rreth 18,000 banorë në fund të viteve 2020.

**Emigrimi-** Siç u theksua edhe më lart pas viteve 90 një pjesë e madhe e fuqisë punëtore aktive emigroi për arsye ekonomike në Greqi. Vlerësimet e përafërta tregojnë se nga rajoni i Himarës kanë emigruar mbi 70% e popullsisë, ose rreth 7,500 persona, pjesa më e madhe e të cilëve presupozohen të jenë të moshës së afërta për punë 15-65 vjeç. Pas viteve 2000 trendi i emigracionit ndryshoi në kah të kundërt, që do të thotë një pjesë e vogël e kësaj popullsie filloi të kthehet në Himarë, duke filluar aktivitetet private kryesisht ato të lidhura me industrinë e turizmit. Informacionet e mbledhura në terren tregojnë se një numër gjithnjë e më i madh i popullsisë e cila ka emigruar në Greqi në 10 vjeçarët e fundit të shekullit të kaluar po shikojnë mundësinë e kthimit në vendlin e tyre, duke u nisur nga kushtet jo të favorshme ekonomike në Greqi, si dhe persepektiva e zhvillimit të rajonit të Himarës, duke u bërë një potencial shumë premtues për zhvillimin e këtij rajoni, pasi kjo fuqi popullore e afërta për punë përveç investimit potencial është dhe më e kualifikuar.

**Densiteti i popullsisë-** Duke ditur se Bashkia Himarë shtrihet në një territor të përafërt me 132 km<sup>2</sup>, si dhe rrethën e popullsisë rezidente të Himarës nga 3.250 në vitin 2001 në 4500 në vitin 2010 atëherë del se dendësia e Himarës është afërsisht 35 banorë/ 1km<sup>2</sup>. Kjo shifër është pothuajse sa gjysma e dendësive për Qarkun e Vlores, prej 71 banorë për 1km<sup>2</sup> dhe shumë e vogël nga ajo në nivel kombëtar prej 111 banorë për km<sup>2</sup>.

## 1.2 Zhvillimi Ekonomik i Zonës

Tre janë aktivitetet kryesore ekonomike që zhvillohen në rajonin e Himarës. Se pari është aktiviteti i shërbimeve turistike, se dyti blegësia dhe se treti bujqësia e mbështetur tek fruti kulturat. Tabela 3 tregon dinamikën e zhvillimit të sipërmarjeve në bashkinë himarë të ndërsa sipas madhësisë dhe sezonalitetit të tyre.

| <b>Tabela 3: Zhvillimi i sipermarjeve ne Bashkine Himare 2005-2010</b> |              |             |             |             |             |             |                   |
|--|--------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------------|
| <b>Vleresimi I ndermarjeve sipas madhesise</b>                         | <b>Vitet</b> |             |             |             |             |             | <b>Ritja ne %</b> |
|  | <b>2005</b>  | <b>2006</b> | <b>2007</b> | <b>2008</b> | <b>2009</b> | <b>2010</b> |                   |
| Micro ndermarrje (1-5 punonjes)  | 123          | 129         | 136         | 146         | 148         | 156         | 27                |
| Te tjera (> 5 punonjes)  | 19           | 19          | 20          | 20          | 21          | 23          | 21                |
| Biznese sezonale (< 3 muaj)  | 32           | 34          | 37          | 48          | 73          | 123         | 284               |
| <b>Total</b>   | <b>174</b>   | <b>182</b>  | <b>193</b>  | <b>214</b>  | <b>246</b>  | <b>302</b>  | <b>74</b>         |
| Burimi, Bashkia Himare   |              |             |             |             |             |             |                   |

Tabela 3 tregon se sipermarrrja private ne Himare predominohet ne 99% te tyre nga microndermarrjet me 1-5 punonjes si dhe firmat me karakter te theksuar sezonal ne sherbim te aktivitetit turistik. Vetem 23 ndermarrje nga totali prej rreth 300 firmave ne vitin 2010 kane te punesuar mbi 5 punonjes. Per me teper numri I tyre ne keto 5 vjetet e fundit ka mbetur pothuajse constant me nje rritje te vogel. Nga tabela vihet re se rritjen me te madhe e kane firmat qe operojne me karakter sezonal. Numri i tyre ne vitin 2010 eshte pothuajse 4 fishuar ne krahasim me vitin 2005, i cili sigurisht eshte ndikuar nga rritja e fluksit turistik ne rritje ne vitet e fundit. Tabela 4 tregon shperndarjen e biznesevesipas degeve te ekonomise.

| <b>Tabela 4: Struktura e ndermarrjeve sipas degeve te ekonomise 2005 - 2010</b> |              |             |             |             |             |             |                       |
|---|--------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-----------------------|
| <b>Lloji I biznesit</b>   | <b>Vitet</b> |             |             |             |             |             | <b>Struktura ne %</b> |
|   | <b>2005</b>  | <b>2006</b> | <b>2007</b> | <b>2008</b> | <b>2009</b> | <b>2010</b> |                       |
| Industri perpunuese   | 11           | 14          | 14          | 16          | 15          | 18          | <b>6</b>              |
| Tregti dhe restorante   | 132          | 139         | 143         | 161         | 193         | 245         | <b>81</b>             |
| Ndertim   | 9            | 9           | 11          | 11          | 11          | 12          | <b>4</b>              |
| Sherbimet e tjera   | 14           | 12          | 16          | 16          | 16          | 16          | <b>5</b>              |
| Transport   | 8            | 8           | 9           | 10          | 11          | 11          | <b>4</b>              |
| Burimi, Bashkia Himare  |              |             |             |             |             |             |                       |

Perpra viteve 90 bujqesia dhe blegtoria dhe aktivitet qe lidheshin teresisht me mbeshtetjet e ketij sektori ishte aktiviteti baze i ketij rajoni. Tradicionalisht ky rajon eshte i shquar per prodhimin e agrumeve, ullirit, frutave te tjera dhe me pak vreshta, per vete klimen mesdhetare dhe pozicionin gjeografik. Ne vitin 1991 siperfaqja me drejtim bujqesor e ketij rajoni llogaritet te jete rreth 2,200 ha. Sot kjo siperfaqe perdoret ne destinacione te tjera duke e kufizuar mjaft siperfaqen per kultivimin e kulturave bujqesore por edhe pemtarise. Nje tjetër drejtim I rendesishem per rajonin eshte ai i blegtorise, e cila perben nje tradite te hershme te rajonit, e stimuluar kjo edhe nga kullotat qe ndodhen ne rajonin ku perfshihet rajoni i Himares. Tabela 5 tregon siperfaqet e kullotave te ndara sipas rajoneve.


| <b>Tabela 5: Siperfaqja e Kullotave ne Bashkine Himare</b> |                         |
|--|-------------------------|
| <b>Fshati</b>  | <b>Siperfaqja ne Ha</b> |
| Gjomall  | 1494 Ha                 |
| Qeparo- Pilur  | 3854 ha                 |
| Mali I Cikes Himare  | 2471 ha                 |
| Dhermi – Vuno  | 4468 ha                 |
| Fajeo  | 460 ha                  |
| Ane e Detit  | 1737 ha                 |
| Burimi, Bashkia Himare                                     |                         |

### III | 2. MUNDËSITË PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT NË HIMARË

#### 2.1 Aksesueshmeria

Aksesibiliteti në Himarë është i vështirë. Aeroporti me i afërt ndodhet në Sarandë, por pista zbritese është vetëm 700m e gjatë dhe e ben praktikisht te pa perdoreshme. Aeroporte te tjera më të afërt janë Korfuzi dhe ai i Janinës. Nga Korfuzi me një traget vihet në Sarandë, udhëtim i cili zgjat rreth 45 minuta. Nga Saranda nepermjet linjes rugore udhëtohet për në Himarë per rreth 30-40 minuta. Trageti nga Korfuzi për në Sarand përdoret shpesh nga turistët edhe për një ditë udhëtim për të vizituar vendin e Trashëgimisë Botërore, Butrintin, që ndodhet në jug të Sarandës.

Me poshte kemi perfshire nje harte me pikat kryesore hyrese ne Himare.



**Figura 4:** Aksesibiliteti në Himarë

|    |                   |          |
|----|-------------------|----------|
| 1. | Tirana - Aeroport | Shqiperi |
| 2. | Durres            | Shqiperi |
| 3. | Vlore             | Shqiperi |
| 4. | Himara            | Shqiperi |
| 5. | Saranda           | Shqiperi |
| 6. | Korfuz - Aeroport | Greqi    |
| 7. | Janine – Aeroport | Greqi    |
| 8. | Brindizi          | Itali    |

Nga aeroporti i Janinës udhëtimi me makinë për në Himarës kërkon rreth 2,5 orë, që është ndoshta pika më e lehtë për qasje nga ajri, por përsëri Janina nuk ka asnjë lidhje ajrore ndërkombëtare. Nga aeroporti ndërkombëtar i Tiranës me makinë do të duhen të paktën 4 orë në rrugë me terren të thyer. Përveç portit të Sarandës, i cili është i lidhur vetëm me Korfuzin, është dhe porti i Vlorës, që përdoret për tu lidhur me Brindisin në Italinë e Jugut, (por vitin e kaluar agjencia e udhëtimeve Skenderbeglines ka ndaluar udhëtimet). Qyteti i Durrësit në Shqipëri është i lidhur më mirë me linjat e anijeve tragetare dhe trageteve për në Bari, Ankona dhe Trieste të Italisë. Megjithatë, Durrësi është shumë larg nga Himara, për shkaket, që u përmenden më lartë, infrastruktura rrugore ka aksesueshmeri të vështirë.

## 2.2 Klima dhe popullsia

Zona në studim ka një klimë subtropikale, e ndikuar nga klima mesdhetare, me një fotoperiodicitë ditore dhe sezonalet të dalluar mjaft qartë nga sezonet e ndryshimit të temperaturave dhe rreshjeve të përqendruara gjatë pjesës së ftohtë të vitit. Lagështia mesatare e ajrit arrin deri në 70%. Për sa i përket temperaturave mund të themi se temperatura më e ulët është 12 ° C, regjistruar në Janar dhe temperatura më e lartë prej 32 ° C, në muajt Korrik-Gusht. Zona dallohet nga një verë e ngrohtë me temperatura të favorshme për plazh për një periudhë 5-mujore, kur gjatë tre muajve të verës mund të qëndrohet deri në 14 orë në plazh. Temperatura absolute e detit arrin deri në 27,2 ° dhe minimale rreth 13,5 ° C. Gjate gjithë vitit janë mesatarisht 106 ditë me diell dhe 190 ditë pjesërisht me re ose të vrenjtura. Pra, ka në total rreth 2,805 ore me diell në vit.

Shumica dërrmuese e njerëzve në Himarë, që e quajnë veten "Horiani", që do të thotë banorët në dialektin lokal Grek, dhe janë përdorin dy gjuhë Shqipen dhe Greqishten, ndërsa 85% e punonjësve të bashkisë përdorin Greqishten si gjuhën e tyre amtare, sipas autoriteteve bashkiake. Në qytetin e Himarës, si dhe në fshatrat përreth të Dhërmiut dhe Palases kryesisht flasin një dialekt të veçantë lokal të Greqishtes që ruan shumë tipare arkaike që nuk figurojnë më në standardet moderne Greke. Ky dialekt ka ndryshime të vogla në çdo qytet, sidomos në theks. Nga ana tjetër qytetet përreth si Ilias, Vuno, Qeparo, Kudhes dhe Pilur kryesisht flasin dialektin Tosk Shqiptar.

## 2.3 Infrastruktura

**Pamjet-** Qyteti mesjetar i Himarës besohet të jetë themeluar si Χίμαιρα, (Chimaira, nga vjete emeri Himara) nga Chaonians si një vend tregtar në bregdet Chaonian. Megjithatë, një tjetër teori për emrin thotë se vjen nga χείμαρρος Greqisht (cheimarros), do të thotë "përrua". Qyteti i vjetër Kastro, i vendosur në dhe rreth kalasë së vjetër. Pjesë të tjera të qytetit janë Potami, Livadhi, Zhamari, Michaili dhe Stefaneli. Një numër kishash janë vendosur në kalanë e Himarës, e cila është ndërtuar fillimisht në antikitetin klasik, si Kisha e Virgjëreshës Mari Kasopitra, e cila është një kishë bizantine me një ikonë të Panagia - nëna e Krishtit. Në periudhat e thatësirës popullsia e Himarës do të lutej përpara ikonave dhe këndonte himne dhe një shi i fortë do të pasonte së shpejti. Edhe kisha e Episkopi është gjetur brenda në kështjellë, e cila është ndërtuar në vendin e një tempulli të lashtë kushtuar Apollonit. Dera e kishës mban një strukturë mermeri bizantine të shqiponjës me dy koka. Së fundi, është edhe kisha e Pantës Aghioi, në hyrje të kështjellës. Kjo kishë është ndërtuar rreth vitit 1775. Monumente të tjera në kështjellë përfshijnë rezidencën e familjes Spyromilios që ka luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e Himarës. Gjatë Luftes

se Parë Ballkanike, më 18 nëntor 1912 një qytet i revoltuar nën udhëheqjen Spiros Spyromilios dëboi forcat osmane.

- Himara është e privilegjuar të jete pranë detit me një vijë bregdetare kryesisht ranore.
- **Palasa** e vjetër është një fshat në veri, kur vjenë nga Vlora. Është përmendur për herë të parë nga Jul Cezari në 48BC, kur ai qendroi në brigjet e Jonit gjatë luftës civile kundër Pompeus. Një pemë e vjetër dhe e mëdhe lisi, në pjesën e përparme të kishës së Shën Dhimitrit, është monument i veçantë natyror në Palasë dhe përdoret për mbledhjet e fshatit.
- **Dhermiu** është ndërtuar në një shpat të Malit të Ceraunian, në rreth 200m lartësi. Ky është një fshat i këndshëm tradicional me kisha të shekujve 13 dhe 14 në mesin e Kishës së Ipapandia. Ka edhe monastirin e Theodoros Saint kushtuar Shën Theodhorit. Në pjesën balllore të plazhit gjendet Shpella e Piratëve (Spilia ton Piraton), e cila është e arritshme nga deti dhe toka. Shpella është bërë e famshme nga libri i shkruar nga Petro Marko dhe filmi me të njëjtin titull. Pamje nga deti është unike dhe shumë e veçantë.



**Figura 5:** Pamje nga Qeparo i vjetër drejt Qeparo i ri

- Fshati i **Iliasit** është një vendbanim i vogël bujqësor jo tipik i fshatrave të asajë zone, në këtë zonë çdo shtëpi ka një kopsht të madhe perimesh më vete.
- Fshati **Vuno** ofron pamje të bukura, kisha të ndryshme si Kisha e Shën Mërisë së Mesodhia (1783) dhe kishën e Shën Spiridhonit (1778).
- **Porto Palermo** ndodhet rreth 10 km nga Himara. Kjo është një gjë e mbyllur, shumë e pazhvilluar me një bazë detare në pjesën veriore të saj. Në Porto Palermo gjendet kalaja e Ali Pashes, e cila mori formën e tanishme në fund të shekullit të 18. Ajo ka një formë drejtkëndëshe me katër kulla në qoshet e saj. Hapësira e brendshme është e përbërë nga sheshe, vendetregtie / grumbullimi dhe hapësira të tjera, duke përfshirë edhe zonën e haremit. Në pjesën qendrore të saj janë të pozicionuar shkallët prej guri që të çojnë në terracë. Muret me hapsira të vogla/dritare mbrojnë mjedisin e brendshëm në pjesën balllore dhe

ate anesore. Ne pjesen e jashtëme, me hyrje ne forme qemeri është një ballkon guri në formë krahu.

- Vendbanim i fortifikuar i Kastros ndodhet pranë **fshatit Qeparo** përgjatë lumit Qeparo. Në një vend të zgjedhur në mënyrë të qartë për mbrojtjet e tij natyrore, Kalaja është e vendosur në majë të një kodre. Qasjet nga pothuajse të gjitha drejtimet do të kërkonin një ngjitje të vështirë në një shpat shkëmbor. Muret mbrojtjese origjinale me sa duket kishin vetëm një hyrje. Gjendja aktuale e mureve është një tregues i përdorimit të saj, e zgjeruar me 350 m dhe përafërsisht 3m të trashë. Ajo ndryshon në lartësi, duke arritur një maksimum prej 1,5 m në gjendje të shkatërruar. Dy struktura prapa portës hyrëse kanë qene si pengesa shtesë për sulmet, kjo tregon se rendet e fortifikuar ka qene ai vend në atë kohë. Origjina e zgjidhjes arkitekturore është e panjohur, por objektet e zbuluara gjatë gërmimeve arkeologjike flasin për një larmi të banesave nga Epoka e Hershme e hekurit në shekullin e 4 pas Krishtit
- **Qeparo i Sipërm** ka një manastir të bardhë të rinovuar kushtuar Shën Dhimitrit me një kishë me të njëjtin emër.



**Figura 6:** Qeparo i vjeter

Shumica e objekteve të mësipërme janë në gjendje jo të rregullt dhe në shumicën e rasteve nuk ka rrjete që kalon nëpër vendbanimet. Për më tepër, mbeturina gjenden përreth pothuajse kudo në zonat e banuara dhe shpesh përtej atyre. Një përjashtim i dukshëm për të gjithë sa më sipër është kalaja në majë të Himarës, e cila kohët e fundit është pastruar dhe pajisur me rrjet ndriçim publik dhe infrastrukture rrugore.

## 2.4 Akomodimi

Sic u theksua edhe më lart turizmi është një nga deget më të rëndësishme të Bashkisë Himare. Në vitin 2007 plazhet e këtij rajoni llogariten të kane vizituar rreth 60,000 vizitore që kanë fjetur të pakten në një nga hotelet apo ambientet me qera të zonës. Ky numër në vitin 2010 llogaritet të jetë afër 100.000 persona, me një rritje prej më shumë se 15% çdo vit. Kërkesa për vazhdon të mbetet shumë e lartë, por ajo është koncentruar kryesisht në një periudhë shumë të ngushtë të sezonit veror që fillon në javën e dytë të muajit korrik dhe vazhdon deri në fund të muajit gusht. Si rrjedhojë e rritjes së kërkesës për të kaluar pushimet gjatë sezonit të verës numri i hoteleve në këtë rajon është shtuar në mënyrë të shpejtë nga rreth 11 që ishin në vitin 2005 në rreth 80 hotele në vitin 2010, me një mesatare 10-20 krevate për një hotel. Në total sot llogariten që në Himarë të ketë rreth 1200 krevate të shpërndara në rreth 80 hotele, si dhe rreth 3000 dhoma të leshuara me qira gjatë sezonit turistik nga banoret vendas.



Po kështu ne rajonin e Himares jane edhe disa mjedise qe mundesojne krijimin e kampeve si ne Dhermi dhe Potam, te cilet bejne te mundur te akomodojne nje pjese te fluksit te vizitoreve qe vijne me makinat e tyre, te tipit karavan.

**Argetimi-** Ka rreth 39 restorante në këtë zonë, të cilat 11 kanë qenë të klasifikuar si ushqime të shpejta (fast food). Përveç kësaj ka rreth 36 bare, nga të cilat disa prej tyre ofrojnë edhe ushqim. Perfundimisht ka rreth 13 disko.

## 2.5 Kerkesa

Për fat të keq nuk ka te dhena statistikore për Himaren në drejtim të numerit të vizitoreve, atyre qe kalojne naten, kombësisë etj. Nga PAP / RAC - Raporti i Konsorciumit SOGREA H te 2005 mund të thuhet se ardhja e vizitoreve te huaj eshte kryesisht nje ditore nga porti i Korfuzit në Sarandë, në mënyrë që të vizitojne Butrintin si nje vend i Trashëgimisë Botërore. Në fund të viteve 1980, vizitorët ditore nga Korfuzi përbënin gjysmen e turistëve të huaj qe vizitonin Shqipërinë në aspektin numerik. Në vitin 2004, rreth 22.000 turistë te huaj, ose 50% e të gjithë vizitorëve që mbërrijnë në Sarandë nga deti, vizitojne zonen e Butrintit dhe vendet kulturore rreth tij, për një ditë ose më pak, duke kaluar një ditë në Sarandë dhe pastaj kthehen për akomodim ne ishullin Grek te Korfuzit. Këto turne janë të organizuara nga agjencitë turistike Greke dhe Shqiptare me pak kosto ose infrastruktur turistike në dispozicion (p.sh., hotelet për të mbajtur turistët në Sarandë për më shumë se një ditë). Rritja e numrit të vizitorëve të huaj thekson varësinë e lartë për ndërmjetësimin e huaj (kryesisht nga Korfuzi), që tregojnë në të njëjtën kohë mungesën e operatorëve turistikë vendas dhe të një strategjie për marketingun. Bazuar në këtë raport pothuajse të gjithë turistët në kete vend (me përjashtim të rreth 3% të cilët janë nga jashtë) janë nga Shqipëria, Kosova apo Maqedoni. Ka rreth 107.000 turistë që qëndrojnë gjatë natës, ndërsa qëndrimi mesatar është 7 deri në 14 ditë (109.000 turistë në vitin 2004 qëndruan 5-14 ditë, shih tabelën më poshtë). Ata janë pergjithesisht të interesuar në turizmin e plazhit.

| Tabela 6: Turistëve që qëndrojnë 5-14 ditë në Vlorë |   |
|---|---|
| Zona  | Turist (te huaj & lokal) te cilet qendrojne 5-14 dite |
| Saranda   | 23,320  |
| Lukova  | 2,867   |
| Piqeras   | 1,370   |
| Borsh   | 4,375   |
| <b>Qeparo</b>                                       | <b>1,875</b>  |
| <b>Dhermi</b>                                       | <b>3,000</b>  |
| <b>Himara</b>                                       | <b>9,375</b>  |
| <b>Vuno / Palasa</b>                                | <b>4,375</b>  |
| Orikum  | 6,250   |
| Vlora   | 52,500  |
| <b>Total</b>  | <b>109,307</b>  |
| Burimi: Gunaratnam, 2004                            |   |

Nga ky total prej 109.307 vizitorësh, vetëm 18.625 kanë qëndruar në zonën e studimit, siç tregohet në të gjelbër në tabelën e mësipërme, që përfaqëson 17% të totalit. Nga i gjithë bregdeti jugor i Shqipërisë, duket se Vlora dhe Saranda po tërheqin me shume turistë. Së fundi, do të donim të përmendenim që Himara, ndoshta për shkak të mungesës së infrastrukturës turistike baze, nuk është promovuar akoma. Një kërkim në internet do të tregonte se informacioni turistik në lidhje me zonën është shumë i kufizuar. Lidhja midis Brindizit dhe Vlores që u identifikua nëpërmjet thirrjeve telefonike me portin e Brindizit rezultoi teper e veshtire. Si konkluzion rezultoi një mungesë e plotë e çdo forme e marketingut të zones Himare.

## 2.6 Vlerësim

Mund të thuhet se infrastruktura aktuale është inadeguete si:

- infrastruktura hoteliere konsiston thjesht në dhoma dhe krevat, apo ambiente shumë të vogla,
- nuk ka një kategorizim zyrtar për të ndihmuar vizitorët për zgjedhjen e tyre,
- mundësi atraktive panoramike, si kalaja e Ali Pashës në Porto Palermo, apo Kishat përreth që realisht janë në nevojë të menjëhershme për restaurim. Një rast i vacant është Kalaja e Himarës e cila së fundi (2011) është pastruar dhe shtruar infrastruktura e nevojshme,
- ekzistenca e mbeturinave pranë ambienteve të banimit dhe në mjedisin përreth, krijon një ambient shumë të pakëndshëm për vizitorët; grumbullimi i mbetjeve urbane / riciklimi është pothuaj inekzistent,
- së fundi por jo vetëm në botën e sotme të turizmit shërbimi i internetit dhe wi-fi janë një domosdoshmëri. Interneti i dobët dhe mungesa e pothuajse të plotë e wi-fi në zonën e cila, për udhëtarët moderne, konsiderohet nevojë. Paralelisht me këtë, duhet të theksohet mungesa e një marketingu aktiv në zonë për median elektronikë. Këto mangësi janë veçanërisht të rëndësishme për zhvillimin e turizmit pasi pothuajse 40% e të gjithë biznesit të turizmit në Evropë bëhet nëpërmjet lidhjeve me internetin.
- Së fundi, ka ende çështje të pazgjidhura ose të paqarta të pronës, sipas vezhgimeve të bëra nga Konsulenti në lidhje me modelet e pronësisë për zhvillimin e turizmit, nëpërmjet një diskutimi me një ekspert ndërkombëtar nga OSBE-ja (shih informacionet/ shenimet e takimeve).

Në anën tjetër ,

- Ka mjaft vende panoramike pranë detit dhe në zonë malore;
- Ka shumë plazhe ranore;
- Fshatra të vegjël me shtepi guri të krijojnë një ndjenjë të vecante;
- Qyteti i Himarës konsiderohet i privilegjuar që qyteti përgjate ka formën e gjiut .

Si konkluzion, zona ka një potencial shumë të madh por për momentin infrastruktura është e varfër dhe një sërë elementesh nuk funksionojnë.

## IV. STRUKTURA HAPESINORE

### IV | 1. PERDORIMI EKZISTUESE I TOKES

Bashkia Himare paraqitet si nje relief i integruar ne teresi, i pasur me larmi peisazhi. Bashkia Himare eshte rreth 20 Km e gjate dhe rreth 5 km e gjere qe perfshn nje territor prej 132 km<sup>2</sup>. Kufijte natyrale te Bashkise Himare jane vargmali i Cikes nga lindja, Deti Jon nga Perendimi, Llogoraja ne pjesen veriore dhe mali i Qeparose ne jug. Breda ketij entiteti pjesa e **pa perdorshme per urbanizim** ndjek skemen e thjeshte te zonave te njepasnjeshme: deti, zona bregdetare, zona bujqesore, zona kullotave dhe livadheve dhe se fundi zonat malore dhe ato pyjore. **Zonat per qellime urbane** jane te perqendruara me se shumti ndermjet pjeses kodrionore dhe tokes se ulet bujqesore dhe me tej drejt fillimit te maleve. Ne kete zone gjenden gjithashtu pjese bregdeti dhe vendbanime malore. Evidentimi i tokes me specifikime perkatese te Bashkise Himare sipas studimit te Bankes Boterore eshte paraqitur ne tabelen 7.

| Tabela 7: Bashkia Himare: Shperndarja e tokes |                 |       |
|---|-----------------|-------|
| Perdorimi i tokes                             | Siperfaqja (ha) | %     |
| Toka e urbanizuar                             | 216 ha          | 1.6%  |
| Toke Bujqesore                                | 2,834 ha        | 21.4% |
| Pyje  | 326 ha          | 2.5%  |
| Toke e zhveshur                               | 9,837 ha        | 74.5% |
| Gjithesej                                     | 13,213 ha       | 100%  |
| Burimi: SCDP, 2006                            |                 |       |

### IV | 2. STRUKTURA E PEISAZHIT

Struktura e peizazhit të zonës karakterizohet nga dy tipare dominuese topografike. Një nga tiparet kryesore të zonës është Mali I Cikes qe shrihet në lindje dhe ecen ne drejtim paralel me bregdetin dhe me kete vendosje ben nje izolim natyral te terrenit me pjesen tjetër te zones qe kemi ne studim. Tipari tjetër dallues strukturor i peizazhit është vetë deti dhe bregdeti i saj i cili përcakton kufirin perëndimor natyror të zonës. Verehet se aktiviteti jetesor është organizuar më së shumti në drejtim gjatësor nga veriu në jug ndermjet këtyre dy formatimeve te peisazhit. Kjo zonë gjithashtu e pare nen nje kendveshtrim tjetër karakterizohet nga një seksion morfologjikisht interesant me renie nga mali në det, me shume nderprerje transversale në formën e kanioneve, perrenjve dhe lumenjve. Këto boshllëqe topografike të veçantë e ndajne në mënyrë të natyrshme zonen ne 5 njësi të peizazhit me identitete të veçantë si dhe ne koridore ekologjike e habitate.

**Njesia 1. Zbritja nga Parku Kombetar i Llogarase ne kanionin Ngjipese-** Kur zbrit nga lartësia e konsiderueshme e malit te Cikes nga veriu per në jug, veren një pamje mahnitese, panoramike te peizazhit qe të lë pa frymë. Gjate zbritjes se qafes se Llogarase ne forme zig-zag perpara shpaloset pamja e tre plazheve te gjata ato te Palases dhe Dhermiut si dhe shtrirja madheshtore e lugines në mes të detit dhe majes se larte 2045m qe ndesh në horizontin e largët. Pergjate rruges verehen prania e lisave, ullishteve Ky kompleksitet panoramik është perceptim i një peizazhi ne shkallë

të gjere që zgjerohet sa rruga duke zbritur diagonalisht drejt detit. Gjate rruges per ne drejtim te veriut në drejtim te Manastirit te Shën Todorit perballesh me një tjetër pamje panoramike në sfond. Ky entitet peizazhi mbyllet me afrimin ne Kanionin mahntes se të Ngjipese.

**Njesia 2. Nga Kanioni i Ngjipese tek Lumi-Kanion Himare-** Në kufi të dy zonave(njesive), kanioni Ngjipea paraqitet si një tipar dominues me prerjen e saj vertikale topografike, duke formuar një vijezim te tërthortë përmes faqes kodrinore. Peisazhi mbyllet dhe duket sikur po ngjeshet ne këtë njësi. Mes malit dhe detit të madh, nje pllaje e butë duket se eshte krijuar si një tarracë me ullishte e pershkuar nga perrenj te vegjel. Plazhet janë të një shkalle të vogël, ata duken si të fshehura duke shtuar elementin intim ne to dhe të izoluar dhe jo lehtesisht te aksesueshme. Ne kendveshtrimin e peisazhit ai ngelet mbreselenes por me i vogel ne madhesi se peisazhi i njesise1.

**Njesia 3. Baseni i Himares-** Përherë të parë pas hyrjes në zonën e studimit pjesa e malit duket se tërhiqet prapa, në largësi nga bregu. Zhvendosur nga kjo zone një luginë me kodra të vogla shtrihet zona e Himaraes dhe fshatrat e saj. Rruga kombetare zbrit diagonalisht dukshem në drejtim të detit, rruge kjo që te çon në qytetine Himarës. Shpërndarja e ndertimeve nga kodëra në kodër krijon nje peisazh me njerezor ne tëgjithë zonën dhe natyra duket se ka një rol dytësor. Himara duket se perbehet nga tri plazhe të gjatë dhe relativisht të mëdha. Lumenj, perrenj dhe peizazhe me komplekse të populluara verehen ne kete zone. Në jug verehet nje renie e malit në drejtim të bregdetit ku ne kete menyre formohet kufiri natyror me Porto Palermon duke u konsideruar si pjesa fundore e kesaj njesie.

**Njësia 4. Porto Palermo-** Ne piken ku zgjerimi i harkuar i malit arrin në det shtrihet, gjiri i Porto Palermos. Rruga këtu vjen në afërsi të bregdetit duke dhënë pamje të këndshme te harkuara te plazheve dhe bregdetit. Peizazhi ketu duket se "zbutet" ne kontrast te forte me pjesen e deritanishme intensive bregdet -mal, duke u drejtuar ne kështjellën e Ali Pashait në qendër të gjirit ku te krijohet nje pershtypje e mbylljes se menjehershme te rrethit te hapësires. Mungesa e bimësisë dhe pylli i agaves,të krijojëjne nje ndjesi te ndryshme nga cdo zone tjeter e studiuar. Porto Palermo është një peizazh i veçantë që rrezaton një ndjenjë qetësisë dhe unikaliteti.


**Njesia 5. Lugina e Qeparo-** Pas largimit nga Porto Palermos, rruga vijon e lakuar pergjate malit dhe tenton te hyjë në luginën e Qeparose. Duke e ndare mali ne dy pjese figurative lejon krimin e nje luginë ndermejt tij ne forme trekendeshi e cila sot eshte e lulezuar nga ullinjte. Kjo luginë hyn thellesisht ne peisazh nga perendimi ne lindje duke krijuar per here te pare ne zonen tone te studimit idene e nje shtrirjeje te plote ne nivel te detit te sipefaqes se tokes. Kjo zone eshte pergjate bregdetit dhe ka plazhe te medha, ajo gjithshu pershkohet nga perrenj te vegjel.

**Karakteristikat dominuese te Peisazhit si bartës i strukturës hapësinore:**

- Mali Cikes
- Zbritja e Llogarase
- Shpatet e pjerrta dhe vendet panoramike
- Kanion Gjipa
- Promontories • Himarës dhe kodrat
- Porto Palermo


- Lugina e ullirit Qeparo
- Sistemi i lumenjve dhe perrenjve
- Bregdeti dhe plazhet

Per te kuptuar strukturën e këtij peizazhi jane perdorur një sërë diagramash peisazhi. Vertikaliteti dhe horizontaliteti që kontrastojne ne menyre te vazhdueshme zonën dhe formojnë një entitet peizazhi te tille qe është estetikisht me nje vlere te vecante. Vendosja e ketyre vlerave te peisazhit si nje nga vecanesite e zones do te beje te mundur ruajtjen e ketij peisazhi dhe mbrojtjen nga ndertimet/ zhvillimet.



**Figura 7:**Harta e Peisazhit: (a) Topografi

**Figura 8:** Harta e Peisazhit: (b) Sistemi i korridoreve të ujit




**Figura 9:** Harta e Peisazhit: (c) të bregut

**Figura 10:** Harta e Peisazhit: (d) Infrastruktura dhe mjedisit të ndërtuar



**Figura 11:** Struktura e Peisazhit

**Figura 12:** Diagrama estrukturave te Peisazhit



**Figura 13:** Harta e Peisazhit

## IV | 3. VENDOSJA STRUKTURORE

**Qyteti i hapur-** Bashkia Himare përbëhet nga qyteti i Himarës dhe nëntë fshatra. Vendbanimet e zhvilluara kanë strukturën e përgjithshme të një "qyteti të hapur", përbehen nga grupime vendbanimesh të zhvilluara në afërsi të njera tjetres, brenda një konteksti jo-urban. Ky është një rrjet i decentralizuar i dendësisë të ulët. Qyteti i Himarës është vendbanimi më i madh si në madhësi të tij ashtu edhe për popullsinë që ka, si dhe është qendër referimi për të gjithë Bashkinë. Shumica e vendbanimeve rurale janë të shkallës së mesme dhe me një popullsi të regjistruar 400-900 banorë (Vuno, Kudhes, Dhermi, Gjilek, Palasa, Pilur, Qeparo, Himarë dhe e Vjetër). Rastet e Qeparo të Ri dhe Ilias dalin jashtë përkufizimit të vendbanimit të madh ose të vogël në kontekstin e rrjetit të vendbanimeve.

**Identiteti i Perbashket-** Deri më sot, e gjithë zona ka ruajtur një identitet relativisht koherent, bazuar në specifikat e saj historike, gjeografike dhe kulturore (gjuha, feja, etnia), si dhe në traditën e gjatë të qëndrueshme të një sistemi demokratik dhe administrativ nëpërmjet qeverisjes lokale me kryepelqet.

**Polet-** Në kuadër të këtij rrjeti koherent janë krijuar nyjet me rol të veçantë, nga pikpamja (ekonomike, politike, kulturore) të cilat krijojnë nën-grupime të reja vendbanimesh dhe shoqëruar me një gamë të gjerë panvaresie trans-lokale. Qyteti i Himarës historikisht ka dominimin e tij në të gjithë territorin, si qendër administrative me e madhe, ekonomike dhe shërbimesh (përfshirë shërbimet në arsim dhe shëndetësi). Himara e vjetër qëndron si pikë referimi simbol për pjesën kulturore dhe fetare për të gjithë zonën. Dhermi dhe Qeparo kanë qenë polet e pushtetit ekonomik dhe kulturor, duke mbajtur lidhje të forta me Himarën. Nga ana tjetër, shpesh Vuno ka ruajtur identitetin e vet të veçantë. Siç mund të vërehet, ndryshimet demografike dhe ristrukturimi i ekonomisë gjatë dy dekadave të fundit kanë rikonfiguruar pushtetin e pavarur lokal dhe marrëdhëniet midis vendbanimeve të ndryshme në zone.

**Organizimi i dyfishtë hapësinor** - Organizimi hapësinor i vendbanimeve në Bashkinë e Himarës ndjek një linjë të dyfishtë: nga njëra anë zhvillimi linear i bazuar në rrugën kombëtare, si një aks ndares i zonës bregdetare me atë kodrinore-malore, në anën tjetër organizimi i integruar i njësive -mjedisore hapësinore.

### ➤ **Organizimi Linear hapësinor: zonat bregdetare dhe malore.**

Vendbanimet janë zhvilluar historikisht përgjatë rrugës kryesore, që lidh Vloren me Sarandën. Rruga Nacionale kalon drejtë për drejtë në shumicën e vendbanimeve të zonës, (Himara, e Vjetër Himara, Dhermi, Vuno, Ilias, Palasa dhe Qeparo i Ri), ndërsa vetëm në tre vendbanime të konsideruara si me malore (Qeparo i Vjetër, Pilur dhe Kudhes) kanë një distancë prej saj. Rruga integrohet lehtësisht me gjeomorfologjinë dhe në pjesën e saj më të madhe ndan zonën bregdetare dhe bujqësore nga zonat kodrinore dhe malore. Duke zbritur poshtë nga Llogaraja, rruga kalon diagonalisht Palasan, Gjileken dhe Dhërmiun, duke e ndarë zonën bujqësore në përfundim nga zona malore në lindje. Ajo largohet nga zona bregdetare, kur kalon pranë Ilias dhe pranë Vunoit, duke lënë kështu një zonë të zgjeruar bujqësore në përfundim dhe duke iu afëruar Himarës së vjetër dhe ardhur më afër bregdetit, dhe tokës bujqësore në Livadh. Në Himarë rruga arrin

ne bregdet duke e lënë zonën bujqësore prapa dhe pastaj vijon ne jug ne bregdet (duke iu shmangur gadishullit).


Ky aks shërben si një shtyllë për zhvillim duke ofruar ose lidhje te drejtpërdrejta mes vendbanimeve kodrinore ose lidhje të tërthorta me vendbanimet malore në lindje dhe me plazhet e zonës bregdetare në perëndim. Pas rritjes së shpejtë të përdorimit te makinave private pas 1990 dhe rehabilitimit te rrugës nacionale në vitin 2008, aspektet lineare të zhvillimit hapësinor janë forcuar në mënyrë të konsiderueshme. Për më tepër, kalimi nga ekonomia bujqesore malore drejt bregdetit, ekonomia e turizmit kane krijuar gjatë viteve të fundit tendencat e zhvillimit intensiv në zonën bregdetare, ose në zgjerimin e vendbanimeve ekzistuese ose në urbanizimin e zonave te reja në ish tokën bujqësore-

#### ➤ **Organizimi në Njësi Hapësinore**

Në një nivel të dytë të analizës, Bashkia Himarë mund të kuptohet si e përbërë nga një seri njësisish të integruara hapësinore dhe mjedisore. Këto njësi i referohen strukturës hapësinore te vendbanimeve vleresuar nga pikpamja e evolucionit të tyre historik, gjeomorfologjise dhe elementeve të veçantë të mjedisit të zonës, si dhe për të paraqitur aktivitetet e tyre aktuale ekonomik dhe modeleve te pronësisë. Çdo njësi përmban një grup të vendbanimeve urbane apo rurale që janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin, si me plazhet, aktivitetet e tyre prodhuese, tokën dhe produkte e saj. Bazuar ne keta tregues, formulohen katër njësi hapësinore:

1. **Palasa | Gjilek | Dhermi**
2. **Ilias | Vuno | Jal**
3. **Himara e Vjeter | Himara | Pilur**
4. **Kudhes | Qeparo i Vjeter | Qeparo i Ri**





**LEGJENDA**

- Rrjetit Rrugor**
- ● ● ● ● KULTI BASHKAKE
  - RRUJESH KOMBODNALE
  - RRUJESH KYBESHORE
  - RRUJESH DVYESHORE
  - RRUJESH TERCORE
  - RRUJESH URBAHE KYBESHORE
  - RRUJESH URBAHE DVYESHORE
  - RRUJESH URBAHE TERCORE
  - SITEK

- Infrastruktura Urbane**
- W DRAMBUULLI ME MBETJEVE
  - Q GJUROR
  - R STACIONI I TRANSFERIMIT E VETËDIJES E PLANIFIKIM
  - V VAREZAT

- Përdorimi i Tokës**
- TOKA BULGESHORE
  - ZONA ME TE NDERTUAR
  - ZONA TE URBAZUJARE
  - ZONA SPORTIVE
  - VAREZAT
  - ZONAT ME PËRCORIMAT ME EFENTE TE LARTË BUDOJORE

- Elementet e Peizazhit**
- LUGRAT ME VLERA TE MERA
  - KRESHTE KOCËR KARAKTERISTIKE

9.a

Analiza e përdorimit ekzistues të tokës


Shkalla 1:10.000

Zonen e Dhermi me te gjere

STUDIM PROJEKTIM I ZONES SE HIMARES ME PËRPARESI ZHVILLIMIN E TURIZMIT



THYMBIO PAPAIOANNIS AND ASSOCIATES, INC.  
LANDSCAPE PLANNING AND DESIGN



**LEGJENDA**

- RREZETE BASHKAKE
- Rrjetit Rrugor
- RRUGA NACIONAL
- RRUGA KRYESORE
- RRUGE DYTESORE
- RRUGE TERCIARE
- RRUGE URBANE KRYESORE
- RRUGE URBANE DYTESORE
- DREZG

- Infrastruktura Urbane**
- W URINJALUM-TE-MBETJEVE
  - Q QILORRE
  - R STACIONI I TRANSPERAN E MBETJEVE E PUNEMIRUM
  - V VARRIZAT

- Perdorimi i Tokes**
- FORA RIJDESORE
  - ZONJES TE NDERTUAR
  - ZONE TE URBANIZUAR
  - ZONA SPORTIVE
  - VARRIZAT
  - ZONAT ME PERDORIMT ME EFENTE TE LARTE MUESOR

- Elementet e Peizazhit**
- LUGRAT ME VLERE TE MESH
  - KREZITE KOCER KARAKTERISTIKE

9.b

Analiza e përdorimit  
ekzistues të tokës

Shkalla  
1:10.000

Zonen e Vuno me te gjere

STUDIM PROJEKTIM I ZONES SE HIMARES ME PERPARES ZHVILLIMIN E TURIZMIT



THYLIO PAFAYANNIS AND ASSOCIATES INC.  
spacial planning and design





**LEGJENDA**

- KUFITE BASHKISE
- RREJETIT RRUGOR
- BRIGA NACIONALE
- BRIGJE KRYEQISORE
- BRIGJE DYTESORE
- BRIGJE TERCISORE
- BRIGJE URBAINE KRYEQISORE
- BRIGJE URBAINE DYTESORE
- SITEG

**Infrastruktura Urbane**

- W QILIMBALLIM TE MBETLAVJE
- Q DUKORE
- R STACIONI I TRANSFERIMIT E MBEETLAVJE E PLANIFIKIM
- PORT
- V VARRIZAT
- MPAKET I PERPASHKATIT TE QERAVJE TE NOCTUR

**Perdorimi i Tokes**

- TOKA BULLGUESORE
- ZONJE TE NDERTIMAR
- ZONE TE URBAIZUAR
- ZONA SPORTIVE
- ZONJE ME PERDORIMAT ME EFekte TE ULTE - E MESAJE MJEJSDOR
- VARRIZAT
- ZONJE ME PERDORIMAT ME EFekte TE LARTJE MJEJSDOR

**Elementet e Peizazhit**

- LUGRAT ME ULTRA TE MESAJE
- HRESHTE KODER KARAKTERISTIKE

9.c

Analiza e përdorimit ekzistues të tokës

Shkalla 1:10.000


Zonen e Himara me te gjere

STUDIM PROJEKTIM I ZONES SE HIMARES ME PEPARESI ZHVILLIMIN E TURIZMIT



THYBIO PAPAAYANNIS AND ASSOCIATES, INC.  
PLANNING CONSULTING AND DESIGN





**LEGJENDA**

- KUFËT E BASHKISË
- RREJELIT RRUJTOR
- BRUGA NACIONALE
- BRUGA KRYESORE
- BRUGA DYTËSORE
- BRUGA TERCIARE
- BRUGA URBANE KRYESORE
- BRUGA URBANE DYTËSORE
- SITEG

**Infrastruktura Urbane**

- W QILIMBULLIM TË MBETLAVË
- Q DUKORË
- R STACIONI I TRANSFORMIMIT E NIVELEVE E PLANIFIKIMIT
- PORT PORT
- V VARRËZAT
- IMPANAT I PËRPOHIMIT TË GJERAVE TË NUCITUR

**Përdorimi i Tokës**

- TOKA BULLGËSORE
- ZONJE TË NDERTUES
- ZONJE TË URBANIZUAR
- ZONJE SPORTIVE
- ZONJE TË PËRDORIMIT ME EFEKTE TË UJËT - E MËNJË MËJEDISOR
- VARRËZAT
- ZONJE TË PËRDORIMIT ME EFEKTE TË UJËT MËJEDISOR

**Elementet e Peizazhit**

- LUGRAT ME VLERË TË MËDHA
- HRESHTË KODER KARRAKTERISTIKE

9.d

Analiza e përdorimit  
ekzistues të tokës

Shkalla  
1:10.000

Zonen e Qeparo me te gjere

STUDIM PROJEKTIM I ZONES SE HIMARES ME PËRPARËSI ZHVILLIMIT E TURIZMIT



THYBIO PAPANANNIS AND ASSOCIATES, INC.  
ARCHITECTS PLANNERS ENGINEERS



#### IV | 4. TRASHEGIMIA KULTURORE

Bashkia e Himares eshte e karakterizuar nga nje trashegimi e pasur kulturore e vecante me nje histori te gjere te qendrushme duke kaluar neper periudha prehistorike, Ilire, Helene, Romake, Bizantine dhe Otomane. Kjo trashegimi kulturore perben nje nga pasurite e medha te zones qe tregon historine identitetin e madhe te trashegimise kulturore lokale e cila sherben jo vetem si nje terheqje per turizmin por edhe si nje tradite e gjalle dhe nje pjese integrale e jetes se perditshme.

**Zonat Arkeologjike-** zonat Arkeologjike jane te shumta dhe te shtrira kudo ne Bashki. Me e rendesishme eshte Shpella e Spiles e cila ka qene e banuar qe nga kohet parahistorike. Me shume se 1000 objekte jane gjetur ne germimet arkeologjike por, ndertimet informale te ndertuara gjate viteve 1990 rreth shpelles i kane shkaterruar. Vende te tjera arkeologjike jane si: Keshtjella parahistorike (Katafiqi) ne Ilias, porti i antikitetit ne Porto Palermo dhe shpella karsitikeme stalactite dhe stalagmite ne Dhermi.

- **Ruajtja e statusit-** Shpella e Spiles ka nje kufi mbrojtjeje te percaktuar nga VKM
- **Probleme-** Qendrat arkeologjike jane shpesh te pa promovuara.



**Figura 14:** Vendbanimet Tradicionale

|   | 4.4 Zhvillimi i formave te reja te bashkepunimit dhe rritja e kapitaleve institucionale                         |

| QELLIMI  | OBJEKTIVAT   | PROGRAMET  |
|--|--|--|
| <p><b>Qellimi 1</b><br/>Krijimi i Himarës si një destinacion turistik cilësor në Bregdetin Jugor që ofron standarde të larta të akomodimit dhe shërbimeve të një ekonomie të tipit turistik.</p> | <p>1.1. Pozicionimi i zonës në tregun kombëtar si një destinacion i një turizmi cilësor, me variacione të ndryshme</p> | <p>1.1.1: <b>Originaliteti:</b> Zhvillon një originalitet të qartë lokal në mënyrë që të diferencojë identitetin e zonës si një destinacion turistik bazuar në vizionin e propozuar.</p>   |
|  |  | <p>1.1.2: <b>Plan Tregtar:</b> formulone një plan tregtar gjithë përfshirës për Bashkinë.</p>  |
|  |  | <p>1.1.3: <b>Projektet kryesore:</b> identifikon projekte pilot për dhjetë vitet e ardhshme që do të ndikojnë në të gjithë zonën dhe që do të mobilizojnë turizmin (siç është zhvillimi i zonës së kalasë së Ali Pashës në Porto Palermo në një atraksion kulturore).</p>  |
|  |  | <p>1.1.4: <b>Imazhi dhe identiteti:</b> vlerëson legjendat dhe tregimet për zonat që evidencojnë identitetin e tij (p.sh. shpella e Polyphemus në Himarë, historinë e Ali Pashës në Qeparo dhe Porto Palermo, simbolet e vjetra të Poseidonit të bërë nga detaret në shkëmbinjtë e Grammatës, shprehjet e emigrantëve në Vuno etj).</p>        |
|  |  | <p>1.1.5: <b>Ngjarjet:</b> promovon festat tradicionale dhe prezantimet e festa të reja që do të shërbejnë si aktivitete promovionale (p.sh. eskursionet e organizuara ose jo, si dhe shetitjet me barka) ku turistët mund të njohin kulturën dhe natyrën lokale – dhe me vone ofrimin e arkitekturës dhe ushqimit tradicional vendas etj.</p> |
|  |  | <p>1.1.6: <b>Rregullat e Cilesisë:</b> vendosjen e parametrave të cilësive, si një “marreveshje e qëndrueshme” ku të gjithë aktorët (biznesi pushteti vendore, qeveria) bienin dakort në 'rregullin' për ruajtjen e natyrës dhe shoqërisë, p.sh. gatimin lokal, arkitekturën lokale, sistemin e grumbullimit të mbetjeve, etj.</p>             |
|  |  | <p>1.1.7: <b>Rrjeti turistik:</b> krijimin dhe promovimin e një rrjeti me zona të tjera turistike të Shqipërisë për të krijuar një produkt të kombinuar turistik që evidencojnë eksperiencën unike Shqiptare.</p>  |
|  |  | <p>1.1.8: <b>Aktivitetet Promovionale:</b> Organizimin e aktiviteteve promovionale në Tiranë, Athinë dhe Selanik për të prezantuar cilësitë e zonës mundësite për investime në turizëm në zonën e Himarës.</p>   |
|  | <p>1.2 Terheq dhe lehtëson investimet në zhvillimin e turizmit</p>   | <p>1.2.1: <b>Zonat prioritare:</b> identifikimin e zonave prioritare për zhvillimin e turizmit në zonën bregdetare në mënyrë që të terheqë dhe orientojë investimet e huaja.</p>   |
|  |  | <p>1.2.2: <b>Projektet baze:</b> identifikon projektet baze për investime të mëdha (siç është zhvillimi i një resorti të madh në Porto Palermo)</p>  |
| <p>1.2.3: <b>Nxitja e agroturizmit:</b> sigurimin e stimuljeve për drejtimin e investimeve dhe të ardhurave nga emigrantët në agroturizëm dhe aktivitete të përafërta.</p>                       |  |  |
| <p>1.2.4: <b>Nxitja e rehabilitimeve:</b> sigurimin e stimuljeve për investime në restaurimin e</p>  |  |  |

|   |  |  |
|---|--|--|
|   |  | <p>ndertesave tradicionale, shtepive te fshatit dhe zonat ekzistuese per kthimin e emigranteve dhe te Europianeve te interesuar per shtepi te dyte/shtepi pushimi.</p> <p>1.2.5: <b>Pronesia:</b> zgjidhjen e problemeve te pronesise per te thjeshtuar burokracine per bleres potencial dhe investitoreve ne sektorin turistik.</p> |
| 1.3 Zhvillimi, organizimi dhe promovimi i sektorit te turizmit dhe rritja e sherbimeve cilesore | 1.3.1: <b>Formalizimi</b> : formalizimin e turizmit nepermjet rregjistrimit te biznesit dhe permiresimin e grumbullimit te taksave.  |  |
|   | 1.3.2: <b>Standartizimi:</b> pregatitjen dhe ndjekjen e klasifikimit te turizmit privat, sipas kriterave te cilesise dhe sherbimit te akomodimit qe ofrohet per turistet..   |  |
|   | 1.3.3: <b>Statistikat turistike:</b> zhvillon nje sistem te grumbullimit te te dhenave , rinovon ate, monitoron dhe vlereson, si nje element te zhvillimit te turizmit.  |  |
|   | 1.3.4: <b>Integrimi i sherbimeve turistike:</b> krijimin e nje rrjeti te turizmit te biznesit turistik lokal (hotelesh, vlerash, sherbimi transporti, sherbimesh si guidat, restorantet dhe pajisjesh, etj.)   |  |
|   | 1.3.5: <b>Sisteme te informimit turistik:</b> krijimin e nje sistemi te dhenies se informacionit dhe orjentimi per vizitoret, per akomodimin, aktivitetet etj, me qender ne Himare dhe nen qendra ne zona te tjera.  |  |
| 1.4 Permiresimin e infrastruktures turistike  | 1.4.1: <b>Sistemin e sinjalistikes:</b> instalimin e nje sistemi te pershtateshem per vizitoret qe sigurone guida dhe informacion ne sherbime te ndryshme, vendbanimet dhe vendet me interes te vecante.   |  |
|   | 1.4.2: <b>Aksesueshmeria/Arritja:</b> permireson aksesueshmerine e te gjitha zones , nepermjet riparimit te rrugeve, pastrimin e rrugicave dhe krijimin e rrugeve per bicikleta.   |  |
|   | 1.4.3: <b>Lehtesirave portuale:</b> zgjerimin e lehtesirave ekzistueses ne portin e Himares per mjete detare te perkohshme dhe anije te tjera dhe saktesimin e vendit per zhvillime te metejshme per nje marine te plote ne Porto Palermo.   |  |
|   | 1.4.4: <b>Lidhjet detare:</b> krijon mundesira per lidhje midis plazheve te zones (ndermjet tyre dhe sidomos me ato te izoluara) nepermjet nje rrjeti te mjeteve te vogla /anijeve te vogla me qender ne Himare dhe Dhermi per transportin e turisteve, popullesise lokale si dhe te produkteve te ndryshme. |  |
|   | 1.4.5: <b>Teknologjite e informimit:</b> investon ne infrastrukturen e IT dhe rrjetit social online si nje mjet per promovimin nderkombetar per zhvillimin e turizmit, me synim popullesine e re ne moshe.   |  |
|   | 1.4.6: <b>Energjia dhe telekomunikacioni:</b> sigurimin e furnizimit me energji, telefon dhe sherbim te internetit ne kohe per projektet te ardhshme te zhvillimit turistik.   |  |



|  |  |   |
|--|--|---|
|  |  | <p>1.4.7: <b>Zhvillimin e plazheve:</b> zhvillon zonat e banuara prane plazheve si shetitore publike (per gjate plantacioneve, oboret etj) per aktivitete shplodhese ne ajer te paster.</p>   |
|  |  | <p>1.4.8: <b>Siguria rrugore:</b> permireson sigurine rrugore nepermjet sigurimit te pajisjeve te nevojshme (p.sh. pasqyra, barrierave, vendkalimeve etj), me zhvillimin e trotuareve te pershtateshme dhe te rrugeve shetitore per njerezit.</p> |
|  |  | <p>1.4.9: <b>Rrjeti i vend kalimeve:</b> ngritjen e nje rrjeti te vendkalimeve dhe rrugicave qe se bashku te krijojne zona banimi terheqese duke perfshire plazhet, kanionet, monumentet dhe vendet arkeologjike.</p>                             |

|   |  |   |
|---|--|---|
| <p><b>QELLIMI 2</b><br/>Himara me nje ekosistem te mirembajtuar, qe synon mbrojtjen e saj , ku aktiviteti njerezor dhe ai i vizitoreve shikohen ne kontekstin e mbrojtjes mjedisore.</p>    | <p>2.1 Promovimi dhe mbrojtja e trashegimise kulturore</p>               | <p>2.1.1: <b>Monumentet kulturore:</b> mbrojtja , rehabilitimi dhe promovimi i monumenteve te kultures, kishave, manastireve, zonave arkeologjike dhe kalave sipas standarteve bashkohore Europiane dhe ligjeve vendore per mbrojtjen e trashegimise kulturore.</p>   |
|   |  | <p>2.1.2: <b>Rruajtja e kufijve:</b> identifikimi dhe pershkrimi I kufijve per nje strukture urbane kompakte te vendbanimeve tradicionale per evidentimin e vlerave te vecanta dhe per zonat me pamje te vecanta si dhe prezantimin e rregullores per mbrojtjen e tyre.</p>   |
|   |  | <p>2.1.3: <b>Programet rehabilituese:</b> promovimin e programeve rehabilituese te vecanta me prioritete duke ndjekur rastin e “Kalas se Himares” nepermjet sigurimit te ndricimit, rrjetin e sherbimeve dhe permiresimin e infrastruktures.</p>  |
|   |  | <p>2.1.4: <b>Hapesirat publike:</b> rehabiliton dhe permireson rrugicat me kalldrem guri dhe siguron e zgjeron hapesirat publike/sheshet te vendbanimeve tradicionale.</p>  |
|   |  | <p>2.1.5: <b>Kultura:</b> zhvillon nje atraksion kulturor te vecante ne cdo vendbanim ne menyre qe te terheqe vizitoret dhe ti beje te qendrojne sa me gjate. Ky atraksion mund te lidhe Himaren e Vjeter me identitetin e gjithe zones si nje kufi historik, Vunoi me emigracionin gjate shekullit te 20 dhe Qeparone me historine e Ali Pashes.</p> |
|   | <p>2.2. Mbrojtja e pejsazhit natyror dhe vlerave panoramike te zones</p> | <p>2.2.1: <b>Vija bregdetare:</b> percaktimin e nje kufiri te qarte te ndertimeve ne plazhe dhe zbatimine rregullave strikte per te parandaluar ndertimet e demshme ne vijen bregdetare.</p>  |
|   |  | <p>2.2.2: <b>Ndertimet Informale:</b> minimizimin e ndertimeve informale qe konsumojne natyren, pejsazhin dhe integrimin e situates ekzistuese ne strukturen urbane.</p>  |
|   |  | <p>2.2.3: <b>Zhvillimi linear :</b> kontrolli i zhvillimit linear pergjate rruges kombetare (sidomos ndermjet Himares se Vjeter, Himares se Re dhe Dhermise) ne menyre qe te parandalohen crregullesit.</p>   |
|   |  | <p>2.2.4: <b>Cilesia pamore:</b> mbrojtjen e pejsazheve, kreshtave nga ndertimet si nje entitet mjedisore, si dhe si nje zone shume e dukeshme nga rrethinat e tij.</p>   |
|   |  | <p>2.2.5: <b>Perrenjte dhe lumenjte:</b> njohjen e rreziqeve te ndotjes se perrenje dhe lumenjve si nje kompleks natyrore per te parandaluar shfrytezimin e pa kontrolluar te materialeve inerte nga shtrati I lumit.</p>   |
| <p>2.2.6: <b>Rezervimi:</b> ruan zonat e nje karakteri rural si zona reserve per zhvillimet e me voneshme ne kontekstin e nje zhvillimi te qendrueshem dhe ruajtjes se biodiversitetit.</p> |  |   |
| <p>2.2.7: <b>Korridoret mjedisore:</b> per zhvillimin e korridoreve mjedisore lejon lidhjet vertikale te zonave malore me ate bregdetare dhe lejon funksionimin mjedisor.</p>               |  |   |
| <p>2.2.8: <b>Toka bujqesore:</b> mbron token bujqesore (ullinjte dhe pemetarine) dhe tarracat e pjerreta si toka produktive dhe si karakteristika natyrore dhe pejsazhe kulturore.</p>      |  |   |
| <p>2.2.9: <b>Aktivitet ndotese:</b> percakton token per aktivite ndotese te organizuara dhe te ndara nga tokat</p>  |  |   |

|   |  |  |
|---|--|--|
|   |  | <p>bujqesore, perrenjte dhe lumenjte.</p> <p>2.2.10: <b>Karrierat/gurroret:</b> Heqjen e karrierve ne vendet e papershtateshme (ne afersi te vendbanimeve karakteristike, vlerave mjedisore, perrenjve dhe lumenjte) dhe rehabiliton zonat ekzistuese. Percakton vende te pershtateshme dhe kushtet per shfrytezim.</p> <p>2.2.11: <b>Ndertimi i rrugeve:</b> prezanton dhe zbaton kriteret per ndertimin e rrugeve dhe rehabilitimin e seksioneve te rrugeve ekzistuese qe krijojne probleme te demtimeve natyrore.</p>   |
| 2.3 Himara si nje Bashki e paster dhe e shendeteshme                    |  | <p>2.3.1: <b>Plani i menaxhimit te mbetjeve</b> : zhvillon nje plan te menaxhimit te mbetjeve te ngurta urbane grumbullimin dhe perpunimin e tyre.</p> <p>2.3.2: <b>Vendgrumbullimi/Landfilli:</b> vendos nje vend te perkohshem per grumbullimn dhe ricklimin e mbetjeve.</p> <p>2.3.3: <b>Vendete inerteve:</b> planifikimin dhe vendosjen e pajisjeve te mbetjeve ndertimore. Kjo eshte mjaft e rendesishme per projektet e zhvillimit te sektorit te turizmit.</p> <p>2.3.4: <b>Shpellat/Grykat dhe plazhet:</b> promovimin e nje plan veprimi bashkiak per pastrimin e shpellave, kanioneve dhe plazheve me pjesemarrjen e shoqerise civile.</p>  |
| 2.4 Zhvillimi i infrastruktures publike dhe menaxhimit e burimeve ujore |  | <p>2.4.1: <b>Furnizimi me Uje:</b> kombinimin e studimeve dhe projekteve parciale ne nje sistem te integruar qe mbulon te gjithe territorin e Bashkise.</p> <p>2.4.1: <b>Trajtimi i ujerave te ndotur:</b> kompletimin e sistemit te kanalizimeve per te mbuluar te gjithe territorin e Bashkise.</p> <p>2.4.2: <b>Trajtimi ekzistues:</b> rehabilitimi dhe zgjerimi i sherbimit te largimit te ujerave te ndotura ne Himare nepermjet shtrirjes se rrjetit grumbullues te ketyre ujerave dhe sigurimin e kapaciteteve te mjaftueshme perpunuese nepermjet trajtimit mekanik dhe atij biologjik.</p> <p>2.4.3: <b>Ujerat e ndotur ne lagje:</b> sigurimin e pajisjeve perpunuese te ujerave te ndotura te ndara per cdo zone ose trajtimi i kombinuar i tyre per zona te aferta.</p> <p>2.4.4: <b>Rruajtja e cilesise se ujerave detare:</b> eliminon derdhjen ne det te ujerave te ndotura ose nepermjet impianteve kompakte te parafabikuara ne zonen bregdetare ose nepermjet lidhjes se rrjetit ne kolektorin kryesor te Bashkise.</p> <p>2.4.5: <b>Ujerat nen tokesore:</b> krijon nje sistem monitorimi per te parandaluar ndotjen e ujerave nentokesore qe mund te shkaktohet nga grumbullimi i pa kontrolluar i mbeturinave, mbetjeve blegtorave apo ato te perpunimit te produkteve agro-ushqimore.</p> <p>2.4.6: <b>Riperdorimi i ujerave te ndotur:</b> investigimi per perdorimin e ujerave te ndotur pas trajtimit per nevojat e ujitjes ne bujqesi, si nje forme per te rritur sasine e ujit te paster per nevoja publike.</p> |
| 2.5 Kultivimi i   |  | <p>2.5.1: <b>Promocionet mjedisore:</b> krijon nje program promocial bashkiak qe i referohet komunitetit lokal dhe</p>   |

|  |                    |  |
|--|--------------------|--|
|  | kultures mjedisore | <p>vizitoreve, vecanerisht per te rinjte.</p> <p>2.5.2: <b>Veprimet per informimin publik:</b> realizon veprime per informimin publik per mbrojtjen e natyres dhe trashegimise kulturore.</p> <p>2.5.3: <b>Kriteret mjedisore per biznes:</b> realizon kriteret mjedisore per te asistuar biznesin lokal turistik per te menaxhuar vlerat e tyre.</p> <p>2.5.4: <b>Veprimet vullnetare:</b> promovon veprime vullnetare per pastrimin e plazheve, kanioneve dhe ripyllezimin e kodrave perballe.</p> |
|--|--------------------|--|

|  |  |  |
|--|--|--|
| <p><b>QELLIMI 3</b><br/>Himara e ardhshme si nje komunitet ne lulezim ku turizmi harmonizohet mire me te gjitha aspektet e ekonomise lokale dhe sherben si nje katalizator i rendesishem i saj per tu shtrire pergjate gjithë vitit.</p> | <p>3.1 Permiresimi i cilesise se jetes dhe standarteve per komunitetin lokal</p>   | <p>3.1.1 <b>Qender sherbimesh:</b> forcimi i rolit te Himares (Spilese) si qender aktivitetesh dhe sherbimesh, si dhe zhvillimin e nje qendre te dyte ne Dhermi.</p>   |
|  |  | <p>3.1.2 <b>Hapesirat publike:</b> sigurimin e hapësirave publike dhe te gjelbera ne zgjerimet dhe zonat e reja te ndertimit.</p>  |
|  |  | <p>3.1.3 <b>Rrjeti rrugor:</b> zhvillon rrjetin rrugor sekondar, ne vecanti ne zgjerime dhe zona te reja ndertimore, duke perfunduar pastrimin e rrugeve te perfunduara dhe rritjen e aksesueshmerise.</p>   |
|  |  | <p>3.1.4 <b>Transporti publik:</b> riorganizimin e transportit publik ne menyre qe te mbuloje te gjithë territorin e Bashkise.</p>   |
|  |  | <p>3.1.5: <b>Qendrat komunitare-kulturore:</b> ofron per qendrat kulturore dhe ato komunitare ne vendbanime, riperdorimin e ndertimeve ekzistuese.</p>   |
|  | <p>3.2 Rivitalizimi i ekonomise se vendbanimeve malore</p>   | <p>3.1.5 <b>Infrastruktura Sociale:</b> shtrirjen e Qendres Shendetesore te Himares (duke ndjekur studimet ekzistuese ) dhe ndertimin e nje ambulance te re ne Jal per sezonin verore. Mbulimin e e projekteve per arsimin nepermjet rehabilitimit te ish sherbimeve arsimore.</p> |
|  |  | <p>3.2.1: <b>Stimujt:</b> perdorimin e stimujve per restaurimin e ndertimeve tradicionale dhe transformimin ne hotele te vegjel fjetjeje dhe mengjes/<i>bed and breakfast</i> .</p>  |
|  |  | <p>3.2.2: <b>Ndertimi:</b> mbeshtetjen e ndertuesve tradicionale dhe punonjesve lokal specializuar ne menyren tradicionale te ndertimit (mure-guri, strukturave prej druri, kalldreteve prej guri, etj.)</p>   |
|  |  | <p>3.2.3: <b>Sherbimet:</b> zhvillimin e aktiviteteve ekonomike plotesuese per te plotesuar nevojat e turistevene bare, restorante, dyqane te vogla, etj.</p>  |
|  |  | <p>3.2.4: <b>Aktivite sportive:</b> prezantimin e paketave udhezuese ne lidhje me turnete, eskursionet, perdorimin e bicikletave, ngjitjeve, perdorimin e kuajve etj.</p>  |
| <p>3.2.5: <b>Qendrat e vizitoreve:</b> krijimin e qendrave te vizitoreve referuar produkteve lokale dhe vlerave kulturore te vendbanimit.</p>  |  |  |
| <p>3.3 Zhvillimi dhe zgjerimi i tradites fermere dhe zhvillimi i</p>   | <p>3.2.6: <b>Atraksioni kulturor:</b> të zhvillojë një tërheqje të veçantë kulturore per çdo vendbanim, me qëllim për tërheqjen e vizitorëve dhe për të inkurajuar ata që të qëndrojnë më gjatë. Këto atraksione të mund të lidhin Himarën e Vjetër me identitetin e të gjithë zonën, si një kufi historik, Vunoin per emigracionin në shkalle të gjere gjate shekullit te 20-të dhe Qeparone me historine per Ali Pashën.</p> |  |
|  | <p>3.3.1: <b>Lenda e pare:</b> krijimin e lendeve te para te nje cilesie te larte dhe inkurajimin e kultivimin e produkteve bio (p.sh. produkteve organike, bimeve autentike me cilesi</p>   |  |

|  |   |  |
|--|---|--|
|  | elementeve te agroturizmit                                | <p>aromatike apo mjekesore, frutave te vogla, dritherave organike dhe bishtajave, etj).</p> <p>3.3.2: <b>Stimujt:</b> dhenien e stimujve per planifikimin dhe implementimin e projekteve lokale psh. Terheqja e sipermarrjeve nga jashte, sidomos emigranteve te cilet mund te investojne ne nje sipermarrje te re edhe pse ata nuk jane zhvendosur.</p> <p>3.3.3: <b>Trajnimi dhe marrja e dijeve:</b> realizimi i trajnimeve dhe shkembimit te eksperiencave per sipermarresit lokal dhe fermeret ne funksion te kushteve lokale dhe rrethanave.</p> <p>3.3.4: <b>Agroturizmi:</b> promovon zhvillimin e njesive agroturistike, kryesisht nepermjet riperdorimit te ndertesave ekzistuese ku vizitoret do te perjetojne nje eksperience lokale si dhe aktivitet e perditeshme bujqesore.</p> |
|  | 3.4 Standartizimit te tyre dhe krijimit te markave lokale | <p>3.4.1: <b>Perpunimi ushqimor:</b> rritja e vlerave nepermjet prodhimit te ushqimeve me cilesi te larte dhe zhvillimi i ushqimeve te thjeshta lokale ne harmoni me tiparet mjedisore te rajonit.</p> <p>3.4.2: <b>Njesi te reja agro-ushqimore:</b> sigurimin e tokes per njesi/produkte te reja agro-ushqimore.</p> <p>3.4.3: <b>Origjinaliteti:</b> zbatimi i nje strategjie marketingu origjinale per promovimin e produkteve lokale te Himares me emrin e origjines.</p> <p>3.4.4: <b>Certifikimi:</b> produkte direkt agro-ushqimore orjentuar per certifikim si produkte me cilesi te larte dhe krijimin e nje sistemi te certifikimit cilesor per produktet lokale.</p>   |

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p><b>QELLIMI 4</b><br/>Rritja e kapaciteteve te qeverisjes lokale ne menaxhimin e zhvillimit te turizmit nepermjet rritjes se kapaciteve lokale dhe nxitjes se iniciatives private ne kete fushe si dhe rritjes se bashkepunimit vertikal dhe horizontal te te gjithë aktoreve ne zone.</p> | <p>4.1 Permirosimi i kapacitetit administrativ</p>   | <p>4.1.1: <b>Zyra e turizmit:</b> riorganizon zyren e turizmit ne Bashki, qe siguron pergjegjshmeri ne dhenien e sherbimit, grumbullimin e materialit turistik dhe monitorimin e tij.</p>   |
|  |  | <p>4.1.2: <b>Trajnimi i stafit bashkiak:</b> angazhimin e stafit bashkiak ne seminare trajnuese dhe shkembimet e eksperiencave si dhe ne shkembimin e programeve per te arritur praktika sa me te mira nga eksperiencat Greke apo Italiane.</p>   |
|  |  | <p>4.1.3: <b>Menaxhimi ne destinacion:</b> siguron iniciativa gjithepershiresë per formen e zhvillimit dhe te funksionimit ditor te aktivitetëve turistike nepermjet nje bordi turistik lokal.</p>  |
|  | <p>4.2 Terheqja e fondeve dhe permirosimi i menaxhimit financiar</p>                           | <p>4.2.1: <b>Nivel kombetar:</b> Lobon me qeverine qendrore per terheqjen e fondeve dhe projekteve infrastrukturore.</p>  |
|  |  | <p>4.2.2: <b>Programet e BE:</b> zhvillon programe lokale per zhvillimin e turizmit me mbeshtetjen e fondeve nga programet e BE.</p>  |
|  |  | <p>4.2.3: <b>Donoret:</b> zhvillon nje infrastructure te integruar dhe programe te zhvillimit te turizmit duke synuar ne fonde mbeshtetese nga donator dhe institucione nderkombetare sic jane Banka Boterore dhe qeverite e huaja (p.sh. qeveria Greke).</p>   |
|  |  | <p>4.2.4: <b>Diaspora Himariote:</b> zhvillon programe per mbeshtetje financiare nga Himariotet me mundesi financimi qe jetojne jashte vendit te cilet deshirojne te investojne ne vendin e tyre te origjines.</p>  |
|  |  | <p>4.2.5: <b>Menaxhimi i financave bashkiake:</b> riorganizimi dhe permirosimi i mbledhjes se taksave bashkiake dhe permirosimi i menaxhimit te buxhetit bashkiak.</p>  |
|  | <p>4.3 Promovimi i trajnimeve te ndryshme, mesimi dhe shkembimi i eksperiencave</p>            | <p>4.3.1: <b>Qender per trajnimin profesional:</b> ngreh nje qender per trajnime profesionale ne fushen e turizmit dhe te mirepritjes, mundesisht i vendosur ne kalane e Himares qe do te ndihmonte ne rritjen e standarteve te sektorit turistik ne nje periudhe afat mesme.</p>   |
|  |  | <p>4.3.2: <b>Trajnimi i sipermarresve:</b> organizon trajnime ne shkembimin e njohurive, menaxhimin e biznesit dhe marketingun per sipermarresit lokal.</p>   |
|  |  | <p>4.3.3: <b>Gjuha e huaj dhe IT:</b> realizon seminare per gjuhet e huaja dhe trajnime IT .</p>  |
|  |  | <p>4.3.4: <b>Trajnim per mirepritjen:</b> realizon seminare ne mirepritjen e thjeshte per trajnuesit ne hotelet lokale.</p>   |
|  | <p>4.4 Zhvillimi i formave te reja te bashkepunimit dhe rritja e kapitaleve institucionale</p> | <p>4.4.1: <b>Qeveria qendrore:</b> Vendos bashkepunim sistematik me qeverine qendrore ne menyre qe te rakordoje me mire per strategjine e zhvillimit te turizmit me Ministrine e Turizmit dhe Agjensine per Planifikimin e Territorit per promovimin e zhvillimit te infrastruktureve dhe investimeve shteterore ne zone.</p> |
| <p>4.4.2: <b>Bashkepunimi institucional rajonal:</b> zhvillon nje bashkepunim te ngushte dhe sistematik me autoritetet rajonale nepermjet krijimit te nje bordi te turizmit lokal per te ndermarrë iniciativa gjithë përfshirëse per zhvillimin e turizmit.</p>                              |  |   |
| <p>4.4.3: <b>Partneriteti publik dhe privat:</b> siguron nje model te ri bashkepunimi midis Bashkise dhe sektorit privat</p>   |  |   |

|  |  |   |
|--|--|---|
|  |  | ne rrjetin e biznesit turistik dhe promovimin e produkteve lokale.  |
|  |  | 4.4.4: <b>Pjesemarrja e publikut:</b> angazhon shoqerine civile ne promovimin e zhvillimit te turizmit, duke u mbeshtetur ne metodat bashkekohore te pjesemarrjes se publikut, si dhe ne sistemin tradicional te perfaqesuesve te tyre sic mund te jene kryepleqte. |



# 4 PLANI I PËRDORIMIT TË TOKËS

## I. HYRJA

Plani Struktural perfshin situaten fiziko-hapesinore te Planit Lokal dhe eshte hartuar nga Konsulenti duke interpretuar Vizionin, i cili eshte percaktuar ne bashkepunim me Bashkine. Plani Struktural eshte i bazuar ne parashikimet demografike dhe ekonomike te cilat ndikojne ne vleresimet programatike, ne nevojten per perdorimin e tokes ne menyten me te mire, duke mbeshtetur procesin e zonimit per zhvillimet e ardhshme. Qellimi kryesor i Planit Struktural eshte mbeshtetja e zhvillimit te qendrueshem te turizmit ne menyte qe te arrihen perfitimet ekonomike, nderkohe qe ploteson aspiratat e popullates lokale, duke pasur parasysh ruajtjen e vleres afatgjate te pasurive mjedisore. Rritja e turizmit dhe aktiviteteteve shplodhese dhe rekreative me baze zhvillimin ekonomik eshte pare si prioritet kryesor i zonave qe ajo perfaqeson ne te gjitha aspektet e mundshme, me te favorshme per zhvillimin ekonomik lokal, si dhe arrijten e objektivave rajonale dhe kombetare te zhvillimit ekonomik.

**Plani Struktural** i shoqeruar nga Harta e Perdorimit te Tokes ne shkalle 1:10.000 qe mbulon te gjithe territorin e Bashkise eshte nje dokument strategjik thelbesor qe paraqet strukturen e ardhshme te propozuar te perdorimit te tokes , e cila do te detajohet ne fazat e ardhshme te hartimit te Planit Rregullues. Ky i fundit do te percaktoje zonimin me te hollesishem, dendesine dhe rregulloret e nenndarjeve, si dhe mekanizmat e nevojshme per te zbatuar Planin Struktural duke u perqendruar me shume ne zonat e zgjedhura dhe territorin e urbanizuar sipas percaktimeve dhe normave te legjislacionit kombetar.

Ne kohen e dorezimit te ketij raporti **Ligji i ri per Planifikimin Territorial 10119/2009** ka hyre ne fuqi se bashku me aktet nenligjore shoqeruese te cilat specifikojne dispozita te detajuara dhe proceset e planifikimit dhe kontrollit te zhvillimit. Cka eshte permendur me siper eshte marre ne konsiderate per te siguruar perputhshmerine ligjore te Planit. Pervec kesaj Konsulenti ka pranuar dispozitat, normat dhe rekomandimet e miratuara nga **Plani Rregullues i Zhvillimit te Bregdetit te Jugut** ne percaktimin dhe kategorizimin e zonave te perdorimit te tokes dhe eshte kujdesur per te siguruar harmonizimin me dispozitat e legjislacionit mjedisor ne zonat e mbrojtura.

Perdorimi i metodologjise se zonimit te tokes dhe standardet e planifikimit jane shpjeguar me hollesi ne kete raport, i cili eshte organizuar ne formen e udhezimeve dhe parimeve te Zhvillimit Urban per te lehtesuar komunikimin ne terma teknike me Departamentin e Planifikimit Urban te Bashkise ne procesin e hartimit te Planit Rregullues.

Krahas percaktimit te perdorimit te tokes dhe shifrave programatike per zhvillimin e ardhshem territorial, Konsulenti ka punuar paralelisht ne percaktimin e nevojave per investime ne infrastrukture, ne lidhje me furnizimin me uje, kanalizimet, energjine, telekomunikacionin, si dhe menaxhimin e mbeturinave, te cilat mund te perdoren si udhezime per kryerjen e me shume studimeve te specializuara teknike. Bazuar ne Vizionin Qytetit dhe Strategjine e Zhvillimit te Territorit, si dhe ne hulumtimet e metejshme ne nivel kombetar lidhur me mundesite e financimit, Konsulenti ka hartuar nje liste te projekteve strategjike te infrastruktures, te cilat jane diskutuar me Bashkine.

Permbajtja e Planit u diskutua ne grupet e perkohshme te punes ne periudhen gusht-shtator ndermjet anetareve te ekipit planifikues, Kryetarit te Bashkise dhe Shefit te Departamentit te Planifikimit Urban te Bashkise. Ky diskutim ivazhdueshem u kombinua me vizita ne terren, e cila eshte dokumentuar ne shtojcat e ketij raporti.

## II. ELEMENTE KRYESOR PROGRAMATIK TE SKENARIT TE ZHVILLIMIT

Skenari i zgjedhur per zhvillimin e Himares per 10-15 vitet e ardhshme, i pershkruar ne fazen e formulimit te Vizionit dhe Strategjise se Zhvillimit eshte organizuar pergjate dy akseve kryesore.

1. Krijimi i zones si nje destinacion turistik cilesor me standarde te larta, nepermjet terheqjes se investimeve ne vende te percaktuara te Zones se Planifikimit (zona prioritare) dhe organizimin e sherbimeve turistike dhe infrastruktures.
2. Ruajtja dhe permiresimi i burimeve te zones dhe zhvillimi i lidhjeve organike midis turizmit, ekonomise lokale dhe shoqerise, ne menyre qe te mbeshtese zhvillimin e qendrueshem demografik dhe socio-ekonomik.

Bazuar ne kete skenar, nje sere aspektesh programore jane diskutuar ne vazhdim per t'u marre ne konsiderate gjate formulimit te Planit Struktural. Duhet te theksohet se ne disa raste parashikimet jane te bazuara ne vleresime optimiste te cilat nuk mund te materializohen ne te ardhmen e afert, megjithate duhet te merren ne konsiderate ne planifikimin e territorit.

### II | 1. VLERESIME PER POPULLESINE

**Popullesia Rezidenciale:** Ne menyre qe te behet nje parashikim i sakte i popullise sipas metodologjise se perdorur nga INSTAT, duhen te dhenat e fundit te popullise per te pakten dy periudha te ndryshme, analiza e dallimit midis vdekjeve dhe lindjeve dhe struktura e popullise sipas moshes, si dhe tendenca e migrimit. Keto te dhena nuk ekzistojne per Bashkine e Himares, prandaj jemi munduar te punojme mbi bazen e perafimeve statistikore dhe progresioneve. Analiza e te dhenave ekzistuese dhe treguesit ne fazat e meparshme te punes (Raporti i Analizes se Qytetit / profili demografik), ka llogaritur perafersisht popullsin e rezidente te Bashkise Himare per jo me shume se 4500 banore, e rritur nga 3275 sipas rregjistrimit te fundit (Census 2001). Te dhena me te sakta nuk do te jene ne dispozicion me perpara muajit Prill 2012, do te jene atehere kur te publikohen te dhenat e rregjistrimit te ri (Census 2011). Megjithate, diferenca e madhe ndermjet popullise qe jeton dhe popullise se rregjistruar, eshte dhene ne tabelen e meposhtme, ku vihen re tendencat e migrimit nga Greqia te kushtezuara ne nje mjedis me te gjere ekonomik, si nje faktor kryesor i rendesishem per te percaktuar normen e rritjes se popullise rezidente ne periudhen e 5-10 viteve te ardhshme.

**Tabela 13: Popullesia Rezidente, Bashkia Himare, 2000-2010**

| Burimi i informacionit | Census | Te dhenat e Bashkise per Popullesine e Rregjistruar | Popullesia rezidenciale e vleresuar perafersisht |
|------------------------|--------|---|--|
| Viti                   | 2001   | 2010  | 2010   |
| Banor                  | 3275   | 12344   | 4500   |

Popullsia e vleresuar per nje vit te synuar - ndoshta, ne 2030 eshte 10.000 banore, qe nenkupton nje norme vjetore te rritjes deri ne 5-7% ndermjet viteve 2010 dhe 2020. Kjo eshte nje vlere shume ambicioze, duke konsideruar shkallen e ulet te rritjes ne nivel kombetar (0,55%) dhe nje koeficient lindjesh te femijeve 2 lindje / grua, e cila eshte edhe me e ulet ne Qarkun e Vlores. Megjithate, duhet nje kthim i konsiderueshem i qytetareve qe jetojne ne Greqi, i cili ndodh si rezultat i krizes, ne menyre qe rritja e popullsisë te mund te materializohet fuqishem brenda pese viteve te ardhshme. Ne te ardhmen e afert, vetem zhvillimi i turizmit eshte sektori kryesor qe mund te inkurajoje keto trende ne menyre pro-aktive permes gjenerimit te punesimit dhe krijimin e mundesive te favorshme per biznesin.

**Popullsia Turistike:** Me gjithë rëndesinë e saj për zhvillimin afatgjatë të qendrueshëm të zonës, treguesi i rritjes së popullsisë rezidente nuk është treguesi më i rëndësishëm për të mbështetur vlerësimet programatike të Planit Struktural për shkak të karakterit turistik të zonës, që nenkupton një shkallë të lartë të luhatjes në vlerat aktuale të popullsisë. Është vlerësuar që popullata lokale në muajt e verës i kalon 12,000 njëzëz nga 4,500 në periudhën e dimrit. Kjo shifër i referohet vetëm qytetarëve dhe familjarëve që kthehen në shtëpitë e tyre. Kësaj shifre duhet t’i shtohen pronarët e shtëpive të dyta, që janë nga jashtë zonës, numri i turistëve dhe vizitorëve, si dhe punësimi shtesë sezonal për të arritur shifrën e popullsisë aktuale në periudhën e verës. Një përafrim për popullsinë turistike aktuale të Bashkisë së Himarës në sezonin e pikut, bazuar në kapacitetet ekzistuese është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

| <b>Tabela 14: Popullsia Turistike ne pikun e sezonit, Bashkia Himare, 2010</b> |  |
|--|--|
| <b>Tipi i popullsisë</b>   | <b>Nje vleresim i perafert i popullsisë <sup>4</sup></b> |
| Popullsia Rezidenciale   | 4500   |
| Qytetar te kthyer dhe zgjerime familjare                                       | 7500   |
| Pronar te shtepive te dyta (jo banor te zones)                                 | 800  |
| Vizitor – Turist   | 7200   |
| Te punesuar Sezonal  | 1000   |
| <b>Totali</b>  | <b>21000</b>   |

Natyrisht kjo paraqet një përafrim optimist, që është tregues i mundësive që duhet të realizohen në shërbimet vendore bashkiake, në infrastrukturen publike dhe në objektet bashkiake. Për momentin kjo është e kufizuar në sezonin e pikut dhe do të mbetet e tillë për 5 vitet e ardhshme, por pritet që të zgjerohet për një periudhë më të gjatë në të ardhmen. Zhvillimi i turizmit në zonë do të çojë në rritjen graduale të numrit të turistëve dhe banorëve të shtëpive të dyta në zonë me një normë mesatare prej 7-10% në vit gjatë dekadës së ardhshme, në vartësi të shkallës së plotësimit të kërkesës. Popullsia e ardhshme e zonës së turizmit në 15-20 vitet e ardhshme pritet të tejkalojë 40.000 banorë.

**Dendësia e Popullsisë:** Llogaritja e dendësisë së popullsisë në baze të këtij përafrimi arrin 303 banor për km<sup>2</sup> (llogaritur mbi 132km<sup>2</sup>). Duke marrë parasysh që me shumë se 50% e territorit të Bashkisë është zonë e pabanuar, (zonë malore), përqendrimi aktual i popullsisë në zonat me potencial banor duhet të llogaritet me dyfishin e densitetit, pra 600 banor për km<sup>2</sup>. Kjo pasqyron një situatë më të rëndësishme nga vlera e 34 banor për km<sup>2</sup>, e cila i referohet dendësisë së popullsisë rezidente ekzistuese.

<sup>4</sup> Vlerat janë referuar të dhenave të Bashkisë, që do të analizohen në mënyrë analitike në seksionet në vazhdim.

## II | 2. ZHVILLIMET EKONOMIKE

**Punesimi i Planifikuar:** Te dhenat e pergjithshme zyrtare mbi punesimin aktual ne Bashkine Himare nuk u mundesuan, por u llogariten ne menyre indirekte nga te dhenat bashkiake per zhvillimin e biznesit vendor gjate nje periudhe pese vjeçare nga 2004-2009 te paraqitura ne Raportin e Analizes se Qytetit / Zhvillimit Ekonomik. Bazuar ne te dhenat e punesimit per te gjitha deget e ekonomise, (perpunimi, tregtia, restorantet, ndertimi, transporti dhe sherbimet e tjera), me perjashtim te kultivimit te tokes bujqesore dhe mbareshtimit te kafsheve, rezultojne afersisht ne 1400 te punesuar. Rreth 70% e kesaj shifre korrespondon me punesimin sezonal. Kjo shifer tregon se nje vlere shume e vogel evidenton te punesuar kundrejt popullates se pergjithshme te zones krahasuar me nivelin kombetar.

Kjo perkon me konkluzionet qe rrjedhin nga analiza e perberjes se moshes se popullsisë rezidente dhe nenkupton qe Himara eshte ne nje suate qe importon fuqi sezonale punesimi nga zona te tjera ne menyre qe te mbuloje nevojat e turizmit. Objektiv i per te ardhmen do te jete i tille qe gradualisht te zevendesojte kete fuqi punesimi sezonal duke kthyer popullsisë emigrante nga Greqia, qe do te rrise aftesite e forces se punes dhe do te sherbeje per te ruajtur nivelin e ulet te papunesise aktuale.

Analiza e tendences e se ardhmes se sektorit eshte diskutuar me poshte:

**Industria:** Industria e perpunimit ne pese vitet e ardhshme llogaritet te kete nje rritje te biznesit lokal rreth 12% per kundrejt rritjes aktuale 6% duke iu referuar shifrave te Bashkise. Kjo rritje i referohet ndermarrjeve perpunuese qe do te zhvillojne aktivite te lidhura me prodhimin e vajit, produkteve te qumeshtit si dhe mjaltit dhe tendencave te reja per markat lokale e tradicionale, si recele, lengje portokalli dhe limoni. Ne dekadën e ardhshme mund te realizohen sapunet dhe parfumet. Perpunimi ushqimor do te zhvillohet kryesisht ne zona urbane. Nje pjese e madhe e ketyre aktiviteve do te vendoset si pjese e bizneseve shtepiake/familjare sidomos ne 5 vitet e ardhshme dhe pastaj gradualisht te levize ne zona me te gjera pas 10 vitesh, nese do te kalojne faktoret e caktuar influences. Kultivimi i peshkut si aktivitet eshte i pranishem ne zone, por do te zvogelohet ne prespektiven afat gjate.

**Ndertimi:** Pritet te rritet ne vellim te prodhimit duke rritur punesimin, por jo numrin e bizneseve. Prodhimi i materialeve te ndertimit eshte nje aktivitet qe do te rritet ne nivel lokal.

**Ndertimet e priteshme:** Sipas te dhenave te Bashkise vleresuar ne lejet e ndertimit qe jane dhene ne pese vitet e fundit (2004-2009), tendenca tregon se me shume se 50% e zhvillimit te pergjithshem eshte perqendruar ne Himare dhe me shume se 25% ne Dhermi. Per pese vitet e ardhshme pritet qe Himara do te ruaje te njejtat shifra aktuale ndersa shifrat ne Dhermi do te rriten me shume se dyfishi, keshtu qe perqindja e saj do te arrije me shume se 45% e kerkesave totale per zhvillime te reja. Zonat e reja te tilla si Jali do te zhvillohen me ndertime te reja si dhe rinovimi ne vendbanimet tradicionale. Ne fund te dekades ne jemi te mendimit se shifrat do te vazhdojne te rriten. Dhermi-Palase do te vazhdoje te rritet ndersa Himara do te mbetet ne te njejtat nivele. Pas 10 viteve pritet qe tendenca e ndertimit do te jete me uniforme ne te gjitha

fushat. Rritja e aktiviteteve të ndertimit do të kërkojë me shumë rregulla të rrepta që do të aplikohen në lidhje me nxjerrjen e lendeve të para dhe asgjësimin e mbetjeve.

**Sherbimet:** Tregtia dhe restorantet që veprojnë si aktivitete sezonale janë kategoritë kryesore të cilat do të vazhdojnë të përfaqësojnë me shumë se 50% të rritjes totale të biznesit vendas në vitet e ardhshme. Shifra e rritjes 150% pritet si rritja mesatare në 5 vitet e ardhshme duke u përqendruar me shumë në bizneset turistike sezonale (hotele, restorante, bare, aktivitete argetuese). Në fund të dekadës ato ende do të kenë një rritje të njëjte. Cilësia e shërbimit në këtë sektor do të përmirësohet gjatë dhjetë viteve të ardhshme në harmoni me pritjet e reja në lidhje me standardet e turizmit.

**Bujqësia dhe Blegtoria:** Në vitet e ardhshme sektori i bujqësisë duhet të zhvillohet përpara se të aplikohen kufizimet e politikës CAP. Pjesët e mbetura e sektorit bujqësor dhe blegtoral duhet të jenë të mbrojtura nga politikat kombëtare. Pas përfundimit të dekadës, zhvillimi i këtyre aktiviteteve do të përputhet me standardet e BE-së dhe politikës CAP. Rezervat kryesore të tokës për këto aktivitete do të mbeten në zonat malore. Kullotat në vende bregdetare në afërsi të zonave turistike do të reduktohen, në periudhën afat gjatë për shkak të papajtueshmërisë me karakterin e zonës. Prodhimet blegtorale do të përqendrohen kryesisht në Pilur, luginën e Qeparos dhe zonat e Kudhësit. Hapësirat për këto aktivitete duhet të gjenden në afërsi të këtyre zonave ose në rrethinat e qytetit të Himarës.

## II | 3. ZHVILLIMI I TURIZMIT

Vizioni i hartuar ne bashkepunim, ka percaktuar karakterin e zhvillimit te zones se Himares si destinacion turistik. Zhvillimi turistik do te bazohet ne nje kombinim te dy llojeve te turizmit:

- **Forma e mesme e turizmit diell & plazh** te nje cilesie te larte e perqendruar ne zona prioritare te zgjedhura te bregdetit e cila do te ruhet si rezerve nepermjet ketij Plani.
- **Turizmi i nje interesi te vecante** perfshin lloje te ndryshme, (te tilla si turizmi natyror, agroturizmi, turizmi kulturor dhe eko-turizmin), ai do te perqendrohet ne pjese te ndryshme te territorit, qe paraqesin nje vlere te larte te peisazhit natyror dhe kulturor, te tilla si vendbanime tradicionale, vendet e trashegimise kulturore, peisazheve bujqesore, plazhet, kanionet dhe faqet e malit me bukuri te medha natyrore.

Forma ekzistuese kryesore eshte ajo e akomodimit turistik informal ne dhoma me qera dhe do te vazhdoje te jete e pranishme, por do te jene te pozicionuara ne zonat tashme te urbanizuara dhe zona e zgjerimeve te reja. Aktualisht kapacitetet ekzistuese turistike te bashkise perfshijne 1200 shtreter te shperndare ne 80 hotele dhe rreth 3000 dhoma te vecanta, sipas nje vleresimi te perafert te bashkise. Kjo korrespondon me nje shifer prej 7200 shtreter. Rreth 45% e kapacitetit total te shtreterve te hoteleve jane te vendosura ne Dhermi dhe 25% ne zonen e Himares.

Planifikimi i kapacitetit turistik i ardhshem per 10-15 vitet e ardhshme eshte i bazuar ne ekuilibrin mes dy faktoreve i) vleresimin e rritjes se pritshme brenda kesaj periudhe dhe ii) kapacitetin e territorit.

Parameter i rëndësishëm për vlerësimin e kapaciteteve territoriale është ai, lidhur me kapacitetin e plazheve të cilat luajnë një rol kyç në atraktivitetin e zonës dhe komoditetin e vizitorëve. Duke pasur parasysh se Himara nuk është një destinacion i turizmit masiv dhe se ajo duhet të ruajë karakterin e peisazhit natyror, kapaciteti optimal është llogaritur bazuar në standardet e mëposhtme:

- Lidhur me sipërfaqe plazhi për person, rregulli i përgjithshëm prej 10m<sup>2</sup> për person është i respektuar në përputhje me standardet kombëtare për turizëm elitare. Megjithatë, ky rregull zbatohet vetëm për një zonë prej 15-20m nga uji/deti. Sipërfaqja e mbetur nuk është konsideruar në kapacitetin e plazhit.
- Standardi prej 0.7m gjatësi të plazhit për person për turizmin elitare është respektuar me dy përjashtime (Jali dhe Llaman), ku ky është reduktuar në 0.5m për person në Qeparo dhe pjesërisht në Spilea, ku standardi nuk mund të ruhet për shkak të ngushtesise së plazhit. Për plazhe të gjata ky rregull është aplikuar, por vetëm për një pjesë të territorit duke marrë parasysh parimin e ruajtjes të pjesës natyrore të plazheve. Kjo përqindje është e ndryshme në varësi të karakteristikave të çdo zone.

Një vlerësim për kapacitetet optimale është paraqitur në tabelën në vazhdim:

**Tabela 15: Vleresimi i kapacitetit optimal te plazheve ne Bashkine Himare**

| Plazhi        | Gjatesia | Gjeresia | Siperfaqja | Shkalla e Natyralitetit | Kapaciteti Optimal (persona) |
|---------------|----------|----------|------------|-------------------------|------------------------------|
| Dralleos      | 1025     | 130      | 111500     | 45%                     | 800                          |
| Drymades      | 1800     | 90       | 136150     | 40%                     | 1540                         |
| Dhermi        | 1540     | 70       | 89000      | 30%                     | 1540                         |
| Njipea        | 160      | 70       | 11440      | 60%                     | 100                          |
| Jal 1         | 310      | 60       | 20350      | 0%                      | 440                          |
| Jal 2         |          |          |            |                         | 160                          |
| Livadhe       | 1250     | 60       | 68000      | 35%                     | 1160                         |
| Spilea        | 480      | 20       | 8160       | 20%                     | 400                          |
| Maraki        | 180      | 40       | 6000       | 30%                     | 180                          |
| Potam         | 950      | 45       | 37000      | 30%                     | 950                          |
| Llaman        | 175      | 50       | 8700       | 0%                      | 350                          |
| Palermo       | -        | -        | -          | -                       | 220                          |
| Qeparo        | 1780     | 15       | 24500      | 40%                     | 1000                         |
| <b>Totali</b> |          |          |            |                         | <b>9280</b>                  |

Duke pasur parasysh se hapësira e plazhit është e zënë dy herë në ditë dhe se ajo i referohet vetëm 90% të popullsisë së përgjithshme turistike, duket se zona e Himarës mund të strehojë një kapacitet optimal  $9280 \times 2 = 18560 / 90\% = 20.620$  persona në sezonin e pikut. Duke supozuar se një e katërta e këtij kapaciteti do të zihet nga rritja e popullsisë lokale dhe banorët e zonave të shtëpive të dyta, numri i shtreterve i synuar për turistët në zonën e Himarës është vlerësuar në 15.000 shtreter. Ky kapacitet shtreterish mund të arrihet në 10-15 vitet e ardhshme, me kusht që të arrihet mesatarisht një rritje prej 5-7% në vit të kapaciteteve turistike.

Llogaritja e tokës që duhet të rezervohet për të mbuluar nevojat e zhvillimit të turizmit bazuar në standardin e 10 shtreterve për 1000 m<sup>2</sup>, sipas standardeve ndërkombëtare të akomodimit turistik çilesor (3 vje dhe më lart) dhe rritjes me 30-40% për të mbuluar nevojën për objektet e përbashkëta në zonat turistike (të tilla si rrugët, parking, zonat e gjelbërta dhe shetitoret publike). Kjo shkon deri në një total prej 210 ha tokë turistike. Kjo duhet të shpërndahet ndërmjet zonave turistike të caktuara dhe një pjesë në zonat e banimit. Duke marrë në konsideratë tendencat ekzistuese dhe kapacitetet territoriale, një tregues i përafërt i shpërndarjes territoriale të kapacitetit të shtreterve për lloje të ndryshme të akomodimit turistik është sygjeruar më poshtë:

**Tabela 16: Shpërndarja e kapaciteteve të shtreterve**

| Siperfaqe / Shtreter | Zonat Hoteliere | Resortet    | Zonat Rezidenciale | Fshatrat Malor | Zonat Bujqesore | Eko-Kampingjet |
|----------------------|-----------------|-------------|--------------------|----------------|-----------------|----------------|
| Drymades             | 2400            | 2000        | 2000               | 240            |                 |                |
| Vuno-Jal             | 600             |             | 200                | 220            | 400             | 100            |
| Himara               | 1150            |             | 2800               | 240            | 250             | 300            |
| Palermo              |                 | 600         |                    |                |                 |                |
| Qeparo               | 250             |             | 800                | 100            | 200             | 350            |
| <b>Total</b>         | <b>4400</b>     | <b>2600</b> | <b>5800</b>        | <b>800</b>     | <b>850</b>      | <b>750</b>     |



## III. PARIMET & UDHEZUESI PER FORMULIMIN E PLANIT STRUKTURAL

### III | 1. HYRJA

Planifikimi dhe zhvillimi urban nuk do të ndodhë spontanisht, por do të udhëhiqet dhe drejtohet me tëpër nga parime baze të teorieneve dhe vizionareve largpames, si dhe nga praktikat e suksesshme në të gjithë botën. Planifikuesit urban zbatojnë parimet rilevante kombetare, adaptojnë udhëzimet e BE-se dhe disiplinojnë ose zgjedhin parimet me të pershtatshme nga shumellojshmeria e zgjedhjeve në dispozicion. Planifikuesit gjithashtu krijojnë disa parime duke përdorur praktikat me të mira dhe institucionalizimin e traditave dhe të kultures vendore. Në shumicën e rasteve, parimet do të zgjidhen në përputhshmeri me të vizionin për të ardhmen e zones në studim.

Drafti i parimeve ka marrë në konsideratë burime të ndryshme, të cilat mund të klasifikohen në tre kategori:

- Normat që janë rezultat i rivleresimit të kornizes ligjore në Shqipëri në planifikimin e territorit, zhvillimin e turizmit dhe mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit natyror dhe kulturor;
- Parimet e dala nga direktivat e planit struktural gjithë përfshires, i quajtur PZHBJ;
- Parimet që dalin nga përvoja e teorise bashkekohore dhe të praktikave të mira të planifikimit të BE-se, për planifikimin urban dhe zhvillimin e turizmit.

Udhëzimet dhe parimet e paraqitura këtu, kanë për qëllim të shërbejnë si baze për hartimin e Planit Struktural, por edhe të synojnë për të kontribuar në:

- Planifikimin e detajuar dhe studimet bashkiake;
- Vleresimin e propozimeve për zhvillim/ndertim nga investitori dhe dhenien e lejes;
- Hartimin e projekteve të infrastruktures.

Udhëzuesit do të formulohen në seksionet në vazhdim:

1. Metodologjia e Zonimit të Përdorimit të Tokës
2. Koncepti i Propozuar i Zonimit dhe Kategorizimi i Tokës
3. Ndarja e territorit në Njësi-Strukturore dhe Nen-Strukturore
4. Densiteti i Popullsisë dhe i Zhvillimit të Turizmit
5. Shërbimi social (arsim, kujdesi shëndetësor, ambientet sportive dhe kulturore)
6. Udhëzues për planifikimin e shtigjeve bregdetare
7. Udhëzues për menaxhimin e lumenjve dhe perrenjve
8. Asetet Historike dhe të trashëgimisë Kulturore
9. Zonat Turistike dhe të Shtëpive të Dytë
10. Rrjeti Rrugor

### III | 2. METODOLOGJIA E ZONIMIT TE PERDORIMIT TE TOKES

Komponenti themelor i Planit Struktural është harta e propozuar e përdorimit të tokës. Çdo zonë e propozuar përfshin parimet e zhvillimit që do të shprehet në formën e rregulloreve në fazën e ardhshme. Procesi i zonimit në vetvete ka një rëndësi strategjike për të bërë planifikimin dhe është i bazuar në praktikën me të mira dhe eksperiencën profesionale të Konsulentit. Një qasje sistematike, e cila merr në konsideratë një sërë parimesh udhëzuese, normash ekzistuese, si dhe kufizimet kryesore në nivel kombëtar, është hartuar për të mbështetur procesin e zonimit dhe minimizuar zgjedhjet arbitrare, duke synuar paralelisht draftimin e një sërë rregullash të thjeshta dhe të zbatueshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar, i cili do të lehtësojë procesin e zbatimit.

**Situata aktuale-** Miratimi i Planit të Zhvillimit të Bregdetit të Jugut PZHBJ, ka përcaktuar për të gjithë Bregdetin Jugor zonën e mbrojtur, bazuar në një numër kriteresh, të cilat aplikohen edhe për bashkinë e Himarës duke vepruar si një forcë detyruese për formulimin e Planit Lokal. Për pjesën e mbetur të territorit që nuk bie brenda këtyre kufizimeve, zhvillimi është trajtuar pak a shumë me rregulla uniforme për të gjithë sipërfaqen (urbane dhe jo urbane). Menyra aktuale e zhvillimit pa kriter është e papërshtatshme për të mbështetur një vizion konkret për zhvillimin e ardhshëm të turizmit, ajo kërkon pasuritë natyrore dhe kulturore; konsumon tokën dhe burimet ekonomike; kufizon përdorimin efikas të infrastrukurës; dhe në përgjithësi përfaqëson një zhvillim jo të qëndrueshëm.

**Parimet gjithëpërfshirëse të zonimit-** Parimet e procesit të zonimit të përdorura në krijimin e Planit Struktural, kanë marrë parasysh evolucionin historik të zonës si dhe diferencimin gjeografik dhe morfologjik të territorit, të cilat krijojnë një strukturë hapësimore unike të bregdetit të Himarës. Në të njëjtën kohë procesi i zonimit përfshin edhe filozofinë e qëndrueshmërisë, të miratuar në nivel global me konsideratë të veçante në udhëzimet e BE-së dhe praktikën e suksesshme të ndjekura në vendet evropiane. Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm hapësorë përpiqen të krijojnë barazi dhe drejtësi brenda zonës së planifikimit, duke ruajtur edhe rritjen e potencialit të zhvillimit për brezat e ardhshme.

Një detyrë e rëndësishme në procesin e zonimit është të identifikojë dhe propozojë zonat urbane dhe rurale të zgjerimit për çdo njësi të zonës së studimit, si dhe përcaktimin e zonave të reja të zhvillimit. Kjo nënkupton një seri vendimesh që janë të bazuara në i) vizionin hapësor për zhvillimin e ardhshëm siç është rënë dakord me bashkinë, ii) identifikimin e nevojave programore në baze të parashikimeve shkencore, adaptimin e standarteve kombëtare dhe praktikën me të mira ndërkombëtare iii) detajimin e hollësisht të tokës për çdo lokalitet në studim dhe iv) planifikimin ekzistues dhe rregulloren e kufizimeve.

Menyra se si faktore të ndryshme janë marrë në konsideratë në procesin e zonimit të nëndarjeve është shpjeguar më poshtë :

**i. Modelet primare të përdorimit të tokës:** Kjo përfshin evidentimin e përdoruesve primar të tokave që ndodhen në nëndarjet ekzistuese në nivel rajonal dhe që përfshin të gjithë territorin e bashkisë. Një klasifikim i parë është bërë ndërmjet tokës urbane dhe asaj jo-urbane, bujqësore dhe sistemeve natyrore të zonës së planifikimit. Zona është identifikuar fillimisht sipas përdorimit kryesor të tokës dhe në rastet kur mbizoteron një larmi përdorimesh, duhet të behen nëndarje të tjera që korrespondojnë me përdorimin ekzistues. Konsulentët ka përdorur klasifikimin e hartave PZHBJ për klasifikimin e zonave si (tokë urbane, tokë bujqësore, pyje dhe kullota).

**ii. Ndarja dytesore e përdorimit të tokës:** Në një fazë të dytë, ndarja e zonave të ndryshme duhet të marrë parasysh karakteristikat e veçanta brenda një modeli të përdorimit kryesor të tokës. Kjo përfshin një qasje të ndryshme për zonë, ku një qasje më e hollësishme është ndjekur, që përfshin dallimin në mes të zonave të banuara dhe zonave me karakter të perzier (për banim të kombinuar me veprimtari të tjera), si dhe nivele të ndryshme të densitetit. Analiza është bërë në mënyrë të ngjashme edhe pse me pak hollësi për kategoritë jo-urbane të tokës, sidomos në zonat që janë identifikuar si zona zhvillimi nga vizioni hapësinor.

**iii. Evoluimi historik:** Formulimi i Struktura hapësinore do të thotë marrjen në konsideratë të proceseve të ndryshme të zhvillimit urban, të cilat kanë përcaktuar karakterin e peisazhit që është formuar nga vendndodhja e zonave dhe rrethinat e tyre kufitare. Kjo nënkupton një trajtim të diferencuar midis pjesëve malore dhe zonës në drejtim të detit në lidhje me vendndodhjen e zhvillimeve të reja, si dhe mënyrën se si zona të ndryshme janë të lidhura me njëra-tjetrën. Në shkallë urbane ajo përfshin konsideratat për zonat e ndërtuara në kohë të ndryshme dhe regjime të ndryshme, lagjet e vjetra në zonat historike dhe rolin historik të lokaliteteve të caktuara brenda qytetit.

**iv. Referenca për hierarkinë e rrjetit rrugor:** Nëndarjet hapësinore të zonave të zhvillimit duhet të kryhen në përputhje me hierarkinë e rrjetit rrugor. Zonat homogjene të banimit (lagjet) dhe zonat periferike (fshatra) duhet të përcaktohen dhe jo të përshkohen nga arteriet rrugore urbane (kryesore dhe dytesore) dhe ato ndërbane (kombetare ose rajonale). Vëmendje e veçantë i është kushtuar artikullimit të trafikut automobilistik në brendësi të qendrës së zonave tradicionale dhe atyre turistike, si dhe atyre lidhur me ambientet ujore, me qëllim për të shmangur parandalimin e varesisë së zonave të banuara me detin. Kategorizimi i hierarkisë së rrjetit ekzistues dhe atij të ri rrugor në çdo zonë, u bë paralel me procesin e zonimit të shfrytëzimit të tokës.

**v. Referenca të kufizimeve gjeografike:** Nëndarja sipas kufizimeve gjeografike, lumenj, thyerje, kodra dhe fusha etj, është një qasje shumë praktike në procesin e përcaktimit më të hollësishëm të zgjerimeve urbane dhe atyre periferike, si dhe të zonave të reja të zhvillimit. PZHBJ propozon një qasje shumë sistematike për të identifikuar fushat dhe kriteret e përjashtimit të zhvillimit të bazuar në perkufizimin e zonave të larta, sipërfaqet e shpateve të

pjerreta, zonat e prirura për përmbajtje, si dhe të mbrojtjes së burimeve ujore. Në mënyrë të ngjashme janë vendosur një sërë kriteresh për zonat e mbrojtjes mjedisore dhe pejsazheve, të cilat marrin në konsideratë parametrat topografike dhe vizuale, të tilla si mbrojtja e majave, grykave dhe luginave, deltave aktive, etj, siç përmendet dhe në pikat e mëposhtme.

**vi. Mbrojtja e aseteve / pasurive mjedisore:** Angazhimi kryesor i procesit të zonimit është të respektojë dhe ruajë burimet natyrore të zonës dhe të pejsazhit të cilat përbejnë tërheqjen kryesore dhe përparësinë konkurruese si një destinacion potencial cilësor për të ardhmen e turizmit. Rekomandimet e mëposhtme të dokumentit rregullativ të PZHBJ janë miratuar në procesin e zonimit:

- *Karakteristikat detare dhe bregdetare me rëndësi ekologjike, gjeologjike, gjeomorfologjike, kulturore, historike dhe peisazhi duhen mbrojtur.*
- *Habitati i rendesishëm bregdetar, toka dhe deti, dhe flora e fauna vendase e lidhur me të duhet të mbrohen në të gjitha rastet dhe të ruhen të paprekura ku është e mundur.*
- *Një sistem i mirë-menaxhuar i parqeve dhe rezervateve bregdetare duhet të zhvillohen (mbi Parqet Kombëtare ekzistuese), me përfshirjen e komunitetit lokal në mbrojtjen dhe menaxhimin e territoreve.*
- *Një përqindje e konsiderueshme e bregdetit dhe të rrethinave të tij duhet të zonohen si “zona me vlerë të lartë peisazhi” për të ruajtur cilësinë e përgjithshme të rrethinave si: i) një pasuri ekonomike; ii) një ekosistem; dhe iii) kuadri kryesor i pejsazhit, për të siguruar rritjen e poleve të veçanta.*
- *Një përqindje e rendesishme e bregdetit dhe e rrethinave duhet të mbetet i paarrtshëm për automjetet për të mbështetur kufizimet në ndertime në këto zona dhe për të ruajtur karakterin e tyre rural për mbrojtjen e ekosistemit dhe për përdorim rekreativ.*

**vii. Trashëgimia kulturore dhe ajo natyrore:** Nën-ndarjet duhet të bazohen në respektimin e të gjitha rregulloresve perkatese kombëtare dhe kufizimeve ligjore në lidhje me zonat historike dhe ato natyrore. Në veçanti:

- Mbrojtjen e pejsazheve kulturore - bujqësore, të cilat pasqyrojnë historinë e bujqësisë tradicionale në rajon, duke përfshirë ullishtat e lashta dhe pemeve të tjera të papunuara dhe tarracave, që janë përcaktuar nga zonimi i territorit.
- Zonat e mbrojtura natyrore sipas ligjit 8906/2002 dhe zonat e mbrojtura të propozuara duhet të përjashtohen nga zhvillimet/ndertimet e banesave dhe turizmit, sipas rregullores së këtij ligji; kufizime të ngjashme aplikohen për burimet ujore që mbrohen nga Ligji 8093/1996.
- Fshatrat kulturore dhe historike, si dhe monumentet e rendesishme me vlerë të pazëvendësueshme, të cilat përfshijnë Kalanë e Himarës, Qeparonë e Vjeter, Dhermi fshat dhe Vuno, si dhe vendbanime të tjera të ngjashme, duhet të sigurohen një zonë mbrojtëse prej 500 m, në mënyrë që të mbrohet vendosja e tyre natyrore.
- Monumentet e trashëgimisë kulturore me vlerë të jashtëzakonshme. Këto rregullohen me anë të një zonimi të veçantë hapësiror dhe udhëzimesh

shoqeruese, te nxjerra sipas Ligjit 9048/2003. Zona tampon e ruajtjes se peisazhit prej 250m eshte per te siguruar ekzistencen e monumenteve te regjistruara si te tilla, referuar ligjit 9048/2003.

Pervec faktoreve te mesiperm, ndarja e zonave dhe percaktimi i zonave te zhvillimeve te reja dhe zonat e reja te zgjerimit jane bazuar ne parimet e meposhtme duke marre ne konsiderate udhezimet ekzistuese dhe praktikat me te mira te vleres universale si me poshte:

**i. Perqendrimi i zhvillimit:** bazuar ne parimet e PZHBJ, zonimi ka per qellim te mbeshtese nje numer te kufizuar polesh zhvillimi te identifikuar aktualisht me ndikim te ulet, duke respektuar nevojen primare per te ruajtur vleren e nje pejsazhi thelbesisht te paprishur dhe te pazhvilluar ne shkalle rajonale. Zonimi synon ne kete menyre te shmang zhvillimet sporadike (te shperndara, autonome) qe ndikojne ne natyren e virgjer te pejsazhit ne teresi te Bregdetit Jugor dhe komprometojne vleren e saj te pergjithshme dhe kufizon perftimet potenciale ne ato ekonomike.

**ii. Racionalizimi i zhvillimeve ilegale:** Zonat e zgjerimit urban duhet te percaktohen per lehtesimin, racionalizimin dhe konsolidimin e zhvillimit ekzistues sporadik dhe/ ose te paligjshme ne perputhje me kerkesat e Qeverise se Republikes se Shqiperise, te politikës se planifikimit bregdetar, strategjive dhe planeve, si dhe me skemat perkatese te planifikimit.

**iii. Perdorimi ekonomik i infrastruktures:** Zonimi ka per qellim te mbeshtese shfrytezimin ekonomik te infrastruktures ekzistuese dhe asaj te propozuar, pa shkaktuar mbi perdorimin.

**iv. Homogjeniteti i zonave:** Eshte e nevojshme te siguroj rregulla te plote ne menyre te thjeshte qe do te jene te lehta per t'u zbatuar. **Shkalla e zonave** duhet te ndjehet dy konsiderata parimore:

- Sigurimin e nje zone te nje madhesie absolute ne menyre qe te shmanget nje strukture e fragmentuar urbane dhe rregulloreje te komplikuar, duke ruajtur korrektesine brenda morfologjise urbane.
- Te mund te pergjithesoje perdorimin sipas perdorimit kryesor ne çdo zone. Per shembull, nje zone rezidenciale do te jete pershkruar si nje zone homogjene, pa pasur nevojën per te detajuar ne nje harte te perdorimit te tokës hapësirat publike te hapura, zonat e parkimit qe gjenden brenda tij, etj.

**v. Kombinimi i rezidencave me zhvillimet turistike:** Nje nga qellimet kryesore te zonimit eshte qe te siguroje percaktimin e zonave atraktive dhe te pershtatshme per zhvillimin e turizmit ne menyre qe te terheqe investime ne vende te veçanta duke siguruar cilesi te larte te zonave te zhvillimit te ardhshem. Kjo perfshin nje politike te ruajtjes se disa zonave te veçanta ne pjesen prane bregdetit per lloje te ndryshme te turizmit duke vene kushte qe te kufizojne ose ndalojne banesat apo tipe te tjera zhvillimi, ne menyre qe te shmanget konsumimi i burimeve te vlefshme bregdetare. Kjo parashikon nje qasje te ndryshme per pjese te ndryshme te territorit si me poshte:

- Percaktimin e nje numri te kufizuar te zonave te hotelerise ne pjese te veçanta te bregdetit qe do te kombinohet me aktivitete komerciale qe jane te lidhura me turizmin, si bare, restorante dhe turizmin cilesor. Keto do te formojne bazen per terheqjen e vizitoreve ne vartesi te perqendrimit ekzistues te popullsisë. Eshte propozuar qe banesat atje, duhet te jene te kufizuara ne 10% te siperfaqes totale te zones.
- Percaktimi i zonave turistike dhe resorteve ne vende atraktive, si zona te reja zhvillimi te destinuar per te pranuar investime te nje cilesie te larte e nje densiteti te ulet. Zhvillimet ndertimore rezidenciale duhet te planifikohen si pjese e skemes se pergjithshme dhe te lejohen deri ne 50% te kapacitetit total te shtreterve.
- Hotele familjare “shtrat dhe mengjes” (B&B) ose ato te dhenies me qira eshte lloji kryesor i akomodimit turistik qe funksionon sot ne zone. Variacione te ketij lloji mund te zhvillohen ne qytetin e Himares, ne zonat e shtepive te dyta, vendbanimet tradicionale dhe zonat e zgjerimit te periferive te orientuara me udhezime te veçanta te zhvillimit urban. Megjithate sipas rastit duhet te vendoset kapaciteti maksimal i shtreterve (per shembull 20 shtreter per banese), ne menyre per te shmangur prishjen e struktures urbane.
- Vilat e pushimeve me nje qender sherbimesh ndihmese jane te lejuara ne zonat urbane dhe zgjerimet e fshatrave apo zonat e shtepive te dyta.
- Qendra e qytetit te Himares do te jete e vetmja zone e cila merr karakteristikat e qendres se nje qyteti, ku kombinohen banesat, turizmi, aktivitetet tregtare, etj.

**vi. Konsiderata Mjedisore:** Nje parim themelor per zonimin e perdorimit te tokes eshte zbutja e rreziqeve mjedisore dhe faktoret qe kane nje ndikim negativ ne cilesine e jetes se banoreve dhe te shendetit publik, si dhe te cilesise se burimeve ne zone. Rekomandimet e me poshtme jane bere ne PZHBJ ne lidhje me perdorimin e qendrueshem te burimeve natyrore bregdetare, te cilat jane marre ne konsiderate ne procesin e zonimit:

- *Cilesia e ujit te bregdetit duhet te mbrohet nepermjet kufizimeve te rrepta ndaj zhvillimit ne zonat ekologjikisht te ndjeshme (se bashku me zonat e larta me vlere te konsiderueshme te peisazhit, si dhe plazhet) nder te tjera, i) ndertimi i infrastruktures se trajtimit te ujerave te zeza ne vartesi te dendesise, dhe ii) zbatimin e rregulloreve te tilla qe kerkohen per te siguruar lidhjen me sistemet qendrore, si dhe mirembajtjen e sistemeve individuale.*
- *Zhvillimi bregdetar duhet modeluar ne shkalle dhe ne shperndarje (bazuar se pari nga objektivat e zhvillimit ekonomik dhe konceptet e menaxhimit te aseteve dhe pejsazhit), ne perputhje me burimet e disponueshme te ujit siperfaqesore dhe nentokesore).*
- *Sisteme eficente te largimit te mbetjeve te ngurta duhet te jene funksionale (rregulloret, mbledhja, grumbullimi, transportimi dhe hedhja e tyre), si nje parakusht per çdo zhvillim bregdetar.*
- *Shnderrimi i tokes ekonomikisht produktive per perdorime urbane duhet te minimizohet (te tilla si toka bujqesore, pemetari dhe pyjet, etj), per te ruajtur vleren e aseteve turistike (peisazhin kulturor dhe vlerat e saj si burim turizmi) dhe potencial per te diversifikuar ekonomite lokale.*

- *Nje politike per te mbeshtetur modalitetet e nje energjie-efektive eshte e nevojshme lidhur me: i) udhetimin dhe transportin; ii) teknikat konstruktive te ndertimit, iii) metoda operacionale per infrastrukturen e turizmit dhe veprimtari te tjera ekonomike, se bashku me iniciativa per te gjeneruar forma te tilla te energjise se paster, qe nuk e komprometojne vleren e paprekur te peisazhit te zones bregdetare.*
- *Rregullore specifike jane urgjente per te kontrolluar dhe menaxhuar: i) guroret e hapura per ndertim dhe per materialet mbushese; dhe ii) heqjen e mbeturinave, asgjесimin e materialeve te teperta te mbushjes dhe ndertimit / prishjeve. Rregullore te tilla duhet te mbulojne vendndodhjen dhe menaxhimin e trojeve, me kerkesa specifike per ndikim te ulet funksional dhe rehabilitimin perfundimtar pas ndertimit.*
- *Zhvillimi duhet te kufizohet ose te ndalohet ne zona te cilat jane te rrezikshme per shkak te gjeologjise, gjeomorfologjise apo permbytjeve.*
- *Disa perdorime ekonomike, kryesisht materiale inerte, magazina dhe aktivitetet e blegtorise (dhe disa objekte te infrastruktures) duhet te jene te ndara nga zonat e banuara, objekteve publike te cilat shoqerohen me grumbullime publike dhe tregti. Prandaj zonat ekonomike duhet te dallohen ne baze te efekteve te jashtme mjedisore.*

### III | 3. KONCEPTI I PROPOZUAR I ZONIMIT DHE KATEGORIZIMI I TOKES

Bazuar ne mjetet metodologjike te paraqitura me lart, Konsulenti propozon nje sistem klasifikimi **te zonave te pergjithshme te perdorimit te tokes**, te cilat jane analizuar me tej **ne perdorues specifik te tokes**, ose **tipi i zenies se lejuar te tokes** (apo e ndaluar) brenda çdo zone te perdorimit te pergjithshem te tokes, ne lidhje me destinacionin e tij te deshiruar. Konsulenti ka konsideruar PZHBJ te miratuar si nje udhezues kryesor per te percaktuar metodologjine e perdorimit te tokes per planin lokal duke perfshire dhe kufizimet e saj, si dhe sigurimin e perputhshmerise me aktet nenligjore te miratuar rishtazi per planifikimin territorial. Sistemi i propozuar i klasifikimit, i cili eshte prezantuar me poshte dhe reflektuar ne hartat e Perdorimit te Tokes, do te diskutohet me tej me autoritetet bashkiake dhe do te finalizohet ne formulimin e Planit Rregullues.

Kategorite e propozuara te perdorimit te tokes jane ndare ne dy lloje: i) ato qe synojne te aplikuar ne “zonat te zhvillimit potencial”, siç percaktohet nga analiza e nivelit rajonal (pas eliminimit te te gjitha zonave me kufizime, keto jane zonat e mbetura), dhe ii) kategori te pavarura nga niveli rajonal i zhvillimit te zones, te identifikuara, te cilat synojne te aplikohen per te gjithë rajonin, pavaresisht nese jane ne brendesi apo jashte zonave te zhvillimit potencial.

Hapi i pare i percaktimit te perdorimit te tokes eshte identifikimi i zonave **te perjashtimit te zhvillimit** siç eshte percaktuar ne dispozitat e PZHBJ dhe vleresimit me te detajuar te ndermarre ne nivel lokal. Konsulenti pranoi kufizimet e rezervimit te zonave te larta bregdetare (i gjithë territori mbi lartesine prej 600m) dhe te rezervimit dhe mbrojtjes se shpateve te pjerret (me me shume se 30% pjerresi), per te krijuar nje kategori te gjere per “**zonat e larta malore**” ku do te ndalohet zhvillimi i pergjithshem. Kufijte e tyre te sakte jane percaktuar duke marre ne konsiderate vendndodhjen e rrugeve dhe vendbanimeve ekzistuese. Ne menyre te ngjashme eshte zbatuar distanca mbrojtese prej 50m nga çdo breg lumi, **per te mbrojtur lumin dhe rezervat ujore ne pergjithesi**.

Ne vazhdim **Zonat e Mbrojtura** jane percaktuar ne baze te nje rikonicioni te specializuar ne terren dhe te vleresimeve te kryer nga ekspertet e konsulentit duke marre ne konsiderate propozimin e PZHBJ per ndarjen ne dy kategori te pergjithshme te Rezervave te Mbrojtjes Mjedisore dhe te Zonave te Ruajtjes se Pejsazhit (Tabela X). Konsulenti ndoqi metodologjine e propozuar te PZHBJ ne realizimin e dy vleresimeve te pavarura te cilat çojne ne perputhjen/ mbivendosjen e pjesshme te perkufizimeve.

**Rezervat e Mbrojtjes Mjedisore** jane percaktuar ne baze te kritereve qe lidhen me vlerat ekologjike dhe te pejsazhit ne tre kategorite e meposhtme, ne perputhje me dispozitat e Ligjit 8906/2002:

- **Monumentet Natyrore** (Kategoria III) (Tabela 17) perfshijne formacionet natyrore, me nje siperfaqe deri ne 50 ha, te cilat paraqesin formime te veçanta gjeologjike dhe gjeomorfologjike apo habitate te rralla dhe te kercenuara me vlere te veçante shkencore dhe estetike. Ne monumentet natyrore, eshte aplikuar niveli i pare i mbrojtjes. Zonat e perzgjedhura per kete kategori perfshijne sistemin e kanioneve te



Ngjipes se bashku me formacionet erozive perreth tij si dhe aluvionet e Palases, te dyja jane deklaruar tashme si monumente natyrore. Pervec kesaj jane propozuar si kandidat per konsiderimin si zona te mbrojtura zonat: kanioni i Dhermiut dhe i Livadhit, pjese e bregdetit ne jug te Ngjipes, si dhe gadishulli i Ali Pashes. Elemente te vecante te tilla si shpella dhe peme te lashta jane perfshire ne kete kategori.

| Tabela 17: Kategoria e trete e zonave te mbrojtura ne Bashkine Himare |   |                         |
|---|---|-------------------------|
| Kat.  | Emri  | Siperfaqja e zones (ha) |
| III   | Qafa e Llogorase: Peisazh Kategoria III- Monument Natyre                | 18.37                   |
| III   | Zona Aluviale Palase: Kategoria III- Monument Natyre                    | 205.31                  |
| III   | Kanioni i Dhermiut: Kategoria III- Monument Natyre (i propozuar)        | 44.28                   |
| III   | Kanion i Ngjipes:Kategoria III- Monument Natyre                         | 45.25                   |
| III   | Kanioni i Ngjipes:Kategoria III-Monument Natyre (i propozuar)           | 17.83                   |
| III   | Kanioni i Ngjipes:Kategoria III-Monument Natyre (i propozuar)           | 18.99                   |
| III   | Ngjipe-Jali: Kategoria III- Monument Natyre(seri shpellash-i propozuar) | 39.73                   |
| III   | Vuno: Terra Rossa(Bokerimat)- Kategoria III:Monument Natyre             | 68.90                   |
| III   | Kanion i Vunoit:Kategoria III-Monument Natyre                           | 60.02                   |
| III   | Pilur Biomonument: Kategoria III- Monument Natyre                       | 0.82                    |
| III   | Kudhes Biomonument:Kategoria III- Monument Natyre                       | 1750.07                 |
| III   | Ishulli i Ali Pashait: Kategoria III-Monument Natyre (i propozuar)      | 1.07                    |

- **Zone e menaxhimit te habitateve dhe specieve** (Kategori IV):parku Ujor i Porto Palermos (Tabela 18), ku aplikohet niveli i trete i mbrojtjes. Veprimtarite e meposhtme jane te ndaluara ne kete zone ne baze te ligjeve te meposhtme; Ligji 8906/2002, 9868/2008, per zonat e mbrojtura, Ligji 9587/2006 per mbrojtjen e biodiversitetit dhe Ligji 8905/2002 per mbrojtjen e mjedisit detar:
  - *ndryshimi i gjendjes natyrore te rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve te zonave te lagura;*
  - *depozitimi i kimikateve;*
  - *levizja dhe parkimi i automjeteve jashte rrugeve publike dhe vendeve te caktuara*
  - *impiante peshkimi, peshkimi, si perdorim per qellime portuale ;*
  - *mbledhja e bimeve, mineraleve, gjetjeve paleontologjike dhe e gureve;*
  - *ngritja dhe funksionimi i objekteve per qellime ushtarake dhe mbrojtjeje.*

- *vendosja e stendave, tabelave te te dhenave, reklamave, shenjave dhe posterave, me perjashtim te atyre qe japin te dhena per objektivat e mbrojtjes se rezervatit;*
- *ngjitjet alpine, skite, kampingjet dhe ndezja e zjarreve jashte pikave te caktuara.*
- *Veprimtarite e parashikuara ne piken 2 te nenit 5 te ketij ligji dhe çdo veprimtari tjetër , qe nuk ndalohehet nga ky nen, mund te ushtrohen, pasi te pajisen me leje mjedisi.*

| <b>Tabela 18: Kategoria e katert e zonave te mbrojtura ne Bashkine Himare</b> |   |                                |
|---|---|--------------------------------|
| <b>Kat.</b>   | <b>Emri</b>   | <b>Siperfaqja e zones (ha)</b> |
| IV  | Parku ujqor i Porto Palermos –Rezervat natyror i menaxhuar (Zone menaxhimi i habitateve dhe llojeve)(i propozuar) | 600                            |
| IV  | Gjiri i Lllamanit - Rezervat natyror i menaxhuar (i propozuar)  | 10                             |

- **Peisazhet e Mbrojtura** (kategoria V) (Tabela 19) perfshijne territoret me te medha se 1000 ha me nje peisazh harmonik dhe te formuar mire me nje zhvillim karakteristik te relievit, ekosisteme te larmishme. Eshte propozuar te perfshihet ne kete kategori malet, pjese e territorit te bashkise dhe e gjithe zona bregdetare qe nuk jane pjese e nje kategorie tjetere te mbrojtjes, me perjashtim te fasades bregdetare te qytetit te Himares. Kjo perfshin nje zone me gjeresi te ndryshme qe ndryshon ne 50-150m me disa perjashtime. Ky percaktim perputhet me perkufizimin e distances 100m nga çdo burim ujqor per çdo ndertim te perhershem e cila eshte vendosur edhe nga ana e PZHBJ. Shkalla e katert e mbrojtjes eshte aplikuar per kete kategori qe perfshin ndalimin e aktiviteteve te meposhtme:
  - Mbjelljen/krijimin e pyjeve unike;
  - Shkarkimin dhe djegien e mbetjeve prane zonave publike;
  - Shtimin dhe shperndarjen e kafsheve dhe bimeve te panjohura;
  - Perdorimin e ushqimeve te skaduara per gjueti;
  - Ndertimin e autostradave, kanaleve vozitese dhe zhvillimin urban te zones;
  - *Transportin jashte rrugeve te percaktuara dhe vendeve te shenuara. Ky rregull nuk zbatohet per automjetet e shtetit dhe makinerite bujqesore ose pyjore, zjarrefikset, makinat veterinare dhe atyre te menaxhimit te ujit; garat me makina, motor apo biçikleta.*
  - *Veprimtarite qe ndryshojne perdorimin e territorit, perdoruesit kimike dhe ato te pesticideve,trajtimin e ujerave te zeza ne ferma, per zonat me te medha se 2 ha, aktivitetet te cilat nuk jane te ndaluara ne menyre te qarte si ne piken 2 te ketij neni,mund te ushtrohen vetem pasi ata te marrin leje mjedisore dhe te jene miratuar nga Keshilli Kombetar i Rregullimit te Territorit.*

| Tabela 19: Kategoria e peste e zonave te mbrojtura ne Bashkine Himare |  |                 |
|---|--|-----------------|
| Kat.  | Emri   | Siperfaqja (ha) |
| V   | Peisazh/peisazh deti: Kategoria V (i propozuar)          | 1.47            |
| V   | Peisazh/peisazh deti: Kategoria V (i propozuar)          | 2.35            |
| V   | Palasa- Çika: Peisazh: Kategoria V (i propozuar)         | 648.13          |
| V   | Peisazh/peisazh deti: Kategoria V (i propozuar)          | 0.07            |
| V   | Peisazh/peisazh deti: Kategoria V (i propozuar)          | 1.75            |
| V   | Palasa- Dhermi: Peisazh: Kategoria V (i propozuar)       | 1091.92         |
| V   | Peisazh/peisazh deti: Kategoria V (i propozuar)          | 14.78           |
| V   | Ilias-Vuno: Peisazh: Kategoria V (i propozuar)           | 1028.68         |
| V   | Peisazh/peisazh deti: Kategoria V (i propozuar)          | 0.94            |
| V   | Peisazh/peisazh deti: Kategoria V (i propozuar)          | 1.35            |
| V   | Pilur-Himare: Peisazh: Kategoria V (i propozuar)         | 911.78          |
| V   | Visha: Peisazh: Kategoria V (i propozuar)                | 1485.93         |
| V   | Peisazh/peisazh deti: Kategoria V (i propozuar)          | 3.21            |
| V   | Peisazh/peisazh deti: Kategoria V (i propozuar)          | 1.34            |
| V   | Peisazh/peisazh deti: Kategoria V (i propozuar)          | 29.67           |
| V   | Peisazh/peisazh deti: Kategoria V (i propozuar)          | 19.54           |
| V   | Llamani: Peisazh/peisazh deti: Kategoria V (i propozuar) | 53.15           |
| V   | Peisazh/peisazh deti: Kategoria V (i propozuar)          | 1.33            |
| V   | Pilur: Peisazh: Kategoria V (i propozuar)                | 2202.20         |
| V   | Qafa e Llogorase: Peisazh -Kategoria V(i propozuar)      | 123.46          |

- **Zonat e mbrojtura per menaxhimin e pasurive natyrore** (Kategoria VI) (Tabela 20) perfshin terriore te gjera, relativisht te izoluara dhe jo te banuara me qasje te kufizuar, ose rajone te cilat jane aktualisht me pak te populluara, por nen nje presion te vazhdueshem per t'u populluar dhe per t'u perdorur me gjeresisht dhe konvertimi i tyre ne nje perdorim intensiv eshte i paqarte ose jo i pershtatshem. Aksesi i kufizuar ne keto zona do te thote qe keto zona normalisht do te kerkojne kontroll, i cili eshte i varur nga presioni per te hyre dhe perdorur zonen. Disa zona te tokes bujqesore jane propozuar qe te perfshihen ne kete kategori. Niveli i katert i mbrojtjes eshte aplikuar ne zonat e mbrojtur per menaxhimin e burimeve.

| Tabela 20: Kategoria e gjashte e zonave te mbrojtura ne Bashkine Himare |   |                 |
|---|---|-----------------|
| Kat.  | Emri  | Siperfaqja (ha) |
| VI  | Zone e burimeve te menaxhuara-Kategoria VI (i propozuar)          | 23.95           |
| VI  | Zone e burimeve te menaxhuara-Kategoria VI (i propozuar)          | 82.98           |
| VI  | Zone e burimeve te menaxhuara-Kategoria VI (i propozuar)          | 119.07          |
| VI  | Palase: Zone e burimeve te menaxhuara-Kategoria VI (i propozuar)) | 57.42           |
| VI  | Qeparo: Zone e burimeve te menaxhuara-Kategoria VI (i propozuar)  | 173.76          |

**Pyjet** e ndodhura brenda zonave të mbrojtura përjashtohen nga klasifikimi sipas pyjeve për shfrytëzim.

Percaktimi i **zonave të Ruajtjes së Pejzazhit** ka ndjekur një vlerësim më të detajuar që u realizua në koordinim me formulimin e konceptit të zhvillimit hapësinor. Ndërsa distancat/rezervat për mbrojtjen e mjedisit janë në përgjithësi zona të ndalimit të zhvillimit, zonat e konservimit të pejzazhit janë konceptuar të lidhura dialektikisht me percaktimin aktiv të zonave të zhvillimit. Mjetet e mëposhtme janë përdorur për të krijuar dhe ruajtur karakterin e pejzazhit të zonës:

- **Zonat e larta dhe zgjerimet e majave të larta të thepisura:** Këto zona janë përcaktuar nëpërmjet zonimit hapësinor të SZHBJ dhe janë të mbrojtura nga ndalimi i përgjithshëm i zhvillimit. Një vlerësim më i detajuar i kufijve të tyre është bërë në këto faza duke marrë në konsideratë shoqërimin me zonat e zhvillimit dhe lidhjen në mes të zonës së sipërme/me të lartë dhe sipërfaqeve të larta. Gjithashtu një investim më i plotë është bërë në lidhje me zhvillimet ekzistuese, që kanë ndodhur brenda këtyre territoreve deri tani.
- **Shpatet e pjerrta dhe grykat:** Një përkufizim më i detajuar i kufijve dhe zonave tampon nisur nga këto karakteristika të rëndësishme gjeomorfologjike dhe eko-sistemes është bërë në të gjithë zonën e planifikimit.
- **Mbrojtja e pejzazhit kulturor-bujqësor:** Ndërmjet tokave bujqësore të zonës, zona të përcaktuara në pjesë të ndryshme të bashkisë janë përcaktuar si "pejzazhe bujqësore të mbrojtura" për të theksuar karakterin tradicional bujqësor të rajonit. Këto zona si rregull i përgjithshëm janë karakterizuar nga Pejzazhe të paprishura dhe të qëndrojnë në afërsi, por jo në kontakt të drejtëpërdrejt me zonat e banimit. Pejzazhet bujqësore janë objekt i kufizimeve rigoroze të zhvillimit, me përjashtim të aktiviteteve agro dhe eko turistike që synojnë të mbeshtesin ekonominë bujqësore, duke shërbyer si nxitje për ringjalljen e aktiviteteve tradicionale.
- **Percaktimi i zonave tampon dhe zgjerimi i zonave të banuara:** Duke ndjekur udhëzimet dhe dispozitat e planit të miratuar, një vlerësim më i detajuar i pejzazhit është kryer në çdo zonë, për të identifikuar në mënyrë të kombinuar zonat e pershtatshme për zgjerimin dhe percaktimin e zonave mbrojtëse për ruajtjen e fshatrave kulturore dhe historike, duke marrë parasysh kufizimin prej 500 m, të vendosur nga SZHBJ. Zonimi është kryer bazuar edhe në propozimet për përmirësimin e strukturës së rrjetit rrugor dhe aksesibilitetit/qasjes.
- **Korridoret e veçante vizuale:** Një vlerësim teknik specialistesh të pamjeve nga pika të favorshme është kryer në mënyrë të veçantë për të përvijuar korridore pamore. Kjo kategori përfshin të gjitha pamjet drejt detit nga rruget kombëtare ekzistuese, si dhe ato në brendësi.

- **Percaktimi i rezervës tokësore:** Sipas perkufizimit të SZHBJ, kjo kategori përfshin tokat rurale të eliminuara nga zonat e zhvillimit potencial në fazën e formulimit të planit vendor të përdorimit të tokës. Identifikimi i rezervave tokësore ka ndjekur analizën e cilesive së pejsazhit, për të identifikuar **hapesirën kryesore strukturore të gjelber** që është e nevojshme për të ruajtur cilesinë e përgjithshme të pejsazhit bregdetar. Kjo përfshin lloje të ndryshme sipërfaqesh, të tilla si gadishujt, brezat e gjelber urbane, ndaresit e hapësirave të ndertuara, zonat vegjetale të cilat formojnë pjesën e parë të korridoreve vizuale. Si hap i dytë, kjo kategori përfshin të gjithë token e mbetur brenda zonave të zhvillimit potencial pas caktimit të tokës për qëllime zhvillimi. Brenda sipërfaqeve rezerve mund të caktohen nen-përdorimet në fazën e ardhshme të formulimit të planit rregullues.

**Zonat e zhvillimit** janë përzgjedhur pas përcaktimit të atyre rezervë dhe zonave me kufizime në zhvillim/ndertim. Ata janë përcaktuar në bazë të një numri kriteresh të propozuara nga Konsulentit, të mbështetura dhe aprovuar nga sygjërimet e bashkisë, me qëllim për të akomoduar nevojat e identifikuara për zhvillimin e turizmit të ardhshëm, sipas vizionit dhe strategjisë së prezantuar. Dy kriteret kryesore janë aplikuar në përcaktimin e zonave të zhvillimit: i) përmirësimi i strukturës së zonave të vendbanimeve dhe racionalizimin e zhvillimit ekzistues. Keto vlejne si për zgjerimin e zonave ekzistuese të ndertuara dhe synon të trajtojë problemet e krijuara si rezultat i praktikave të zhvillimit sporadike që kanë qenë karakteristike në 10-15 vitet e fundit, ii) rritjen e interesit për zonat e caktuara për zhvillimin e turizmit të ardhshëm në terriore të cilat ende nuk janë prekur nga zhvillimet joformale me qëllim forcimin e avantazhit konkurrues të bashkisë, në mënyrë që të tërheqë investime të reja për turizmin e cilesive së lartë. Kjo është një formë pro-aktive.

Zonat e Zhvillimit jane ndare ne tre kategori kryesore:

**1. Zonat e Zhvillimit Turistik** jane zonat te destinuar per zhvillimin e formave te ndryshme te pergjithshme te nje turizmi te interesit te veçante, te cilat formojne profilin e zones, ashtu si ato jane identifikuar ne fazen e meparshme te studimit si pjese e Vizionit dhe Strategjise per Zhvillimin e Turizmit. Si rregull i pergjithshem zonat e percaktuara posaçerisht turistike, perjashtojne aktivitete te tjera te cilat nuk jane ne perputhje me karakterin e zones dhe zhvillimet rezidenciale qe nuk jane te lidhura me skemen e pergjithshme te zhvillimit. Kategorite e propozuara te zonave te zhvillimit turistik, jane te pershkruara ne tabelen e meposhtme:

**Tabela 21: Kategorite e propozuara te zonave te zhvillimit turistik**

| Perdorimi i pergjithshem i tokes | Pershkrim i shkurter – Marredhenia me planin e propozuar  |
|----------------------------------|---|
| <b>Zonat Hoteliere</b>           | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Densitet i mesem ndertimi / ne vartesi te siperfaqes.</li> <li>▪ Keto permbajne zhvillime te organizuara hotelesh me sherbime te ndryshme ndihmese te perfshira ne parcela min. 0.2 ha, ku te gjitha ndertesat nuk kalojne lartesine gjashte (6) kate.</li> <li>▪ Mbase si pjese e zonave urbane ose zona zhvillimi te veçanta.</li> <li>▪ Turizem tregtar qe perfshin bare, restorante dhe turizmin qe i cili nuk eshte pjese i resorteve turistike mund te lejohet ne zone, ose te parashikohet si zona shtese prane zonave te caktuara hoteliere.</li> <li>▪ Jo me shume se 10% e zones dhe strukturave te saj mund te perdoren per qellime rezidenciale.</li> <li>▪ Ne zone nuk lejohet tregtia me shumice apo nje aktivitet tjeter ekonomik.</li> <li>▪ Perdorim i veçante lejohet vetem nese eshte e nevojshme te jete atje duke ju nenshtruar rregullave strikte.</li> </ul>  |
| <b>Zonat resort</b>              | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Densitet i ulet ndertimi.</li> <li>▪ Planifikimin dhe menaxhimin e zones dhe sherbimeve per hotel dhe vila si nje entitet i vetem zhvillimi me te madhe se pese (5) hektare. Te gjitha ndertesat nuk kalojne lartesine tre (3) kate.</li> <li>▪ Ato jane te vendosura kryesisht ne zona me parametra te caktuara apo vende te tjera te veçanta te ofruara nga Plani per miratim te veçante te Projektit pas aplikimit prane Autoriteteve Lokale qe vjen pas shprehjes se interesit per zhvillim.</li> <li>▪ Zonat e caktuara mund te menaxhohen nga nje agjenci e vetme zhvillimi (private ose PSP) me nje qiradhenie afatgjate.</li> <li>▪ Zhvillimet rezidenciale ne formen e vilave ne pronesi private bashkangjitur hoteleve me hyrje te veçante (condominiums) mund te jene pjese e skemes se zhvillimit te gjithanshem deri ne 50% te siperfaqes totale te ndertimit.</li> <li>▪ Objektet e perbashketa mund te perfshijne nje game te gjere sherbimesh dhe objektesh.</li> <li>▪ Planet, konfigurimi dhe kapaciteti jane subjekt i propozimit te master-planit te dorezuar autoriteteve lokale qe perfshijne propozimet teknike per sigurimin e infrastruktures dhe lidhjen me sistemet rajonale dhe propozimi financiar per ndarjen e koston.</li> <li>▪ Intensiteti i zhvillimit mund te jete teme e negociimit per tej kufijve te percaktuara nga Plani Rregullues deri ne 10% ne kembim me</li> </ul> |

| Tabela 21: Kategorite e propozuara te zonave te zhvillimit turistik |   |
|---|---|
| Perdorimi i pergjithshem i tokes                                    | Perskrim i shkurter – Marredhenia me planin e propozuar   |
|   | <p>sigurimin e infrastruktures dhe perfitimeve shtese per komunitetin lokal.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ 'Leja e Zhvillimit te Integruar te Zones (LZHIZ)' eshte e kerkuar per kete kategori.</li> </ul>   |
| <b>Vila Pushimesh</b>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Densitet ndertimi i Ulet ne te Mesem.</li> <li>▪ Kjo kategori perfshin vila me nje grup sherbimesh ndihmese ne nje parcel min. 0.2 ha, ku ndertesat nuk kalojne lartesine tre (3) kate.</li> <li>▪ Ato ndahen ne parcela te veçanta zhvillimi me akses rrugor dhe sherbime te infrastruktures kryesore te siguruar deri ne afersi te kufirit te secilit bllok.</li> <li>▪ Vilat e Pushimeve mundet gjithashtu te vendosen brenda zonave rezidenciale dhe ne zonat te shtepive te dyta duke respektuar kerkesat e zonave respektive.</li> <li>▪ Kapaciteti maksimal i çdo vile nuk mund te jete me shume se 10 shtreter dhe siperfaqja minimale e ndertimit nuk mund te jete me pak se 40 m<sup>2</sup>.</li> <li>▪ Pjesa ndihmese mund te perfshije objekte te perbashketa restorante, pishina, dyqane, etj.</li> <li>▪ Nuk mund te jene struktura te perkohshme</li> </ul>  |
| <b>Kampingjet Turizmi ekologjik dhe objektet e jashtme</b>          | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zonat e hapura me mundesi akomodimi ne tenda me higjiene dhe sherbime te siguruar dhe te menaxhuara.</li> <li>▪ Ato ndodhen prane zonave me vlera natyrore siç jane parqet periferike dhe ambientet ujore, mbase per caktuar ne zona te veçanta si zona te trashegimise natyrore (Ligji i zonave te mbrojtura 8906/2002 dhe 9868/2008).</li> <li>▪ Jane per fshire disa objekte te perqendruara turistike per higjiene, restorante dhe rekreacioni. Objekte te perbashketa siç jane pishinat, sportet, etj jane te lejuara.</li> <li>▪ Disa struktura akomodimi te perkohshme (vila) qe nuk e kalojne 10% te kapacitetit total jane te lejuara per parcela me te medha se 2.5 ha</li> <li>▪ Siperfaqja minimale eshte 1ha dhe gjeresia minimale 60m.</li> <li>▪ Zonat e perbashketa mund te jene me peme, ku nuk lejohen tenda per siperfaqe me pjerrresi me te madhe se 10%.</li> <li>▪ Parkime dhe hapësire per karvan duhet te parashikohet.</li> </ul> |
| <b>Zonat Agro-turistike</b>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Densitet i ulet ndertimi.</li> <li>▪ Kjo kategori perfshin akomodim tipi rural/ fshati ne vila tradicionale te pozicionuara ne mjedise piktoreske.</li> <li>▪ Vizitoret kane mundesi te shijojne produktet lokale te prodhuara direkt ne fshat dhe te mund te marrin informacion per historine e zones.</li> <li>▪ Pozicionuar ne Zonat e Peisazheve Bujqesore te pasurive te menaxhuara, te cilat nuk e kalojne 10% te siperfaqes totale te zones.</li> <li>▪ Madhesia e parceles minimale eshte 0.5ha.</li> </ul>  |

**2. Zonat Rezidenciale** perbejne dhe pjesen me te madhe te territorit te urbanizuar te Bashkise Himare duke pferishire ketu zonat e shtepive paresore dhe dytesore. Disa nga sherbimet ndihmese per turizmin mund te perfshihen ne keto zona, sigurisht sipas kushteve specifike per secilen prej tyre, sikurse edhe sherbime te tjera qe jane ne perputhje me zonat rezidenciale. Zonat Rezidenciale perfshijne nje shumellojshmeri terriroresh: i) zonat ekzistuese urbane dhe ato fshatare me kufijte e percaktuara nga ortofotot e vitit 2007; ii) zonat e zgjeruara te propozuara per qytetin dhe fshatin nga Konsulenti per te mundesuar mbulimin e nevojave ne te ardhmen bazuar ne projeksionet programatike; iii) zonat e reja te zhvillimit per shtepite e dyta; iiii) fshatrat e trashegimise kulturore. Kategorite e propozuara per zonat e zhvillimit rezidencial dhe sherbimet qe i shoqerojne ato jane pershkruar ne tabelen e meposhtme:

| <b>Tabela 22: Kategorite e propozuara per zonat e zhvillimit rezidencial</b> |   |
|--|---|
| <b>Perdorim i pergjithshem i tokes</b>                                       | <b>Pershkrim i shkurter – Marredhenia me planin e propozuar</b>   |
| Zonat paresore Rezidenciale Urbane   | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Densitet ndertimesh i mesem ne te larte</li> <li>▪ Prani mbizoteruese per perdorim rezidencial</li> <li>▪ Aktivitet tregtar i ulet deri i mesem (zakonisht duke perdorur katet e para te ndertesave)</li> <li>▪ Hotele (duke iu permbajtur kufizimeve te zones)</li> <li>▪ Aktivitete prodhuese jo ndotese</li> <li>▪ Infrastruktura sociale(sherbime edukimi, hapësira te gjera, sherbime shendetesore dhe kulturore, administrata)</li> <li>▪ Perfshin zonen ekzistuese dhe ato ne zhvillim te qytetit te Himares</li> </ul> |
| Zonat paresore rezidenciale ne fshat   | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Densitet i mesem ndertimi/shtepi banimi jo me shume se tre kate te larta</li> <li>▪ Prani mbizoteruese e perdorimit rezidencial</li> <li>▪ Aktivitet tregtar i kufizuar qe ploteson nevojat lokale</li> <li>▪ Hotele familjare dhe “shtrat dhemengjes” (B&amp;B) ose “shtepi fjetjeje me qira” (kapaciteti maksimal 20 krevate)</li> <li>▪ Struktura sociale (sherbime edukimi, hapësira te gjera, sherbime shendetesore dhe kulturore)</li> <li>▪ Perfshin zonat ekzistuese dhe ato ne zhvillim te fshatrave</li> </ul>       |
| Zonat e shtepive te dyta   | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Densitet i ulet ndertimesh (me pak se 10 njesi per ha)</li> <li>▪ Prani mbizoteruese e shtepive te dyta</li> <li>▪ Aktivitet tregtar i kufizuar sezonal qe ploteson nevojat lokale</li> <li>▪ Hotele(duke iu permbajtur kufizimeve te zones)</li> <li>▪ Vila Pushimi (duke iu permbajtur kufizimeve te zones)</li> <li>▪ Keto jane zona kryesisht te reja apo edhe ato ekzistuese ne zhvillim qe jane te ngjashme me modelin.</li> </ul>   |
| Zonat e trashegimise kulturore   | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zona rezidenciale brenda zonave te mbrojtura te trashegimise kulturore</li> <li>▪ Vetem rikonstruksioni lejohet brenda kufijve ekzistues sipas rregullores specifike urbane.</li> <li>▪ Politika speciale inkurajuese jane parashikuar per rehabilitimin e banesave ekzistuese dhe perballimin e turizmit</li> </ul>   |



| Tabela 22: Kategorite e propozuara per zonat e zhvillimit rezidencial |  |
|---|--|
| Perdorim i pergjithshem i tokes                                       | Pershkrim i shkurter – Marredhenia me planin e propozuar   |
|   | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Hotele familjare dhe “shtrat dhe mengjes” (B&amp;B) ose “shtepi fjetjeje” te ndertuar brenda mureve ekzistuese (kapaciteti maksimal 20 krevate)</li> <li>▪ Mund te jete nje fshat i tere apo nje pjese e nje fshati malor</li> </ul>  |
| Zonat e pershtatshme rezidenciale                                     | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ndertime me densitet shume te ulet (2.5 njesi per ha) – jashte planit</li> <li>▪ Ndertim shtepish per banim jo me te larta se dy(2) kate</li> <li>▪ Keto zona shtrihen ne afersi te kufijve te zonave te urbanizuara apo zonave qe kane karakter rezidencial dhe qe mund te perfshihen ne plan ne te ardhmen</li> </ul> |

**3. Toka per Aktivitet prodhues,** krijojne tipin e trete te kategorise se perdorimit te pergjithshem te tokes qe perfshin te gjitha pjeset e urbanizuara te territorit te Bashkise qe i takojne aktiviteteteve ekonomike qe nuk duhet te shtrihen ne zonat rezidenciale dhe/ ose zonat per zhvillimin e turizmit. Ketu dallohen dy kategori:

- Nje kategori toke qe nuk eshte e nevojshme te lokalizohet ne zona specifike por te percaktohet sipas kerkesave specifike si p.sh distanca e shkurter nga vendbanimet dhe zonat e turizmit. Njesite e prodhimeve blegtorale bejne pjese ne kete kategori dhe qe kategorizohen ne tre nenkategori ne vartesi te numrit te kafsheve te vogla, te mesme dhe te medha. Impiantet e rritjes se peshkut jane gjithashtu objekt i kufizimeve te largesive nga zonat e zhvillimit te turizmit qe mbeshtet ne nje vleresim te specializuar. Po ashtu mund te thuhet edhe per guoret dhe vendhedhjen e materialeve inerte.
- Kategoria tjetere eshte ajo qe perfshin token me impakt ekonomik te ulet ku perfshihen hapësira relativisht te medha qe jane te lidhura dhe qe mbeshtetin zonat urbane. Ketu perfshihen magazinat, dyqane te medha te shitjes me pakice dhe supermarkete, njesi prodhuese te vogla ushqimore, panairë, qe duhen te perqendrohen ne zona te caktuara me akses te veçante dhe qe te mos jene te dukshme nga zonat perreth. Konsulenti ka perzgjedhur hapësira te pershtatshme per kete qellim ne afersi te qytetit te Himares. Gjithashtu mund te perfshihen ne kete zone edhe infrastruktura speciale te bashkise si parking per automjetet e bashkise, thertoret, prodhues energjie etj.

### III | 4. NDARJA E TERRITORIT NE NJESI-STRUKTURE DHE NEN-STRUKTURE

Organizimi hapësinor i **njesive dhe nennjesive strukturore** është një proces paralel me procesin e zonimit të përdorimit të tokës, i cili shërben si mjet themelor metodologjik për organizimin funksional të territorit të bashkise dhe planifikimin e shërbimeve sipas standardeve të planifikimit të miratuara në legjislacionin kombëtar. Caktimi i njesive dhe nennjesive është i lidhur direkt me popullsinë ekzistuese dhe ato të planifikuar, si dhe dendësinë e popullatës, numrin e parashikuar të turistëve dhe të vizitorëve, si dhe shpërndarja e shërbimeve sociale (arsim, kujdesit shëndetësor, kulturë, sport dhe gjelberim).

Caktimi i njesive dhe nennjesive strukturore zbatohet vetëm për pjesën e urbanizuar të territorit të parashikuar duke marrë në konsideratë formimin e zonave të vazhduara urbane apo njesive të ndara territoriale. Zonat janë njësi relativisht homogjene ku përqendrohen një sërë karakteristikash të përbashkëta, siç janë përdorimi i tokës, tipologjia hapësinore, destinacioni i zhvillimit dhe profili social-ekonomik. **Kriteret** në procesin e ndarjes të zonave në njese strukturore ka marrë në konsideratë organizimin e territorit të bashkise në pesë njese hapësinore të identifikuar, siç përcaktohen në fazat e mëparshme të punës, të cilat janë formuar nga grupimet e vendbanimeve urbane apo rurale me funksionimin dhe lidhjet historike me njëri-tjetrin, në lidhje me plazhet, aktivitetet e tyre prodhuese, tokën dhe kultivimin e tyre.

Percaktimi i **nenzonave** synon të përcaktojë zonat e një karakteri dhe të destinacionit me specifik, ku dispozitat e planifikimit dhe zhvillimit do të zbatohen, në mënyrë që të lehtësojë procesin e realizimit të kontrollit të zhvillimit. Për më tepër ato mund të shërbejnë si një referencë udhëzuese për përgatitjen e planeve të detajuara urbanistike, me shpesh në zonat e reja të zhvillimit.

Kriteri për percaktimin e strukturës së nennjesive përfshin:

- a. Kompaktesimin dhe uniformitetin e tipologjisë së hapësirave ekzistuese dhe atyre të reja;
- b. Planifikim uniform dhe dispozitat e zhvillimit;
- c. Përdorim homogjen të tokës apo përdorim i kombinuar i tokës (në raste të përdorimeve të përziera);
- d. Ekzistenca e vlerave të rëndësishme të entiteteve kulturore dhe natyrore;
- e. Kufizimin me rrjet rrugor dhe/ose me kufij të tjere natyrore;
- f. Mire percaktimin e zonave prioritare të zhvillimit apo zonat për realizimin e projekteve të rëndësishme të qytetit.

Në rastin e zonave në studim, struktura e njesive mund të përputhet me strukturën e nennjesive kur struktura e njësive, pavarësisht nga madhësia e saj ka përdorim homogjen të tokës dhe planifikim uniform të dispozitave të zhvillimit, për shembull në rastin e një zgjidhje tradicionale.

Plani përfundimtar i percaktimit të njesive dhe nennjesive do të përcaktohet në kontekstin e Planit Rregullues.

### III | 5. DENSITETI I POPULLSISE DHE I ZHVILLIMIT TE TURIZMIT

Llogaritja e dendesise se popullsisë ne pergjithesi, perben nje mjet shume te dobishem per vleresimin e kapaciteteve te zonave te zhvillimit urban dhe per caktimin e zgjerimeve te reja, kjo eshte vetem pjeserisht relevante per rastin e Bashkise Himare. Kjo per shkak te mosperputhjeve demografike ndermjet popullsisë se regjistruar zyrtarisht dhe popullsisë aktuale, si pasoje e emigrimit dhe nivelet te larta te levizshmerise se banoreve. Popullsia rezidente e perhershme ne dimer eshte pothuajse sa nje e treta e asaj te konstatuar gjate sezonit te veres. Megjithate, llogaritjet duhet te behen ne baze te shfrytezimit te pergjithshem te zones dhe te popullates se pergjithshme prezente gjate sezonit te pikut. Kjo e fundit perfshine llogaritjen per nje shumellojshmeri te kerkesave te parashikuara: (a) popullsisë se perhershme rezidente; (b) popullsisë qe vetem shpenzon disa jave / muaj ne vit ne shtepite e dyta ose shtepite familjare (c) turistet, (d) vizitore ditore, kryesisht ne vere, te cilet nuk qendrojne gjate nates dhe (e) punonjesve sezonale.

**Densiteti i pergjithshem i popullsisë (DPP)**– shpreh raportin e banoreve mbi siperfaqen totale te nje zone. Nivele te ndryshme te ketij indeksi baze te planifikimit korrespondojne me karakteristikat e ndryshme te zhvillimit urban dhe afersisht pershkruajne morfologjine e indit hapesinor, praktika me e zakonshme eshte kategorizimi i zonave si zona me dendesi te ulet, te mesem dhe te larte. Duke ju referuar indeksit DPP per **zhvillimet rezidenciale**, praktikant nderkombetare veçojne tre kategori:

- Densiteti midis 100-400 banore/ha, pergjithesisht krijon nje standard te pranueshem per zonat ne qytet dhe zonat e banuara; referuar si densitet i mesem;
- Densiteti me i ulet se 100 banore/ha eshte konsideruar se zona me densitet te ulet, siç jane zonat suburbane te qyteteve apo zonat e shtepive te dyta. Kjo situatë karakterizon pjesen me te madhe te zonave te zhvilluara se fundi ne Bashkine e Himares;
- Densiteti ndermjet 400-600 banore/ha, eshte konsideruar si zona “te ngopura” te qendrave te qyteteve te medha te cilat nuk kane te bejne me qytetin e Himares dhe nuk ka nje skenar per zhvillimet e ardhshme.

Per sa i perket indeksit DPP per **zhvillimin e turizmit**, legjislacioni i planit kombetar per zhvillimin e territorit percakton normen qe i referohet planit per zonat turistike si dhe siç ilustruhet ne Tabelen 23.

| Tabela 23: Densiteti i pergjithshem i popullsisë per zhvillimin e turizmit |  |  |
|--|--|--|
| Kategorite dhe treguesit   | Kategorite turistike te uleta dhe te mesme | Kategorite e larta turistike dhe ato te elites |
| Intensiteti i turistëve ne resortin turistik                               | 100 – 150 vizitor/ha                       | 50 – 100 vizitor/ha                            |
| Siperfaqja mesatare e reres, zhavorrit dhe shkembinjve bregdetare          | Jo me pak se 6 m <sup>2</sup> /vizitor     | Jo me pak se 10 m <sup>2</sup> / vizitor       |
| Gjatesia e plazhit qe i takon  | Jo me pak se 0.5 ml/vizitor                | Jo me pak se 0.7 ml/vizitor                    |
| Siperfaqe deti per vozitje   | 1 ha/motorbark<br>0.5ha/anije me vela      | 1 ha/motorbark<br>0.5ha/anije me vela          |

Klasifikimet e mesiperme perputhen me standardet e rinovuara nderkombetare te cilat japin:

- 8 deri 9 shtreter per 1000m<sup>2</sup> per parcelat e hoteleve te reja me 5\* dhe 4\* qe i korrespondojne kategorise se turizmit elitare dhe
- 10 deri 12 shtreter per 1000m<sup>2</sup> per parcelat qe i korrespondojne kategorise se turizmit te mesem.

Gama e mesiperme e DPP duhet te perdoret si reference ne normat e planifikimit urban dhe te sherbejne per karakterizimin e zonave te zhvillimit rezidenciale dhe te densitetit te turizmit te ulet, te mesem dhe te larte me perpunime te metejshe, ne menyre qe t'i pergjigjet sa me mire kushteve aktuale dhe atyre te parashikuara urbane ne zonen se studimit. **Zona reference/baze** per llogaritjen e dendesise ekzistuese dhe te planifikuar te popullsise eshte nennjesia, me perjashtim te rasteve te vendbanimeve te vogla malore qe perbejne nje njesi me vete.

**Siperfaqja e ndertimit per banore/ vizitore-** Nje pjese integrale per llogaritjen e territoreve te nevojshme per zhvillimet rezidenciale dhe ato turistike (si dhe per vleresimin e vellimit te pergjithshem te ndertimit qe potencialisht do te zhvillohet/ ndertohet) ne baze te dendesise se popullsise se planifikuar, jepen nga shifrat standarde te "*siperfaqes se ndertimit per banore*" dhe "*siperfaqes se ndertimit per vizitor*". Keto indekse planifikimi jane perdorur shpesh ne praktiken e planifikimit nderkombetar, por norma e tyre tipike ndryshojne nga njeri vend ne tjetrin.

- Per zhvillimet/ndertimet rezidenciale, praktikantet me te mira nderkombetare ne menyre tipike praktikojne nje norme prej 30 m<sup>2</sup>/ banore. Konsulenti propozon nje shifer me fleksibel standardi, ndermjet 25-30 m<sup>2</sup>/ banore, ne perputhje me karakterin e çdo zone.
- Per zonat e zhvillimit turistik perdoret nje game e gjere, qe varet nga niveli i sherbimit dhe i destinacionit te çdo zone turistike:
  - 10-15 m<sup>2</sup>/ vizitor ne shtepite e uleta 1 kateshe;
  - 15-25 m<sup>2</sup>/ vizitor mesatarisht ne hotele dhe vila;
  - 25-30 m<sup>2</sup>/ vizitor ne resorte luksoze.

**Nevojat territoriale per infrastrukture fizike dhe sociale-** Nevojat territoriale per infrastrukturen sociale dhe fizike ne nje zone urbane jane llogaritur si nje perqindje e caktuar e siperfaqes totale te saj. Me fjale te tjera, zhvillimet rezidenciale dhe turistike te nje terreni qe eshte parcele private mbulojne vetem nje pjese te zones dhe pjesa tjeter eshte e rezervuar per rruget, hapesirat e gjelbra, parkingjet, sherbimet publike, etj.

- Per zhvillimet rezidenciale, Konsulenti, bazuar ne praktikantet nderkombetare te planifikimit, sugjeron nje raport prej rreth 40% (e destinuar 25% per infrastrukturen sociale dhe 15% per rruget). Kjo shifer vlen vetem pjeserisht ne qytetin e Himares dhe nuk eshte e rendesishme per vendbanimet e tjera malore dhe rurale.
- Per zonat e reja te zhvillimit (te gjitha llojet e zonave te hotelerive dhe zonat e shtepive te dyta), ky raport mund te reduktohet ne 20-30%, duke pasur parasysh mungesen e nevojave per infrastrukture te caktuara sociale. Megjithate, duhet theksuar se ne terrenet me pjerrtesi mbi 20° (e cila ndeshet shpesh ne Himare) perqindja reale e tokes qe do te jene te pershtatshme per zhvillim do te jete shume me pak, per shkak te pjerrtesise te medha.

### III | 6. SHERBIMI SOCIAL

#### (OBJEKTET ARSIMORE, KUJDESI SHENDETESOR, KULTURA DHE SPORTET)

Organizimi dhe shperndarja e mire e objekteve arsimore, kujdesit shendetesor, gjelberimit, objekteve kulturore e sportive, jep nje kontribut te madh per krijimin e zonave funksionale dhe terheqese urbane dhe rurale. Planifikimi ka per qellim te siguroje qe keto objekte te jene te mjaftueshme dhe te arritshme. Ne lidhje me sherbimet sociale, Himara ka nevojte per te permbushur sfidat e nje popullsie heterogjene qe ndryshon vazhdimisht dhe gjate gjithe vitit, perhapjen e vendbanimeve dhe aksesit shpesh te veshtire per shkak te distancave, cilesise se infrastruktures dhe gjeomorfologjise se terrenit.

Siç dihet nje sherbim social i referohet nje grupi specifik te popullsise ose vendi/zone te veçante: Edukimi referuar banoreve te perhershem te nje zone, duhet te llogaritet ne baze te te dhenave aktuale te popullsise. Ne menyre te ngjashme objektet sportive i referohen kryesisht struktures senje zone urbane dhe jane me te rëndesishme per rastin e qytetit te Himares (duke mos llogaritur sportet e ujit dhe ato te lidhura me turizmin dhe aktivitetet e kohese lire nuk llogariten). Nga ana tjetere, objektet e kujdesit shendetesor duhet te mbulojne sa me shume te jete e mundur nevojat e te gjithe territorit dhe popullsise, konkretisht nevojat e popullsise se per hershme gjate gjithe vitit, por edhe te turisteve dhe vizitoreve qe kryesisht perqendrohen pergjate zonave bregdetare dhe perkohesisht gjate sezonit te veres. Ne menyre te ngjashme, objektet kulturore, i sherbejne banoreve vendas, por sherbejne ne te njejten kohe si atraksione te rëndesishme per turistet dhe vizitoret e zones.

Se fundi, hapesirat e gjelberta dhe te hapura, ne kontekstin e hapesirave publike, parqeve dhe shetitoreve, kryesisht i referohen zonave urbane te Himares dhe zonave te reja te zgjerimit dhe ne nje mase me te vogel shesheve te brendshme, te banesave dhe atyre siperfaqeve te vogla ne zonat malore. Per pjesen tjetere te territorit, me karakter rural dhe zgjerimet e plazheve si dhe entitetet natyrore dhe mjedisore, nocioni i hapesirave te gjelberta urbane nuk eshte i pershtatshem.

Tabela 24 ilustron standardet e kerkuara per sherbimet sociale ne Shqiperi, ne raport me popullsine rezidente dhe shkallen e vendbanimit, sipas Dekretit per "Miratimin e Rregullores se Planifikimit Uniform" (ndryshim i Ligjit 10.119 te vitit 2009, mbi Planifikimin Territorial). Siç mund te verehet, megjithese popullsia e regjistruar zyrtarisht e Bashkise se Himares tejkalon 10.000 njerez, duket me e arsyeshme per te perfshire Himaren ne kategorine e pare te qendrave te banimit (deri ne 10.000), duke pasur parasysh karakterin rural te zones dhe mosperputhjet demografike te pershkruara me lart.

| Tabela 24: Standardet e kerkuara per sherbimet sociale ne Shqiperi |                      |                       |                       |                       |                       |                       |                       |
|--|----------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|
| Qendra te banuara  | Banore aktual        | Perdorim i publik     | Hapesirat e gjelbra   | Sportet               | Arsimi                | Parkimi Publik        | Totali                |
|  | m <sup>2</sup> /ban. | m <sup>2</sup> / ban. | m <sup>2</sup> / ban. | m <sup>2</sup> / ban. | m <sup>2</sup> / ban. | m <sup>2</sup> / ban. | m <sup>2</sup> / ban. |
| Deri ne 10,000   | 25                   | 2                     | 5                     | 3.5                   | 4.0                   | 3                     | 51.5                  |
| mbi 10,000   | 25                   | 2                     | 9                     | 3.5                   | 4.5                   | 3                     | 52                    |

**Arsimi-** Sigurimi i objekteve arsimore eshte nje pjese integrale e planifikimit te politikave dhe praktikave moderne. Arsimi fillor dhe ai i mesem i ofrojne brezit te ri mjetet teorike dhe praktike qe do te kontribuojne ne zhvillimin social dhe ekonomik. Planifikimi ka per qellim te siguroje objekte te mjaftueshme, ndersa parimi themelor per funksionimin efikas te objekteve arsimore eshte aksesueshmeria ne to.

- *Objekte e arsimit baze* (çerdhet, kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare):
  - *Ne zonat urbane*, (qyteti i Himares) parimi i aksesit eshte i perfshire ne planifikimin e objekteve te arsimit fillor,te cilat jane te lidhur me lagjet, duke siguruar qasje me rruge lokale dhe dytesore te lagjeve. Distancat ajrore te mbulimit te zonave te sherbimit respektojne dispozitat kombetare te planifikimit.
  - *Ne zonat rurale*, qe eshte rasti me i ndeshur ne territorin e bashkise, objektet arsimore kane nje mbulim te vogel rajonal, per shkak te terrenit dhe te vendbanimeve, popullsise se vjeter dhe numrit te kufizuar te nxenesve. Ato duhet te jene te vendosura ne qendrat e njesive te banuara. Eshte e nevojshme qe te lehtesoje sa me shume te jete e mundur aksesin e nxenesve ne objektet arsimore dhe edukative, per shembull nepermjet autobuseve dhe te sigurimit te vend stacioneve te tyre per te siguruar transportin e sigurte te nxenesve qe perdorin autobuset e shkollave.
- *Objekte e arsimit te meset* (shkollat e mesme, qendrat profesionale dhe shkollat, etj) duhet te pozicionohen ne zona qe kane aksesibilitet te larte perfshire dhe transportin publik. Per rastin e Himares, duke pasur parasysh siperfaqen e territorit,objektet e arsimit te mesem konsiderohen te parendesishme duke pasur parasysh karakterin dhe strukturen hapesine te zones.

Kuadri i strukture se re ligjore siguron normat minimale per ne njesite dhe nen njesite e banimit te shperndarjes se objekteve arsimore:

- Per objektet e arsimit fillor koeficienti eshte 4.5 m<sup>2</sup>/ per banore.
- Per objektet e arsimit te mesem koeficienti eshte 1.5 m<sup>2</sup>/ banore.

Norma me te detajuara per objektet arsimore jane demonstruar ne Tabelen 25.

| <b>Tabela 25: Normat per objektet arsimore</b>                                       |                               |                                     |   |  |
|--|-------------------------------|-------------------------------------|---|--|
| <b>Vendodhja</b>   | <b>Klasat/<br/>kapaciteti</b> | <b>Madhesia e<br/>parceles (ha)</b> | <b>Parcela<br/>m<sup>2</sup>/nxenes</b> | <b>Distanca ajrore e<br/>mbulimit te<br/>sherbimit</b> |
| <b>Çerdhe</b>  |                               |                                     |   |  |
| Qytet: 25-30<br>femije / 1,000<br>banore;<br>Fshat: 13-15<br>femije/ 1000<br>banore. | 1                             | 0.09                                | 30                                      | 200-300m   |
|  | 2                             | 0.15                                | 25                                      |  |
|  | 3                             | 0.22                                | 25                                      |  |
|  | 4                             | 0.24                                | 20                                      |  |
|  | 10                            | 0.04                                | 40                                      |  |
|  | 20                            | 0.06                                | 30                                      |  |
| <b>Kopshte</b>   |                               |                                     |   |  |
| Qytet  | 1                             | 0.15-0.2                            | 24-32                                   | 250 – 500m   |
|  | 2                             |                                     |   |  |
|  | 3                             | 0.24-0.3                            | 20-25                                   |  |
|  | 4                             |                                     |   |  |
|  | 5                             | 0.32-0.4                            | 18-22                                   |  |
|  | 6                             |                                     |   |  |
| Fshat  | 1                             | 0.15-0.2                            | 24-32                                   | 500 – 900m   |
|  | 2                             |                                     |   |  |
|  | 3                             | 0.24-0.3                            | 20-25                                   |  |
|  | 4                             |                                     |   |  |
|  | 5                             | 0.32-0.4                            | 18-22                                   |  |
|  | 6                             |                                     |   |  |
| <b>Shkolla 9-vjeçare</b>   |                               |                                     |   |  |
| Qytet  | 8                             | 0.8                                 | 28                                      | 500  |
|  | 16                            | 1.2                                 | 21                                      | 500  |
|  | 24                            | 1.6                                 | 20                                      | 500-600  |
| Fshat  | 8                             | 0.6                                 | 20                                      | 1000   |
|  | 16                            | 0.8                                 | 28                                      | 1200   |
|  | 24                            | 1.2                                 | 21                                      | 1900   |
| <b>Objektet e arsimit te mesem</b>   |                               |                                     |   |  |
| Tipi i shkolles  | Kapaciteti                    | Madhesia e<br>parceles (ha)         | Parcela<br>m <sup>2</sup> /nxenes       | Distanca ajrore e<br>zones se mbulimit                 |
| Shkolla te<br>mesme ne qytet   | 16                            | 1.4                                 | 25                                      | 1000   |
|  | 20                            | 1.6                                 | 20                                      | 1200   |
|  | 24                            | 1.8                                 | 19                                      | 1400   |
|  | 28                            | 2                                   | 18                                      | 1500   |
| Shkolla te<br>mesme ne fshat   | 8                             | 1                                   | 31                                      | 2500   |
|  | 12                            | 1.4                                 | 28                                      | 3000   |
|  | 16                            | 1.6                                 | 25                                      | 4700   |
| Shkolla te<br>mesme te<br>pergjithshme<br>ne qytet                                   | 16                            | 1.2                                 | 20                                      | 1000   |
|  | 20                            | 1.6                                 | 20                                      | 1200   |
|  | 24                            | 1.8                                 | 19                                      | 1400   |
|  | 28                            | 2                                   | 18                                      | 1500   |

**Kujdesi Shendetesor-** Mbulimi me objekte te kujdesit shendetesor eshte nje komponent thelbesor i standardeve te pranuar te jeteses dhe nje parakusht i rendesishem per zhvillimin e turizmit te bazuar ne sherbime cilesore. Vemendje e veçante duhet t'i kushtohet banoreve te perhershem te zones (sidomos ne rastet e popullsisë ne moshe te madhe (plakje), si dhe per vizitoret dhe turistet nga perspektiva e rritjes se parashikuar te sektorit te turizmit. Normat minimale te kujdesit shendetesor jo spitalor ne lidhje me rastin e Himares (kujdesi shendetesor primar) jane:

| Tabela 26: Normat minimale te kujdesit shendetesor jo spitalor |              |                            |
|--|--------------|----------------------------|
| Pershkrimi   | Parcela (ha) | Treguesit e Planifikimit   |
| Qendra e Kujdesit Shendetesor                                  | 0.07-0.1     | Nje per 1500 – 9000 banore |
| Ambulance Konsultimi   | 0.03-0.04    | Nje per 230 – 1200 banore  |

**Objektet kulturore-** Objektet kulturore jane nje komponent thelbesor ne njerën ane te zhvillimit shoqeror per ndertimin e kapitalit social dhe permiresimin e cilesise se jetes, ndersa ne anen tjetër si nje pasuri e madhe lidhur me zhvillimin e turizmit. Kategoria e objekteve kulturore perfshin nje game te gjere duke perfshire ketu bibliotekat, qendra kulturore te komunitetit, muzeume etj. Disa objekte mund te sigurohen nga bashkia, qeveria lokale ose kombetare, ndersa te tjeret mund te sigurohet nga organizatat jofitimpruresë ose private. Planifikimi i objekteve kulturore ne qytete duhet te marre parasysh nevojen per te siguruar objekte te mjaftueshme, ku banoret mund te mblidhen dhe te marrin pjese. Per rastin e Himares objektet kulturore te meposhtme jane te rendesishme:

- **Qendra kulturore, muzeumet:** Rekomandohet ekzistenca e ketyre objekteve ne strukturat historike te restauruara te vendbanimeve tradicionale. Kjo do te lejoje shfrytezimin me te madh te larmise tradicionale dhe do te kontribuojë per rivitalizimin e tyre.
- **Qendrat e komunitetit (per te rinjte, te moshuarit, etj.):** Eshte e mundur qe keto lloje klubesh mund te ofrohen si objekte te veçante ose si pjese e objekteve te integruar edukative.
- **Aktivitetet Kulturore:** Objekte te tilla si teatrot ne mjedise te hapura dhe kinemate mund te sigurohen, per organizimin e festivaleve verore, ndersa Bashkia apo aktore te tjere mund te organizojne dhe promovim te aktiviteteve, si festivale dhe festa fetare ne lidhje me monumentet kulturore te zones dhe praktikat ekzistuese, zakonet dhe traditat.



**Objektet Sportive-** Sporti perben nje burim te rendesishem te kohes se lire dhe kreative per banoret dhe vizitoret e zones, por edhe nje aspekt te rendesishem te jetes shoqerore. Sporti perfshin nje shumellojshmeri te objekteve, duke filluar nga kende lojerash per femijet deri te fushat e hapura te lojerave per sporte me top, deri ne strukturat e sportive formale te tilla si pishina dhe stadium. Objektet sportive jane planifikuar ne baze te zonave te sherbimit dhe te shtreses se synuar.

- **Objektet Sportive Lokale:** Sportet dhe fushat e hapura te lojerave duhet te sigurohen prane vendndodhjes se shkollave dhe te jene te hapura dhe te pranueshme per njerezit e zakonshem jashte oreve te mesimit. Norma e pergjithshme prej 1.6m<sup>2</sup> / banore e parashikuar ne kuadrin e ri ligjor dhe duhet te konsiderohet si nje kerkese minimale.
- **Objekte Sportive ne Nivel Qyteti:** Eshte e rendesishme qe zona te kete nje strukture bashkiake sportive te nje madhesie te caktuar, e cila perfshin nje shumellojshmeri te objekteve te hapura dhe te mbyllura dhe funksionimi i saj do te jete subjekt i studimeve te fizibilitetit. Siperfaqja e kerkuar duhet te respektoje normen minimale te 1m<sup>2</sup> / banore.
- **Objekte Sportive ne lidhje me Hotelet:** Nje pjese e objekteve sportive, te tilla si fushat e lojerave dhe pishina pritet te jene te vendosura ne zonat turistike ne kontekstin e zhvillimeve te hotelit si pjese e sherbimeve te ofruara per vizitoret.
- **Objektet Sportive Ujore:** sportet e ujit (nen dhe mbi ujore) jane veçanerisht te rendesishme per rastin e Himares dhe jane te lidhura ngushte me turizmin dhe aktivitetet e kohes se lire pergjate bregdetit. Ato duhet te veprojne ne nje ekuiliber me funksionet dhe aktivitetet e tjera, pa shkakuar zhurme apo shqetesim . Menaxhimi i objekteve sportive te ujit mund te ndermerren nga Bashkia apo sektori privat.

**Hapesirat e Gjelberta-** Rrjeti i hapësirave të gjelberta dhe të hapura luan një rol të rëndësishëm ekologjik në përmirësimin e mikroklimës, komfortin klimatik dhe kontrollin e balancave të rrjedhës ujore. Ai gjithashtu rrit strukturën urbane dhe kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës urbane dhe të imazhit të përgjithshëm të një zone, duke e bërë atë tërheqëse. Kuadri i ri ligjor i ndan zonat e gjelberta urbane në tre kategori të gjera:

- Gjëlberimi i përgjithshëm publik;
- Gjëlberimi i kufizuar publik; dhe
- Gjëlberimi i Veçante.

Specifikimin e këtyre kategorive, si dhe normat përkatëse minimale udhëzuese janë të paraqitura në Tabelën 27:

| <b>Tabela 27: Normat perkatase minimale udhezuese per zonat e gjelberta</b> |   |                                  |
|---|---|----------------------------------|
| <b>Zonat e Gjelberta</b>  | <b>Specifikimi</b>  | <b>Normat minimale udhezuese</b> |
| <b>Gjelberim i Pergjithshem Publik</b>                                      | Gjelberimi ne nennesine rezidenciale strukturore (p.sh. sheshet e lojerave)   | 2.5 m <sup>2</sup> /banore       |
|   | Gjelberim masiv i parqeve dhe kopshteve brenda nje zone banimi  | 1 m <sup>2</sup> /banore         |
|   | Gjelberim per gjate rrugeve, bulevardeve, shesheve dhe brigjeve ujore   | 1.5 m <sup>2</sup> / banore      |
|   | Totali  | 5 m <sup>2</sup> / banore        |
|   | Gjelberim i zones se pushimit te parkut periferik, i cili perveç gjelberimit mund te perfshije struktura te ndryshme per argetim, kulturore dhe aktivitete sportive | 8 m <sup>2</sup> / banore        |
| <b>Gjelberim i Kufizuar Publik</b>  | Zona te gjelberta per struktura per perdorim social ( sherbimet )   | 1-2 m <sup>2</sup> / banore      |
|   | Gjelberim perreth vilave individuale  |                                  |
| <b>Gjelberim i Veçante</b>  | Kopshte Botanike  | 0.3-0.5 m <sup>2</sup> / banore  |
|   | Kopsht Zoologjik  | 0.6-1 m <sup>2</sup> /i banore   |
|   | Çerdhe femijesh dhe / ose zona sanitare   | 0.8-2 m <sup>2</sup> / banore    |
| <b>Parqet Private</b>   |   | Pa Norma                         |

Eshte e qarte se masat e permendura me siper i referohen kryesisht zonave urbane dhe jane pjeserisht te aplikueshme per rastin e Bashkise se Himares. Normat minimale udhezuese duhet te aplikohen ne planifikimin urban dhe zonat e zgjerimit te fshatrave dhe te zonave te reja te zhvillimit. Lidhur me vete vendbanimet tradicionale keto norma jane me pak te rendesishme, duke pasur parasysh strukturen tradicionale dhe aktuale te popullsise rezidente. Ne menyre te ngjashme, ne rastet e zhvillimeve turistike bregdetare, ne llogaritjen e hapësirave te gjelbra dhe te hapur duhet te merret parasysh karakteri sezonal i te dhenave demografike, si dhe zgjerimet e hapësirave te gjelbra dhe publike te orientuara nga deti.

Me te rendesishme ne planifikimin e zonave te gjelbra, jane aspektet cilesore sesa ato sasiore, qe kane te bejne me percaktimin strukturor te hapësirave te gjelbra. Keto te fundit jane thelbesore per te ruajtur cilesite natyrore dhe vleren e pejsazhit dhe te perfshijne brezat e gjelber per te ndare zhvillimin e vazhdueshem urban nga korridoret, per te siguruar vazhdimesine vizuale dhe ekologjike midis hapësirave te hapura te zonave te vendbanimit dhe objekteve natyrore dhe mjedisore rrethuese. Referenca ne kete proces eshte bere edhe ne konceptin e zonimit ne seksionin ne vijim.

### III | 7. PLANIFIKIMI I PJESES SE ORIENTUAR NGA DETI

Ana e orientuar nga deti e zones se planifikimit eshte nje burim veçanerisht i ndjeshem, me rendesi thelbesore per destinacionin turistik dhe zhvillimin e Bashkise. Ajo luan nje rol ekologjik dhe mjedisor te rendesise se larte, duke permbajtur habitate dhe ekosisteme te veçanta, nderkohe qe rendesia e saj ekonomike eshte themelore, si aset i ose pasuria me e madhe e zones per zhvillimin e turizmit.

Perkufizimi i anes se orjentuar nga deti/ vijes ujore te bregdetit do te konsiderohet nje siperafeq prej rreth 500m distance nga bregu me gjeresi te ndryshme ne varesi te karakteristikave te relievit, i cili permban peisazhe te morfologjive te ndryshme. Ne perputhje me legjislacionin kombetar, Strategjine Kombetare per Zhvillimin e Turizmit, parimet e pergjithshme te SKZHT- se, si dhe Vizioni i Konsulentit mbeshtetin idene e nje zhvillimi organik te pjeses se orientuar nga deti , , e cila eshte e destinuar per nje zhvillim e turizmit te bute dhe te pjeseve te saj qe mbeten ne gjendjen natyrore.

Brenda territorit te Bashkise, ekzistenca e tipologjive te ndryshme te bregdetit, propozon koncepte te ndryshme te planifikimit per çdo rast. Tipologjite e anes se orientuar nga deti perfshijne:

- **Bregdetin Urban:** Bregdeti urban i qytetit te Himares perben nje pasuri te rendesishme ekonomike dhe mjedisore per karakterin dhe identitetin e zones, qe shtrihet nga Spilea (me portin e saj dhe Marina e vogel e projektuar), deri ne Potam. Parimi udheheqes ne kete rast ka per qellim te balancoj prioritetet ndermjet zhvillimit te turizmit dhe mbrojtjes se mjedisit. Kjo perfshin masa per permiresimin e atraktivitetit dhe aksesit te shetitores bregdetare, ndersa ne te njejten kohe ruan cilesite vizuale te pejsazhit rrethues te gjirit duke parandaluar zhvillime sporadike, si dhe mbrojtjen e cilesise se ujit te detit nga derdhja e ujerave te zeza urbane. Vend tjetër per veç qytetit te Himares, i cili pozicionohet ne anen ballore te vijes bregdetare eshte plazhi i Jales.
- **Vendet e Turizmit Bregdetar:** Zonat e karakterizuara nga presione te ndryshme per zhvillimin turistik bejne pjese ne kete kategori, te tilla si plazhet e Livadhit, Qeparo-it te Ri, Jales, Dhermiut dhe Drimadhes. Zonimi i kujdesshem eshte aplikuar ne varesi te karakteristikave gjeomorfologjike te çdo vendi dhe sipas orientimit te vizionit per çdo rast. Parimi udheheqes nuk eshte qe te tejkalojne kapacitetin e pejsazhit qe mund te vendosi ne rrezik atraktivitetin e percaktuar te plazhit. Si rregull i pergjithshem per plazhet e gjate, qe eshte konsideruar edhe ne llogaritjen e kapacitetit te plazhit, rreth 50% e gjeresise se plazhit me sfond perreth eshte planifikuar te qendroje ne forme natyrore. Ky rregull nuk zbatohet ne mjedise te mbyllura dhe te ngushta. Nje aspekt i veçante qe ndikon ne cilesine e pejsazhit bregdetar ne keto vende eshte i lidhur me strukturat e perkohshme te lehta, per te perballuar sherbimet turistike te tilla si restorante plazhi te hapura dhe bare, plazhe dhe kioska me paisje te sporteve ujore qe merren me qira dhe aktivitetet e ngjashme komerciale te cilat duhet te jene te vendosura prane

anes se detit. Rregullat e meposhtme jane propozuar per zonat e siperpermendura:

- Duhet te jene: i) te çmontueshme (ne menyre qe te merren poshte dhe te montohen pa demtuar materialet perberese); ii) te ndertuara mbi themele me platforma te ngritura, dhe iii) nuk duhen te ndertohen ne themele me bazament te perhershem ose te ngjashme me to.
  - Mund te perdoren vetem per perdorim rekreativ. Nuk lejohet asnje forme e akomodimit rezidencial apo turistik.
  - Nje pengese minimale prej gjashtembedhjete (16) metra nga burimet e larta te ujit e vijes se batices eshte e vendosur per strukturat e perkohshme prane bregdetit.
  - Distanca minimale qe duhet te mbahet ndermjet strukturave te perkohshme eshte caktuar ne 80m per kioska (deri ne 25m<sup>2</sup>) dhe 150m per lloje me te medha te objekteve (max 150m<sup>2</sup>).
  - Lejet e ndertimit per strukturat e perkohshme jane subjekt i lejes se veçante dhe jane te rishikueshme dhe te rinovueshme, nese eshte e pershtatshme ne çdo tre (3) vjet.
  - Bare, restorante, klube dhe aktivitete te tjera qe kerkojne kuzhine dhe instalime higjienike lejohen vetem me kusht qe ato te jene te bashkelidhura prane hotelit te licencuar apo te bizneseve te tjera te turizmit.
- **Pjeset shkembore te bregdetit:** Kjo kategori perfshin pjesen me te madhe te mbetur te bregdetit qe perfshin zonat e perjashtuara nga zhvillimi te caktuara nga SKZHT-se (zonat strategjike). Kjo zone ka nje kapacitet shume te madhe lidhur me karakterin e pejsazhit dhe per kete arsye duhet te ruhet dhe te qendroje ne mase te madhe ne gjendjen natyrore. Rregulli i distances prej 100m eshte i zbatueshem ne menyre universale per çdo ndertim dhe shtrihet ne çdo rast, ne varesi te mjediseve te specializuara dhe ne vleresimin e pejsazhit te ndermarre nga Konsulenti. Disa plazhe te vogla me akses te kufizuar dhe plazhi i Dralleos bejne pjese ne kete kategori dhe jane trajtuar me te njejtat parime.

Zhvillimi i pritshem i anes se orientuar nga deti duhet te jete ne harmoni me parimet e meposhtme:

1. Shmangia e trafikut automobilistik, i cili realizon shkeputjen e bregdetit nga struktura urbane;
2. Sigurimi i vendeve te mjaftueshme te parkimit;
3. Sigurimi i servitutit publik pergjate bregdetit dhe aksesit te sigurt per te gjithë;
4. Ruajtjen e karakterit te natyrshem te anes se orjentuar nga deti, duke e ruajtur ate ne gjendje natyrore dhe ndalimin e zhvillimit; si zone me kuptimin e sensit te eksplorimit dhe te largesise;
5. Mbajtja e distances se pershtatshme te ndertimeve nga bregdetit ne rastet e zhvillimeve te bregdetit dhe sigurimi i nje kuadri te qarte per ndertimet e perkohshme.


Normat me te hollesishme per zhvillimin e anes se orjentuar nga deti, ne perputhje me ndryshimet ne Ligjin e ri mbi Planifikimin Territorial, mbi “Rregullat Uniforme te Planifikimit”, si dhe masat e SKZHT-se jane treguar ne Tabelen 28:

| <b>Tabela 28: Normat per zhvillimin e anes se orientuar nga deti</b>   |  |
|--|--|
| <b>Parime</b>  | <b>Normat minimale udhezuese</b>   |
| <b>Shmangia nepermjet trafikut, i cili realizon shkeputjen e bregdetit nga struktura urbane</b>  | Rruge te reja te te gjitha kategorive nuk do te ndertohen me afer se 2 km nga bregu i detit. Rruget e domosdoshme ne sherbim te kesaj kategorie do te konceptohen se bashku me bregun si ne hapësirën e specifikuar ne kete pike.  |
| <b>Sigurimi i vendeve te mjaftueshme te parkimit</b>   | Se paku nje (1) parkim publik ne çdo plazh duhet te sigurohet.   |
| <b>Sigurimi i servitutit publik pergjate bregdetit dhe aksesit te sigurt per te gjithë</b>   | Nje servitut publik prej (10) metra eshte caktuar pergjate gjithë gjatesise se bregdetit. Servitutet nuk mund te pengohen nga asnje forme e zhvillimit, me perjashtim te zhvillimeve te lidhura me detin, te tilla si doket, molet, bankina dhe lloje te ngjashme te infrastruktures detare. |
|  | Ne zhvillim te vazhdueshem ne zonat para plazhit, aksesit per rrugen (minimumi (6) metra korsi me (10) metra rezerve duhet te ofrohet ne çdo (500) metra), dhe per aksesin per kembesore (per nje minimum (2.5) metra rruge ne (4) metra rezerve ne çdo (250) metra duhet te planifikohen.   |
| <b>Ruajtjen e karakterit te natyreshem te anes se drejtuar nga deti, duke e ruajtur ate ne gjendje natyrore</b>  | Madhesia minimale e hapësirave te hapura natyrore pa ndertime ne bregdet dhe mjediset detar (gjatesi 1 km me frekuence çdo 2 km).  |
| <b>Mbajtja e distances se pershtatshme te ndertimeve nga bregdetit ne rastet e zhvillimeve te bregdetit dhe sigurimi i nje kuadri te qarte per ndertimet e perkohshme.</b> | Kufizimet e ndertimit nga bregdeti dhe pergjate rripave me rezerva ujore ne baze te specifikave te L.8093/1996 "Per rezervat ujore".   |
|  | Per strukturat e perhershme ne vijat bregdetare te forta (shkemb): minimumi (100) metra nga burimet e larta ujore te vijes ujore   |
|  | Per strukturat e lehta te perkohshme prane bregdetit: Minimumi (16) metra nga burimet e larta ujore te vijes bregdetare- batices.  |
|  | Distanca minimale 1 km nga bregdeti per qendren e re te banimit urban ose zgjerimin e qendres ekzistuese ne menyre te tille qe mos jete e dukshme nga bregu.   |

### III | 8. MENAXHIMI I LUMENJVE DHE PERRENJEVE

#### 8.1 Hyrja

Lumenjte / perrenjte kane qene pike qendrore per zhvillimin e vendbanimeve urbane dhe te transportit te mallrave. Si rezultat mund te thuhet se lumenjte sherbejne si bosht i zhvillimit urban. Zhvillimi, zgjerimi i qyteteve kane rritur transportin modern dhe ate automobilistik duke bere qe lumenjte te humbin rolin e tyre te rendesishem ne rrejetin urban.



**Figura 28:** Prerje terthore dhe nje prezantim skematik i nje projekti rigjenerues te lumit/perroit

#### 8.2 Aspektet Integruese

Lumenjte / perrenjte mund te funksionojne si nje zone tampon ndarese midis sistemeve te ndertimeve urbane dhe mjedisve te hapura. Kjo eshte veçanerisht prekesa per lumenjte qe kalojne neper zonat me popullesi te dendur, ku lumi vepron si nje ndares pergjate shtrirjes se hapësirave. Per me teper, nje lume/perrua luan nje funksion te rendesishem social pasi ai sherben si nje mushkeri e gjelber per nje qytet, duke ofruar gjithashtu nje vend per kalimin e kohes se lire.

#### 8.3 Aspektet Hidrologjike

**Mbajtja/ruajtja e ujit te lumenjve:** Qellimi kryesor i ruajtjes/mbajtjes se ujit te lumit eshte per te rivendosur rrjedhen natyrale dhe historike te ujit te paster te lumit. Nje nga problemet kryesore eshte fakti se rrjedhat e lumenjve/ perrenjve te zones se Bashkise Himare jane shume te ndjeshme dhe kryesisht sezonale (per shkak te perberjes gjeologjike te shtratit te tyre) qe kerkon me shume perpjekje dhe studime specifike ne ruajtjen e rrjedhes ne shtratin e lumit, sa me gjate qe te jete e mundur te paster dhe te vazhdueshem, si nje nga aktoret me te rendesishem te peisazhit natyror te zones. Puna rehabilituese duhet te siguroje vazhdimesine e shtratit dhe te rrjedhes ujore te lumit, nderkohe qe duhet te kontrollohen shkarkimet e objekteve te ndryshme qe ndodhen rreth tij. E rendesishme te theksohet eshte se planet duhet te specifikojne standardet e cilesise se ujit ne veçanti ato te BE-se per trupat ujore si dhe hapat e nevojshem qe duhet te ndermerren per t'i arritur ato.

Perpjekje te veçanta duhet te behen ne zhvillimin e rritjes se vetedijes te publikut te gjere dhe te autoriteteve vendimmarrese per rolin e lumenjve ne jeten social-ekonomike te zones (kemi parasysh ketu ujitjen, permbytjet dhe perdorimin e gjere te tij si ambjent shlodhes dhe argetues).

**Kullimi:** Skemat e rehabilitimit te lumit duhet te marrin ne konsiderate problemet e kullimit, te pritave malore si dhe ato te permbytjeve ne nje menyre sa me te plote. Parametrat e kullimit duhet te plotesohen sa me shume te jete e mundur duke synuar ruajtjen e rrjedhes natyrore te lumit, mbrojtjen e pasurive natyrore dhe peisazhin nga demtimi. Veprat kulluese dhe pritat malore te ndertuara ne te kaluaren per mbrojtjen e tokes duhet te vleresohen dhe rehabilitohen per te evituar fenomenet erozive te humbjes se tokes, gje qe do t'i sherbente integritimit me te mire te lumit ne sistemin natyror te zones. Mirembajtja e duhur e sistemeve te kullimit eshte thelbesore per mbajtjen funksionale te vlerave natyrore.

**Permbytjet:** Duhet te krijohet nje ekuilibër midis kontrollit te permbytjeve (edhe pse nuk eshte nje problem shqetesues ne zone) dhe nevojave te ekosistemit te lumit / perroit. Kjo do te parandaloje demtimin e njerezve dhe te pasurise nga permbytjet dhe do te siguroje nje rregjim rrjedhje te nevojshme per proceset ekologjike te lumit.

**Rrjedhjet siperfaqesore, erozioni dhe mbrojtja e tokes:** Rrjedhjet siperfaqesore sherbejne si burim uji per lumin/perroin. Erozioni i tokes duhet te menaxhohet permes drejtimit te rrjedhjes se siperme dhe ndarjes se saj gjate shtratit. Kapja dhe kontrolli i rrjedhjeve siperfaqesore do te lehtesoje depertimin intensiv te ujit ne toke dhe do zhvilloje bimesine duke ndihmuar ne stabilizimin e tokes. Mbrojtja e tokes dhe parandalimi i erozionit kerkon menaxhimin e tokes bujqesore, aq me teper kur ajo ndodhet ne shpate te pjerreta sic eshte rasti i zones ne studim.

### III | 9. UDHEZUES PER VENDNDODHJET TRADICIONALE

Trashegimia kulturore perben lidhjen e nje vendi dhe nje komuniteti me te kaluaren dhe te tashmen e saj. Restaurimi, zhvillimi dhe rritja e pasurise historike dhe kulturore, forcimi i identitetit vendor, per te krijuar nje ndjenje te perbashket te perkatesise ndermjet banoreve. Me shume akoma asetet e trashegimise kulturore sherbejne si burim kryesor ne terheqjen dhe zhvillimin e turizmit dhe te sigurojne nje mjedis te mire per organizimin e veprimtarive sociale dhe kulturore.

Parimet per planifikimin e vendbanimeve tradicionale prezantuar me poshte i referohen: a) percaktimit te kufijve dhe te zonave te mbrojtura, b) restaurimit te qendrave ekzistuese; c) kriteret e projektimit per ndertime te reja ne zonat e trashegimise.

**Integriteti hapesor:** integriteti i nje zone te trashegimise ose te gjithe zones tradicionale / duhet te mirembahet dhe te trajtohet si nje e tere dhe jo si pjese te vecanta. Ky eshte parimi i "ansamblit" i cili perfshin strukturat, rrjetin e hapësirave publike te vendosura ne mjediset rrethuese me nje identitet historik qe i perket nje zone te caktuar. Ky parim reflektohet ne ligjin shqiptar mbi Percaktimin e Trashegimise Kulturore, te kufijve te zones se mbrojtjes dhe zonave tampon per sigurimin e pamjes i cili eshte mjete primar per mbeshtetjen e integritetit hapesor te vendndodhjeve tradicionale dhe zonave te trashegimise. Zgjerimi i vendbanimeve tradicionale, si nje nxitje per zhvillim, mund te procedoje, vetem nese eshte e nevojshme, me kusht qe vlerat e burimeve kulturore te ruhen dhe karakteri tradicional te mbrohet.

**Shkalla e mirembajtjes dhe cilesia e strukture ekzistuese:** Struktura ekzistuese e ndertimeve ne lagjet tradicionale eshte nje nga komponentet kryesore te integritetit te saj arkitektonike dhe historike. Zhvillimet e reja duhet te jene te ndjeshme ndaj shkalles ekzistuese si dhe cilesise hapesorine dhe ne pajtim me normat tradicionale. Ndertimet informale dhe ndertimet qe nuk respektojne karakterin tradicional, brenda dhe ne afersi te vendbanimeve duhet te kontrollohen menjehere.

**Zbatimi i kriterëve të projektimit:** Çdo ndertim i ri, restaurim apo modifikim ne ndertesat ekzistuese, duhet te permbushe nje sere kriteresh te projektimit ne lidhje me morfologjine e ndertimit. Keto kriteret jane formuluar per te siguruar qe zhvillimet e reja te jene vizualisht ne perputhje me karakterin tradicional te zgjidhjes dhe kryesisht merren me pamjen e jashtme te ndertesave. Pronaret jane keshilluar te marrin ne konsiderate avantazhet e projekteve te zbatuara ne menyren qe respekton traditat lokale, nderkohe qe duhet te jene plotesisht te integruara me standardet e jeteses bashkekohore, pra edhe me rritjen e vleres se proneve se tyre dhe per te siguruar qendrushmeri ndermjet pamjes se jashtme dhe karakterit te brendshem.

**Perdorimi i materialeve lokale:** Ndertimet ne vendbanimet tradicionale qofshin keto ndertime te reja apo ekzistuese, duhet te perdorin materiale lokale ose te ngjashme me to. Kjo do te ruaje vazhdimesine dhe uniformitetin ndermjet te rese dhe te vjetres, si dhe do te ruaje integritetin arkitektonik te zones.





**Figura 29:** Referenca: Kalldreme dhe sheshe publike te rinovuara ne Zagorohoria, Greqi

**Kufizimi i ndertimeve periferike:** Ndertimet ne zonat ngjitur apo perreth vendbanimeve tradicionale duhet te kontrollohet me kujdes dhe te monitorohen. Zonat brenda zones tampon kane per qellim te mbeten ne gjendjen natyrore ose te kultivojne dhe mbajne nje kontrast vizual me siperfaqet ne ndertim, nderkohe qe ato mbrojne pamjen drejt dhe ne drejtim te vendbanimeve. Ndertimet normalisht nuk lejohen brenda zones tampon, me perjashtim te rasteve te restaurimit te ndertimeve ekzistuese, ne gjurmet e ndertimit te meparshem dhe te kriterëve te veçanta te projektimit si me poshte.

**Dispozitat e infrastruktures baze:** Shumica e vendbanimeve tradicionale vuajne mungesen e infrastruktures baze te sherbimeve te tilla si linjat e furnizimit me uje, kanalizimet dhe rrjetit kullues te ujit, linjave te energjise elektrike dhe te telekomunikacionit. Strukturat e reja dhe ekzistuese duhet te sherbehen ne menyre adekuate dhe lidhja me infrastrukturen duhet te realizohet ne nje menyre financiare te pershtatshme, qe nuk do te kerkoje mirembajtje te rëndesishme afatgjate. Me e rëndesishmja megjithate, eshte permiresimi i infrastruktures dhe lidhjet duhet te behen ne nje menyre, qe te mos demtohen, prishen apo ndryshohen ne asnje rast ndertimet e jashtme tradicionale. Nje zgjidhje e kujdesshme dhe ekonomike ne menaxhimin e mbeturinave eshte e nevojshme te kryhet ne menyre qe te eliminohet ekzistenca e vendeve te hedhjes ne afersi te zonave te banuara.

**Restaurimi i rrjetit rrugor:** Restaurimi i rrjetit rrugor eshte nje komponent i rëndesishem i ruajtjes ne vendbanimet tradicionale. Eshte e rëndesishme qe te perdoren materiale dhe veshje te pershtatshme per rruget, qe te jene ne perputhje me karakterin e pergjithshem tradicional te vendbanimit.

**Ndriçim rrugor i integruar:** Ndriçimi rrugor duhet te integrohet ne peisazhin rrugor ne menyre te ndjeshme. Kjo perfshin perdorimin e llampadareve ne sasi dhe voltazhin e pershtatshem. Per me teper, ndriçimi i rrugeve duhet te perdoret per te theksuar elemente te veçante te zonave historike apo monumenteve kulturore, te cilat jane percaktuar si qendra per forcimin e imazhit te vendbanimit.



**Figura 30:** Referenca: Pjese e trashegimise se rinovuar te vendbanimit, Zagorohoria, Greqi

**Rivitalizimi ekonomik:** Vlera ekonomike e peisazhit kulturor, si nje burim per zhvillimin e turizmit duhet te vleresoje, sidomos pjeset e braktisura ose te shkaterruara. Banesat e shumta me struktura arkitektonike interesante dhe tradicionale te abandonuara ne vendbanime, ofrojne nje mundesi per zhvillimin e objekteve te akomodimit, ne formen e sherbimit B&B (shtrat dhe mengjes), se bashku me argetimin, aktivitetet kulturore dhe ato tregtare (te tilla si restorante, kafene, dyqane te vogla, qendrat kulturore dhe muzeume). Politikat e rivitalizimit duhet te synojne nje zhvillim te ekuilibruar, qe perfshin objektet turistike te orientuara, se bashku me perdorimin rezidencial, duke siguruar nje perzierje dinamike dhe terheqese te aktiviteve. Keto politika duhet te shoqerohen me stimuj per pronaret ekzistues ose te zhvilluesve potenciale dhe mekanizmave te zbatimit per te kapercyer problemet e pazgjdhura te prones. Normat e paraqitura ne tabelen e meposhtme, zbatohen per autoritetet kombetare dhe ato vendore, pronaret individuale, zhvilluesit e biznesit dhe sipermarresit e turizmit i referohen aspekteve te ndryshme te nderhyrjes ne zona te trashegimise te tilla, si restaurimi i komplekseve ekzistuese, zgjerimi i shtepive, ndryshimi ne perdorimin e hoteleve B&B, restorante, dyqane te vogla, ose vende te kultures.

**Tabela 29: Zhvillim i pergjithshem, kriteret e projektimit per ndertimet ne vendbanimet tradicionale<sup>5</sup>**

| <b>Kriteri i Pergjithshem</b>                    | <b>Normat Udhezuese</b>   |
|--|---|
| <b>Zonat tampon per vendbanimet tradicionale</b> | Minimumi 500m gjeresi zone nga perimetri i zones se ndertimeve ekzistuese ( vendosur nga fotografite ajrore te vitit 2007). Kjo zone 500m duhet ti referohet topografise se zones.  |
| <b>Zonat maksimale te zgjerimit</b>              | Maksimumi 20% e zones se banuar brenda 500m nga perimetri i zones se ndertimit ekzistuese ( vendosur nga regjistrimet ajrore te vitit 2007).  |
| <b>Zonat tampon per monumentet e kultures</b>    | Rreth zonave te klasifikuara si monumente kulturore te mbrojtura, nje siperfaqe e tokes do te percaktohet si zone e mbrojtur, me nje minimum gjeresie te vazhduar prej 200m.  |
| <b>Kriteret e Projektimit</b>                    | <b>Normat udhezuese</b>   |
| <b>Madhesia/ shkalla e ndertimit</b>             | Ndertimet e reja ose zgjerimet ne ndertesat ekzistuese nuk duhet te jene ne dukje me te medha se ato ekzistuese (te percaktuar ne Planin Rregullues, rast pas rasti).   |
|  | Ballafaqimi i vellimeve duhet te trajtohet arkitektonikisht ne menyre qe te perputhet me mjedisin e ndertuar ekzistues.   |
| <b>Lartesia e ndertimit</b>                      | Ne pergjithesi 3 kate ose 9m plus çati duhet te jete lartesia maksimale e lejuara (do te percaktohet ne Planin Rregullues, rast pas rasti).   |
| <b>Muret</b>                                     | Ne qofte se ndertimet e nje vendbanimi jane te ndertuara kryesisht prej guri, te gjitha muret e jashtme ne te gjitha ndertimet e reja duhet te behen me gure natyror te llojit perkates. Lidhjet dhe llaçi duhet gjithashtu te ndjekin traditen lokale. |
|  | Nese nje vendbanim ka nje numer te konsiderueshem te ndertesave me mure te suvatuara dhe lyera, ndertime e reja mund te ndjekin stile te ngjashme.  |
|  | Ndertimet e reja duhet te evitojne çdo diference vizuale me ndertimet e tyre ekzistuese.  |
| <b>Hapjet (dyert/dritaret)</b>                   | Ne perputhje me permasat e ndertesave tradicionale, ne ndertimet e reja hapësirat midis dritareve duhet te jete me e madhe se gjeresia e vete dritares (zakonisht 1,5-2,0 here, ne krahasim me gjeresine e dritares).                                   |
|  | Lartesia e hapjes normalisht duhet te jete 1,5-2 here me e madhe se sa gjeresi. Formatet horizontale te dritareve nuk duhet te lejohen ne çdo fasade qe eshte e dukshme nga nje perspektive e jashtme.  |
|  | Dyer te vetme me hapje te thjeshte katerkendore jane sugjeruar per ndertime te reja.  |
|  | Dyert e jashtme te harkuara te gjetura ne disa vendbanime (Dhermi, Vuno, Qeparo), mund te lejohen ne menyre qe te rritet interesi ne  |

<sup>5</sup> Adaptuar nga dokumenti ‘Udhezues per zhvillimin/ndertimin e fshatrave ne Rajonin e Bregdetit te Jugut (RBJ)’ perfshire si aneks ne rregulloren e aprovuar te SZHBJ

| Kriteret e Projektimit                                | Normat udhezuese   |
|---|--|
|   | <p>mjedisin e ndertuar, por ato nuk duhet te behen element dominues arkitektonike.</p> <p>Ne rastet e ndertimeve te reja qe kerkojne hapje te gjere (fasade dyqanesh, restorante, etj.), shtylla guri mund te ndajne nje seri dyersh pa shkaterruar karakterin arkitektonik te nderteses.</p>  |
| <b>Siperfaqet e jashtme te mbuluara</b>               | <p>Shtimi i objekteve te mbrojtjes diellore / pergola (korniza te lehta prej druri ose metali te mbuluara shpesh nga rrushi) per ndertesat eshte diçka pozitive. Ndertimet e renda prej betoni duhen te shmangen.</p> <p>Ballkonet prej betoni krijojne forma horizontale qe nuk perputhen me cilesite tradicionale. Ballkone duhet te behen prej druri apo guri, me gur ose trare hekuri. Parapetet duhen gjithashtu te bera nga druri apo hekuri.</p>  |
| <b>Çatia</b>  | <p>Te gjitha kulmet duhet te jene me dy ose kater pjerresi, duke ndjekur format e pershtatshme te vendbanimit. Çatite me nje pjerresi apo te sheshta mund te lejohen vetem ne se eshte e pranueshme nga tradita e vendbanimit.</p> <p>Te gjitha çatite duhet te kene pjerresi ne kendin tradicional, (rreth 23°)</p> <p>Mbulimi i çatise mund te jete pllaka argjili te formes Romake apo Bizantine, ose pllaka prej guri.</p> <p>Elementi i vetem qe mund te lejohet mbi çati eshte oxhaku apo sistemet e ventilimit te ndertuara ne formen e oxhaqeve tradicionale. Te gjitha elementet e tjera qe prishin pamjen e çatise (furnizimin me uje, antena TV, panele diellore, ajer te kondicionuar) duhet te vendoset ose ne hapesiren nen çati ose ne nje zone te veçante te mbyllur te padukshme me sy te lire.</p> |
| <b>Ngjyrat e lyerjes</b>                              | <p>Ne rast se vendbanimet tradicionalisht i lyejne objektet e ndertimeve te reja mund te zgjedhin te bardhen, oker te lehta ose ngjyren gri qe perputhet me guret ekzistuese. Ndryshimet e medha vizuale ndermjet ndertimeve te reja dhe atyre fqinje duhet te shmangen.</p> <p>Dyert, dritaret me kanate, dhe elemente te tjera te jashtme prej druri jane te lyera me ngjyren tradicionale te tokes, apo edhe blu, jeshile apo dhe te kuqe te zbehte. Ne pergjithesi edhe pse elementet e jashtme mund te jene te lyera, ata nuk duhet te terheqin vemendjen nga karakteri i pergjithshem i nderteses / vendbanimit.</p>   |
| <b>Punime jashte nderteses, (sherbime dhe nevoja)</b> | <p>Aty ku eshte e mundur tuba dhe kabllot duhet te futen ne ndertese. Nese nuk eshte e mundshme duhet te kete nje ndikim minimal negative. Drejtimi i gypave dhe kabllave te dukshme duhet te jete vertikale, i mbrojtur me gypa metalike dhe suva te lakuara qe pershtatet me ngjyren e nderteses.</p> <p>Te gjitha ndertesat e reja duhet te jene te pajisura me vend grumbullim te mbuluar te mbetjeve te ngurta javore, brenda vendndertimit, e cila te mos jete e dukshme nga hapesirat publike apo rruget hyrese.</p>  |
| <b>Punime te jashtme dhe mbjelljet</b>                | <p>Materialet riparuese ne rruget publike ose private duhet te jene ato qe jane perdorur tradicionalisht. Siperfaqet e asfaltuara ose te betonuara nuk</p>   |

| Kriteret e Projektimit            | Normat udhezuese   |
|-----------------------------------|--|
|                                   | <p>jane ne perputhje me traditen dhe nuk do te lejohen.</p> <p>Kullimi i ujerave siperfaqesore nga çdo prone private duhet te jete i lidhur ne menyre adekuate me te sistemin rrugore te kullimit, apo rrugices qe eshte e vendosur perballe prones. Kur kjo perfshin kanale te hapura, ato duhet te jene te ndertuara me materiale te ngjashme me rrugen apo kanalet me gur te njejte me ate te perdorur per zonat e shkarkimit</p> <p>Mbjellja e pemeve, rrushit dhe bimeve dekorative eshte e inkurajuar ne pergjithesi ne te gjitha zhvillimet ekzistuese dhe te reja. Megjithate, mbjellja e pemeve duhet te jete e kufizuar ne llojet tradicionale lokale (selvi, ullinj, agrume, etj). Lloje te huaja te bimeve si eukalipti e cila behet shume e madhe dhe terheq sasi te medha te lageshtise nga toka nuk duhet te lejohet.</p> |
| <b>Punime dherash dhe germimi</b> | <p>Duke ndjekur traditen e shtepive te ngritura dhe pershtatura ne shpate shkembore, ndertimet e reja duhet te minimizojne germimet per te siguruar qendrueshmerine statike.</p> <p>Kur germimet nuk mund te shmangen, materialet e germimit duhet te hiqen me kujdes. Ne disa raste kjo mund te behet ne vend, duke krijuar tarraca te reja guri ose mure mbajtese prej guri. Me mbjellje te kujdesshem mund te shtohet vlera peisazhit te vendbanimit.</p> <p>Materialet e germimit nuk duhet te mbahen brenda ose jashte zones apo te hidhen ne vende qe mund te jene te dukshme nga çdo pike e jashtme.</p>  |
| <b>Hyrja dhe parkimi</b>          | <p>Te gjitha ndertimet duhet te kene nje distance maksimale prej 30 m nga sherbimi i emergjences.</p> <p>Nuk ka asnje te drejte automatike te makinave ne pronat individuale, por hyrja do te jete e mundur atje ku eshte e pranishme sot dhe ku nuk krijon konflikt ndermjet kembesoreve dhe automjeteve.</p> <p>Ne shumicen e rasteve, hyrja ne pronat private do te behet permes nje rrugice qe eshte menduar ekskluzivisht per perdorim te kembesoreve. Keto do te jene te lidhura me zonat e parkimit.</p> <p>Te pakten nje parkim publik duhet te zhvillohet ne çdo vendbanim tradicional me kapacitet te pershtatshme, me ndikim te kufizuar negative pamore.</p> <p>Zonat e parkimit duhet te kene veshje te mjaftueshme per te ofruar mbrojtje nga dielli, uljen e ndotjes dhe permiresimin e vizual te vendbanimit.</p>        |

### III | 10. ZONAT TURISTIKE DHE TE SHTEPIVE TE DYTA

#### **Klasifikimi i Objekteve Turistike**

Klasifikimi i objekteve turistike sipas standardeve nderkombetare parashikon pese kategori, bazuar ne nje sistem yjesh (1, 2, 3, 4, 5 \*), qe korrespondon me nje numer te caktuar te standardeve te kerkuara dhe te kritereve renditese. Aktualisht ne Shqiperi nuk ka kritere te percaktuara ne nivel kombetar per kualifikimin sipas yjeve qe zbatohen ne menyre universale per te gjitha objektet e turizmit.


**Shkalla e njesise hoteliere:** Objektet e turizmit jane karakterizuar ne perputhje me standardet nderkombetare, nga me i vogli, kur ato kane nje kapacitet deri ne 100 shtreter, te mesem kur kane 101-300 shtreter dhe te medhenj kur ato i tejkalojne 300 shtreter. Ne rastin e Himares, nje shkalle me e ulet klasifikimi do te jete me e pranueshme, duke marre parasysh se aktualisht madhesia mesatare e njesive hoteliere eshte ndermjet 15-20 shtreter. Jane konsideruar shkallet e meposhtme:

- Hotele te vegjel jane konsideruar ato deri ne 20 shtreter. Ne kete kategori jane perfshire kryesisht banesat familjare B & B te ndodhura ne zonat e vendbanimeve, si dhe njesite agro-turistike.
- Hotele mesatare jane konsideruar ato deri ne 100 shtreter. Ne kete kategori jane perfshire pjesa me e madhe e objekteve turistike te cilat do te ndertohen ne dekadën e ardhshme dhe mund te gjenden, ne zonat turistike te percaktuara si ne zonat e banimit ashtu dhe ne zonat e zgjerimit te fshatrave.
- Hotele te medha konsiderohen ato me mbi 100 shtreter deri ne 300 shtreter te cilet jane te lejuara vetem ne zonat e caktuara per turizem. Kjo shkalle e investimeve aktualisht mungon ne zone dhe mund te jete e vetmja forme profesionale e biznesit te turizmit qe permbush kriteret e caktuara ne lidhje me sherbimet e ofruara, standardet e mjedisit etj. Njesia me e madhe hoteliere ne zone pritet te jete ne Porto Palermo.

**Tipet e ndertimeve turistike:** Ndertimet turistike jane klasifikuar ne pese (5) tipe kryesore si me poshte:

- 1. Hotele te Tipit Klasik,** permbajne:
  - Dhoma te thjeshta ose me hapesira ndihmese.
  - Zone per perdorim te perbashket;
  - Zone qendrimi te perkoheshme;
  - Restorante/ kafé/ bar/ zona rekreative.

Ky tip mund te marri formen e nje strukture unike, nje volumore ose kompleks strukturash te vogla qe formojne nje entitet brenda te njejtës parcele. Mund te jete nga 1 ne 5 yje.



**Figura 31:** Referenca: Hotel te tipit klasik (Thalatta seaside hotel), Evia, Greqi

**2. Vilat e pushimeve, permbajne:**

- Apartamente me nje apo me shume hapesira, me dhoma dhe kuzhine
- Zone te perbashket perdorimi;
- Zona qendrimi te perkohshme;
- Hapesira ndihmese.

Vilat e pushimit jane nje ose dy kate te larte, njesi te shkeputura, çdonjera nga to ka hyrje te pavarur dhe te drejtperdrejte qe siguron privatesine dhe jane te vendosura ne te njejten parcele. Prandaj, kjo kategori nuk perfshin banesat shumekateshe te blloqeve te banesave, te cilat kane hyrje te perbashket. Vilat e pushimeve mund te merren me qira ne jave, dite ose muaj. Ato mund te jene nga 1 ne 5 yje.



**Figura 32:** Referenca: Vilat e pushimit ne Ishullin Kea , Greqi



- 3. Tipi i perzier** (përfshin tipin klasik dhe vilat e pushimeve), mund të përmbajne:
- Dhoma me një banje.
  - Apartamente me një apo me shumë hapësira kryesore, me banje dhe kuzhinë.
  - Siperfaqe për përdorim të përbashkët;
  - Zona qendrimi të perkohshme;
  - Restorante/ kafë/ bar/ zona rekreative;
  - Përdorime komerciale për plotësimin e nevojave të klienteve;
  - Objekte sportive;
  - Marine;
  - Infrastruktura e vecante turistike (qendër konferencash, spa etj.)
  - Hapësira ndihmëse.

Kjo lloj e perzierjes të objekteve të hoteleve duhet të jetë e vendosur kryesisht në kuadër të zonave të caktuara për zhvillimin e turizmit. Ata duhet të jenë komplekse, që në teresinë volumore të përbejnë një njësi të vetme ekonomike brenda së njëjtes parcele. Një tip i tillë i zhvillimit duhet të sigurojë të paktën 50 shtreter në total dhe me standarde të kategorive 4 deri 5 yje.



**Figura 33:** Referenca: Tip i perzierjes luksoz turistike, Kosta Navarino, Greqi

**4. Kombinim i turizmit dhe objekteve rezidenciale,** permbajne:

- Te gjitha objektet e permendura me siper; dhe
- Njesite rezidenciale.

Kombinimi i referohet objekteve hoteliere qe ofrojne sherbime te standardeve te larta dhe te klasifikuara si kategori nga 4 deri ne 5 yje. Ajo siguron mundesine qe njesite e banimit munden edhe te shiten, ne menyre qe te mund te perdoren per sherbimet e standarteve te larta te turizmit. Ne kete rast perqindja e njesive te banimit nuk mund te tejkalojte 40% te siperfaqes totale te ndertimit ne vend, ndersa perqindja e hapësirave te hapura te perdorimit te perbashket do te llogaritet ne baze te infrastruktures hoteliere ne pergjithesi. Njesite rezidenciale duhet te kene hyrje te veçante nga hoteli dhe nje madhesi minimale prej 100m<sup>2</sup> duke perfshire tarracat.

Ky lloj paraqet si nje model i kombinuar i zhvillimit te turizmit qe ofron mundesi per palet e treta per te blere te drejten, per te perdorur dhe menaxhuar pjese te kompleksit hotelier, per nje periudhe maksimale prej 6 muajsh ne vit. Per pjesen tjetere te vitit keto njesi veprojne si pjese e kompleksit turistik. Perqindja e objekteve hoteliere qe pranohet per t'u perdorur si e tille nuk mund te jete me shume se 40% e siperfaqes totale te ndertimit. Eshte e mundur gjithashtu shitja (dhenia ne perdorim) e njesive te banimit ose pjese hotelerie per nje periudhe te caktuar kohe (p.sh. 20-50 vjet).



**Figura 34:** Referenca: Zhvillimi i turizmit dhe vilat e pushimit ne Mykonos, Greqi

| Tabela 30: Organizimi funksional i hoteleve sipas tipit te objekteve   |                             |                   |                |                                  |
|--|-----------------------------|-------------------|----------------|----------------------------------|
|  | Tipet e Objekteve Turistike |                   |                |                                  |
|  | Tipi Klasik                 | Vilat e Pushimeve | Tipi i Perzier | Kombinimi Turizem & Rezidenciale |
| <b>Funksione</b>   |                             |                   |                |                                  |
| Siperfaqe te perdorimit te perbashket                                  | ▪                           | ▪                 | ▪              | ▪                                |
| Siperfaqe te vecanta   | ▪                           | ▪                 | ▪              | ▪                                |
| Restorante/kafé/ bar/ambjente rekreative                               | ▪                           |                   | ▪              | ▪                                |
| Perdorues tregtar per plotesimin e nevojave te klienteve               |                             |                   | ▪              | ▪                                |
| Hapesira ndihmese  |                             | ▪                 | ▪              | ▪                                |
| Dhoma fjetje me nje banje  | ▪                           |                   | ▪              | ▪                                |
| Apartamente me nje ose me shume hapësira kryesore me banje dhe kuzhine |                             | ▪                 | ▪              | ▪                                |
| Objekte sportive   |                             |                   | ▪              | ▪                                |
| Infrastruktura e vecante turistike (qender konferencash, spa, etj.)    |                             |                   | ▪              | ▪                                |
| Marine   |                             |                   | ▪              | ▪                                |
| Njese rezidenciale   |                             |                   |                | ▪                                |
| <b>Klasifikimi</b>   |                             |                   |                |                                  |
| 1,2,3,4,5*   | ▪                           | ▪                 |                |                                  |
| 4,5*   |                             |                   | ▪              | ▪                                |
| <b>Standarti volumor</b>   |                             |                   |                |                                  |
| Nje volumor  | ▪                           | ▪                 |                |                                  |
| Kompleks volumesh  | ▪                           | ▪                 | ▪              | ▪                                |

## 10.2. Standartet Teknike per Siperfaqet e Zhvillimit Turistik

Kriteret per perzgjedhjen e parcelave te reja per zhvillimin e turizmit perfshijne:

- Pozicion atraktiv ne lidhje me natyren dhe kushtet mjedisore;
- Hyrje/arritje e lehte, gjithashtu me transport publik;
- Distance te mjaftueshme nga aktivitet e zhurmshme dhe ndotese;
- Shmangja e mosperputhjeve ne lidhje me perdorimet ekzistuese te tokes;

Keto kriteret jane marre ne konsiderate ne drejtim te specifikimit te zonave te perdorimit te tokes per zhvillimin e turizmit. Megjithate, duhet te ndiqet edhe ne hartimin e planeve te detajuara dhe studimet per projektet e reja per zhvillimin e turizmit. Nje numer i standardeve teknike qe udhezojne zhvillimin e objekteve hoteliere, referuar distancave te kerkuara nga perdorimi tjetër i tokes, karakteristikave te parcelës, kushteve te infrastruktures dhe kerkesave mjedisore dhe jane paraqitur ne Tabelen 31:

| Tabela 31: Standartet teknike per objektet hoteliere |  |
|--|--|
| <b>Pozicionimi i parcelës</b>                        |  |
| <b>Distanca nga perdorues te tjere toke</b>          | Distanca minimale 100 m nga varrezat, industrite ndotese, qendrat shendetesore, ambulanca dhe vende arkeologjike.  |
|  | Minimumi 500m distance nga karierat, pellgjet ujore/kenetat dhe impiantet e pastrimit.   |
|  | Minimumi 1,000m distance nga vend depozitimi i mbetjeve.   |
| <b>Karakteristikat e parcelës</b>                    |  |
| <b>Nje parcel e veteme</b>                           | Per ndertimin e nje objekti hotelier te ri apo per shtesa ne objektet ekzistuese, zhvillimi duhet te behet brenda nje parcele qe i perket vetem nje pronar, ose ne nje pronesise kolektive (ku prona eshte e pandashme mes pronareve te shumte). |
| <b>Siperfaqja e parcelës</b>                         | Per aplikimin e distancave dhe dispozitave te tjera perkatese, ndertimi i nje njesie hoteliere duhet te kete nje kapacitet prej te pakten 10 shtreter.   |
| <b>Pamje e lire</b>                                  | Per sigurimin e pamjes se lire, ne nje distance minimale prej 6m eshte e nevojshme ndermjet dhomes se gjumit te klienteve, zonave pritese dhe atyre rekreative si dhe çdo ndertese tjetër (e se njejtës parcele), ose kufirit te parcelës.       |
| <b>Elementet Infrastrukturore</b>                    |  |
| <b>Aksesueshmeria/Hyrja</b>                          | Aksesi rrugor publik eshte i nevojshem per hyrjen e mjeteve per ne cdo objekt turistik, nepermjet nje rruge te shtruar me nje gjeresi te pakten 5.50m.   |
|  | Per hotelet me me shume se 100 shtreter parashikimi i nje vend ndalimi autobuzi eshte i nevojshem si dhe vend parkimi i autobuzave turistik.   |
|  | Hapesira parkimi per mjete private per 25% te dhomave, te hapura apo te mbuluara, brenda ndertesës ose ne nje distance maksimale 200m.   |

|   |   |                     |                 |                  |                  |
|---|---|---------------------|-----------------|------------------|------------------|
|   | <p>Ne rastet kur aksesibiliteti eshte i mundshem vetem nepermjet detit, studimi per objektet hoteliere duhet te shoqerohet nga nje studim per transportin detar dhe infrastruktures qe do te mbuloje nevojat e turisteve dhe funksionimin e objektit.</p> |                     |                 |                  |                  |
|   | <p>Aksesueshmeria per personat me aftesi te kufizuara ne te gjithe hapësiren hoteliere si dhe dhoma te vecanta per kete kategori turistesh.</p>   |                     |                 |                  |                  |
| <b>Furnizimi me uje</b>                         | <p>Kerkoht mundesia e furnizimit me uje i panderprere gjate gjithes dites, sipas normave te meposhtme:</p>  |                     |                 |                  |                  |
|   | Hotel 5*  | 450 lit./ person    |                 |                  |                  |
|   | Hotel 4*  | 350 lit./ person    |                 |                  |                  |
|   | Hotel 3*  | 300 lit./ person    |                 |                  |                  |
|   | Hotel 2*  | 250 lit./ person    |                 |                  |                  |
|   | <p>N.q.s hoteli ka kopesht, furnizimi me uje duhet rritur nga 5.5-7 lit/m2 per qellime ujitjeje.</p>  |                     |                 |                  |                  |
|   | <p>N.q.s. sistemi qendror i furnizimit me uje nuk eshte i pershtateshem per hotelin, alternative e re duhet parashikuar, duke perfshire shpimin e puseve, shkripezimin, transportin dhe depozitimn e ujit etj.</p>  |                     |                 |                  |                  |
| <b>Elektriciteti dhe sigurimi i komunikimit</b> | <p>Lidhja me sistemet ekzistuese te rrjetit te zones eshte e nevojshme. Nese kjo nuk eshte e mundur duhet te realizohet nje shqyrtim sipas rastit te nevojshem. Norma udhezuese per energjine elektrike jane:</p>   |                     |                 |                  |                  |
|   |   | Deri ne 50 shtreter | 51-100 shtreter | 101-200 shtreter | 201-300 shtreter |
|   | 5* Hotel  | 2.8                 | 2.5             | 2                | 1.75             |
|   | 4* Hotel  | 2                   | 1.5             | 1.3              | 1.1              |
|   | 3* Hotel  | 1.7                 | 1               | 0.85             | -                |
|   | 2* Hotel  | 0.8                 | 0.75            | -                | -                |
|   |   |                     |                 |                  |                  |
| <b>Kanalizimet</b>                              | <p>Lidhja me sistemin qendror te ujerave te zeza ne pergjithesi eshte e nevojshme. Ne vende te largeta, eshte gjithashtu e mundur, qe te perdorin impiante te trajtimit kompakte te parafabrikuara.</p>   |                     |                 |                  |                  |
|   | <p>Eshte e nevojshme instalimi i nje impiant trajtimi te ujerave te zeza per hotele mbi 100 shtreter.</p>   |                     |                 |                  |                  |
| <b>Kerkesat Mjedisore</b>                       |   |                     |                 |                  |                  |
| <b>Vleresimi mjedisor</b>                       | <p>Studimi, Projektimet per çdo objekt turistik me mbi 100 shtreter duhet te shoqerohet nga nje “vleresim paraprak mjedisor” (VPM).</p>   |                     |                 |                  |                  |

Pervec objekteve baze qe mund te gjenden normalisht ne hotelet tipike klasike (me siperfaqe per perdorim te perbashket, rekreative, akomodime dhe zona qendrimi), objekte te tjera mund te perfshihen, te cilat perbejne kriteret e cilesise qe te permiresojne ndjeshem standardet e sherbimeve dhe cilesine e pergjithshme te njesise hoteliere. Lista e kriterëve te cilesise eshte paraqitur ne Tabelen 32.

| <b>Tabela 32: Kriteret per hotele cilesore</b>  |
|---|
| <b>Recepsioni</b>   |
| Kasaforta te vogla ne 100% te dhomave   |
| Garderobe   |
| Dhome te ndihmes se shpejte   |
| <b>Ambjentet e takimeve</b>   |
| Salle konferencash 20-50m2  |
| Ambjente shume funksionale, te pakten 50m2  |
| <b>Sporte – Rekreacion</b>  |
| Ambjent rekreacioni (lojra, biliardo,etj.)  |
| Pishine e hapur   |
| Pishine e hapur, e ngrohte  |
| Pishine e mbyllur   |
| Pishine e mbyllur,e ngrohte   |
| Pishine femijesh  |
| Pishina private per suitat  |
| Dhome leximi- librari   |
| Sauna   |
| Spa (banja te ndryshme, solar, jacuzzi, hidro-masazhe, masazh, banja balte, shiatsu, iontoforesis, analiza trupore, reflexology, fizioterapi) |
| Sallon bukurie (pastrim fytyre, maska fytyre dhe trupi, hidratim, depilim trupor, depilim fytyre, manikyr, pedikyr, make up, trajtim kembesh) |
| Palester (makine ecjeje, bicikleta, pesha, etj.)  |
| Dhome televizori  |
| Kend lojrash per femije   |
| Teater apo cirk ne ambjente te hapura   |
| Fushe basketbolli   |
| Fushe volejbolli  |
| Fushe tenisi  |
| Mini golf   |
| Klub nate - diskoteke- piano bar  |
| <b>Tregtare</b>   |
| Gazeta/ revista/ kinkaleri  |
| Trajtim flokesh   |
| Dyqan stolish   |
| Dyqan veshjesh  |
| Dyqan suveniresh  |
| Dyqan veturash me qera  |

### 10.3. Tipet e vecanta te objekteve turistike

#### 1. Kamping

Objektet kamping jane shume te rendesishme ne rastin e Himares, ato integrohen mire me peisazhin dhe perbejne e krijojne nje opsion natyror dhe miqesor per turizmin. Objektet e kampingut permbajne:

- Zonat e jashtme me mundesi akomodimi ne tenda apo karavane;
- Hapesire perdorimi te perbashket; per sherbime higjene, menaxhimi dhe objekte turismi (rekreative dhe komerciale, per te plotesuar nevojat e klienteve);
- Objekte sportive te jashtme;
- Disa akomodime ne struktura te perkohshme (vila) qe nuk e kalojne 10% e kapacitetit total, per parcela me te medha se 1.5ha;
- Hapesire parkimi.

Kriteret per pozicionimin e parces se kampingut perfshijne:

- Vend terheqes ne afersi te zonave me vlere natyrore, si parqe periferike dhe trupa ujore; mund te caktohen si pjese te zgjedhura te trashegimise natyrore ( me perjashtim te zonave te mbrojtura te Ligjit 8906 / 2002);
- Qasje e lehte ; Edhe me transport publik;
- Distanca te mjaftueshme nga aktivitetet e zhurmave dhe ndotesve
- Distanca te mjaftueshme nga zonat e banuara per te shmangur mosperputhjet dhe shqetesimet;
- Klime e mire, me shira te pakta dhe mjegull dhe nje cilesi e mire e tokes per thithjen apo absorbimin e ujrave.



**Figura 35:** Referenca: Kampingu Koralli, Serifos, Greqi

| <b>Tabela 33: Standartet teknike per zhvillimin/krijimin e nje kampingu</b> |  |
|---|--|
| <b>Karakteristikat e Parceles</b>   |  |
| <b>Parcele e vetme</b>  | Zhvillimi duhet te behet brenda nje parcele qe i perket vetem nje pronari ose ne nje pronesi kolektive (ku prona eshte e pandashme ndermjet pronareve te tjere)                |
| <b>Sipefaqja e parceles</b>   | Siperfaqja minimale e parceles eshte 1ha dhe dimensionimi minimal eshte 60m per cdo ane te parceles  |
| <b>Pjerresia mesatare</b>   | Pjerresia maksimale duhet te jete 10%; perndryshe do te jete subjekt i studimeve specifike bazuar ne azhornime topografike   |
| <b>Plantacioni</b>  | Plantacioni ekzistues duhet ne pergjithesi te ruhet dhe te plotesohet me te reja, ne menyre qe te krijoje hije te pershtateshme.   |
| <b>Ndertimet ekzistuese</b>   | N.q.s ka ndertime ekzistuese Brenda zones, ajo duhet te integrohet ne projektin e pergjitheshem te kampingu.   |
| <b>Bregdeti</b>   | Ne rastin e zhvillimit te kampingu pranë bregdetit, kufijte duhet te ndjekin rregullat e pergjitheshme per zhvillimin e zonave bregdetare.                                     |
| <b>Pozicioni i parceles</b>   |  |
| <b>Aksesueshmeria</b>   | Aksesueshmeria nga rruget publike, me nje minimum gjerësie 5.5m  |
| <b>Distanca e perdorimit te tokes</b>                                       | Parcela duhet te mbaje nje distance prej 500 m nga varrezat, industrite ndotese, tubacionet e ujerave te zeza, spitalet, fabrikat e vajit, baxhot dhe guroret.                 |
| <b>Dispozitat e Infrastruktues</b>  |  |
| <b>Furnizimi me uje</b>   | Lidhja me sistemin e furnizimit me uje, si dhe masa per ruajtjen e ujit ne depozitat perkatese per furnizim te pavarur (per te mbuluar nevojat per uje te pijshem dhe ujitje). |
| <b>Elektriciteti dhe telekomunikacioni</b>                                  | Lidhja me sistemin elektrik te energjise dhe sistemin e telekomunikacionit ose perdorimi i gjeneratoreve elektrik per perdorim te pavarur ne kampe.                            |
| <b>Kanalizimet</b>  | Lidhja me sistemin qendror te kanalizimeve ose perdorimi i impianteve te trajtimit kompakte te parafabrikuara te ujerave te zeza.  |



## 2. Objektet agro-turistike

Agro-turizmi perben nje potencial te veçante pozitiv per zhvillimin ekonomik lokal ne zonen e Himares, ne promovimin e shfrytezimit te qendrushem te burimeve natyrore dhe kulturore te zones. Objektet agro-turistike te zhvilluara jane te tipit ferme per rritjen, vjeljen dhe perpunimin e ushqimeve lokale tradicionale. Turistet kane mundesine per te shijuar peisazhet bujqesore dhe te provojne shijet e prodhimeve vendore dhe ushqimin tradicional, njohjen nga afer me jeten e perditshme ne fshat, te marrin informacion ne lidhje me historine e zones dhe te marrin pjese ne aktivitetet rurale.

Kriteri per pozicionin e objekteve agro-turistike perfshin:

- Vendodhje ne brendesi te zonave te pejsazhit bujqesor;
- Vendodhje atraktive ne lidhje me natyren dhe mjedisin ndertimor;
- Ne afersi te zones me vlera historike, kulturore apo natyrore, sic jane vendodhjet tradicionale, vendet arkeologjike, parqet periferike dhe mjediset ujore;
- Aksesueshmeri e lehte; me transport publik;
- Distance e mjaftueshme nga zhurmat dhe aktivitet ndotese.

Objektet agroturistike mund te permbajne:

- Nje shtepi fshati;
- Akomodime me dendesi te ulet ne fshat, akomodimi ne vila tradicionale apo njesive te apartamenteve;
- Restorante;
- Hapesira ndihmese ne shkalle te vogel per informimin e turistev te produkteve lokale apo aktivitetev kulturore;
- Prezantime te menyres se pregatitjes se ushqimit
- Hapesira parkimi.





**Figura 36:** Referenca: Agro-turizmi ne Zakynthos (Logothetis bujqesi organike), Greqia

### 3. Vendqendrimet mjedisore

Vendqendrimet mjedisore jane modele te raporteve miqesore me natyren qe ka nje ndikim pozitiv ne mjedis dhe ne komunitetin lokal. Turistet jane te inkurajuar per t'u angazhuar ne aktivetet e shumellojshme kulturore, sportive dhe ato mjedisore. Objektet e vendqendrimeve mjedisore mund te menaxhohet dhe te furnizohen nga forma alternative te energjise; perdorimit ditor te diellit dhe shiut, te perbere nga kuzhina dhe tualetet, riciklimin e ujerave gri per ujitje etj, ndersa projektimi i tyre duhet te ndjeke konsiderata bio-klimatike dhe te perdorin materiale natyrale lokale apo te ricikluara.



**Figura 37:** Referenca: Shembuj te banesave mjedisore

## 10.4. Zonat e Shtëpive te Dyta

Zhvillimi i zonave të shtëpive të dyte përben një tendencë të përgjithshme për rajonin e Mesdheut dhe tashmë është duke u zhvilluar edhe në bashkinë e Himarës, kryesisht në fushën e Gjilekut. Ky trend duhet të jetë i organizuar dhe i lidhur me standarde të caktuara teknike dhe kritere projektimi. Në përgjithësi, ndryshimi i zonave të shtëpive të dyta nga zonat e banuara (rezidence e pare) i referohet:

- Koeficientit të ulët të ndërtimit në raport me zonat rezidenciale;
- Disa nevojave për hapësira të hapura publike dhe infrastrukture sociale shërbimesh, meqenëse ato i referohen një popullësie me prezencë sezonale.

Në rastin e Himarës zonat e shtëpive të dyta paraqesin dy kërkesa kryesore:

- Popullsia nga pjesë të tjera të vendit, kryesisht Tirane, apo popullsi evropiane (p.sh. njerezit në pension, familje, etj) që e konsiderojnë zonën tërheqëse dhe janë të gatshëm për të blerë një pronë, zakonisht një vilë pushimi ose një apartament me cilësi të mirë, ku të kalojnë disa javë / muaj në vit;
- Popullsia lokale, kryesisht ish patrioti Himariot, emigrante që kërkojnë të investojnë në vendlindjen e tyre nëpërmjet zhvillimit të shtëpive të dyta.

Bazuar në kërkesat e mësipërme, objektet e shtëpive të dyta janë klasifikuar në tre tipe:

1. **Vila luksoze të nivelit të lartë:** ato janë vendosur në parcela të mëdha (minimumi 0.1ha); ose një njesi për çdo parcelë; ato kanë koeficient të ulët të ndërtimit që lejon për hapësira të gjera të hapura dhe kontribuon për mbrojtjen e peisazhit.
2. **Komplekset me njësi të vecanta pushimi dhe/ose apartamente:** ato janë vendosur brenda së njëjtes parcele (minimumi madhësie 0.1 ha); të organizuara si venbanime ose pjesë të tij me hapësira të përbashkëta përdorimi dhe hyrje të vecanta, në përshtatje dhe me tipologjinë lokale të arkitektures tradicionale, që ndjekin parimet e përkrahura më poshtë;
3. **Zonat e urbanizuara të shtëpive të dyta:** ato i referohen standardeve të njësive të pushimit standart të një shkalle të mesme për një njesi të vetme ose të dubluar për parcele dhe brenda parcelës në një shkallë të vogël (minimumi 500m<sup>2</sup>).



**Figura 38:** Referenca: Vila luksoze, të integruara në peisazhin natyror

Siç mund të vërehet, dy tipet e para janë organizime të formave të zhvillimit dhe përgjigje për kërkesën e investitorëve dhe popullsisë jashtë zonës (kombetare apo ndërkombetare). Nga ana tjetër lloji i tretë i referohet kryesisht popullatës lokale dhe emigrantëve të kthyer, si dhe i referohet zhvillimeve që ndodhin nga pronarët e parcelave në përputhje me planet e detajuara të përgatitura sipas dispozitave të Planit Rregullues.

Zonat e shtëpive të dyta mund të kombinohen me objektet turistike në një turizëm të tipit të perzier dhe zonave të pushimit. Zonat e shtëpive të dyta karakterizohen nga:

- Dominimi i shtëpive të dyta;
- Aktivitete tregtare të kufizuara që mbulojnë nevojat lokale (sezonale);
- Hotele (sipas kufizimeve të zonës);
- Vilat e pushimeve (sipas kufizimeve të zonës).



**Figura 39:** Referenca: Shembuj të vilave të pushimit

Parimet udhezuese per zhvillimin e zonave te shtepive te dyta perfshijne:

- **Integrim ne peisazhin e zones:** Integrimi i ndertimeve te reja ne peisazhin natyror, duke marre parasysh relievin. Vellimet duhet te ndahen dhe te artikuloohen ne nivel, ne menyre qe te pershtaten me mire ne mjedisin rrethues.
- **Privatesia:** siguron privatesine e njesive te pavarura, ne rastet e komplekseve te pushimit, por te lejoje nje nderveprim social diskret;
- **Pamja:** hapësira organizon zhvillimet e reja ne menyre qe te shfrytetoje panoramen dhe pamjet e privileguara me drejtim nga deti apo peisazhet natyrore;
- **Hapesirat e hapura:** te siguroje nje hyrje automjetesh te kontrolluara, e kombinuar me rrugica per kembesore dhe hapësira te shumefishta te hapura dhe te perdorimit te perbashket te cilesive te ndryshme;
- **Aksesueshmeria:** ne rastin e komplekseve te pushimit te sigurohet aksesueshmeri e pavarur e seciles prej njesive, si dhe te siguroje aksesueshmeri per te gjithe, ne te gjitha hapësirat e perbashketa;
- **Kriteri morfologjik:** konsiderimi i tipologjise arkitekturore dhe cilesine hapësimore te vendbanimeve tradicionale per projektimin e zhvillimeve te reja;
- **Kriteri bioklimatik:** perfshin kriterin bioklimatik per orientimin, hijen, mbrojtjen nga dielli, izolimin dhe perdor sistemin fotovoltaiq;
- **Materialet lokale:** perdor materiale lokale, naturale dhe teknika qe jane vazhdimi dhe permiresimi i tradites lokale.



**Figura 40:** Referenca: Shembull i perdorimit te materialeve lokale, Kea, Greqi

Nje seri e standarteve teknike per projektimin e zonave te shtepive te dyta jane prezantuar ne Tabelen 34:

| <b>Tabela 34: Standartet teknike per zonat e shtepive te dyta</b> |  |               |
|---|--|---------------|
| <b>Pozicioni i parceles</b>                                       |  |               |
| <b>Distanca nga perdoruesit e tjere te tokes</b>                  | Minimumi 100m distance nga varrezat, industrite ndotese, qendrat e sherbimit shendetesor, ambulances dhe vendeve arkeologjike.   |               |
|   | Minimumi 500m distance nga karierat, kenetat, mocaleve/pellgjeve ujore dhe impianteve te perpunimit.   |               |
|   | Minimumi 1,000m distance nga vend grumbullimi i mbetjeve.  |               |
| <b>Karakteristikat e parceles</b>                                 |  |               |
| <b>Nje parcele e vetme</b>  | Per ndertimin e nje objekti hotel i ri apo per shtesa ne objektet ekzistuese, zhvillimi duhet te behet brenda nje parcele qe i perket vetem nje pronar, ose ne nje pronesi kolektive (ku prona eshte e pandashme ndermjet pronareve te saj).   |               |
| <b>Siperfaqja minimale e parceles</b>                             | Vila te nje niveli te larte, nje njesi per parcele.  | <b>0.1ha</b>  |
|   | Komplekse me njesi te ndara pushimesh ose apartamentash brenda se njejtes parcele.   | <b>0.1ha</b>  |
|   | Siperfaqe te urbanizuara apo per tu urbanizuar, me nje apo dy njesi pushimesh per parcele, sipas studimit urban te Bashkise.   | <b>0.05ha</b> |
| <b>Kriteret e projektimit</b>                                     |  |               |
| <b>Lartesia e ndertimeve</b>                                      | Ndertesat nuk duhet te kaloje lartesine e dy kateve (7 m plus cati) perfshire dhe themelet ku vendi eshte i sheshte. Kur siperfaqja ka nje pjerresi prej me shume se 15%, themelet mund te jene te dukshme 1.50m, qe do te thote se lartesia maksimale e pergjithshme mund te shkoje ne 8.50m. |               |
| <b>Elementet morfologjik</b>                                      | Nuk lejohen shkalle te jashtme.  |               |
|   | Jo ballkone te vazhduara qe zene me shume se 70% te seciles fasade apo ballkon i vazhduar ne dy fasada jane te lejuara.  |               |
|   | Hapesirat (dyer & dritare) duhen te sigurojne ndricim te mjaftueshem, ventilim terthor dhe izolim termik.  |               |
| <b>Parkimi</b>  |  |               |
| <b>Parkimi</b>  | Minimumi nje vend parkim per njesi (brenda parceles). Vend parkimi duhet te mbulohet me peme, ndricim ose pergola.   |               |

### III | 11. RRJETI RRUGOR

Rrjeti i rrugëve është një pjesë integrale e një zonë urbane apo rurale, pasi ajo lidh zonat dhe vendet, si dhe lehtëson lëvizjen e njerëzve, automjeteve dhe mallrave. Përveç kësaj, rrjeti rrugor luan një rol vendimtar në mbështetjen e zhvillimit dhe më konkretisht në zhvillimin e turizmit, duke lejuar qasje në zonat e zhvilluara rishtazi, zonat e interesit dhe atraksione të tjera. Për këto arsye, është shumë e rëndësishme për të zhvilluar një rrjet të qartë dhe të mirepercaktuar rrugor, që ndjek një hierarki duke përcaktuar madhësinë e saj, funksionin dhe qëllimin.

**Hierarkia Rrugore:** Hierarkia rrugore e detajuar më poshtë është e bazuar në dispozitat e kuadrit ligjor Shqipëtar, referuar projekteve nderkombetare dhe standarteve funksionale, me një qëllim të veçantë për tu pershtatur me karakteristikat e veçanta të Bashkisë Himarë. Kjo hierarki është miratuar nga Konsulenti dhe e projektuar për ti shërbyer vëllimeve të ndryshme të trafikut, në përputhje me përdorimin.

#### i. Rrjeti Interurban

Rrugët interurbane lidhin qendrat urbane me rajone të tjera, qytetet dhe vendet me interes në të gjithë vendin. Ato ndryshojnë në qëllim, gjerësi dhe në shpejtësi të udhëtimit, duke filluar nga autostradat në zinxhoret e rrugëve të vogla rajonale të qendrave të vogla urbane dhe fshatrat, duke ndikuar relativisht në kufijte e moderuar të shpejtësisë. Në kuadër të Planit, rrugë ndër-urbane mendohen të jenë:

- a. **Rrugët kryesore interurbane** është një rrugë e vetme, rrugë me dy kalime, autostrada me shpejtësi të lartë (me zona anesore rezerve), domethënë shtylla ekzistuese e rrugës kombetare, që lidh të gjitha vendbanimet kryesore të Bashkisë nga Llogaraja në Qeparo.
- b. **Rrugët dytesore interurbane** është një rrugë e vetme, rrugë me dy kalime ose me një kalim, që përbëjnë lidhjet primare nga rruga kombëtare për vendbanimet e vecanta dhe plazhet.
- c. **Rrugët tretesore interurbane** janë një rrugë e vetme, rrugë me dy kalime ose me një kalim me standarde më të ulëta të projektimit dhe të shpejtësisë të trafikut, e cila lidh vendbanimet individuale dhe / ose zonat e zhvillimit dhe plazhet.
- d. **Rrugët lokale** janë të gjitha rrugët e tjera jashtë kufijve të vendbanimeve (të shtruara ose të pashtuara).


#### i. Rrjeti Urban

Rrugët urbane përbëjnë pjesë të rrjetit rrugor që shtrihet brenda vendbanimeve urbane dhe rurale të Bashkisë. Ato ndryshojnë në madhësi dhe në shpejtësi të udhëtimit, duke filluar nga rrugët kryesore në rrugët vetëm për këmbësorë. Të gjitha rrugët urbane duhet të lehtësojnë qarkullimin e këmbësorëve, prandaj trotualet janë të nevojshme. Për më tepër, shumica e tyre kanë nevojë për të mbuluar nevojat e rastit për parkime në rrugë. Madhësitë e trotuareve dhe numri i vendeve të parkimit duhet të përcaktohen

mbi bazën rast pas rasti, sipas nevojave dhe tipareve hapësinore të çdo vendbanimi. Më konkretisht rrugët urbane përfshijnë:

- a. **Rrugët kryesore urbane** janë rrugë me dy kalime, projektuar për levizje të njëkohshme përmes trafikut nëpër qytet dhe për të lidhur nyjet e mëdha ose rajonet. Rrugët kryesore urbane gjenden në qendrat e aktiviteteve kryesore të qytetit, duke përfshirë edhe qendrën e tij dhe qendrat e lagjeve.
- b. **Rrugët dytesore urbane** janë orientuesit me dy kalime ose me një kalim, të trafikut automobilistik në rrugët kryesore urbane, duke organizuar strukturën e qarkullimit të lagjeve të veçanta. Ata funksionojnë si plotësuese të rrugëve kryesore urbane dhe kanë standarde projektimi në përgjithësi me të ulëta se të parat.
- c. **Rrugët lokale urbane** janë rrugët e mbetura me dy kalime ose me një kalim që lidhen me rrugët dytësore, si dhe për të mundësuar qasje të automjeteve në parcela të veçanta. Meqenese këto rrugë janë të lidhura ngushtësisht me zonat e banuara, vëmendje e veçantë duhet të adresohet për të siguruar hapësirë për lëvizjet e këmbësorëve dhe parkimin në anë të rrugës.
- d. **Rrugë vetëm për këmbësorë** janë të mbyllura për trafik automjeteve - ose në çdo kohë ose gjatë orarit të caktuar dhe nxisin qarkullimin e këmbësorëve dhe përdorimin e biçikletave. Ato duhet të krijojnë një rrjet rrugësh për këmbësorët dhe hapësira publike të hapura, duke përcaktuar qarkullimin e këmbësorëve brenda zonave të vendbanimit. Ky lloj i rrugëve është gjithashtu veçanërisht i rëndësishëm për pjesët tradicionale të vendbanimeve, rrugët me gur të tipit historik dhe kalldre.

Dimensionet e sistemit të rrjetit të rrugëve janë paraqitura në Tabelën 35:








Figura 41: Hierarkia Rrugore

| <b>Tabela 35: Kategorite e Sistemit Rrugor</b> |  |                             |                             |             |                              |             |                                   |                                   |                                  |                                  |                                  |
|--|--|-----------------------------|-----------------------------|-------------|------------------------------|-------------|-----------------------------------|-----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|
| <b>Elementet e Klasifikimit</b>                |  | <b>Rrjeti Inter-Urban</b>   |                             |             |                              |             | <b>Rrjeti Urban</b>               |                                   |                                  |                                  |                                  |
|  |  | <b>Interurbane Kryesore</b> | <b>Interurbane Dytesore</b> |             | <b>Interurbane Tretesore</b> |             | <b>Urbane Kryesore</b>            | <b>Urbane Dytesore</b>            |                                  | <b>Urbane Lokale</b>             |                                  |
| <b>1</b>                                       | Numri i Korsive  | 1+1                         | 1+1                         | 1*          | 1+1                          | 1*          | 1+1                               | 1+1                               | 1*                               | 1+1                              | 1*                               |
| <b>2</b>                                       | Gjeresia e korsive ( per drejtimin e trafikut )  | 3.75                        | 3.50                        | 3.50        | 3.00                         | 4.00        | 3.50                              | 3.00                              | 3.50                             | 3.00                             | 3.50                             |
| <b>3</b>                                       | Gjeresia e vendeve reserve ne ane te korsive   | 1.75                        | 0                           | 0           | 0                            | 0           | 0                                 | 0                                 | 0                                | 0                                | 0                                |
| <b>4</b>                                       | Numri i Trotuareve   | 0                           | 0                           | 0           | 0                            | 0           | 2                                 | 2                                 | 2                                | 2                                | 2                                |
| <b>5</b>                                       | Gjeresia e Trotuareve  | 0                           | 0                           | 0           | 0                            | 0           | 2.00                              | 2.00                              | 2.00                             | 1.50                             | 1.50                             |
| <b>6</b>                                       | Numri i shenjave te pjeses anesore te rruges   | 2                           | 2                           | 2           | 0                            | 0           | 0                                 | 0                                 | 0                                | 0                                | 0                                |
| <b>7</b>                                       | Gjeresia e shenjave te pjeses anesore te rruges  | 0.50                        | 0.50                        | 0.50        | 0                            | 0           | 0                                 | 0                                 | 0                                | 0                                | 0                                |
| <b>8</b>                                       | Numri i aneve me Parking   | 0                           | 0                           | 0           | 0                            | 0           | 2 **                              | 2 **                              | 2 **                             | 2 **                             | 2 **                             |
| <b>9</b>                                       | Gjeresia e korsise se parkimit   | 0                           | 0                           | 0           | 0                            | 0           | 2.00 **                           | 2.00 **                           | 2.00 **                          | 2.00 **                          | 2.00 **                          |
| <b>10</b>                                      | <b>Gjeresia e plote e rruges</b>   | <b>12.00</b>                | <b>8.00</b>                 | <b>4.50</b> | <b>6.00</b>                  | <b>4.00</b> | <b>15.00</b><br><b>(11.00 **)</b> | <b>14.00</b><br><b>(10.00 **)</b> | <b>11.50</b><br><b>(7.50 **)</b> | <b>13.00</b><br><b>(9.00 **)</b> | <b>10.50</b><br><b>(6.50 **)</b> |
| <b>11</b>                                      | <b>E drejte kalimi</b>   | <b>14.00</b>                | <b>10.00</b>                | <b>5.50</b> | <b>7.00</b>                  | <b>5.00</b> | <b>16.00</b>                      | <b>15.00</b>                      | <b>12.50</b>                     | <b>14.00</b>                     | <b>11.50</b>                     |
|  | * Rruge me nje kalim – gjeresia minimale e korsise me nje drejtim kalimi do te jete 3.50 metra |                             |                             |             |                              |             |                                   |                                   |                                  |                                  |                                  |
|  | ** Dispozitat e parkimit per tu specifikuar mbi bazat e rast pas rasti                         |                             |                             |             |                              |             |                                   |                                   |                                  |                                  |                                  |

## IV. PERDORIMI I TOKES DHE STRUKTURA HAPESINORE

### IV | 1. STRUKTURA HAPESINORE DHE SHPERNDARJA E VENDBANIMEVE

**Struktura funksionale:** Qyteti i Himares eshte vendbanimi me i madh urban dhe qendra e Bashkise, nga e cila varen te gjitha vendbanimet e tjera. Ne pergjithesi, Bashkia e Himares shtrihet midis dy poleve te rendesishme te sherbimit dhe zhvillimit: Vlora ne veri dhe Sarandes ne jug, duke zoteruar varesi te forte prej tyre. Bashkia varet kryesisht nga Vlora, si qender rajonale per sherbimet administrative dhe infrastrukturore te nivelit social (spitalet, universitetet, etj) dhe gjithashtu ne nje mase me te vogel nga qendra e rendesishme urbane e Sarandes. Ne perspektiven e forcimit te rolit te Himares si nje destinacion turistik, keto varesi kane gjasa te zvogelohen duke forcuar rolin e vet dhe te qendrueshem te Bashkise.

Pese njesi te integruara hapesine jane identifikuar tashme qe ne fazen e analizimit, duke iu referuar gjeomorfologjise se zonave, peisazhit dhe zhvillimit te vendbanimeve urbane dhe rurale. Kater prej tyre jane te rendesishme per kete kapitull aktual si njesi banimi hapesine, duke perjashtuar njesine e Porto Palermos. Keto kater njesi jane:

| Tabela 36: Shperndarja e vendbanimeve |                     |                     |                          |
|---------------------------------------|---------------------|---------------------|--------------------------|
| Njesite Strukturale                   |                     | Popullsia rezidente | Distanca nga Himara (km) |
| Njesi 1                               | Dhermi              | 262                 | 15                       |
|                                       | Gjilek              | 395                 | 17                       |
|                                       | Palasa              | 175                 | 18.5                     |
|                                       | <b>Nen-totali 1</b> | <b>832</b>          | -                        |
| Njesi 2                               | Vuno                | 204                 | 7.5                      |
|                                       | Ilias               | 47                  | 11                       |
|                                       | <b>Nen-totali 2</b> | <b>251</b>          | -                        |
| Njesi 3                               | Himara              | 2,193               | 0                        |
|                                       | Pilur               | 204                 | 10                       |
|                                       | <b>Nen-totali 3</b> | <b>2,397</b>        | -                        |
| Njesi 4                               | Qeparo              | 646                 | 11                       |
|                                       | Kudhes              | 374                 | 16                       |
|                                       | <b>Nen-totali 4</b> | <b>1,020</b>        | -                        |
| <b>TOTALI</b>                         |                     | <b>4,500</b>        | -                        |

Shkalla e vogel e vendbanimeve dhe shperndarja e tyre hapesine ne nje relief intensiv eshte kryesoreper organizimin e tyre, pasi ka pengesa praktike per mbulimin e nevojavete infrastruktures sociale dhe sherbimeve te tjera. Nje nga problemet kryesore te zones, ka te beje me distancat e vendbanimeve te vogla nga qendrat e tyre te sherbimit. Kjo rezulton ne modelet me te nderlikuara te varesise hapesine, per shembull Palases nga Vlora apo Qeparo-se nga Saranda.

Ne vitet ne azhdim, pavaresisht nga zhvillimi i parashikuar i turizmit, varesite hapesine, kane gjase te mbeten relativisht te qendrueshme.


**Zgjerimet e propozuara rezidenciale:** Ne procesin e hartimit te Planit Struktural, kriteret per sigurimin e zonave te zgjeruara te vendbanimeve, perfshijne:

- Raporti ndermjet hapesirave te ndertuara dhe te pandertuara ne kuader te vendbanimit;
- Rolin e vendbanimit ne hapesiren e pergjithshme strukturore te Bashkise;
- Rolin e vendbanimit ne lidhje me zhvillimin e turizmit te programuar;
- Pershtatshmerine e vendit per zgjerimin, ne afersi te vendbanimeve.

Dendesite e popullsise rezidente ne te gjitha vendbanimet jane veçanerisht te uleta, duke pasur parasysh tendencat intensive te emigrimit dhe perqindjen e larte te shtepive qe jane te zena gjate sezonit. Prandaj dendesia e popullsise nuk eshte perdorur si nje kriter per zgjerimet e propozuara sepse ato ne te vertete nuk reflektojne nevojat e zhvillimit. Per me teper, duhet theksuar se zgjerimet e propozuara, gjithashtu mbulojne nevojat per zhvillimet e turizmit dhe te zonave te shtepive te dyta dhe nuk jane te kufizuar vetem per zhvillimet per banesat e perhershme. Nga kjo perspektive, zgjerimet sherbejne si nxitje per zhvillimin e popullates lokale, ne ofrimin e mundesive dhe kontribuon ne rigjallerimin e vendbanimeve.

Sipas kriterëve të sipërpermendura, zgjerimet rezidenciale për secilin vendbanim janë paraqitur në Tabelën 37:

| <b>Tabela 37: Zgjerimet rezidenciale per secilin vendbanim</b> |                            |                                   |                                       |                                     |  |                                   |
|--|----------------------------|-----------------------------------|---------------------------------------|-------------------------------------|--|-----------------------------------|
|  | <b>Njesite Strukturale</b> | <b>Popullsia Rezidente (2011)</b> | <b>Popullsia e Parashikuar (2030)</b> | <b>Zonat urbane ekzistuese (ha)</b> | <b>Zgjerimi urban i propozuar (ha)</b> | <b>Totali i zones urbane (ha)</b> |
| <b>1</b>   | Dhermi                     | 262                               |                                       | 27                                  | 7                                      | 34                                |
|  | Gjilek                     | 395                               |                                       | 29                                  | 17                                     | 46                                |
|  | Palasa                     | 175                               |                                       | 11                                  | 5                                      | 16                                |
|  | <b>Nen-totali 1</b>        | <b>832</b>                        | <b>1,900</b>                          | <b>67</b>                           | <b>29</b>                              | <b>96</b>                         |
| <b>2</b>   | Vuno                       | 204                               |                                       | 12                                  | 5                                      | 17                                |
|  | Ilias                      | 47                                |                                       | 4                                   | 3                                      | 7                                 |
|  | <b>Nen-totali 2</b>        | <b>251</b>                        | <b>500</b>                            | <b>16</b>                           | <b>8</b>                               | <b>24</b>                         |
| <b>3</b>   | Himara                     | 2,193                             |                                       | 52                                  | 53                                     | 105                               |
|  | Pilur                      | 204                               |                                       | 8                                   | 7                                      | 15                                |
|  | <b>Nen-totali 3</b>        | <b>2,397</b>                      | <b>5,400</b>                          | <b>60</b>                           | <b>60</b>                              | <b>120</b>                        |
| <b>4</b>   | Qeparo                     | 646                               |                                       | 24                                  | 14                                     | 38                                |
|  | Kudhes                     | 374                               |                                       | 13                                  | 9                                      | 22                                |
|  | <b>Nen-totali 4</b>        | <b>1,020</b>                      | <b>2,200</b>                          | <b>37</b>                           | <b>23</b>                              | <b>60</b>                         |
| <b>TOTALI</b>  |                            | <b>4,500</b>                      | <b>10,000</b>                         | <b>180</b>                          | <b>110</b>                             | <b>300</b>                        |



**LEGJENDA**

REGION I  
 REGION II  
 REGION III  
 REGION IV  
 NISHTË STRUKTURORE LINDOR  
 NISHTË STRUKTURORE QENDRORE  
 NISHTË STRUKTURORE TËRTHORË

RRETHI ETAPAR  
 NISHTË INFLUENÇE TËRTHORË  
 NISHTË INFLUENÇE QENDRORE

**14** Harta e njësive strukturore

Skala 1:30.000

STUDIUM PROJEKTIMI ZONËS DE JHMARËS ME PËRBYRJE ZINÇULIM E TËRTHORË

INSTITUTI QENDRORE I PLANIMIT TERRITORIAL



## IV | 2. PERSHKRIMI I PERDORIMIT TE TOKES DHE STRUKTURA HAPESINORE SIPAS ZONAVE

### 2.1 NJESIA HAPESINORE 1 (DHERMI - PALASE)

**KARAKTERI & DESTINACIONI-** Zona Palase – Dhermi eshte poli me i madh i zhvillimit ne te ardhmen te turizmit ne Bashkine e Himares, e cila do t'i jape zones emrin si nje destinacion i nje turizmi cilesor me standarde te larta se bashku me Porto Palermon. Zona paraqet nje shkalle te larte terheqjeje dhe pershtatshmerie per zhvillim pasi eshte ne pjesen me te madhe e pademtuar dhe ka pothuajse gjysmen e kapacitetit te plazheve te Bashkise, e shperndare kjo ne tre plazhe te medhenj ai Dhermiut, Drimadhes dhe ai Palases. Pritshmeria eshte qe kjo zone te absorboje pjesen me te madhe te investimeve cilesore te hoteleve dhe resorteve, njesite “shtrat dhe mengjes, sikurse dhe shtepi te dyta qe mund te jene me vete apo bashkangjitur me hotelet.

**KONCEPTI I MBROJTJES SE PEISAZHIT** – Perceptimi panoramik i ketij Peisazhi te madh qe nis nga niveli i rruges automobilistike kombetare krijon mundesine per zona te medha te ruajtura dhe per zhvillim. Duke qene se rruga zbret diagonalisht drejt detit Ne perceptojme pjese te vogla te Peisazhit pergjate rruges. Konsiderata te veçanta per keto zona me relief interesant, me ullishte dhe bime te tjera, kane kerkuar qe ato te shnderrohen ne zona zhvillimi. Eshte e rendesishme qe per keto Peisazhe te medha te ruhet variacioni dhe te mos mbi ndertohen. Kufijte e seciles zone jane percaktuar me shume kujdes, nisur nga perceptimi pamor nga rruga automobilistike dhe nga bregu i detit, sikurse edhe nga kapaciteti pamor i zones. Kanionet dhe bregdeti jane te mbrojtura. Delta e Palases krijon Peisazhin me te spikatur ne zone dhe perben nje barrikade natyrale kundrejt influences se aktivitetit te njeriut. Zona e Dralleos zoteron nje Peisazh me vlere unike, i cili deri me tani eshte i paprekur dhe reflekton ne tere hapësirën e Bashkise duke na kujtuar se duhet zhvilluar me shume kujdes.

**ORGANIZIMI HAPESINOR DHE KONCEPTI I ZONIMIT-** Plani paraqet qasje te ndryshme per secilen nga zonat ne varesi te tendencave ekzistuese te zhvillimit dhe kapaciteteve te seciles zone.

Fshati i **Dhermiut** mbetet qendra e njesise per popullsine lokale ne lidhje me aktivitetet kulturore, historine dhe sherbimet. Popullata rezidente mendohet se do te shtohet permes kthimit te emigranteve dhe zhvillimit te turizmit ne zone. Kufijte e fshatit jane tashme te prekura nga zgjerimi i bere nga ndertimet e kryera nga vendasit kohet e fundit pergjate rruges kombetare. Me qellim ruajtjen perceptimit pamor nga bregu si dhe te vendodhjes se tij natyrale, nuk duhet te behen me ndertime pergjate rruges. Plani propozon nje zgjerim ne pjesen e pasme prane, ne nje faqe kodre me nje pjerresi te lehte ne drejtim te malit. Kanioni i Dhermiut eshte propozuar si zone e mbrojtur si monument natyre per shkak te formacionit te rralle gjeologjik e gjeomorfologjik si dhe per vlere estetike.



**Figura 42:** Referenca: Hotele te tipit Klasik (Kasandra Bay Hotel), Skiathos, Greqi

Bregdeti i Dhermiut (Jaliskari), ku aktualisht ka nje trend te forte zhvillimi, eshte vleresuar si poli me i madh i turizmit ne te gjithe zonen, duke kombinuar zonat hoteliere me aktivitetet tregtare dhe argetuese, gjithashtu edhe si zone rezidenciale per shtepi te dyta dhe apartamente me qira. Koncepti i zonimit ka per qellim te lehtesoje, organizoje dhe konsolidoje trendin e tanishem te zhvillimit por ne te njejten kohe te ruaje vlerat turistike dhe te mbroje burimet dhe Peisazhin natyror. Vemendje e veçante i eshte kushtuar ruajtjes se ndarjes ndermjet pjeses se sipërme te fshatit dhe pjeses se detit, e cila eshte nje tipar unik i Peisazhit bregdetar. Tre zona kryesore dallohen ketu:

- Zona kryesore per **zbavitje dhe argetim** krijon nje porte te zones ne piken ku rruga arrin ne bregdet. Atje, nje Peisazh i veçante krijohet si pasoje e kombinimit te plazheve te vogla ranore thyer nga pjese shkembijnsh te futur ne det, me bar-kafe qe shohin mbi det, nen hijen e bimesise se dendur. Ky tipar krijon nje atmosfere qe e gjejme edhe ne vende te tjera mesdhetare. Zona eshte caktuar si turistike qe ne periudhen e PSRA siç dhe duket edhe nga strukturat ekzistuese. Eshte shume e rendesishme qe zona ka ruajtur kete karakter dhe eshte zhvilluar permes nje rinovimi te kujdesshem te ndertesave ekzistuese turistike duke i zgjeruar ato vetem per qellime turistike dhe pa demtuar te bimesise. Aksesi dhe levizja e kembesoreve dhe ajo e mjeteve te tjera duhet zgjidhet permes rirregullimit te rruges ekzistuese drejt bregut si dhe permes gjetjes se hapësirave per parking.

- **Zona hoteliere kryesore** është lokalizuar në vijën e parë të plazhit duke zënë kështu pjesën balllore të plazhit e cila menjëherë zgjerohet deri në zonën e argetimit prapa perroit. Kjo zonë karakterizohet nga shpatet e bute dhe kufijtë e saj natyralë përcaktohen nga shpatet dhe toka e pyllëzuar që krijojnë një sfond vendbanimi. Në këtë zonë, e cila sot është prekur nga zhvillimi, është e pershtatshme për hoteleri klasike me një densitet të mesëm me një lartësi të konsiderueshme duke qenë se nuk krijon probleme pamore për vendbanimin përreth. Rritja e dendësisë pritet që të rrisë dhe të nxisë pronarët të rinovojnë dhe zgjerojnë shërbimet ekzistuese. Investimet e reja do të ndikojnë pozitivisht në zonë në aspektet organizative dhe ato menaxhuese. Pjesa e mbetur përtej fundit të zonës duhet të ruajë karakterin e saj natyror me qëllim ruajtjen e ekuilibrit midis pjesës së zhvilluar dhe asaj natyrore.
- **Zona rezidenciale** është organizuar përgjatë rrugës që zbrit në breg, në të dyja anët e saj, pas zonës hoteliere, dhe është planifikuar bazuar mbi parimet e racionalizimit të zhvillimit ekzistues. Kufijtë e zonës përcaktohen nga dy perrenjtë e Dhermiut. Një pjesë e zonës është menduar të mbulohet nga shtëpi të dyta për të plotësuar nevojat e popullatës lokale, kryesisht emigrante, të cilët do të duan të investojnë në rast të kthimit të tyre në vendlindje të kombinuara këto me apartamente dhe dhoma për qira.
- Me në brendësi, në drejtim të Drimadhes dhe në veri të zonës së argetimit, është propozuar **zona me hotele me të vogla** larg perroit, kufirit natyral të zonës. Kjo zonë është me e pershtatshme për njësi të vogla dhe **vila pushimi** në pjesën e gjelbër. Cilesia e saj ruhet përmes një planifikimi të kujdesshëm të brezave të gjelbër që rrethojnë zonat e zhvilluara.

Poli i dytë i zhvillimit është ai i Gjilekës dhe i Drimadhes (plazhi i Perivolos). Zona ka toka dhe mundësi zgjerimi dhe është me pak e zhvilluar se sa Dhermiu por ka një presion në rritje zhvillimi kryesisht për shtëpi të dyta dhe resorte të cilësive të larta. Intensiteti i propozuar i zhvillimit për këto zone është në përgjithësi me i ulët se sa ai i Dhermiut dhe i organizuar në një shkallë më të gjërë. Tipi mbizotërues i propozuar i zhvillimit është një kombinim i shtëpive të pushimit me të ardhura mbi mesataren dhe resorte të një shkallë relativisht të lartë sikurse edhe vila pushimi.




Figura 43: Referenca: Shembuj të vilave të pushimit



Fshati i **Gjilekut** ka një trend të fortë rritjeje kryesisht për shtëpi të dyta që paraqet një model që shtrihet drejt anës së bregut. Kjo i dedikohet pozicionit të tij midis rrugës kombëtare dhe rrugës që zbrit për në plazhin e Drimadhes, i cili është pranë detit, me shpatë të buta dhe me pamje të mira dhe karakterizohet nga një akses i mirë. Fshati akoma nuk ka një infrastrukturë të pershtatshme e cila sigurisht duhet të përmiresohet. Pjesa e sipërme është e pushtuar me shumë nga shtëpi të dyta që i takojnë popullsisë vendase, të cilat gradualisht shndërrohen në vila të një shkalle më të cilësore, hotele të vegjël dhe komplekse rezidenciale për njëzëzit që vijnë jashtë zonës. Ka një tendencë për ndertime voluminoze, të cilat duhen kontrolluar pasi demtojnë pamjen nga deti. Planit e njëh këto tendence duke propozuar zgjerimin e fshatit në dy drejtime duke i përfshirë dhe racionalizuar këto zona sikurse edhe duke ruajtur cilësinë e Peisazhit duke e kombinuar me breza të gjelber.



**Figura 44:** Referenca: Resort Hotel në Skiathos, Greqi

Plazhi i **Drinadhes** (Perivolos) është më i madhi në të gjithë hapësirën e Bashkisë dhe që ruan dukshëm karakterin e tij natyral dhe tërheqës si dhe hapësirat e gjelbra. Zona është poli i dytë i defrimit dhe i jetës së natës gjatë sezonit të verës dhe bazohet në strukturë të perkohshme gjë që reflekton karakterin sezonal të aktiviteteve. Këto dy trende duhet të balancohen dhe të shtrihen përmes planit. Koncepti i zonimit parashikon një zhvillim të kujdesshëm të disa segmenteve të përzgjedhura në vijën e parë duke i alternuar ato me breza të gjelber. Bregu është i organizuar në tre zona:

- Pjesa qendrore është zona turistike dhe argetuese kryesore, ku rruga vjen nga fshati dhe bashkohet me bregun. Kjo zonë duhet të zhvillohet me një densitet relativisht më të ulët se sa Dhermiu me ndertime prej 2 katësh të integruara këtu në ullishtë. Organizimi i vilave të pushimit apo Hoteleve në vëllime të veçanta i kombinuar me bare dhe restorante me terrace që shohin nga deti është modeli më i pershtatshëm për këto zona.
- Pjesë veriore drejt Palases është zona kryesore e zhvillimit që karakterizohet nga pamje të mira të detit, toka të pjerrëta dhe që nuk kanë shumë bimesi. Kjo zonë është rezervuar për ndertimin e resorteve të mëdhenj, vilash pushimi dhe resortesh. Një planifikim i kujdesshëm siguron ndarjen midis këtyre dy zonave si dhe ruajtjen e distancës nga deti.
- Zona e jugut në drejtim të Dhermiut është një hapësirë ku zhvillimi është i ndaluar dhe karakterizohet nga një bimesi e dendur. Nuk do të ketë asnjë rrugë

qe te çon ne breg te detit. Mundesia per nje zhvillim te kufizuar duhet te hetohet me kujdes dhe do te jete objekt i nje procesi per marrje leje te veçante.

Funksionimi i bregut si nje zone argetimi dhe rekreacioni per investime cilesore kerkon nje kontroll dhe organizim te veçante te kesaj zone me rregulla speciale ne menyre te veçante per funksionimin e bareve dhe klubeve. Ne distance 100m jashte kufijve te zones turistike, asnje forme akomodimi e perhershme nuk duhet te lejohet pasi komprometon cilesine e te gjithe zones.



**Figura 45:** Referenca: Shembull turistik luksoz

Fshati i **Palases** eshte vendbanimi ekzistues ne zone i cili do te ndikohet pozitivisht nga zhvillimi i turizmit ne te gjithe zonen duke terhequr me shume banore te perhershem si dhe duke shtuar nje pjese te akomodimeve turistike. Zgjerimi i fshatit propozohet te behet pergjate rruges nga deti e cila karakterizohet nga pamje te bukura.

Siç e kemi permendur edhe me pare hapësira e **Dralleos** paraqet nje Peisazh me vlera unike e cila reflektohet ne te gjithe Himaren dhe duhet trajtuar me kujdes dhe si rezerve toke. Kjo toke eshte e pershtatshme per resorte te medhenj vila pushimi luksoze si dhe per eko-shtepiza. Ketu jane aplikuar parimet e meposhteme te qasjes se zonimit:

- Rregulli i pare i mbrojtjes i referohet zones se plazhit e cila duhet ruaje formen e saj natyrale ne te gjithe gjatesine e saj. Kjo eshte arsyeja qe zona e ndaluar prej 100m duhet te rritet ne 200 nga bregu.
- Delta aluvionale e Rrugeve te Bardha eshte mbrojtur si nje Monument natyre me vlera te larta estetike dhe mjedisore. Perreth deltes dhe perroit nje zone


tampone eshte percaktuar bazuar kjo mbi kritere pamore. Asnje terheqje materialesh nga shtrati i lumit nuk lejohet te behet.

- Zhvillimi informal, ndertimet individuale dhe hapja e rrugeve te reja eshte rreptesisht e ndaluar te behet ne kete zone. Ne pergjithesi asnje zhvillim individual nuk duhet te lejohet te behet per toka me siperfaqe me te vogla se 5ha.
- Propozimet per investime per nje zhvillim te integruar te shoqeruara nga “vleresim paraprak mjedisor” dhe plani i infrastruktures, mund te pranohen vetem per zonat qe bien brenda zones se gjere te caktuar per zhvillim te pershtatshem te specifikuar nga plani (zonat me potencial zhvillimi).



**Figura 46:** Referenca: Qualia e gjelber turistike, Australia

**ZONA E TRASHEGIMISE KULTURORE:** Per vendbanimet tradicionale dhe malore te Dhermiut dhe ne nje shkalle me te vogel per Palasen, plani promovon njesi te reja te vogla qe integrohen ne mjedisin tradicional dhe qe pjesa me e madhe e godinave tradicionale te mbetura te perdoren si facilitete per hotele te vegjel dhe per ato te tipit shtrat s dhe mengjes ; numri i madh i monumenteve te kultures ne Dhermi (Kisha e Panayia, Shen Stefanit, Ipapandit, shtepia e Zhupave, Vretove, Kunit, Gjipopulit), berthama kohezive e fshatit e ndertuar me kalldrem dhe festivalet lokale perbejne nje entitet kulturor qe mund te jete shume terheqes si per tregun vendas ashtu edhe per ate nderkombetar. Kerkesa per kete tip turizmi duhet te shoqerohet me projekte rehabilitimi te ndertesave tradicionale prej guri, permiresimi i infrastruktures dhe ai i siperfaqeve te hapura e te lira duke sjelle nje imazh te permiresuar te vendbanimeve.



## LEGJENDA

- Rrjetit Rrugor**
- KULTURE BASHKAKE
  - RRUJETA KOMBETARE
  - RRUJETA RRUJTOR KRYESOR
  - RRUJETA RRUJTOR SEKONDOAR
  - RRUJETA RRUJTOR TERCIAL
  - URVAZ RRUGOROR E PRODUKTOAR E HIRANES
  - RRUJETA RRUJTOR KRYESOR I PRODUKTOAR
  - RRUJETA RRUJTOR SEKONDOAR I PRODUKTOAR

### Zone Rezidenciale

- ZONE URBANE
  - ZONE RURIALE
  - A5 ZONA REZIDENCIALE ME KUFIZIME TE VECANTA
  - A5 ZONA E RE TE SHITESHME TE DYTIA
  - A21 ZONA TE PERHATATSHME REZIDENCIALE
- Turizem & Rekreacion/Pushimi**
- T1 ZONA HOTELIERE DHE SHIFOCENSE
  - T2 RESORT E DHE VILA (ENJLAVA ZIVILLER)
  - T3 KAMPING DHE AKTIVITETE EKOTURISTIKE
- Zone Aktivitetesh**
- A1 ZONA EKONOMIKE ME MPAKET TE ULJET

### Zone Sherbimesh

- S1 SHERBIMET PUBLIKE (SHENJTESI, ARBA, KOMUNISTRAT)
- Zone Bujqesore**
- B1 PLAGHJI BUKESOR I AGRO-TURIZEM
- Zonat Natyrore**
- N1 REZERVAT LUORE, PEPERDITJE DHE LUMBALTE
  - N2 RRAFSHINJAT STRATEGJIKE DHE LUGRAT E THELLA
  - N3 RRAFSHINJAT SHPET DHE KULLLOT
  - N4 TOKAT JO PUELDOR
  - N5 HAPORAT E SHULEBNA TE STRUKURUARA
  - N6 PUCJET
  - N7 MONUMENTE NATyrore
  - N8 ZONAT TAMPON TE MONUMENTE NATyrore

### Zona te Trashgimise Kulturore

- M1 ZONAT TAMPON TE TRASHGIMISE KULTURORE
- Kufizime te Pergjithshme**
- IMPANTE ME PUESHRESI ME TE ANKHE SE 30%
  - DISTANCA SIDA VJAK E BATESIS SIDA
  - ZONAT ERZDHE
  - ZONAT E LARTA
- Infrastruktura**
- REZERVUARE
  - REZERVUAR BASHKAK
  - STACIONE ELEKTRIKE
  - SPRINT TRATIMI I UBERAVE TE NDOTUR

- MIET-ET BASHKAKE
- VENDORELLIJA DHE VETUR I PERSHESHEM
- MIET-ET
- VENDORELLIJA I PRODUKTOAR I PERSHESHEM
- MIET-ET
- KARIN E PRODUKTOAR

13.I Përdorim të Përgjithshëm të Tokës Planit Shkalla 1:10.000

Zonen e Dhermi me te gjere

STUDIUM PROJEKTIM I ZONES SE HIMARES ME PEPARESI ZHVILLIMIN E TURIZMIT

THYMIO PAPAANNIS AND ASSOCIATES INC.  
spatial planning and design



## 2.2 NJESIA HAPESINORE 2 (VUNO - ILIAS)

**KARAKTERI DHE DESTINACIONI-** Kjo njesi hapesine perfshin pjesen e territorit te Bashkise midis dy poleve te zhvillimit, atij te Himares dhe te Dhermiut. Dy vendbanimet kryesore ndahen njeri nga tjetri nga kanioni i Ngjipese, i cili eshte zona me peisazhin me te spikatur. Zona nuk ka nje dalje ne bregdet te pershtatshem per zhvillimin e turizmit me perjashtim te gjiut te vogel te Jal-it. Duke ndjekur vizionin e perzgjedhur per Bashkine Himare, kjo zone paraqet mundesi dhe pershtatshmeri per turizmin Natyror dhe Kulturor, i perqendruar tek fshatrat me trashegimi kulturore, eko-aktivitete dhe rekreacioni ne natyre te lidhura keto te fundit me pranine e kanionit te Ngjipese dhe te peisazhit bujqesor si dhe permes akomodimeve ne mjedise agroturistike.

**KONCEPTI I ZONIMIT DHE I MBROJTJES SE PEISAZHIT** – Kjo zone karakterizohet nga natyra e ruajtur dhe e pademtuar, nga kanioni i Ngjipese dhe nga zona dendur me peme. Ne nje shkalle makro, ne nivel bashkie zona konsiderohet si nje zone tampon midis dy poleve te zhvillimit, atij te Dhermiut dhe Himares. Kanioni i Ngjipese paraqet interesin e pare per vizitoret ne zone. Ketu peisazhi duhet te mbetet i paprekur si nje zone e qete ku mbizoteron natyra. Struktura e peisazhit ne te dyja anet e kanionit krijon nje seri peisazhesh te izoluara ne breza horizontale qe zbresin nga mali ne det:

- Brezi i pare i peisazhit eshte **vendbanimi**, qe eshte i vendosur ne nivelin e rruges kombetare, zgjerohet poshte kufirit te zones malore bregdetare. Ne kete zone mund te parashikohet nje zgjerim i kujdesshem per zonen rezidenciale te vendbanimit ne menyre te tille qe te komplementohet me fshatin duke e kombinuar me rregullin e zones tampone prej 500m. Ne menyre te veçante ne Vuno, ndertimet e reja duhet te zbatojne kritere specifike me qellim qe te perputhen me karakterin tradicional te vendbanimit. Konsulenti ka identifikuar segmente te vogla te pershtatshme per ndertime prane nivelit te rruges duke marre parasysh shpatet ekzistuese dhe impaktin pamor nga deti dhe rruga.
- Brezi i dyte i peisazhit formohet nga toka bujqesore e cila shtrihet ne nje pllaje poshte vendbanimit rreth 300-400 metra nga deti. Kjo zone eshte karakterizuar si nje **peisazh bujqesor** i mbrojtur duke vene theksin ne mbeshtetje te karakterit te bujqesise tradicionale dhe ne kultivimin e pemeve te ullirit. Duke ndjekur politikat dhe direktivat e BE-se aktivitetet agro-turistike promovohen si nje forme te ardhurash shtese dhe shtyjne rigjallerimin e bujqesise klasike te te lashtave dhe te prodhimeve te tjera si dhe ngritjen e njesive te vogla perpunuese. Turizmi i akomodimit ne vila tradicionale me çati lejohet te zhvillohet deri ne nje kufi prej 10-15% te totalit te zones me nje koeficient te ulet per plot (ngaster) qe nuk duhet ta kalojne lartesine e pemes se ullirit.
- **Zonat e gjelbra te strukturuara** ne formen e peisazheve te vegjel nderfuten midis zones bregdetare dhe peisazhit bujqesor midis kanionit dhe vendbanimeve. Keto zona te kufizuara sipas kriterit pamor, ne pergjithesi jane zona te vlefshme peisazhi dhe te pershtatshme per aktivitete rekreative qe zhvillohen ne natyre dhe te ngjashme me ato qe zhvillohen ne zonat perreth siperfaqeve te gjelbra urbane. Nje numer i kufizuar ndertimesh per sherbime si kafe apo restorante mund te lejohen te ndertohen ne rreth 2-5% te totalit te

siperfaqes.

- Brezi i katert i peisazhit eshte ai i **bregdetit**, i cili paraqet nje gjeomorfologji me kodra dhe shpate te rrepire ku mungon bimesia dhe shkembinjte me plazhe te vegjel dhe shpella qe nuk mund te arrihen nga toka. Kufijte e saj percaktohen mbi baze te kriterit pamor nga deti qe krijon mjedisin e Kanionit. Ky brez duhet konsideruar ne teresine e tij se bashku me sfondin e shpateve si nje zone e mbrojtur ku ndalohen zhvillimet.

Organizimi hapesinor dhe koncepti i zonimit i zones eshte hartuar direkt nga struktura e peisazhit te pershkruar me siper dhe nga koncepti i zones se mbrojtur.




**Figura 47:** Referenca: Hotel i vogel ne lagjen tradicionale, Peloponesus (Taleton). Greqi

**STRUKTURA HAPESINORE DHE VENDBANIMET:** Njesia 2 permban fshatrat e Vunoit dhe te Ilias si dhe zonen per zhvillimin e turizmit te Jal-it.

Fshati i **Vunoit** eshte nje vendbanim tradicional me nje vlere arkitekturore dhe kulturore te veçante, i cila do te jete edhe qendra e njesise ne kuptimin e madhesise, historise, kultures dhe sherbimeve dhe e perqendrimit te popullsis se perhershme. Trendet e tanishme demografike priten qe te kthejne pozitivisht si rezultat i zhvillimit te bujqesise dhe turizmit qe do ndikojne pozitivisht ne ekonomine e fshatit. Shtepite e vjetra ekzistuese do te restaurohen per hotele te tipit Shtrat dhe Mengjes si edhe ne bare dhe restorante qe ofrojne pamje panoramik qe do te terheqin vizitoret. Katet perdhese mund te ofrojne edhe sherbime tregtare si dyqane ku do mund te shiten produkte lokale dhe artizanale, kryesisht keto ne rruget me kalldrem. Gjithashtu fshati

ka nevojë të mbeshtetet në asetet e tij kulturore, me qëllim që të plotësojë kërkesat për turizëm malor dhe kulturor dhe të shndërrohet në një pikë tërheqëse për vizitorët; konkretisht me qëndren e tij tradicionale, rrugët e shtruar me kallëdrem dhe me monumentet kulturore si Shen Spiridhoni, Shen Mihali, Mesodhia, Shen Sotiri, Shtëpitë e Kokave dhe Kasnecit). Duke ndjekur Vizionin e propozuar për zhvillimin e turizmit, do të propozohet të ngrihet një muze kushtuar historisë së fshatit dhe emigracionit, si një atraksion për vizitorët. Nderkohe fshati mund të përballojë një qendër informimi turistike për prodhimet agro-turistike lokale si dhe të shërbimeve që ofron zona.



**Figura 48:** Referenca: Agroturizmi në Peloponesus (Eumelia)

Nje problem i rendesishem funksional, i cili duhet ngritur Planin, eshte i lidhur me zhvendosjen e rruges kombetare, qe ndan vendbanimin ne dy zona, ne nje nivel me poshte midis vendbanimit dhe zones bujqesore, me qellim qe te mbeshtetet krijimi i nje qendre tregtare ne zemer te fshatit qe do t'i bashkonte keto dy pjese duke e bere nje vendbanim edhe me te bashkuar e te lidhur.

Fshati i **Ilias** eshte nje fshat i vogel, qe varet nga Vunoi per sa i perket sherbimeve. Struktura e tij e veçante dhe i identifikuar si nje “Fshat Kopsht” duhet te jete baza qe do te percaktoje karakterin e ardhshem arkitekturor te vendbanimit si dhe tipologjine rezidenciale. Nje zgjerim i kufizuar i fshatit ne drejtim te rruges kombetare eshte propozuar me qellim qe te sigurohen disa shtytysa zhvillimi per komunitetin lokal. Vunoi dhe Iiasi jane dy vendbanimet kryesore te zones qe pritet te mbulojne rreth nje te treten e totalit te kerkeses per tipin tradicional te akomodimit ne fshatrat malore te Bashkise. Qellimi eshte te permiresohen kushtet e popullsisë rezidente. Projekte rehabilitimi, permiresim i infrastruktures dhe sigurimi i hapësirave te gjera duhen promovuar per kete qellim, se bashku me perdorimin e banesave tradicionale.

**Jali** eshte e vetmja zone e zhvillimit turistik te zones, e cila eshte organizuar rreth nje gjiri te mbyllur dhe dy plazheve. Ideja kryesore e konceptit te zonimit ne kete rast eshte rritja e dendesise si pasoje e hapësirës se kufizuar te tokes se vlefshme per ndertim ne formen e nje amfiteatri me ndertime te vendosura ne tarraca e me pamje te hapur. Njese te vogla jane parashikuar te ndertohen ketu duke krijuar nje vendbanim terheqes ne plazhin kryesor me nje zgjerim ne drejtim te veriut ne zones e shpateve te pjerret poshte rruges kryesore. Pjesa e hotelit te kohes se komunizmit qe gjendet mbi kepin e gjiut nuk ndikohet nga zonimi. Zonimi eshte i organizuar ne dy breza. Njera eshte pjesa ballore qe sheh detin dhe eshte planifikuar per hotele te vegjel dhe vila pushimi, bare dhe restorante, ndersa pjesa tjeter perfshin shpatet e pjerreta ku do te shtrihet zona rezidenciale me shtepi te dyta. Ne rastin e Jalit, madhesia e plazhit eshte nje faktor kushtezues e kufizues qe percakton dhe kufirin e siperm te kapacitetit te shtreterve ne zone.

Pozicioni i Jales ne organizimin hapesinor do te ripercaktohet permes permiresimit qe do t'i behet rruges qe do ta lidhe ate me Livadhin, gje e cila do te rrise aksesin ne zone dhe do te ule varesine e saj nga Himara. Zona te tjera te pershtatshme zhvillimi jane identifikuar ne kete segment te bregut.








**Figura 49:** Referenca: Shembuj te zonave turistike

**ZONAT E MBROJTURA** – Kanioni i Ngjipeas, eshte klasifikuar si nje Monument Natyre, perben nje zone me interes te veçante dhe natyral e mjedisor me nje vlere te madhe e bukuri mahnitese, qe duhet mbrojtur dhe duhet perjashtuar nga çdo forme zhvillimi. Nje zone perreth Kanionit eshte mbrojtur si nje zone tampone Peisazhi per arsye estetike, ndersa ne verilindje te Kanionit zona eshte e ndjeshme ndaj erozioni, per kete arsye ndertimi eshte i ndaluar. Plani propozon po ashtu nje pjese te bregut ne jug te Ngjipese si zone te mbrojtur e kategorise se III, kandidate per monument natyre per vlerat e saj te veçanta estetike.

**ZONAT E TRASHEGIMISE KULTURORE:** Nje zone tampone prej 250m eshte vendosur per manastirin e Shen Theodorit, si nje atraksion kulturor i rendesishem dhe nje zone turistike me vlere te veçanta.



### LEGJENDA

|  |   |  |   |  |
|--|---|--|---|--|
| <p><b>Rrjetit Rrugor</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— RRUJTI KOMBETARE</li> <li>— RRUJTI RREZOR QYKOR</li> <li>— RRUJTI RREZOR SEKONDAR</li> <li>— RRUJTI RREZOR TERCIAL</li> <li>— UNIZA RRUDORE E PROPOZUAR E HIMARES</li> <li>— RRUJTI RREZOR KRIVOROR I PROPOZUAR</li> <li>— RRUJTI RREZOR SEKONDAR I PROPOZUAR</li> </ul> | <p><b>Zone Rezidenciale</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A.1 ZONE URBANE</li> <li>A.2 ZONE RURALE</li> <li>A.3 ZONA REZIDENCIALE ME NUFIZIME TE VECANTA</li> <li>A.4 ZONA E RE TE BETERPIME TE OJTA</li> <li>A.24 ZONA TE PERSHPTIMTE RUDIMENDIALE</li> </ul> <p><b>Turizem &amp; Rekreacion/Pushimi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>T.1 ZONA HOTELIERE DHE SHIFLOHISE</li> <li>T.2 RESORTE DHE VILA (ENKLAVA ZHOLLIM)</li> <li>T.3 KAMPING DHE AKTIVITETE EKSTURISTIKE</li> </ul> <p><b>Zone Aktivitetesh</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A.1 ZONA EKONOME ME MPAKET TE LULET</li> </ul> | <p><b>Zone Sherbimesh</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>S.1 SHERBIMT PUBLICI (SHENDETESI, ARSUK, SHANORAT)</li> </ul> <p><b>Zone Bujqesore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>B.1 PESHQI BUKJESOR I AGRO-TURIZEM</li> </ul> <p><b>Zonat Natyrore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>N.1 REZERVAIT LUKRE (PERRIBETE DHE LINDJETE)</li> <li>N.2 RAFTSHKALTAT STRATEGJKE DHE LINDJETE THIELLA</li> <li>N.3 RAFTSHKALTAT (PJETI DHE KULLOTAT) TONI 20 VELLEJE</li> <li>N.4 HAFSIRAT E GJELPERA TE STRUKTURIMARA</li> <li>N.5 PLAZHET</li> <li>N.6 MONUMENTE NATYRORE</li> <li>N.8 ZONAT TAMPON TE MONUMENTE NATYRORE</li> </ul> | <p><b>Zona te Trashegimise Kulturore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>K.1 ZONAT TAMPON TE TRASHEGIMISE KULTURORE</li> </ul> <p><b>Kufizime te Pergjitheshme</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— SHPATE ME PUNRES ME TEMPOHE E 30%</li> <li>— DISTANCE NGA VILA E BATIKES 100M</li> <li>— ZONAT EROZIVE</li> <li>— ZONAT E LARTA</li> </ul> <p><b>Infrastruktura</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— REZERVAHURE</li> <li>— REZERVAHUR RAJONAL</li> <li>— STACIONE ELEKTRIKE</li> <li>— SHANAT TRAZHIT LUGRIVE TE RRUJTOR</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>— MBREJETI BASHKIMAKE</li> <li>— VENDORJABALLZIZHTAR I PERICHESHM MBRETESH</li> <li>— VENDORJABALLZIM I PROPOZUAR I POKONKURSHMIBRETESH</li> <li>— KARRIER E PROPOZUAR</li> </ul> |
|--|---|--|---|--|

13.II Përdorim të Përgjithshëm të Tokës Planit Shkalla 1:10.000

### Zonen e Vuno me te gjere

STUDIM PROJEKTI I ZONES SE HIMARES ME PEPARPESI ZHVILLIMIN E TURIZMIT

THYMI PAPAIOANNIS AND ASSOCIATES INC.  
 URBAN PLANNING AND DESIGN

### 2.3 NJESIA HAPESINORE 3 (HIMARE - PILUR)

**KARAKTERI DHE DESTINACIONI-** zona e qytetit të Himares përfaqëson qendrën administrative kulturore dhe qendrën e shërbimeve për Bashkinë. Zona ka kapacitetin për të shndërruar në një **pol të ndërmjetëm të turizmit urban** në Bregdetin e Jugut të Shqipërisë midis Vlores dhe Sarandës duke zëvendësuar kështu varesinë e vendbanimeve bashkiake nga qendra të tjera jashtë zones. Qyteti parashikon të tërheqë në të ardhmen, pjesën më të madhe të rritjes së popullatës rezidente dhe asaj sezonale, e cila do të përfshihet në biznesin e turizmit dhe të shërbimeve për ekonominë e turizmit, e cila në pjesën më të madhe do të lokalizohet këtu. Kërkesa për zhvillime të reja rezidenciale do të përbejë në të ardhmen një pjesë të rëndësishme të rritjes urbane. Identiteti i turizmit në zonë duhet të ndërtohet mbi atraksionet e shumta si një kombinim i turizmit komercial, aktiviteteve të plazhit, aktiviteteve kulturore dhe eko-natyrore. Shndërrimi i zones urbane në një hapësirë gjithnjë e më tërheqëse përmes intensifikimit dhe dendësimit dhe përmirësimit të shërbimeve nga njëra anë dhe me ruajtjen e atraksioneve natyrore dhe kulturore në rrethinat e afërta të qytetit në anën tjetër, do të mbështesë kushtet për një turizëm të gjitha llojeve. Qëllimi është që të mundësohet ofrimi i një larmie zgjedhjesh për akomodim dhe eksperiencë të shkëlqyera për vizitorët duke filluar që nga bregu i detit të qytetit, tek akomodimet tradicionale në Kështjelle apo në bregun e qetë të detit të ndonjë hoteli në qytetin e Livadhit.

**KONCEPTI I MBROJTJES SË PEISAZHIT** – Baseni i Himares kërkon një planifikim të kujdesshëm duke qenë se morfologjikisht ka një Peisazh të nderlikuar me perrenj e kodra dhe se nderhyrja e njeriut me ndërtime të shumta mbizoteron në zonë. Elementet e veçante të Peisazhit që ekzistojnë në zonë duhen të mbrohen dhe të vihen në dukje me qëllim që të ruhet perceptimi pamor dhe funksional. Të tilla janë kodrat e kepeve, perrenjtë, ullishtat, lugina dhe plazhet. Marrëdhënia midis natyrës dhe urbanizimit duhet të ruhet në kontrast me vendbanimet pranë detit dhe me mbrojtjen e luginës në thellësi të tokës të mbjellë me ullinj që ka mbetur pas kodrave të vogla. Kombinimi midis Peisazhit urban dhe atij bujqësor janë një pjesë e identitetit të zones që nuk duhet të shkatërrohet. Pamjet nga kodrat (zgjerimi i Stefanelit, Himara e Vjeter, etj.) në drejtim të pjesës së basenit (ullishtat, kodra e kepit, shtrati i lumenjve) janë marrë me kujdes në konsideratë për të përcaktuar kufijtë e zhvillimit të çdo zone. Kodrat e kepeve në anë lindore dhe perëndimore që përcaktojnë gjiun e Himares, që zbrësin nga zona malore në drejtim të detit, duhet të mbrohen dhe të ruhen pasi ato krijojnë kufirin pamor struktural të të gjithë zones. Të dy perrenjtë që përshkojnë Peisazhin duhet të shfaqen si shtrat lumi dhe duhet të rehabilitohen nga ana mjedisore atje ku aktiviteti i njeriut i ka demtuar. Pjesa e luginës në thellësi të tokës së mbjellë me ullinj duhet të mbrohet si një peisazh çilesor i zones e cila e rrethon me një brez të gjelbër hapësirën urbane. Mbi të gjitha, zona duhet të mbrohet nga ndërtime sporadike dhe zhvillimet urbane informale që janë sot një trend, si dhe nga ndërtime pa leje të çilesisë së ulët që përbejnë rrezikun dhe kërcënimin më të madh për Peisazhin dhe që mund të minojë identitetin e ardhshëm turistik të zones.

**ORGANIZIMI HAPESINOR DHE KONCEPTI I ZONIMIT** – Koncepti i zonimit i propozuar për basenin e Himares bazohet në përshkrimin e mesipër të strukturës së peisazhit. Qyteti mbulon pjesën ballore të gjiut i organizuar në dy plazhe kryesore atij të Spilese dhe Potamit. Integrimi i zhvillimeve sporadike rezidenciale në zonën urbane përreth është promovuar me qëllim që të krijohet një strukturë urbane me e

konsoliduar. Pjesa e pasme e qytetit kufizohet nga kodrat qe sherbejne si nje brez i gjelber duke ruajtur keshtu nje perqindje te siperfaqes se gjelber te zones urbane. Pas brezit te gjelber jane organizuar zonat e pershtatshme per rezidenca, aktivite prodhuese dhe token bujqesore qe do te vazhdoje te mbuloje nje pjese te madhe te territorit te basenit. Fshati i Mihal paraqitet si poli rezidencial me i rendesishem, si qender bujqesore dhe e aktiviteteve perpunuese. Aksesit ne kete zone te pasme eshte mundesuar permes nje rruge te brendshme qe kalon pas brezit te gjelber. Gjate 5-10 viteve te ardhshme kjo pritet te luaje rolin e nje by-pass te brendshem per qytetin. Ne nje periudhe me afatgjate eshte propozuar qe trafiku rajonal dhe ai nderrajonal te devijohet ne nje lloj unaze qe do te kaloje prane anes se basenit ku dhe eshte kufiri natyral i Himares duke perfshire edhe token bujqesore.

Ndertimi i unazes do te permiresoje rrenjesisht organizimin dhe funksionimin e qytetit si dhe do te sherbeje per konsolidimin e brendshem te tij. Pjesa e detit do te çlirohet dhe do te shnderrohet ne hapësirë kryesore publike, ne nje zone rekreacioni si dhe ne nje korridor qe do te bashkoje dy pjeset kryesore te qytetit.

**Spillea** do te mbetet dhe do te forcoje karakterin e saj si qendra ekzistuese e qytetit, e cila do te perforcet nga turizmi komercial me kafene, dyqane dhe restorante po ashtu ne lidhje kjo edhe me portin ekzistues, i cili do te permiresohet dhe orientohet si port me funksion argetimi. Per te gjitha eshte parashikuar nje intensifikim i perpjekjeve per te permiresuar imazhin e urban te vijes bregdetare. Drejtimi kryesor planifikimit eshte te eliminoje trafikun permes qytetit dhe inkurajuar ecjen. Nje hapësirë publike per parkim eshte e nevojshme ne dy vende, prane lidhjes ne rrugen by-pass te brendshem si dhe ne ane te plazhit te Spilleas prane perroit, duke i siguruar ne kete menyre sherbime edhe portit. Plani siguron zgjerime urbane ne qendren e qytetit, me qellim integrimin e rezidencave te reja dhe te vjetra midis tyre, qe shperndahen ne menyre te çrregullt, duke marre parasysh edhe rritjen e parakohshme demografike dhe ate te turizmit. Ndryshe eshte propozuar trajtimi i zonave fqinje qe do ndertohen ne shpatet e pjerreta qe shohin nga deti, te cilat do te kene nje lidhje me organike si dhe ato qe do te ndertohen ne brendesi te qytetit ne terrenet e sheshta, qe mund te kene nje model urban me te rregullt me kuadrate dhe hapësira te hapura.

Zona e **Potamit** do te perbeje polin e dyte te qytetit, qe do te kete nje funksion dhe orientim per shtepi te dyta dhe akomodime turistike. Qellimi kryesor i pjeseve te zonuara do te jete organizimi me i mire i pjeseve te drejtuara nga deti duke ruajtur nje intensitet te ulet dendesimi ne perputhje me karakterin e zones. Zona eshte e ndare ne dy pjese, karakteri i te cilave percaktohet ne lidhje me pozicionin ndaj rruges se bregut. Zona e pare eshte ajo e Sreglit, qe ndodhet siper rruges se bregut eshte parashikuar si nje zgjerim rezidencial, duke ndjekur trendin ekzistues. Eshte parashikuar qe te akomodoje nje perqindje te vogel turistesh me hotelesh te vegjel dhe dhoma me qera. Zona e dyte, qe zgjerohet poshte rruges se bregut deri ne breg, do te jete zona turistike e qytetit. Zona eshte e pershtatshme per hotele te nje shkalle te mesme, per qellime rekreacionale ne lidhje me shetitoren buze detit, si zone defrimi qe do te funksionojë si plotesuese me pjesen e Spillese.



**Figura 50:** Referenca: Shetitore bregdetare ne Santorini, Greqi

Poli i trete i kompleksit urban eshte formuar nga **Fshati i Himares**, e cila eshte e lidhur organikisht me qytetin permes rruges kombetare dhe mbetet nje reference simbolike e fuqishme pamore e gjithe zones. **Keshtjella** (Kastro) do te gjallerohet si nje qender kryesore kulturore me mundesi per te pritur evenimente te tipeve te ndryshme (muzike, kenge, ekspozita, etj) shoqeruar keto me sherbime si kafene, restorante dhe dyqane. Mundesia per ta vizituar ate naten duhet inkurajuar. Nje pjese e rendesishme e kapacitetit te krevateve per kategorine “e fshatrave malore” duhet te akomodohen ne shtepite tradicionale te tipit “shtepive mikpritese”. Dy ide jane promovuar per keshtjellen e Himares:

- Ngritja e nje muzeu, qe te paraqese historine e zones me mbeshtetje te Ministrive te Kultures se Greqise dhe Shqiperise, qe do te sherbeje si nje atraksion per vizitoret. Nje godine e pershtatshme duhet te perzgjidhet per kete qellim, e cila duhet te rehabilitohet me fondet e BE-se apo te ndonje institucioni tjetër.
- Krijimi i nje qendre per trajnime profesionale ne fushen e turizmit, e cila do te funksionojë mbi baza seminaresh qe do te kryhen ne strukturat ekzistuese qe duhet te rehabilitohen dhe do mundesojne akomodimin e studenteve.

Karakteri rezidencial i zones duhet te zgjerohet ne ekuilibër me nevojën për të mbrojtur urbanistikën e këtij monumenti nga zhvillimet sporadike. Drejtimi kryesor eshte sigurimi i shtysave për të rehabilituar banesat tradicionale, permiresimi i infrastruktures, i hapësirave të hapura si dhe imazhit të vendbanimeve. Zonat rezidenciale ekzistuese qe jane zhvilluar vitet e fundit brenda zones tampone jane integruar por me kufij specifik. Nje brez i gjelber eshte propozuar qe te ndaje kete zone nga ajo e qytetit te Himares.

Poshte kalase shtrihet plazhi i **Livadhit**, i cili sot eshte i pazhvilluar. Zona nuk ka nje popullsi te qendrushme rezidente. Karakteri i ardhshem i tij eshte parashikuar si nje pol komplementar rekreacioni dhe shtepish te dyta te lidhur me sistemin e qytetit te Himares, duke marre parasysh avantazhin e tij kryesor ate te afersise me detin dhe te Peisazhit te pademtuar, gje qe do sjelle vizitore nga Himara. Plani siguron nje zone turistike me hotele te vegjel familjare ne ane te plazhit, si dhe sherbime te shtrira ne pjesen ballore te zones ku rruga zbret ne plazh. Nje kamping eshte propozuar ne ane te plazhit ne anen tjetër te perroit, ne nje vend qe nuk eshte terheqes duke iu ofruar nje mundesi akomodimi familjeve dhe te rinjve. Pjesa e plazhit qe mbetet eshte lene ne formen e saj natyrale e rrethuar nga Peisazhi bujqesor. Nje zone rezidenciale e nje madhesie te konsiderueshme eshte parashikuar te ngrihet ne brendesi, ne nje zone lart mbi perrua dhe qe ofron pamje te bukura mbi plazhin dhe detin. Kjo zone pritet qe te absorboje kerkesat per shtepi te dyta dhe dhoma me qera.

Fshati i thelle i **Pilurit** ka nje identitet te pavarur i cili lidhet ekonomine e zonave malore qe karakterizohen nga prodhimi blegtoral dhe nga aktiviteti bujqesor. Lidhja e tij me Himaren eshte pamore si dhe varesia nga sherbimet qe mer prej saj. Nje zonim i kujdesshem eshte propozuar me qellim ruajtjen e bazes prodhuese te tij dhe vendosjen natyrale te fshatit duke parashikuar zona te pershtatshme zhvillimi rezidenciale me qellim sigurimin e shtysave per investime per popullsine lokale. Pamja panoramike gjut te Himares qe mund te shikohet nga fshati ne menyre te veçante gjate nates eshte nje atraksion i rendesishem per vizitoret. Eshte parashikuar qe fshati mund te ofroje nje numer te kufizuar krevatesh ne strukturat tradicionale. Zona eshte e pershtatshme per aktivitete eko-turistike. Peisazhi terheqes malor prane Pilurit (ne Vumblo ne verilindje te Pilurit) eshte nje vend i pershtatshem per zhvillime te ketij tipi turizmi.



**Figura 51:** Referenca: Fshat malor Papades, Evia, Greqi

**AKTIVITETET PRODHUESE:** Siç eshte permendur edhe me perpara, Bashkia e Himares ne te ardhmen ka nevojë per nje zone ku te perqendrohen aktivitetet si, magazina, njesi perpunuese, prodhim materialesh ndertimi te cilat priten qe te shtohen se bashku me kerkesen per token dhe trendin e zhvillimeve turistike. Kjo zone eshte caktuar ne rrethinat e qytetit te Himares bazuar mbi kriterin pamor dhe ate te distances minimale nga zonat rezidenciale. Nje vend i pershtatshem qe i ploteson keto kriteret dhe nuk ndikon pamjen nga Keshtjella eshte propozuar prane Mihalit pas brezit te gjelber dhe me akses nga rruga periferike e brendshme. Zonat ekzistuese qe jane lokalizuar pas perroit perbejne nje rrezik per mjedisin dhe shendetin dhe duhet qe gradualisht te largohen qe andej dhe te zhvendosen ne zonen e re te mirepercaktuar. Ky largim duhet te shoqerohet me nje projekt rehabilitimi per stratin e perroit dhe per zonen perreth.

**ZONAT E MBROJTURA-** Kanioni i Livadhit eshte propozuar nga Plani si nje kandidat per monument natyre per cilesite e tij te rralla gjeologjike dhe gjeo-morfologjike si dhe per vlerat e tij estetike. Dy kepet qe formojne kufijte natyral te gjut te Himares duhet te mbrohen nga zhvillimet e pakontrolluara. Zonat ekzistuese te zhvillimit mbi Potam jane integruar ne Planin Rregullator me disa kufizime te veçanta. Per me teper, zhvillimi duhet te ndalohet ne te gjithë shpatin nga Kalaja e Himares deri ne breg te detit, me qellim mbrojtjen e pamjes nga Kalaja ne drejtim te detit. Nje zone tampone eshte parashikuar perreth vendbanimeve tradicionale te Kalase se Himares , e cila mbron cilesine e pamjes dhe kontrastin midis vendbanimeve tradicionale dhe zones perreth. Pjese te medha toke bujqesore jane mbrojtur gjithashtu ne Himare, Livadh dhe Pilur.

## 2.4 NJESIA HAPESINORE 4 (PORTO PALERMO)

**KARAKTERI DHE DESTINACIONI** - Zona e Porto Palermos është shquar si një njësi e veçantë hapësinore, për shkak të Peisazhit të saj të veçantë skenik të shtrirë rreth gjirit me gadishullin e vogël dhe Kalanë e Ali Pashës, e cila është e njohur në të gjithë Shqipërinë dhe jashtë saj. Në këtë zonë nuk ka asnjë vendbanim, pra nuk ka pretendim të drejtperdrejtë në zonë, e cila mbetet deri tani, në një masë të madhe e paprekur nga zhvillimi joformal dhe sporadik. Prania e bazës së ish nendeteseve dhe tunelit paraqet një element intrigues që i shtohet atmosferës së vendit. Ky vend unik paraqet kushte të pershtatshme për të zhvilluar resorte luksoze në formën e një investimi të konsiderueshëm, të cila do të funksionojnë gjatë gjithë vitit. Prania e këtij investimi do të përmirësojë pozitën e zonës së Himarës si destinacion turistik cilësor në të gjithë bregdetin jugor të Shqipërisë.

**ORGANIZIMI HAPESINOR DHE KONCEPTI I ZONIMIT** - Në mënyrë që të përmbushë rolin dhe destinacionin e saj, zona duhet të jetë e mbrojtur nga çdo formë e zhvillimit, që do të komprometonte vlerën e saj për investitorët potencial. Një zonë e vetme turistike, në formën e një enklave të vetme zhvillimi është menduar në vendin e bazës ushtarake e rrethuar nga terrene të pjerta. Marina me permashë të plota do të zhvillohet atje në kombinim me resortin e shoqëruar nga objekte zhvillimi rezidenciale që do të specifikohen në Planin Urbanistik. Resorti mund të përfshijë një gamë të gjërë objektivash argetimi, të tilla si kafene dhe restorante, dyqane, spa, qender jahtesh, si dhe mundësi për kazino. I gjithë Gadishulli rreth bazës ushtarake duhet të konsiderohet si zonë e mbrojtur, ku çdo zhvillim në të ardhmen mund të ndodhë vetëm në funksion të resortit.

Kalaja e Ali Pashës mund të shtohet si një pikë dytesore për tërheqjen kulturore dhe turizmin në zonë. Strukturat e braktisura dhe hapësirat e hapura në hyrje të zonës pranë portit të peshkimit duhet të rehabilitohen për shërbimet turistike. Vizitat e zonës në orët e mbremjes duhet të rriten nëpërmjet mbajtjes apo organizimit të eventeve, ndriçimit, muzikës dhe gastronomisë. Duhet të promovohet mundësia e vizitës së zonës me anije nga Himara.




**Figura 52:** Referenca: Vend ekskluzivisht turistik Cape Sounio, Athinë, Greqi



Referenca: Vend ekskluzivisht turistik Cape Sounio, Athine, Greqi

**ZONAT E MBROJTURA** - Gadishulli me keshjtjellen e shekullit te 19-te e ndertuar nga Ali Pasha Tepelena eshte propozuar si monument natyror, kandidat per te qene i mbrojtur, per shkak te formimeve te saj gjeo-morfologjike te rralla dhe vlerave estetike. Per Kalane e Ali Pashes, plani sygjeron dhenien e statusit te mbrojtjes rrigoroze, te vendosur nga korniza ligjore mbi Trashegimine Kulturore. I gjithë gjiri, me perjashtim te zonave te zhvillimit, eshte klasifikuar ne grupin e perdorimit ku bejne pjese kreshtat dhe kepet strategjike, ku zhvillimi eshte i ndaluar.





## LEGJENDA

— Kufiute bashkake

### Rrjetit Rrugor

- RREZJA KOMETARE
- RREZJA RRUGOR KYVESOR
- RREZJA RRUGOR SEKONDAR
- RREZJA RRUGOR TERCIAR
- UNAZA RRUGORE E PROPOZUAR E HIMARES
- RREZJA RRUGOR KYVESOR I PROPOZUAR
- RREZJA RRUGOR SEKONDAR I PROPOZUAR

### Zone Rezidenciale

- A1** ZONE URBANE
- A2** ZONE RURALE
- A3** ZONA REZIDENCIALE ME KUPÇORE TE VECANTA
- A4** ZONA E RE TE SHTRIPJE TE DITA
- A5** ZONA TE PENZIATASH REZIDENCIALE

### Turizem & Rekreacion/Pushimi

- T1** ZONA HOTELIERE DHE SHPLODHESE
- T2** RESORTE DHE VILA (INKLAVIV ZHVILLIM)
- T3** KAMPING DHE AKTIVITE ENDURISTINE

### Zone Aktivitetesh

- I1** ZONA EKONOMIKE ME HAPKAT TE ULLET

### Zone Sherbimesh

- B1** SHERBIMET RURALME (SHENDETESI, ARIKIM, ADEHISTET)

### Zone Bujqesore

- S1** PESHIZH BUGEJOR / AGRO-TURIZEM

### Zonat Natyrore

- N1** REZERVAT LUORE (PERLLODTE DHE LUMENJTE)
- N2** RRAFSHALCAT STRATEGJIKE DHE LUGNAT E THELLA
- N3** RRAFSHALCAT (PJETI DHE KULLOTAT, TOMAT 20 PËLLORË)
- N4** HAPSHIRË E QELBENA TE STRUKTURAJARA
- N5** PLAGHET
- N6** MONUMENTE NATYRORE
- N7** ZONAT TAMPON TE MONUMENTE NATYRORE

### Zona te Trashegimise Kulturore

- M1** ZONAT TAMPON TE TRASHEGIMISE KULTURORE

### Kufizime te Pergjitheshme

- SHPATE ME PAKRRESI ME TE MADHE SE 30%
- DISTANCA NGA VUA E BATESIS 100M
- ZONAT ERODIVE
- ZONAT E LARTIA

### Infrastrukturë

- R** REZERVUAR RACIONAL
- E** STACIONE ELEKTRIKE
- T** MARRAMU TRAJTAMU I LUARAVE TE MOTORE
- M** MBEJTEJ BASHKAKE
- V** VENGDORRUBULLAS ZYRTARI I PERKESHEDIM
- V** VENGDORRUBULLAS I PROPOZUAR I PERKESHEDIM
- K** KARRIER E PROPOZUAR

13.III Përdorim të Përgjithshëm Shkalla 1:10.000  
të Tokës Planit

## Zonen e Himares me te gjere

STUDIUM PROJEKTIM I ZONES SE HIMARES ME PËRPARESI ZHVILLIMIN E TURIZMIT



THYIMO PAPAYANNIS AND ASSOCIATES, INC.  
OFFICE OF ARCHITECTURE AND PLANNING



## 2.5 NJESIA HAPESINORE 5 (QEPARO - KUDHES)

**KARAKTERI DHE DESTINACIONI** - Qeparoi sherben si porta jugore hyrese per zonen e Himares. Ajo eshte e formuar nga dy faqe. Fasada e tij okupon brezin bregdetar midis Porto Palermos dhe Borshit dhe eshte i pozicionuar pa prishur pejsazhin bujqesor. Ne pjesen e brendshme pejsazhi malor eshte pozicionuar rreth lugines se lumit te Qeparose. Zona duhet te zhvillohet si nje pol/nyje e trete e sherbimeve per popullaten lokale, pas atyre te qytetit te Himares dhe Dhermi-Gjilek. Qeparo i Ri eshte vendbanimi kryesor, ne aspektin e popullsisë, madhesise, potencialit te zhvillimit dhe sherbimeve dhe per shkak te vendndodhjes se saj prane rruges nacionale. Pjesa e plazhit duhet te jete e orientuar per ndertime te turizmit lokal dhe rajonal ne trendet ekzistuese, ndersa pjesa e brendshme e lugines duhet te jete e rezervuar dhe te promovohet per natyren, kulturen dhe aktivitetet eko - turistike, te tilla si shetitjet dhe perdorimi i kuajve. Fshati Qeparo i Vjeter i ndertuar ne maje te nje shkambi ne rrenojat e lashta te fortifikuara te vendbanimit te Karos, paraqet atraksion te madh turistik te nje zone qe duhet te ringjallet dhe te mbrohet, ndersa Kudhesi ruan karakterin e tij me te thelle rural.

**KONCEPTI I MBROJTJES SE PEISAZHIT** - tipar i veçante i pejsazhit te zones eshte lugina me ullishte qe pershkohet nga rrjedha e lumit, e cila formon nje prerje terthore qe pershkone malin ne drejtim te nje bote te brendshme, pa referenca me detin. Aktivitetet tradicionale bujqesore mund te aktivizohen pergjate lugines. Vendbanimet e populates ngjiten drejt kodrave me pamje te bukur te lugines, orjentuar nga deti, ndersa vete lugina mbetet e paprekur. Shkambi i Qeparos se vjeter eshte si nje mbikeqyres i lugines. Pamjet drejt vendbanimeve nga rruga sapo kalon zonen jane konsideruar si nje pejsazh shume i veçant. Zgjerimi i Qeparoit te Ri drejt kodrave per te integruar ndertimet e koheve te fundit jane planifikuar me kujdes nga shkalla makro ne mikro ne menyre qe te mos prishin efektin vizual te fshatit.

**ORGANIZIMI HAPESINOR DHE KONCEPTI I ZONIMIT** – Karakteri i qendres se **Qeparoit te Ri** eshte rritur nga zgjerimet aktuale, te cilat synojne qe te integrohen dhe te konsolidojne zhvillimet e fundit, per te forcuar karakterin dhe identitetin e vendbanimit dhe per te lidhur pjesen e siperme e cila eshte e vendosur ne ane te rruges me pjesen me te ulet qe ndodhet perballe detit. Kjo lidhje eshte menduar permes nje rrjeti te hapësirave publike qe te çojne ne plazh, ku eshte planifikuar nje zone e vogel per zhvillimin e turizmit, prane zones rezidenciale te bregdet te shtepive te dyta. Qellimi eshte qe te krijoje nje pike reference ne plazh per argetim, sherbime dhe rekreativitete, te cilat do te terheqin edhe komunitetin lokal ne menyre qe te orientojne vendbanimin drejt detit. Nje shetitore bregdetare eshte parashikuar per te njejtin qellim, si dhe per te percaktuar nje kufi konkret per ndertimet. Nje kamping i madh / eko-gabinash me shume pajisje te tilla si pishina, sporte, restorante dhe hapësire per mjetet e furnizimit eshte percaktuar prane kesaj zone, vendosur ne mes te ullishtes si nje opsion alternativ per pushime familjare. Pjesa tjeter e plazhit dhe lugines do te mbaje karakterin e saj rural.

Pertej pikes se zhvillimit te Qeparo te Ri, Plani synon te percaktoje nje zone te shtepive te dyta ne anen tjeter te lugines, ne pjesen kodrinore ne perendim te ullishteve mbi rrugen nacionale, ne menyre qe te mbuloje kerkesat ekzistuese te zhvillimeve te fundit dhe te konsolidoje keto zhvillime te paorganizuara.



**Figura 53:** Referenca: Kampingu Erodios, Peloponnese, Greqi

Per me teper, Plani identifikon nje tjeter vend me pamje te brendshme brenda zones se mbrojtur te “Kreshtave Strategjike”, si vende te zhvillimeve te mundeshme.


Eko-turizmi dhe agroturizmi perbejne nje komponent te rendesishem per zhvillimin e turizmit te zones, te cilat zene pjesen e brendshme te lugines mbi rrugen nacionale. Fshati **Kudhes** eshte konsideruar si qender per aktivitetet bujqesore dhe aktivitetet e agroperpunimit. Fshati mund te terheqe vizitore si nje qender per produktet vendase te lidhura me vajin e ullirit. Plani percakton zonat e pershtateshme te zgjerimit te fshatit dhe siperfaqeve ne menyre qe te ruaj traditen ekzistuese dhe te ofroje stimuj per zhvillimin e popullsisë lokale. Nje pejsazh malor veçanerisht terheqes ne afersi te vendbanimit e cila paraqet pershtateshmeri per aktivitetet eko-turistike eshte caktuar per kete qellim.



**Figura 54:** Referenca:Pjese e trashegimise se rinovuar te vendbanimit, Zagorohoria, Greqi

**ZONAT E TRASHËGIMISE KULTURORE-** Per **Qeparon e Vjeter** Plani nxit venien ne jete te saj nepermjet perdorimit te shtepive tradicionale per strehimin e tipit B&B. Monumentet e listuara kulturore dhe thelbi koheziv me rrugen me kalldrem, perbejne nje njesi me vlera te veçanta arkitektonike dhe kulturore qe mund te jene veçanerisht atraktive per vizitoret vendas dhe ata nderkombetare. Kerkesa per kete lloj turizmi duhet te shoqerohet me projekte rehabilituese ne ndertimet ekzistuese tradicionale, permiresimin e infrastruktures publike dhe permiresimin e hapësirave te hapura dhe imazhin e vendbanimit.

**ZONAT E MBROJTURA-** Shkambi i Qeparo-se, eshte propozuar si kandidat monumenti natyror. Lumi i Qeparo-se eshte i mbrojtur ne tere gjatesine e saj nga çdo zhvillim dhe hedhja e materialeve. Ligatinat ne delten e lumit jane nje zone e mbrojtur. Pjesa me e madhe e tokes bujqesore ne te gjithë luginen dhe prane fshatrave ruhet per qellime produktive.



## LEGJENDA

— ALFUTE BASHKAKE

### Rrjetit Rrugor

- RREJETI INTERURBAN
- RREJETI RRUJTOR KRYESOR
- RREJETI RRUJTOR SEKONDOAR
- RREJETI RRUJTOR TERCIAR
- UNAZA RRUJTORE E PRODUKUAR E HMARRES
- RREJETI RRUJTOR KRYESOR I PRODUKUAR
- RREJETI RRUJTOR SEKONDOAR I PRODUKUAR

### Zone Rezidenciale

- ZONE URBANE
  - ZONE RURALE
  - ZONA REZIDENCIALE ME KUFIZIME TE VECAPTA
  - ZONA E ME TE SHTRITURIT TE DITA
  - ZONA TE PENITATESHARE REZIDENCIALE
- ### Turizem & Rekreacion/Pushimi
- ZONA HOTELIERE DHE DIFUGJESHISE
  - RESORTE DHE VILA (DIMALIA DHALLMIR)
  - KAMPING DHE AKTIVITETE BEO-FUNGJISTINE
- ### Zone Aktivitetesh
- ZONA EKONOME ME NIVAKU TE ULJET

### Zone Sherbimesh

- SHERBIMET PUBLIKE (SHENDETESI, JASIM, ADRESHAT)
- ### Zone Bujqesore
- PESHIZH BUGEJOR / AGRO-TURIZEM
- ### Zonat Natyrore
- REZERVAT UOORE (PERENDITE DHE LUMENDET)
  - RRAFSHAKTAT STRATEGJIKE DHE LUMNAT E THELLA
  - RRAFSHAKTAT (PJETI DHE RULLLOTAT, TOMAT, ZEPULLI)
  - HAPSHIRAT E GJELBERA TE STRUKURUARA
  - PLACHET
  - MONUMENTE NATYRORE
  - ZONAT TAMPON TE MONUMENTE NATYRORE

### Zona te Trashegimise Kulturore

- ZONAT TAMPON TE TRASHEGIMISE KULTURORE
- ### Kufizime te Pergjitheshme
- SHPATE ME PUBRESI ME TE MADHE BE 30%
  - DISTANCE NGA VIA E BATICES 100M
  - ZONAT ERODIVE
  - ZONAT E LARTA
- ### Infrastruktura
- REZERVUAR
  - REZERVUAR RAZONAL
  - STACIONE ELKTRIKE
  - NIVAKU TRAFIKUMI I UETRAVE TE NIVAKU
  - MBIETJET BASHKAKE
  - VENCORRMBULLAS ZYRTARI I PERKESHESH
  - MBIETJET
  - VENCORRMBULLAS I PRODUKUAR I PERKESHESH I MBIETJESH
  - KARRIB E PRODUKUAR

13.IV Përdorim të Përgjithshëm Shkalla 1:10.000  
të Tokës Planit

## Zonen e Qeparo me te gjere

STUDIM PROJEKTI I ZONES SE HIMARES ME PEPARESI ZHVILLIMIN E TURIZMIT

# 5 PLANI I SHERBIMIT PUBLIK

## I. VLERESIMI I DUHUR I INFRASTRUKTURES

### I | 1. FURNIZIMI ME UJE DHE KANALIZIMET

**Pershkrimi i Pergjitheshem-** Shqipëria është vend i pasur me ujera sipërfaqesore (lumenje, perrenjë), si dhe ujera nëntokësore (burime), fale kushteve gjeologjike dhe klimatike. Vlera e mesatares vjetore të rreshjeve është mbi 1500mm, qe eshte dhe vlera maksimale e vendeve Mesdhetare. Furnizimi me ujë kryhet kryesisht me puse, stacionet e pompimit dhe rrjeti shpërndaes eshterelativisht i vjetër, duke shkaktuar humbje të mëdha dhe duke rritur koston e prodhimit të tij.

Grumbullimi dhe perpunimi i ujerave te ndotura është problemi më i madh në vend, pasi shume pak qytete kanë impiante te trajtimit dhe perpunimit te tyre dhe të gjitha ujërat e ndotura me se shumti shkarkohen direkt në det. Ky problem bëhet shumë serioz sidomos në qytetet turistike. Që prej tre vitesh sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve është nën administrimin e pushtetit lokal. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit mbulon politikat e zhvillimit dhe problematikat teknike te sektorit.

**Pasurite ujore te zones-** Duke marre në konsideratë harten hidro-gjeologjike te Shqiperise, morfologjinë me ujembajtes karstik te përhapur gjerësisht dhe malet e larta me shpate te pjerreta drejt detin Jon në Jug te Zones Bregdetare te Shqiperise, me nje mesatare efektive filtrimi në masivet karstike, e cila varion nga 1000-1300mm/vit , mund të thuhet se në këtë zonë gjenden:

- (i) pasurite ujore nentokesore, jane relativisht te kufizuara, per shkak te zhvillimit te fenomenit te karstit dhe sasise se konsiderueshme te ujerave qe derdhen direkt ne dete;
- (ii) rrjedhje ujore sipërfaqesore shume te shpejta;
- (iii) ndryshim sezonal te ndjeshem te rrjedhjes dhe
- (iv) perrenj perkohesisht te thate.

Është për t'u përmendur fakti se burimet e rëndësishme të ujërave nëntokësore përmbajnë ujembajtesa zhavorresh, të cilat krijojnë mundesine e zhvillimit/ shfrytezimit te puseve te konsiderueshme edhe jashtë zonës së Bashkise se Himarës, (*Burimi: Studim Fisibiliteti i*

*Burimeve Ujore në Jug të Shqipërisë-MPP & T).* Si një e tere, ato janë gjerësisht të mjaftueshme për qëllimet e furnizimit me ujë për vendbanimet aktuale si dhe për zhvillimin e ardhshëm turistik te zones. Burimi më i rëndësishem karstik me cilësi të mire te ujit, pranë zonës së studimit jane burimet e Borshit me nje kapacitet 170 l/s. *(Burimi: Studim Fisibiliteti i Burimeve Ujore në Jug të Shqipërisë-MPP & T).*

**Situata e Furnizimit me Uje dhe Kanalizimet ne zone-** Eshte konstatuar se ne përgjithësi çdo zonë (fshat) ka burimin e vete lokal. Edhe pse të gjitha fshatrat kane rrjetin e vete te tubacioneve ekzistues, cilësia e tyre le shume per te deshiruar referuar parametrave te kërkuar teknike, duke shkaktuar humbje të mëdha teknike dhe renie të efikasitetit te shpërndarjes/furnizimit me uje.

| Tabela 38: Kapacitetet furnizuese qe kane te bejne me burimet bregdetare dhe ujerat e perdorura nga pellgjet nentokesore |                         |                       |                               |
|--|-------------------------|-----------------------|-------------------------------|
| Bashkia  | Kapaciteti uJOR Q (l/s) | Sasia ditore V (m3/s) | Kapaciteti furnizues (person) |
| Himara   | 1,144                   | 98,868                | 411,948                       |
| Burimi: Plani dhe Studimi i Zhvillimit te Integruar te Bregdetit – Raport Paraprak                                       |                         |                       |                               |

Ne vazhdim do të jepen detaje të sistemeve te furnizimit me ujë të ndërtuar ne zonat e përfshira në studim. Tabela e mëposhtme permbledh informacionin më të rëndësishem për çdo pjesë (fshat) te Bashkise Himarë. Përveç Qytetit te Himarës, në te gjithë zonen tjetër te kesaj Bashkie, ujerat e zeza grumbullohen ne gropa septike në pronën private te seciles familje, e cila në rastin më të mirë përfaqëson pellgje të nëndheshme betoni të mbuluara me kapak betoni, por në shumë raste ndeshen vetëm gropa të thjeshta me kapak por pa veshje te mureve te brendeshme te tyre. Per shkak te karakterit shkembor te shtresave nentokesore dhe mungeses se shtresave ranore dhe perzjerjeve te saj, nuk ka filtrim të pjesshem apo depertime te ngadaleshme ne thellesi. Kjo situatë është duke ndikuar në ndotjen e ujerave nentokesore, sidomos kur pusët për furnizimin me ujë janë të vendosura pranë gropave septike, duke perbere kështu nje rrezik të përherëshëm për pellgjet ujore nentokesore qe përdoren per furnizimin me uje të pijshëm të popullatës lokale.

| Tabela 39: Furnizimi me uje i fshatrave |             |      |                 |                      |                 |
|---|-------------|------|-----------------|----------------------|-----------------|
| ZONA                                    | BURIMI UJOR |      | STACION POMPIMI | RRJEDHA UJORE ( l/s) | GJENDJA AKTUALE |
|   | BURIM       | PUSE |                 |                      |                 |
| Palase                                  | 1           | jo   | jo              | 5 - 10               | e pakenaqeshme  |
| Dhermi                                  | 2           | jo   | 1               | 40 - 42              | e pakenaqeshme  |
| Ilias                                   | 1           | jo   | jo              | 1 - 2                | e pakenaqeshme  |
| Vuno                                    | 2           | jo   | 2               | 45 - 50              | e pakenaqeshme  |
| Himare                                  | 1           | 1    | 2               | 80 - 90              | e pakenaqeshme  |
| Qeparo                                  | 2           | jo   | jo              | 18 - 20              | e pakenaqeshme  |
| Porto Palermo                           | 1           | jo   | 1               | < 1                  | e pakenaqeshme  |
| Pilur                                   | 1           | jo   | jo              | 1 - 2                | e pakenaqeshme  |
| Kudhes                                  | 2           | jo   | jo              | 1 - 2                | e pakenaqeshme  |

### **Fshati Palase**

- Merr uje nga burimet e malit te Llogorase (rreth 7l/s), nepermjet nje rezervuari uxor 250 m<sup>3</sup>;
- Ka furnizim me uje 24/24;
- Ka edhe nje burim te vogel te perdorur per nje pjese tjeter te zones;
- Ne periudhen e veres ka veshtiresi ne furnizim per kete sezon, perdoret furnizimi me orare te caktuara (rotacion);
- Nuk ka rrjet kanalizimesh, por vetem gropa septike.

### **Fshati Dhermi**

- Furnizohet nga dy burime me rreth 20 l/s uje secili, njeri per zonen e sipërme nepermjet rezervuarit te ujit 250 m<sup>3</sup> dhe tjetri per pjesen e poshtme te fshatit;
- Nuk ka rrjet kanalizimesh por vetem gropa septike;
- Edhe ne zonen e plazhit ndeshet perdorimi i gropave septike.

### **Fshati Ilias**

- Rezervuari i ketij fshati furnizohet me uje nga burimet e Dherkes me rrjedhje te lire, i cili furnizon gjithashtu edhe rezervuarin e fshatit te Dhermiut;
- Kapaciteti i rezervuarit eshte 50m<sup>3</sup>;
- Rrjeti shperndares eshte ne pergjithesi i amortizuar dhe me shume lidhje individuale te pa kontrolluara;
- Ka nje cezem publike afersisht 0.5l/s nga nje burim tjeter i cili eshte konstant gjate gjithe periudhes se vitit;
- Nuk ka rrjet kanalizimesh, por vetem gropa septike.

### **Fshati Jal**

- Nuk ka rrjet te furnizimit me uje, por perdoren kryesisht pusët individuale te furnizimit me uje;
- Nua ka rrjet kanalizimesh, por vetem gropa septike.

### **Fshati Gjilek**

- Pjesa e poshtme e fshatit furnizohet nga nje burim 1.5l/s dhe nje rezervuar me kapacitet 150m<sup>3</sup>, projekt i financuar nga KE;
- Rezervuari me kapacitet 300 m<sup>3</sup> merr uje nga nje burim me rreth 3l/s, financuar nga KE;
- Nuk ka rrjet te kanalizimeve, por vetem gropa septike;
- Respektimi i kriterëve sanitare prane burimeve duhet fuqimisht te vleresohet.

### **Fshati Vuno**

- Nje rezervuar me kapacitet 50 m<sup>3</sup> merr uje nga rezervuari 150 m<sup>3</sup> gjate periudhes se veres, si dhe nga perroi i Iliasit me tubacion metalik DN=200mm, kryesisht per zonen e plazhit.
- Rezervuari 50m<sup>3</sup> dhe stacioni i pompimit qe merr uje nga burimi Varakalas me 50l/s (2 pompa me 4l/s, 1 rezerve), furnizojne rezervuarin me kapacitet 150m<sup>3</sup>;
- Ne zonen e sipërme mbi rruge ka rrjete shperndarese;
- Nuk ka nje furnizim te rregullt dhe rrjeti shperndares ne disa vende eshte ne kushte teknike (pa puseta shperndarjeje dhe linja tubacionesh plastike ajrore te furnizimit);
- Nuk ka rrjet kanalizimesh, por vetem gropa septike.



### Qyteti i Himares

Furnizohet nepermjet dy stacioneve të veçanta ekzistuese të pompimit. Stacioni kryesor në Potam me kapacitet rreth 80 l/s (2 \* 40 l/s), ku janë tri pompa dy në funksionim (1 rezerve). Linja e transmetimit dërgon ujë në dy depozita, me kapacitet 1000 m<sup>3</sup> dhe e dyta me kapacitet 200 m<sup>3</sup>. Ne uje ndihet prezenca e kriprave per shkak te afersise me detin, fenomen i ndjeshem sidomos gjate periudhes se veres. Uji nepermjet rrjetit shperndares zbret nga depot ne puseten shperndarese prane rruges kombetare, ku janë tre saracineska te cilat manovrohen per te furnizuar sa me uniformisht qytetin. Rrjeti i ujësjellësit është kryesisht tub PE me 12,5 atm. Ekziston projekti per shtimin e nje depozite te re (1000m<sup>3</sup>) e cila gjithashtu do te marre uje nga pusi i Potamit (do te shtohet edhe nje pompe ne gjendje pune ne kete pus). Kjo pritet te permiresoje furnizimin me uje per qytetin.

Në këtë stacion pompimi nuk evidenton asnje respektim hidro sanitar sidomos persa i perket ekzistences se gropave septike dhe aktivitetit njerezor ne afersi te saj. Ky objekt eshte shume prane ndertimeve te reja dhe atyre ekzistuese te cilat vazhdojne te jene pa kolektor te ujerave te ndotur. Ky është një problem për t'u konsideruar, pasi ai është sot dhe ne te ardhmen e afert burimi kryesor i furnizimit me ujë për qytetin. Stacioni i dyte i pompimit është në Livadh (me kapacitet 16 l/s, 2 \* 8 l/s), i cili së bashku me stacionin e vjetër të pompimit te Himarës fshat, furnizojne rezervuarin me kapacitet 200m<sup>3</sup>. Te dy stacionet e pompimit kanë probleme në respektimin e kriterëve sanitarë, bazuar dhe në ligjin shqiptar për mbrojtjen sanitarë te burimeve ujore. Rrjeti shperndares i ujësjellësit nuk mbulon të gjithë qytetin dhe vetëm 1/3 e familjeve kanë matësa uji te instaluar. Aktualisht, Himara furnizohet vetem 6/24 orë me ujë, të ndarë 3 orë në mëngjes dhe 3 orë në mbrëmje. Sic e thame dhe me larte për të permiresuar furnizimin dhe lehtesuar menaxhimin e ujit dhe të shpërndarjes, do te shtohet një pompë e re në stacionin ekzistues te Potamit, qe do te shoqerohet me ndertimin e nje depozite te re me kapacitet 1000 m<sup>3</sup> ne afersi te lagjes Stefanel. *Me pak fjale mund te thuhet se furnizimi me ujë i qytetit te Himarës është në të vërtetë i pakënaqshem në lidhje me sasinë dhe cilësinë e tij.*



**Figura 55:** Shperndarje teknikisht jo e rregullt e ujit (tuba ajrore)



**Figure 56:** Derdhja e Ujerave te ndotura ne Detin Jon

**Rrjeti i kanalizimeve** Edhe ky rrjet i sherben nje pjese te tij duke mbuluar me pak se gjysmen e qytetit me nje rrjet i cili pervec kolektorit kryesor eshte mjaft i vjeter (viti 1978, DN = 300mm), pjesa tjeter eshte pa rrjet kanalizimesh, ku zgjidhja e largimit te ujerave te ndotura eshte bere ne menyre individuale bazuar ne gropat septike te cilave ne pjesen me te madhe te rasteve nuk ju behet asnje sherbim. Pjesa perendimore e qytetit

perdor rrjetin ekzistues te kanalizimeve e cila nepermjet stacionit te pompimit pas Bashkise i derdh keto ujera ne det.

Stacioni i pompimit te ujerave te zeza perbehet nga dy pompa me kapacitet 20 m<sup>3</sup>/ore. Sic thame ky stacion i derdh keto ujera ndermjet Livadhit dhe Spilese direkt e ne det shih fig.57. Rrjeti i kanalizimeve eshte me kapacitet dhe parametra te pa mjaftueshem, shume larg parametrave te kerkuara nga legjislacioni i BE. Gjate periudhes se sezonit veror eshte evidentuar dhe prania e ererave te pakendeshme, te cilat fatmiresisht zbehen ndjeshem me perfundimin e sezonit veror. Eshte pregatitur nje studim per nje rrjet te ri te kanalizimeve, i cili do te grumbulloje dhe pompoje te gjitha ujerat e ndotura per ne stacionin ekzistues te pompimit te ujerave te zeza te pjeses se mbetur pa rrjet kanalizimesh te qytetit, i planifikuar te ndertohet poshte lagjes, prane rruges nacionale. Ky Stacion do te hedhe keto ujera ne rrjetin ekzistues te kanalizimeve, per ne stacionin ekzistues i cili do ti pompoje ato per ne Impiantin e ri te Trajtimit te ujerave qe mendohet te ndertohet ne vendin ku derdhen sot keto ujera, pra ndermjet Livadhit dhe Spilese. Në akset e reja të rrjetit rrugor, ujerat e zeza dhe ato te bardha bashkohen me ato te shiut dhe nuk mblidhen ne rrjet te vecante, pra në akset e reja rrugore te qytetit kemi kolektor të përzier për ujerat e ndotura dhe ato te shiut.

| Tabela 40: Te dhena administrative te furnizimit me uje |                       |               |               |                |                |
|---|-----------------------|---------------|---------------|----------------|----------------|
| Fshatrat  | Familje qe furnizohen | Me matesa uji | Pa matesa uji | Familje pa uje | Pagesat ne %   |
| Himara  | 1200                  | 524           | 676           | 250            | 65             |
| Vuno  | 260                   | 79            | 181           |                | 27             |
| Illias  | 46                    |               | 46            |                | 32             |
| Dhermi  | 360                   |               | 360           |                | 30             |
| Gjilek  | 385                   | 211           | 174           |                | 20             |
| Palase  | 279                   |               | 279           |                | 20             |
| Qeparo  | 330                   |               | 330           | 50             | 50             |
| Livadh  |                       |               |               | 35             |                |
| Jale  |                       |               |               | 25             |                |
| <b>TOTAL</b>  | 2860                  | 814           | 2046          | 360            | Mesatarisht 35 |

(Burimi: Bashkia)

**Fshati Qeparo-** Ky fshat i bukur ka dy pjesë, Qeparo (i sipërm) fshat dhe Qeparoin e poshtem (zonën e plazhit). Qeparo fshat merr ujë nga 2 burime rreth 1 km largesi ajrore në distancë nga fshati me  $q < 1$  l/s për çdo burim. Furnizimi behet me rrjedhje te lire ne depozitat e fshatit me 200m<sup>3</sup> dhe 30m<sup>3</sup>, furnizimi me ujë është cilësisht i kenaqshem, por me sasi te pamjaftueshme. Fshati vuan veshtiresine e furnizimit me uje sidomos gjate periudhes se veres. Ne kete periudhe fshati zakonisht furnizohet me rreth vetem 3 ore ne dite Rrjeti shpernadares ekziston, por eshte shume i amortizuar. Qeparo plazh furnizohet me uje nga fshati Borsh rreth 4.5km me rreth 10 l/s me rrjedhje te lire. *Furnizimi eshte cilesisht i mire, por le per te deshiruar ne aspektin sasior sidomos gjate periudhes se veres.* Nuk ka rrjete te kanalizimeve dhe impiant trajtimi per fshatrat. Cdo familje e ka zgjidhur largimin e ujerave te ndotura ne menyre individuale kryesisht nepermjet gropave septike, fig 58.

**Porto Palermo-** Kjo zonë është përdorur në të kaluarën, si zonë ushtarake dhe në të vërtetë nuk ka popullësi që banon dhe jeton. Kjo zonë merr ujë nga rezervuari kryesor i Potamit në qytetin e Himarës,  $q < 1$  l/s, e cila furnizon me ujë një rezervuar të vogël të amortizuar  $c=50\text{m}^3$ , në afërsi të njësisë së vjetër të ushtrisë. Nuk ekziston as rrjet dhe as impiant trajtimi i ujerave të ndotura.

**Fshati Pilur-** Fshati ka aktualisht rreth 300 persona dhe në kohën e verës arrijn deri në rreth 1 000 banorë. Furnizimi me ujë bëhet nga një burim me cilësi të mirë me prurje  $q=2$  l/s, ( $0,2$  l/s në sezonin e verës), rreth 5km larg nga fshati. Rezervuari i ujit është  $200\text{m}^3$  dhe furnizon me ujë nëpërmjet rrjetit shpërndarës të amortizuar të ujit (viti 1976). Ka edhe cezem publike. Rrjeti i kanalizimeve është i bazuar në gropa septike individuale.

**Fshati Kudhes-** Ka një popullësi prej rreth 1500 banorë në sezonin veror. Aktualisht furnizohet nga burime me rreth 2 l/s dhe nëpërmjet katër deponitave të vogla dhe të një rrjeti të vjetër të shpërndarjes. Është në përdorim edhe furnizimi publik i ujit në fshat.



**Figura 57:** Gropa septike familjare



**Figura 58:** Humbje teknike të ujit

## Konkluzione

| Permbledhje e problematikave  |
|---|
| - Mungesa e pajisjeve te nevojshme dhe kualifikimit te stafit   |
| - Furnizimi me uje pergjithesisht sipas ndarjes administrative dhe mos konsiderime si nje problem qe duhet te marre zgjidhjen me te mire nga kendveshtrimi rajonal;                           |
| - Ndihet mungesa e aftesive akumuluese te depozitave dhe rrjeteve shperndarese per te mbuluar te gjithe zonen dhe popullesine qe jeton ne te;   |
| - Ekzistenca e zgjidhjeve te furnizimit me uje ne menyre individuale familjare/biznes nepermjet lidhjeve direkte ne burim/rrjet duke ulur eficiencen e perdorimit te ujit si pasuri natyrore; |
| - Vendndodhjet dhe kapacitetet e pamjaftueshme te rezervuareve ka veshtiresuar administrimin dhe menaxhimin e mire te shperndarjes se ujit;   |
| - Mos respektimi i zones te mbrojtjes sanitare rreth burimeve ujore (burime/puse, rezervuar, etj.);   |
| - Perzierja e ujerave te ndotur urban me ato te shiut;  |
| - Humbjet e medha teknike, qe ulin ndjeshem parametrat e eficences se sistemit, Fig. 83;  |
| - Perdorimi intensiv i ujit te pijshem per ujitjen e oborreve private apo lavazheve duke ndikuar ndjeshem ne sasisne e ujit te perdorshem per pirje, sidomos gjate periudhes se veres.        |

| Nderhyrje emergjente qe duhen ndermarre  |
|--|
| - Nje plan rajonal per te zgjidhur kerkesen ne rritje per ujin e pijshem dhe grumbullimin dhe perpunimin e ujerave te ndotur ne menyre qe te mbulohe nevojat e zhvillimeve prespektive te zones;       |
| - Rritjen dhe permiresimin e kapaciteteve dhe pajisjeve ne Departamentin e Sherbimit Publik ne Bashkine e Himares;   |
| - Reduktimin e humbjeve teknike nepermjet evidentimit ne kohe te rrjedhjeve'   |
| - Shtrirjen dhe kompletimin e rrjetit shperndares per te mbulluar te gjitha zonat e banuara;   |
| - Respektimin e brezit te mbrojtjes sanitare per te parandaluar ndotjen e burimeve ujore, puseve etj.  |
| - Kontrollin dhe mire administrimin e ujit nepermjet instalimit te plote te matesave dhe zbatimin e tarifave;  |
| - Burimet ujore qe rezultojne me probleme te cilesise se tyre duhet te mos perdoren ne mundesine e pare te mundeshme, sic mund te jene burimet e Potamit ne Himare (sidomos gjate periudhes se veres); |
| - Ndalimin e perdorimit te ujit te pijshem per qellime te tjera si ujitje, larje makinash, etj;  |
| - Instalimin e matesave te ujit ne te gjithe territorin bashkiak;  |
| - Vleresimi dhe rehabilitimi i burimeve dhe rrjetit ekzistues ujites nepermjet shoqatave te perdoresve te ujit per ujitje;   |
| - Izolimin, mirembajtjen dhe pastrimin e rregullt te gropave septike ekzistuese;   |
| - Perdorimin e njesive te vogla te trajtimit te ujit si nje nderhyrje emergjente ne situaten aktuale;  |
| - Vlersimin ekonomik dhe teknik te ndarjes se ujerave te ndotur nga ato te shiut ne projektet e infrastruktures, qe do te zbatohen ne te ardhmen ne kete zone.   |


## I | 2. FURNIZIMI ME ENERGJI DHE ALB - TELEKOMI

**Furnizimi me energji-** Furnizimi me energji është përgjegjësi e CEZ (kompani private), në vartesi të zyrës rajonale CEZ Fier. Sistemi i shpërndarjes është relativisht i vjetër. Furnizimi me energji nuk është i rregullt, por ajo që lehtësisht konstatohet është tensioni i ulët i fenomenit të energjisë, që konstatohet kryesisht në zonat rurale të Bashkisë, sidomos gjatë periudhës së verës. Gjatë bisedës me përfaqësuesit lokal u mesua se ka disa ndërhyrje të planifikuara të cilat synojnë përmirësimin e situatës. Në javët e ardhshme është planifikuar ndryshimi vetëm i linjës së transmetimit ajror, e cila do të përfundojë në dy muajt në vazhdim përpara sezonit turistik. U mesua gjithashtu se është planifikuar që të ketë ndryshime edhe në linjën kryesore të transmetimit. Detaje të metejshme janë premtuar, por akoma nuk kemi marrë ende ndonjë material nga (CEZ) Fier.


**Alb-Telekomi-** Sot Himara ka central telefonik me 1000 numra/abonent dhe një rrjet kabllor me kapacitet prej 1200 numrash, ku janë përdorur vetëm 660 të tilla. Rrjeti telefonik është kabllor, kryesisht në linja tokësore bakri dhe pjesërisht me ato ajrore. Alb Telekom ka hartuar projekte me qëllim futjen e shërbimeve të reja përveç thjeshtë ekzistencës së telefonit, të tilla si interneti i shpejtë dhe televizionit kabllor. Për këtë qëllim është e nevojshme për të ndryshuar teknologjinë ekzistuese të rrjeteve, me qëllim zgjerimin dhe shtrirjen e fibrit optik.

| <b>Tabela 41: Tregon numrin e klienteve të Bashkisë Himare</b> |                           |
|--|---------------------------|
| <b>Fshatrat</b>  | <b>Numeri i Klienteve</b> |
| Palase   | 190                       |
| Dhermi   | 436                       |
| Qeparo   | 453                       |
| Gjilek   | 398                       |
| Ilias  | 58                        |
| Jal  | 41                        |
| Vuno   | 253                       |
| Livadh   | 73                        |
| Himare   | 2,400                     |
| Pilur  | 85                        |
| Kudhes   | 174                       |
| <b>TOTALI</b>  | <b>4,561</b>              |

Qëllimi është që të zvogëlojë gjatësinë mesatare të linjave. Do të ndërtohen 3 Qendra (MSAN), respektivisht, në Himare Fshat, Potam dhe Spile. Kapaciteti i synuar është rreth 3000 linja. Ky shërbim do të shtrihet gjithashtu në Dhermi, Vuno, Qeparo, etj., duke ndërtuar dhe këtu impiante të tilla. Për këtë është e rëndësishme, ndërtimi i fibrit optikë përgjatë rrugës Qeparo – Palase. Shih hartën e punimeve civile dhe instalimeve që së bashku do të përbejnë Projektin e linjës telefonike të Bashkisë Himare (Figura 59).



**Figura 59:** Punime civile dhe instalime qe se bashku do te perbejne Projektin e linjes telefonike te Bashkise Himare



## II. STRUKTURA E PROPOZUAR E SHERBIMEVE PUBLIKE

### II | 1. UDHEZIMET PER PROJEKTIMIN E RRJETIT TE INFRASTRUKTURES

Shumica e sistemeve te infrastruktures (ujë, energji elektrike, kanalizime dhe telekomunikacioni), do te vendosen nen siperfaqen e tokes dhe do te jene te sistemuara ne nje korridor qendror infrastrukture pergjate zones urbane dhe ne drejtim te rrugeve. Edhe pse sistemet do te jene te vendosur ne korridorin qendror te infrastruktures, çdo sistem do te qendroje me vete brenda korridorit dhe nuk do te pengohet apo te nderpritet nga nje sistem tjetër - si psh. kullimi dhe kanalizimet te rrjedhin se bashku, siç mund te jete rasti ne disa fshatra sot. Kjo do te siguroje funksionim te mire dhe efikas te sistemit dhe do te lehtësoje mirembajtjen dhe punimet riparuese.

Zgjerime ne lagjet e qytetit do te behen me degezime perpendikulare ne drejtim te lagjeve. Lidhjet me rrjetin duhet te behen ne korridoret sekondare me te afert te linjes kryesore qendrore. Monitorimi i rregullt i cilesise se ujit te pijshem, te parametrave kimike dhe mikrobiologjike duhet te behet ne vazhdimesi ne stacionet e pompimit si dhe ne pikat fundore te çdo degezimi sekondar.




Figura 60: Prerje terthore e infrastruktures ne rrugët kembesore

Relievi i Himares eshte faktor percaktues per **sistemin e kullimit** te qytetit. Ne zonat e vendosura ne shpate kodre, kryesisht te ndodhura ne zonen lindore te qytetit,



graviteti dhe forma natyrore e shpatit do të përdoret për kullimin dhe furnizimin me ujë. Në zonat fushore të qytetit dhe në veçanti në zonat të identifikuar me rrezik përmbajtje, infrastruktura kulluese duhet të vendoset në thellësi, në sipërfaqe për të parandaluar çdo përmbajtje të zonave të ulta.

Bashkia e Himarës i jep prioritet përmirësimit të **sistemit të ujerave të ndotura** pasi prej kohësh por edhe aktualisht popullsia vendore, si dhe turizmi ndjejnë ndikimet e pakëndshme të ujerave të zeza në situatën ekzistuese. Me studimin e Himarës, Bashkia do të mund të realizojë rehabilitimin e sistemit të kanalizimeve ekzistuese si dhe zgjerimin e rrjetit në mënyrë që të lidhë të gjitha zonat e banuara me rrjetin kryesor të kanalizimeve. Trajtimi i sotëm mekanik i ujerave të ndotura duhet të mbyllet/përmirësohet dhe trajtimi i kombinuar mekanik-biologjik duhet të ndërtohet.

**Sistemi i Kanalizimeve** do të ndjehet aksin qendror të infrastruktures. Kanalizimet do të orientohen jashtë qytetit për në impiantin e trajtimit në perëndim të qytetit. Për ndërtimet e reja, ata do të lidhen në zgjerimet e rrjetit grumbullues sekondar dhe terciar, ndërsa gropat ekzistuese septike duhet të monitorohen / rehabilitohen / mbyllet në mënyrë që të shmangët ndotja e tokës dhe ujerave nëntokësore. Mëqenëse kjo do të kërkojë investime të mëdha, është propozuar një zbatim gradual i sistemit të monitorimit të përqendruar në çështje të rëndësishme institucionale dhe parametrike të cilësive (p.sh. marrja e mostrave në rrjet në vendin dhe kohën e duhur për CSB, E.coli, etj.). Në këtë mënyrë mund të arrihet me zbutjen e situatës së tanishme.

**Energjia elektrike dhe telekomunikacioni** kabllot duhet të vendosen në një kanal në njërin anë të rrugës në mënyrë të rregullt. Tubat ujore (të kullimit, kanalizimeve dhe të furnizimit me ujë), duhet të kalojnë në anën e kundërt. Tuba e furnizimit me ujë duhet të vendosen pranë sipërfaqes (për të parandaluar kontaminimin e mundshëm nga ujërat e ndotur urbane dhe ato të kanalizimeve), tubat për ujërat e ndotura urbane/industriale në mes dhe kanalizimi më poshtë.

Zgjidhja më e mirë për **infrastrukturen ujore** duhet të bazohet në studime më të detajuara teknike makro-ekonomike afat gjatë të burimeve të ujit, duke marrë parasysh të gjitha burimet sipërfaqësore dhe të ujerave nëntokësore si nga pikepamja sasimore ashtu dhe nga ajo cilësore. Kjo punë tashmë ka filluar me Studimin e Fizibilitetit mbi Burimet Ujore në jug të Shqipërisë (DFAA-MPP & T), të cilat mbulojnë të gjithë zonën në jug, nga qyteti i Vlores në Sarandë. Mëqenëse investimet afatgjata duan kohë dhe vlera të konsiderueshme financiare, është e rëndësishme që investimet infrastrukturore aktuale afatshkurter dhe afatmesme të fokusohen në zgjerimin e rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë për të mbuluar sa më shumë të jete e mundur zonat e populluara.

## II | 2. FURNIZIMI ME UJE DHE KANALIZIMET

### 1.1. Furnizimi me Uje

#### Vleresimet e kushteve hidro- gjeologjike dhe hidrologjike

Vleresimi i rrjetit hidrografik dhe burimeve nentokesore te ujit ne zone, i kapaciteteve te tyre dhe mundesite per projekte ne perspektive te zhvillimit te infrastruktures ujore, jane bazuar ne studimet ekzistuese si dhe ne disa studime te ndermarra rishtazi ne zone. *PAP/RAC - SOGREAH: Plan-Studim i Zhvillimit te Integruar te Bregdetit - Raporti Paraprak dhe Studim i Fizibilitetit "Mbi Burimet Ujore ne jug te Shqiperise, Draft Analiza, Alternativat (DFAA-MPP & T)*

**Situata hidrologjike:** Zona e studimit pershkohet nga nje numer rrjedhash ujore, ku me e rendesishme eshte **rrjedha/perroi i Kudhesit**. Perroi i Kudhesit furnizohet nga burimet i tij ne malet ne lindje te bregdetit dhe derdhet ne det. Kjo rrjedhe (si te gjitha rrjedhat e tjera me te vogla), kryesisht ka uje gjate dimrit dhe ne raste te veçanta te reshjeve te rrembyera edhe gjate veres..

**Rezervat e ujerave nentokesore:** Kushtet hidro-gjeologjike varen nga struktura gjeologjike dhe morfologjike e zones bregdetare. Ekzistojne burime natyrore te shumta ujore me sasi uji te kufizuar pothuajse ne te gjitha zonen e studimit. Ujerat jane te nje cilesie shume te mire. Keto burime kane nje origjine karstike dhe dalin ne nivele te ndryshme hipsometrike (burimet ne fshatin Dhermi, Potam, burimet ne fshatin Qeparo, etj).

*Bazuar nga sa pame me siper, mund te thuhet se burimet ujore ne zonen e studimit (Bashkia Himare) nuk jane te mjaftueshme per te permbushur kerkesat per uje, qe rrjedhin nga nje konsumim ne rritje te tij ne te ardhmen, duke pasur parasysh kerkesat ne rritje nga zhvillimi i turizmit.*

Konsulenti mendon se sherbimet definitive te furnizimit me uje ne zonen e projektit duhet te zgjidhet ne nje fokus me te gjere hapesinore, ekonomik dhe teknik dhe jo duke u perqendruar ne çdo njesi ne veçanti. Zgjidhjet e veçanta dhe lokale duhet te mbesheten dhe zbatohen, duke ju referuar zgjidhjes definitive te te gjitha territorit te Bashkise Himare, ose edhe me gjere, gjithmone nepermjet studimeve te thella dhe te detajuara te burimeve ujore, jo vetem ne zonen e Bashkise Himare por edhe ne baze rajonale. Ky koncept do te çojte ne perdorimin me te mire te mundshme te pasurive ujore per zhvillimin e duhur perspektiv te ketij territori.

Aktualisht ka disa studime per furnizimin me uje te zones, te zbatuara apo ne stad projektimi te cilat pothuajse mbulojne nje pjese te mire te territorit te Bashkise se Himares. Ekzistenca e sistemeve te veçanta te furnizimit me uje te cilat mbulojne terriore te kufizuara do te komplikojte edhe me shume administrimin dhe menaxhimin e ujit nga Departamenti i Sherbimeve Publike, me staf dhe pajisje modeste.

Uje i nxjerre nga pusët e ceketa shteterore dhe private te hapura jane shpesh te ndotur per shkak edhe te efekteve infiltruese te ujerave te zeza, duke bere qe direktivat perkatese te BE 80/778/EEC dhe 98/83/EEC te mos jene plotesuar deri me tani. Kjo situatë rrezikon drejtperdrejte dhe ne vazhdimesi shendetin e njeriut, prandaj kerkon t'i jepet prioritet i larte kapercimit te ketij problemi.

## Mundesite e furnizimit me uje

**Furnizimi me uje nga burimet:** Llogaritjet per popullsine ekuivalente qe do te perdorin burimet ujore bregdetare eshte bere mbi bazen e nje konsumi specifik per fryme prej 240 l / p / d, siç percaktohet me Dekretin Nr 102 te Qeverise Shqiptare te vitit 1992. Kjo vlere standarde perfshin 150 l / p / d konsum familjar, 40 l / p / d, konsum specifik institucional dhe 50 l / p / d per humbjet (25% i totalit). Eshte e mjaftueshme te thuhet se burimet ujore bregdetare dhe ato potenciale nentokesore llogariten ne 144.228 m<sup>3</sup> /dite e cila do te kenaqe 600.000 banore bazuar ne nivelet e mesiperme te konsumit. Burimet ujore karstike te shfrytezueshme ne zonen e projektit dhe ne afersi te rajonit jane si ne vijim:

- a) Burimi i Buronjes – 300 l/s;
- b) Burimi i Borshit – 170 l/s;

**Burimi i Buronjes:** Nje projekt ekzistues i furnizimit me uje (faza paraprake), e filluar nga autoritetet kombetare parashikon nje sistem te perbashket te furnizimit me uje per qytetin e Himares dhe fshatrat perreth Qeparo, Pilur, Kudhes, si dhe disa banesa ne gjirin e Porto Palermo. Projekti perfshin ndertimin e nje rezervuari te ri (V = 5000 m<sup>3</sup>) ne Himare dhe perdorimin e burimit te Buronjes (kapaciteti minimal 300 l / s) ne brendesi te Qeparoit. Kapaciteti minimal i burimit te Buronjes prej 300 l / s eshte me se i mjaftueshem per te mbuluar kerkesen per uje te fshatrave ne fjale nga ky projekt.

Projekti synon ndertimin e nje linje kryesore tubacioni nga burimi i Buronjes ne Porto Palermo. Gjithashtu do te ndertohen degezime linjash per ne Pilur dhe Kudhes. Nga Porto Palermo linja kryesore vazhdon pergjate bregut deri ne Himare. Per shperndarjen e ujit jane parashikuar dy stacione pompimi. Per akumulimin e ujit dhe rregullimin e presionit jane menduar kater rezervuare, nje ne Pilur, nje ne Kudhes, i treti dhe i katerti ne Himare. Projekti synon shtrirjen e linjes kryesore te ujit ne Veri me qellim te lidhjes se fshatrave Vuno dhe Ilias me rrjetin kryesor.

Nga pikepamja e sigurise se furnizimit ky projekt (ne te dy variantet) do te realizoje nje permiresim te dukshem te furnizimit me uje per komunitetin, pasi kapaciteti i burimit te Buronjes se bashku me burimet e tjera ujore jane te mjaftueshme per te mbuluar kerkesen per uje per te gjithë fshatrat e bregut. Bazuar ne nevojen ekuivalente per uje prej 190 l / cd dhe kapacitetin minimal prej 300 l / s te burimit te Buronjes, teorikisht nje numer prej 136.000 personash mund te furnizohen me uje te pijshem.

Megjithate, nga nje kendveshtrim afatgjate, burimi i Buronjes mbetet nje opsion realist per furnizimin me uje te vendbanimeve bregdetare. Prandaj ai mund te perfshihet ne potencialin e burimeve ujore bregdetare.

**Burimi i Borshit** perdoret per furnizimin me uje te fshatrave Borsh dhe Qeparo i ri me rrjedhje te lire. Nje pjese e ujit te nxjerre nga burimi kalon ne rrjetin shperndare dhe nje pjese kalon ne rezervuar. Sasia dhe cilesia e ketij burimi eshte mundesi e mire per zgjidhjen perfundimtare te furnizimit me uje ne zone, duke shfrytezuar vecanerisht rrjedhjen e lire me gravitet te tij.

**Furnizimi nga pusët e shpimit:** Disa burime të rëndësishme të ujerave nentokesore mund të propozohet për tu marrë në konsideratë në tri fusha të reja të ndodhura pranë disa luginave lumore karstike afër zonës së projektit.

- a) Pellgu ujembajtes i Himares – 200 l/s;
  - b) Pellgu ujembajtes i Qeparos – 200 l/s;
  - c) Pellgu ujembajtes i Borshit – 150 l/s
- a) **Pellgu ujembajtes i Himares**, pozicionohet nga lindje në pjesën në qendër të Himares dhe rreth 1.5 km larg nga bregdeti i Detit Jon. Kjo duhet të jetë së paku topografikisht zona më e mirë për shfrytëzimin e ujërave sipërfaqësore dhe nentokesore. Mendohet se me gjashtë puse mund të pompohen rreth 200 l/s.
- b) **Pellgu ujembajtes i Qeparo**, ndodhet në luginën e lumit Qeparo, që rrjedh në drejtimin veri-jug. Këtu mund të shpohet gjashtë puse përgjatë luginës me një kapacitet total rreth 200 l/s. Për çdo propozim në pellgun ujembajtes duhet të paktën të shpohet dy puse në shkëmbinj karstike për të provuar kapacitetet përkatëse.

**Furnizimi i Kombinu**: Ky opsion i referohet propozimit të konsideruar më të pershtatshëm në studimin Studimin e para-fizibilitetit mbi “Burimet Ujore në Jug të Shqipërisë (DFAA-MPP & T), i cili sugjeron përdorimin e:

- Pellgut ujembajtes të Vrionit;
- Burimet e Bakajvës;
- Burimet e Sasaj;
- Burimet e Borshit;
- Burimet e Tatzatit, pjesërisht.

Është llogaritur se vetëm burimet e Saajt dhe të Borshit (me rrjedhje të lirë) me kapacitetet e tyre mund të përballojnë furnizimin me ujë për të paktën 6-8 muaj të vitit dhe përdorimin e burimeve të tjera (një pjesë me stacione pompimi) gjatë periudhës së pak të vitit.

Këto janë disa mundësi por zgjidhja më e mirë e mundshme e furnizimit me ujë duhet të bazohet në studime më të detajuara teknike makro-ekonomike afatgjate të burimeve ujore. Kjo punë ka filluar me Studimin e para-fizibilitetit mbi “Burimet Ujore në Jug të Shqipërisë (DFAA-MPP & T), e cila trajton të gjithë zonën jug-perëndimore nga qyteti i Vlores deri në Sarandë. Meqenëse zona e projektit Bashkia Himare është pjesë e bregdetit jugor shqiptar, të gjithë nderhyrjet aktuale në infrastrukturën e furnizimit me ujë duhet të marrin në konsideratë nderhyrjet e planifikuara në shërbimin e furnizimit me ujë të studimit të mesiperm. Duke qenë se investimet afatgjate kërkojnë kohë dhe sasi të konsiderueshme financiare, është e rëndësishme që investimet afatshkurter dhe afatmesem të fokusohen në zgjerimin e rrjetit shpërndarës ekzistues të ujit për mbuluar sa më shumë që të jetë e mundur territoret e populluara.

Meqenëse siç e thamë kjo do të arrihet nëpërmjet investimesh të konsiderueshme, aktualisht duhet propozuar një zbatim gradual i sistemit të monitorimit, duke u përqendruar në çështje të rëndësishme institucionale dhe atyre të parametrave të

cilesise se ujit (p.sh. percaktimit te vendeve dhe kohes per marrjen mostrave te ujit, CSB, E.coli). Ne kete menyre mund te zbutet pakenaqesia per cilesine e sherbimit te furnizimit me uje.

Siç është shpjeguar më lart, ka disa burime të ujit në zonën e burimeve natyrore me ujë të ujëmbajtësve të ndryshme. Të gjithë ata kanë sasi të tyre (të qëndrueshme ose të ndryshueshme gjatë vitit), të cilësisë dhe te vendndodhjes. Duke marrë parasysh dhe kombinim e secilës prej tyre me rezultat në skenarë të ndryshëm për përmirësimin e zgjidhjes se shkurtër / afat gjatë për këtë çështje të rëndësishme, veçanërisht në zonën e Bashkisë se Himarës me vlera të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit. Detyra kryesore e pushtetit lokal në infrastrukturën e ujit është që të fokusohet në:

- (a) përmirësimin e situatave ekzistuese (afat të shkurtër);
- (b) përgatitja e zgjidhjes perfundimtare lokale apo rajonale (afatgjatë);

Natyrisht menyra e sipermendur do të varej nga mbështetja financiare dhe institucionale si dhe bashkëpunimi ne nivel qendror dhe lokal. Krahas perspektivës e furnizimit me ujë, Bashkia duhet të jetë e përqendruar në përmirësimin e gjendjes ekzistuese e menjëherëshme, përmes:

- (i) kontrollit e furnizimit me cilësinë e ujit (p.sh. përcaktimin e vendndodhjes dhe kohës për marrjen e mostrave të ujit, CSB, E. coli).
- (ii) zgjerimin e furnizimit me ujë dhe rrjetin ekzisues i kanalizimeve për të mbuluar shtëpitë e reja
- (iii)eliminimin e te gjitha rrjedhjeve te ujit;
- (iv)instalimi i matesave te ujit ( ujematesve):
- (v) permiresimi i shperndarjes se ujit: dhe
- (vi) rritja e masave te menjëherëshme per mbledhjen e taksës së ujit, për shërbimet e ujit, duke u përqendruar në çështjet e rëndësishme institucionale dhe parametrat e cilësisë së ujit.

Për të qenë te fokusuar në zgjidhjen e perspektivës ka dy menyra, siç është thënë më lart. Zgjidhja lokale që merr ujë nga burimi i Bulonjes (300 l/s) do të furnizojë me ujë për katër njësi si Kudhes fshat, Pilur, Porto Palermo dhe qytetin e Himarës. Si pjesë e këtij rrjeti do të jenë dy stacione pompimi dhe katër rezervuare të ujit, një në Pilur, nje ne Kudhes dhe dy në zonën e Bashkise se Himarës. Tre prej tyre do të jenë të reja dhe një është rezrvuari i ujit ekzisues i permiresuar në Potam (5 000m3).Rezervuari tjetër i ujit i Himarës do të jetë afër lagjes se Stefaneli (1 000m3).

**Zgjidhja rajonale** e cila do të fillojë nga stacioni i pompimit të ujit të Vrionit (250l / s), do të mbledhë burimet kryesore pergjate rrugës, në zonën e Himarës, si Bakaj (500l / s), Sasaj (200l / s), Borshit (170l / s) dhe burime te pjesës se Tatzati (deri në 1 000L / s). Nga llogaritja rezulton, qe burimet e Sasaj dhe Borshit mund të furnizojne me ujë në zonë nga graviteti për rreth 6-8 muaj dhe vetëm për pjesën e mbetur te vitit furnizimi me ujë do te jete i nevojshem nga stacioni i pompimit te Vrionit dhe burimet e ujit ne Bakaj.

Secila prej zgjidhjeve ka avantazhet dhe disavantazhet përkatëse, kështu që vetëm një ekip profesional, duke analizuar çdo opsion, jo vetëm gjate fazës se zbatimit, por edhe

gjate kostimit, e fazes se funksionimit dhe menaxhimit te ketyre sherbimeve, mund të vendosë për mundesine e zbatimit te ketij projekti.

Zgjidhjet e rrjeteve përkatëse janë treguar në hartën e infrastrukturës së re të Bashkise së Himarës.

## 1.2 Problematikat e kanalizimeve

Nga vezhgimet e viteve te fundit ekziston nje tendence e perkeqesimit te cilesise se ujit. Per sa i perket turizmit lokal veror numri i popullsise ne muajt Qershor, Korrik dhe Gusht rritet me rreth 150% pjesa me e madhe ne qytetin e Himares. Ne menyre qe te perballohet kjo prirje dhe per te shmangur ndotjen e mjedisit uJOR ne te ardhmen eshte e nevojshme nje infrastrukture funksionale per grumbullimin dhe trajtimin e ujerave te zeza dhe atyre te perdorura. Kjo perfshin rehabilitimin e objekteve ekzistuese si dhe ndertimin e atyre te reja per zgjerimin e rrjeteve te grumbullimit te ujerave te zeza dhe per sigurimin e kapaciteteve te mjaftueshme per trajtimin dhe perpunimin e tyre.

Bashkia e Himares i jep prioritet te larte permiresimit te sistemit te ujerave te zeza pasi si popullsia rezidente edhe ajo turistike vuan nga ndikimi i pakendshem i situates me ujerat e zeza. Me projektin e Himares, Bashkia po perpiqet per rehabilitimin e sistemit ekzistues te kanalizimeve si dhe per zgjerimin e rrjetit ne menyre qe te perfshije te gjitha zonat e banuara ne rrjetin e kanalizimit. Sipas mendimit me te mire teknik vend-grumbullimi i ujerave te ndotura aktual duhet te mbyllet dhe nje impiant i ri perpunimi mekanik-biologjik duhet ndertuar. Banesat e reja duhet te lidhen ne zgjatimet e rrjetit ekzistues fundor te kanalizimeve, ndersa gropat septike ekzistuese duhet te mbyllen per te frenuar ndotjen e tokes dhe te ujerave nentokesore. Per shtepite e veçuara dhe ne distance nga kolektoret e rrjetit te kanalizimeve ku lidhja me te mund te jete e kushtueshme, zgjidhja do te jete instalimi i nje impiant trajtimi te veçante kompakt i parafabrikuar. Megjithate, vendimin per nje opsion te veçante apo per ndertimin e lidhjes me kanalizimin bashkia do te bazohet ne konsideratat ekonomike te nje projektimi te detajuar.

*Zgjidhjet teknike te propozuara:*

**Impianti i trajtimit klasik:** Nga pikepamja ekonomike e efikasitetit te pastrimit si dhe ate te funksionimit, zgjidhja me e mire eshte ndertimi i nje impianti te vetem te madh klasik te trajtimit, per te gjitha njesite. Arsyeya eshte se shpenzimet e pergjithshme specifike te trajtimit te ujit zvogelohen me rritjen e numrit te popullsise te lidhur ne te. Meqenese shtrirja e rrjetit te kolektoreve te ujerave te zeza kondicionon kostot specifike te rrjetit (kostot e kanalit, tubacioneve), ajo duhet te merret ne konsiderate per planifikimin e impiantit te trajtimit. Duke njohur strukturen morfologjike te rajonit bregdetar dhe per shkak te distancave te gjata ndermjet disa fshatrave, nuk eshte ekonomik ndertimi i nje rrjeti te gjate kolektori qe do te lidh te gjitha vendbanimet. Perveç vleres se madhe financiare per ndertimin, nje sistem i tille do te kerkoje perpjekje dhe financime te konsiderueshme edhe per funksionim dhe mirembajtje. Per fshatrat e vegjel qe ndodhen relativisht afer njeri-tjetrit, sigurimi i nje rrjeti unik kolektori me shkarkim ne nje impiant trajtimi te perbashket mund te jete nje zgjidhje e arsyeshme. Alternative do te ishte realizimi i disa rrjeteve kolektoresh te veçante dhe impiante trajtimi respektive. Megjithate, kjo eshte nje

çeshtje e planifikimit të projekteve të veçante dhe do të varet edhe nga kushtet specifike lokale.

**Impiant kompakt trajtimi i parafabrikuar:** Për shtepite e shkeputur dhe për vendbanime të vogla me densitet të ulet të vendosura në fshatra të thella, ndertimi i një impianti trajtimi klasik do të ishte jo i arsyeshëm. Kostot specifike të ndertimit do të rriten në mënyrë të pajustificuar. Performanca funksionale e një impianti klasik mund të mos jetë e pershtatshme, prandaj realizimi i një impianti kompakt të parafabrikuar trajtimi do të jetë një zgjidhje më e mirë. Ato janë të pershtatshme për kapacitete nga një familje e vetme deri në një grup shtepish të një vendbanimi të vogël. Në çdo rrethane zbatimi i arsyeshëm i tipit klasik ose kompakt është i ngjashëm, prandaj zgjidhja dhe vendimi i perfundimtar për një opsionin optimal do të varet nga kushtet lokale. Në rajonin bregdetar argumenti për impiantin e trajtimit kompakt të parafabrikuar është instalimi i shpejtë dhe me efekte të shpejta pozitive në mjedis në drejtim të reduktimit të ndotjes. Gjate procesit të planifikimit afatgjatë, është normale zgjidhja në teresi i problemit për sistemet e kanalizimeve që përfshin disa vendbanime, përfshirë dhe ato nuk janë konsideruar si pjesë e një zgjidhje unike.

Kjo do të bëjë që punimet e ndertimit të jenë shumë më të shkurtra. Për situatën e tanishme arsyeja më bindëse dhe qëllimi është zvogëlimi i ndotjes së mjedisit, i cili të mund të arrihet në një afat të shkurtër për disa pjesë të vendbanimeve bregdetare. Kjo zgjidhje mendojmë se është më e mirë se sa të pritet për një koncept kompleks të trajtimit rajonal, i cili ka nevojë për shumë vjetërgatitje. Me fjale të tjera, një reduktim i menjehershëm i ndotjes së mjedisit në të ardhmen e afert është më e mirë se mos ta kemi atë. Kjo qasje është në përputhje me politiken qeveritare për ujërat e ndotura bregdetare. Impiantet e trajtimit klasik janë objektiv afatgjatë; zgjidhjet lokale në shkallë të vogël janë përpjekje për mundësi të ndërmjetme. Përveç kësaj, duhet të vihet në dukje se opsioni i shpejtë i impianteve kompakte të parafabikuara nuk e përjashton konceptin e zgjidhjes afatgjatë bashkiake apo rajonale të trajtimit të këtyre ujërave.

**Gropat septike:** Avantazhet e gropave të rregullta septike është kostoja e ulet, jetegjatesia e shërbimit dhe funksionimit të qëndrueshëm. Disavantazhi qëndron në efikasitetin e kufizuar të pastrimit, për shkak të trajtimit vetëm mekanik dhe të rrezikut të ndotjes së ujërave nëntokesore.

Megjithatë në shumë raste për shtepite dhe vendbanimet e shkeputura, impiantet e trajtimit të parafabikuara nuk mund të financohen, opsion alternativ ende janë gropat e rregullta septike. Shpenzimet totale janë më të ulëta se sa për metodën e impianteve të parafabikuara, metode që është pranuar në zone edhe për shkak të funksionimit individual dhe pavarësisë nga furnizimi me energji. Megjithatë, gropat septike ekzistuese shpesh tregojnë gjendjen e pamjaftueshme të kushteve të ndertimit dhe të funksionimit. Në pjesën më të madhe këto objekte duhet ose të rehabilitohen ose të mbyllën dhe të zëvendësohen nga një ndërtim i ri. Vendimi për opsionin më të pershtatshëm duhet të arrihet me vlerësimin e rasteve specifike teknike dhe kostove të lidhura me to.

Megjithatë gropat septike mundësojnë vetëm trajtimin mekanik, efikasiteti i pastrimit është gjithmone më i ulët se trajtimi me pajisjet e parafabikuara. Prandaj nga këndvështrimi i reduktimit të ngarkesës së ndotjes ato janë një zgjidhje më e keqe se

trajtimit me impiantin e parafabrikuar. Por duke marre parasysh mjetet e kufizuara financiare per infrastrukturen e ujit, ato do te ndikojne duke lene situaten e ujerave te zeza ashtu siç ajo eshte sot. Ne qofte se zgjedhja do te jete ndermjet trajtimit me impiant te parafabrikuar dhe gropave septike, vendimi do te varet nga mundesia e financimit, kushteve social-ekonomike dhe mundesise se furnizimit me energji. Ndersa nga pikepamja e mbrojtjes se mjedisit mundesia me impiant te parafabrikuar do te jete me e avantazhuar. Per me tej, kostot totale (per ndertimin dhe funksionimin) duhet te mbulohen. Nje parakusht tjetër është ne mundesine e furnizimit me energji per nje funksionim te vazhdueshem. Nese ndonje nga keto kerkesa nuk eshte e siguruar, zgjidhja me grupa te rregullta septike mund te jete zgjidhja me e mire afatshkurter.

Si furnizimi me ujë dhe çështja e kanalizimeve janë një nga detyrat kryesore të Bashkise, edhe në këtë rast ndryshimi i situatës do të kalojë përmes dy koncepteve:

- (a) përmirësimin e gjendjes ekzistuese (ndërrhyrje afatshkurtër):
- (b) zgjidhja perfundimtare individuale për çdo njësi apo e bashkuar me ate më të afert (afatgjatë)definitive solution individual for each unit or join with closer one (long term)

Përmirësimi i menjëhershëm i situatës se kanalizimeve duhet të ndjehet:

- (i) kontrollin, rehabilitimin ose heqjen e gropave septike prane burimeve të afërta te furnizimit me ujë / stacioneve te pompimit dhe zbatimin e standardeve në funksionim dhe ne menaxhimi të mbetjeve të tyre. Në çdo rast duhet të jetë monitorimi sistematik i ujerave dhe cilesise se ujerave nëntokësore;
- (ii) zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve ekzistuese për të mbuluar të gjitha shtepite dhe pjesë të vendbanimeve;
- (iii)impiante kompakte te parafabrikuara te trajtimit për shtëpitë e shkëputura dhe zonat e largëta.

Bashkia duhet të vleresoje zgjidhjen e përhershme të problemit te kanalizimeve . Për qytetin e Himarës, tashmë ekziston Projekti që do të lidhë të gjitha vendbanimet e zonës me rrjetin e kanalizimeve ekzistuese dhe do të përdorë impiantin ekzistues te trajtimit klasike, përmirësimin e teknologjisë se trajtimit nga ajo mekanike siç është tani, në ate bio-mekanike, duke ruajtur të njëjten vend derdhje. Linja e kanalizimeve është paraqitur skematikisht në hartën e re te infrastrukturës.

Për pjesën tjetër të zonave të Bashkise, ashtu siç është shpjeguar më lart, impiantet klasike të trajtimit mund të jenë të pavarura për çdo fshat (njësi) ose impiant i perbashket trajtimi, në vartesi të strukturës morfologjike të zonës bregdetare, distancave midis fshatrave, dhe koston për funksionimin dhe mirëmbajtjen, etj.

Për fshatrat e vegjel, të vendosura relativisht afër njëri-tjetrit, sigurimi i një rrjeti te perbashket grumbullimi, qe shkarkon në një impiant te vetem trajtimi mund të jetë një zgjidhje e arsyeshme. Alternativë tjetër do të jetë realizimi i disa rrjeteve të veçanta grumbullimi dhe impiantesh përkatëse të trajtimit. Megjithatë, kjo është një çështje e projekteve te fisibilitetit qe do te zgjidhet në vartesi me kushtet specifike lokale dhe burimeve te financimit, gje qe i kalon objektin e punes se Konsulentit..



### 1.3 Projektet e infrastruktures ujore dhe te kanalizimeve

Projektet e infrastruktures ujore dhe kanalizimeve ne vendbanimet e bashkise se Himarespershkruhenh ne listen e projekteve, te grupuara ne kater lloje te nderhyrjeve te nevojshme (si me poshte). Projektet specifike do te bazohen ne studimet e fizibilitetit perkates, sipas kushteve te vendbanimeve

Tipi i nderhyrjes se nevojshme te kerkuar:

1. **Zgjerimin e rrjetit te furnizimit me uje dhe kanalizimet ekzistuese per te mbuluar te gjithe zonen e populluar / sigurimin e impianteve te trajtimit per çdo njesi banimi, ne funksion te kushteve;**
2. **Ndertimin e impianteve te trajtimit te ujrave te ndotur: (i) te veçante per çdo zone ose (ii) impiant trajtimi te perbashket me zonen bashkengjitur.**
3. **Ndertimi i objekteve sanitare turistike ne afersi te plazhit, tualet publik lidhur me impiantin e trajtimit me te afert, (ii) impiant kompakt i ndare.**
4. **Ndertimin e impianteve kompakte te parafabrikuara ose gropave septike te rregullta per shtepite e veçuara.**

Ne fazen e dyte te trajtimit radikal duhet te realizohet rehabilitimi, kontrolli, ose heqja e gropave septike ne afersi te objekteve ujore / stacioneve te pompimit dhe respektimin e standardeve te funksionimit dhe menaxhimit te mbetjeve te tyre. Ne çdo rast duhet te ekzistojë monitorimi sistematik i cilesise se ujrave nentokesore dhe atij ne rrjetin e furnizimit.

Monitorimi i rregullt dhe permanent i parametrave kimik dhe mikrobiologjik per cilesine e ujit te pijshem duhet te respektohet dhe zbatohet.

Nderhyrjet specifike per çdo njesi do te jene si me poshte:

|   |
|---|
| <b>Palasa</b>   |
| Zgjerimi i rrjetit te furnizimit me uje per te mbuluar te gjithe popullsine;  |
| Kontrolli i kushteve teknike te gropave septike. Per shtepite e shkeputura, lidhja me rrjetin e ri te kolektorit ose sigurimi i nje zgjidhje trajtimi te veçante (impiant trajtimi te parafabrikuar kompakt ose grupa septike), sipas rasteve individuale |
| Ndertimin e impiantit te trajtimit (i) i veçante per Palasen; (ii) impiant i perbashket me Dhermiun.  |
| <b>Dhermi</b>   |
| Zgjerimi i rrjetit te furnizimit me uje per te mbuluar te gjithe popullsine;  |
| Permiresimin e administrimit te ujit dhe reduktimin e humbjeve teknike;   |
| Ndertimin e impiantit te trajtimit te ujrave te ndotur (i) te veçante per Dhermiun; (ii) impiant te perbashket trajtimi me Palasen;   |
| Planifikimi i impianteve sanitare per pushuesit ne bregdet (i) tualet publik te lidhur  |

|  |
|--|
| me rrjetin e kolektoreve lokal; (ii) tualet publik trajtimi te parafabrikuar   |
| <b>Ilias</b>   |
| Zgjerimi i rrjetit te furnizimit me uje per te mbuluar te gjithe popullsine;   |
| Permiresimin e administrimit te ujit dhe reduktimin e humbjeve teknike;  |
| Ndertimi i nje rrjeti te ri kolektori per zonat e reja rezidenciale;   |
| Ndertimin e impiantit te trajtimit te ujrave te ndotur (i) te veçante per Ilias; (ii) impiant te perbashket trajtimi me Vunon;   |
| Impiante kompakte te parafabriuara trajtimi apo gropa septike per banesat e shkeputura;  |
| <b>Vuno (Jal)</b>  |
| Zgjerimi i rrjetit te furnizimit me uje per te mbuluar te gjithe popullsine;   |
| Permiresimin e administrimit te ujit dhe reduktimin e humbjeve teknike;  |
| Ndertimi i nje rrjeti te ri kolektori per zonat e reja rezidenciale  |
| Ndertimin e impiantit te trajtimit te ujrave te ndotur (i) te veçante per Vunoin; (ii) impiant te perbashket trajtimi me Iliasin;  |
| Impiante kompakte te parafabriuara trajtimi apo gropa septike per banesat e shkeputura;  |
| Planifikimi i impianteve sanitare per pushuesit ne bregdetin e Jal-set (i) tualet publik te lidhur me rrjetin e kolektoreve lokal; (ii) tualet publik trajtimi te parafabrikuar                              |
| <b>Himara</b>  |
| Zgjerimi i rrjetit te furnizimit me uje per te mbuluar te gjithe popullsine;   |
| Permiresimin e administrimit te ujit dhe reduktimin e humbjeve teknike;  |
| Ndertimin e rrjetit te ri te kolektoreve te lidhur me rrjetin kryesor te impiantit te qytetit te Himares, mbylljen e gropave septike;  |
| Sisteme kompakte te parafabriuara trajtimi per shtepite e shkeputura;  |
| Planifikim i impianteve sanitare per pjesen e poshtme te kodres se Himares se vjeter: (i) zgjidhje e veçante (impiant kompakt i parafabrikuar), (ii) kanalizime te lidhura me impiantin kryesor te bashkise. |
| <b>Porto Palermo</b>   |
| Ndertimin e rrjetit te ri te kolektoreve per vendbanimet ekzistuese, mbylljen e gropave septike.   |
| Ndertimin e impianteve te trajtimit (i) kompakte te parafabriuara per trajtim te veçante, (ii) lidhje me impiantin e trajtimit te Himares ose Qeparoit;  |
| Impiant trajtimi te parafabrikuar apo gropa septike per shtepite e shkeputura;   |
| Per sherbimin sanitar turistik (i) impiant i veçante trajtimi; (ii) te lidhur me rrjetin e kolektoreve.  |
| <b>Piluri</b>  |

|  |
|--|
| Zgjerimin e rrjetit të furnizimit me ujë për të mbuluar të gjitha zonat e banuara;   |
| Lidhja me rrjetin kryesor të furnizimit me ujë të Bashkisë Himarë;   |
| Ndërtimin e rrjetit të kolektoreve dhe mbylljen e gropave septike;<br>Ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujrave të ndotur të veçante për fshatin Pilur;                           |
| Impiante kompakte të parafabrikuara ose gropa septike të rregullta për shtëpitë e veçuara.   |
| <b>Kudhes</b>  |
| Lidhja me rrjetin kryesor të furnizimit me ujë të Bashkisë Himarë;   |
| Ndërtimi i një rrjeti të ri kolektorësh për zonat rezidenciale dhe mbyllja e gropave septike;  |
| Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujrave të ndotur: (i) impiant të veçante për fshatin Kudhes, (ii) kolektor të lidhur me impiantin e trajtimit të fshatit Qeparo.                |
| <b>Qeparo</b>  |
| Lidhja me rrjetin kryesor të furnizimit me ujë të Bashkisë Himarë;   |
| Ndërtimi i një rrjeti të ri kolektorësh për zonat rezidenciale dhe mbyllja e gropave septike;  |
| Ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujrave të ndotur (i) të veçante për fshatin Qeparo eventualisht kompakt i parafabrikuar, (ii) impiant trajtimi i perbashket me fshatin Kudhes; |
| Impiante kompakte të parafabrikuara ose gropa septike të rregullta për shtëpitë e veçuara.   |

#### 1.4. Udhezues për projektet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet

##### A. Faza e projektimit/planifikimit:

- Duhet bërë një studim kompleks (ekonomik, hidro gjeologjik, social), që të ofrojë më shumë se një alternativë. Me të miri duhet të zgjidhet bazuar në:
  - a. koston;
  - b. mundësitë e financimit;
  - c. kohën e zbatimit;
  - d. kostot e funksionimit;
  - e. teknologjinë;
  - f. fleksibilitetin e funksionimit të rrjetit, etj.;
- Zbatimi në fazën e planit, sipas burimeve të financimit.
- Ndarjen e ndërtimit të rrjetit të furnizimit me ujë në seksione, bazuar në njesitë hidraulike (burim, puse, vepermarrje);
- Disa fshatra të Bashkisë së Himarës mund të kenë rrjete të perbashket kolektorësh të ujrave të zeza, në varësi të kushteve duke bërë vlerësime për çdo rast dhe sigurisht të realizuar/zbatuar në fazën.

**B. Faza e zbatimit:**

- Te gjitha projektet parciale duhet te marrin ne konsiderate studimin afatgjate dhe rajonal te furnizimit me uje.
- Monitorim te rregullt te cilesise se ujit te pijshem nepermjet analizave kimike dhe bakteriologjike (sipas kriterëve te Keshillit te Evropes).
- Shperndarje dhe menaxhim sa me te mire te ujit per nje funksionim sa me te mire te sistemit;

Duke ditur qe investimet afatgjate kerkojne kohe dhe sasi te konsiderueshme financiare, eshte e rëndesishme qe *investimet afatshkurter dhe afatmesme ne infrastrukture te jene te fokusuar ne zgjerimin e rrjetit te shperndarjes se ujit per te mbuluar sa me shume qe te jete e mundur zona te banuara.*

*Permiresimi i gjendjes aktuale duhet te ndjeke aktivitetet/projektet e meposhtme:*

- Detajimi i nje programi investimesh ne baze te vleresimit realist te kostove perkatese.
- Permiresimi i shpejte afatshkurter qe mund te zbatohet deri ne tre vjet, per te minimizuar ndryshimin midis nevojës/kerkeses per uje dhe pasurise ujore te zones, *e financuar nga qeveria qendrore/lokale;*
- Hartimi i nje plani infrastrukturor afat mesem dhe afat gjate qe mund te plotesoje nevojat per uje familjare, industriale, tregtare dhe ate te sektorit te turizmit, *financuar nga qeveria qendrore ose donatore;*
- Formulimin dhe miratimin e nje rregulloreje per trajtimin e ujrave te ndotur per sherbimet e reja, hotelet dhe apartamentet (**per me shume se 20 shtreter/persona**) per:
  - a. Ndertimin nga ana e tyre te impianteve biologjike te trajtimit te ujrave te ndotura;
  - b. Funksionimin e tyre nen mbikeqyrjen dhe kontrollin e inspektoratit publik te bashkise;
  - c. Ujerat e mbetura pas trajtimit te derdhen ne perrenj ose te filtrohen ne toke pa efekte ndotese;
  - d. Te organizohet ne menyre permanente largimi i mbetjeve fekale sipas nje rregulloreje perkatese, e monitoruar gjithmone nga inspektorati bashkiak.
- Per hotelet/shtepite “BB” apo dhoma me qera, me me pak se **20 shtreter** duhet te formulohet dhe miratohet nje rregullore per:
  - a. Ndertimin e impiantit te tyre bashkekohor te trajtimit te ujrave / gropa septike pa efekte mjedisore;
  - b. Pastrimin/shkarkimin permanent te gropave septike individualisht apo te organizuara nga bashkia (kundrejt nje takse te caktuar).
  - c. Organizimin e derdhjeve te ketyre gropave ne nje rrjedhe te percaktuar/kanal.
- Kontrollin, rehabilitimin ose mbylljen e gropave septike ne afersi te burimeve ujore apo stacioneve te pompimit;
- Zbatimi i standardeve per funksionimin dhe menaxhimin e mbetjeve;
- Ne çdo rast duhet te kete kontroll sistematik te cilesise se ujrave ne rrjetin e furnizimit me uje.

## 1.5. Konceptimi i koston per projektet e propozuara

### *Per furnizimin me uje*

Kostoja e projekteve te veçanta do te kerkoje nje studim rajonal te fizibilitetit dhe do t'i referohet **zgjidhjes dhe teknologjise perkatese**, e pranuar nga qeveria dhe pushteti vendor.

Kostoja ne vetvete eshte funksion i:

- a) Numrit te popullsisë qe do t'i sherbeje;
- b) Kerkeses specifike per uje;
- c) Relievit te zones;
- d) Teknologjise dhe materialit te perdorur;
- e) Pronesise mbi token, etj.

Ne stadin e ketij studimi, bazuar dhe ne informacionin qe disponojme mund te themi se:

*Nje buxhet prej 0.5 milion Euro do te nevojitet per permiresimin e situates se furnizimit me uje vetem per qytetin e Himares.*

Siç u tha dhe ne raport, Konsulenti eshte i mendimit per nje zgjidhje rajonale te furnizimit me uje dhe atij te largimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura. Per nje vleresim te shpejte mund te merren ne konsiderate koston aktuale te peraferta per keto lloje punimesh si:

- a) Kosto per furnizim per vendosjen e tubacionit DN nga 150-900 ne 330-350 Euro/m;
- b) Kosto njesi per rezervuaret me kapacitet 1000 m<sup>3</sup> deri 170.000-200.000 Euro.

Kostoja progresive duhet te marre ne konsiderate koston e vepres se marrjes, stacionet e pompimit dhe puseve, te cilat te gjitha se bashku formulojne koston e projektit per çdo projekt te furnizimit me uje.

**Per Ujerat e ndotura:** Edhe per projektet e largimit dhe perpunimit te ujrave te zeza, kostoja e projekteve te veçanta do te kerkoje nje studim rajonal te fizibilitetit per mundesite e zgjidhjes per çdo zone te Bashkise Himare. Ajo do te jete ne vartesi te **zgjidhjes se propozuar dhe teknologjise se perdorur**, te pranuar nga qeveria dhe pushteti lokal.

Nga te dhenat e siguruar per vleresimin e planit te propozuar per impiantet e largimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura ne Bashkine Himare, si dhe nga eksperiencat e ngjashme mund te thuhet se:

- a) 3.0 milion Euro mund te nevojiten per permiresimin e sistemit te kanalizimeve ne qytetin e Himares;
- b) 1.0 milion Euro do te nevojiten per permiresimin e procesit mekanik te trajtimit te ujrave, e shoqeruar me nje shkarkim ne thellesi te detit.
- c) 1 000-2.000 Euro do te nevojitet per trajtimin me impiant kompakt te parafabrikuar te banesave te shkeputura.

## 1.6. Konkluzione

1. Permiresimi i sherbimit uxor (ujit te pijshem dhe ujerave te zeza), jane te nje prioriteti te larte per zhvillimin turistik te zones se Bashkise Himare.
2. Zgjidhja me e mire e mundshme, duhet te bazohet ne studim te detajuar tekniko-ekonomik, duke pasur parasysh kapacitetin e investimeve, kapacitetin e burimeve ujore, relievin, kostot e funksionimit dhe te mirembajtjes, popullsine perfituese, etj;
3. Zgjidhjet afatshkurter dhe afatmesme te sherbimit uxor per çdo zone te Bashkise Himare duhet te bazohen/sherbejne dhe respektoje zgjidhjet afatgjate si per furnizimin me uje ashtu edhe per trajtimin e ujerave te ndotur;
4. Bashkia e Himares duhet te perqendrohet ne zgjerimin e rrjetit te infrastruktures ekzistuese ujore ne qytetin e Himares dhe njesive te veçanta, pa neglizhuar ato ne zonat malore, per te mbuluar sa me shume zona te jete e mundur te popullsise dhe gjithashtu ne permiresimin e sherbimeve me kosto te ulet te ujit si eliminimi i humbjeve teknike, instalimi i matesve, etj.
5. Kontrollimin dhe permiresimin e te gjithe gropave septike te banesave te shkeputura te cilat nuk mund te lidhen me kolektorin me te afert dhe veçanerisht ne eliminimin e filtrimeve nentokesore, si rreziku kryesor per ndotjen e ujerave nentokesore;
6. Permiresimin e kapaciteteve profesionale te stafit teknik per kontrollin dhe menaxhimin, e cilesise dhe humbjeve te ujit, etj.

## II | 3. FURNIZIMI ME ENERGJI

Shperndarja e energjise tashme eshte e privatizuar nga Kompania Ceke CEZ qe dy vjet me pare. Sipas marreveshjes, shperndarja e energjise ne zonen tone te projektit eshte pergjegjesi e zyres se CEZ ne qytetin e Fierit. Per permiresimin e sherbimeve te ofruara ne zonen e projektit, jane planifikuar investime specifike qe konsistojne ne permiresimin e furnizimit nepermjet projekteve rajonale Sipas informacionit te marre nga zyra pergjegjese per funksionimin e sistemit te furnizimit me energji ne pjesen jugore te zones se studimit (perfshire te gjitha vendbanimet nga Vlora ne Sarande), nderhyrja e fundit ka si qellim reduktimin e humbjeve dhe permbushjen e kerkesave per deri ne 50 vitet e ardhshme. Projekti perbehet nga:

- Modifikimi i karakteristikave teknike ne shperndarje (ndarjen e dy linjave te tensionit te larte nga 35 ne 110 kV;
- Modifikimi i voltazhit te mesem nga 10 KV ne 20 kV;
- Modifikimi i duhur i nenstacioneve;
- Rehabilitimi i rrjetit te tensionit te ulet.

Nje linje e tensionit te larte (220 kV), do lidhe te Fierin dhe Vloren. Projekti i transformimit te sistemit te vjeter te tensionit 35-110 kV eshte zbatuar ne Vlore. Nenstacionet 110 kV jane projektuar apo po zbatohen ne Palase, Himare, etj. Zona turistike nga Vlora ne Sarande do te kete furnizim te sigurt te energjise, si pjese e linjes 110/20kV (permes Bashkise Himare). Linja 110/20kV eshte tashme pjeserisht funksionale ne qytetin e Vlores. Se fundi, mund te themi se ka disa hidrocentrale te vegjel ne zone qe kontribuojne ne furnizimin me energji elektrike nga linjat lokale.- (PAP / RAC - SOGREA: *Plani dhe Studimi i Zhvillimit te Integruar te Bregdetit - Raporti Paraprak*) Konsulenti u informua gjithashtu se nderhyrjet kryesore jane planifikuar ne linjen kryesore te transmetimit. Detajet pritet te merren nga (CEZ) ne Fier.

## II | 4. TELEKOMUNIKACIONI

Ky sektor është gjithashtu privatizuar disa vite më parë. Telekomunikacioni është në proces të shpejtë të përmirësimit dhe modernizimit. Bashkia e Himarës si pjesë e zonës më të rëndësishme ekonomike të zhvillimit të Shqipërisë është përfshirë në disa projekte zhvillimi. Sipas informacioneve jozyrtare, kapacitetet ekzistuese të Bashkisë së Himarës do të rriten deri në 3000 numra të rinj / kontrata. Mundësia teknike për rritjen e kapaciteteve telekomunikuese ekziston nëse do të ketë kërkesa. Përdorimi i kabllave optike për internet dhe shërbimet e tjera në kushtet aktuale nuk janë fitimprurëse meqenëse kërkesa është e kufizuar dhe këto shërbime janë kryer kryesisht nga operatorë të mëdhenj të telefonisë celulare si AMC dhe Vodafone.

Si përfundim, zhvillimi i infrastrukurës së telekomunikacionit nuk është aspak një faktor kufizues për zhvillimin e rajonit. Sapo të fillojnë proceset e zhvillimit, infrastruktura e telekomunikacionit do të zgjerohet dhe të përmirësohet për të përballuar kërkesat shtesë. Albtelekomi ka realizuar projekte në mënyrë që të fusë shërbime të reja përveç telefonit, të tilla si internet i shpejtë dhe televizionin kabllor. Për këtë qëllim është e nevojshme të ndërrohet teknologjia ekzistuese e rrjetit, me qëllim zgjerimin e përdorimit të fibrave optike. Qëllimi është që të zvogëlojë gjatësinë mesatare të linjave. Për këtë arsye do të ndërtohen 3 stacione të reja (MSAN), respektivisht në Himarën Fshat, Potam dhe Spile. Kapacitet që synohen janë për rreth 3000 lidhje të reja. Ky shërbim gjithashtu do të shtrihet në Dhermi, Vuno, Qeparo etj., duke ndërtuar dhe këtu disa impiante. Për këtë është e rëndësishme përdorimi i fibrave optike përgjatë rrugës Qeparo – Palasë.





## II | 5. MENAXHIMI E MBETJEVE URBANE PER BASHKINE HIMARE

Gjendja e mbetjeve urbane dhe atyre te ndertimit ne Bashkine Himare eshte kaotike. Kudo gjenden grumbullime plehrash te hedhura ne vendet te papershtatshme (lugina, qytet, fshat, rruge kombetare, buze detit etj). **Hapi i pare i domosdoshem dhe urgjent** eshte pastrimi dhe largimi i tyre nga te gjitha pikat e pershkruara dhe te identifikuara nga specialistet ne terren ne raportet e meparshme (Vishe, Ilias, Himare, Qeparo, Jale. Dhermi, Porto Palermo, Gjipe etj) dhe depozitimi i tyre ne zonen e percaktuar(stacion transferimi) nga Bashkia Himare prane zones industriale. Mundesimi i eleminimit eshte me kosto shume te ulet.

Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe ndertimi eshte pjese e infrastruktures dhe duhet te bazohet ne ligjin Nr .9010, date 13.2.2003. Eliminimi i tyre kontribuon ne mbrojtjen e shendetit te banoreve, ne permiresimin e kushteve te jeteses dhe cilesine e saj, ekuilibrin ekologjik, ne turizem si dhe ne ruajtjen afatgjate te burimeve natyrore. Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe atyre te ndertimit ne Bashkine Himare ne pergjithesi nenkupton:

- Grumbullimin ne çdo fshat dhe qytet te ketyre mbetjeve sikurse dhe pastrim rruges dhe te bregut te detit;
- Transportimin nga fshati dhe qyteti ne piken e grumbullimit;
- Trajtimin dhe
- Depozitimin apo riciklimin e tyre.

### 4.1 Grumbullimi

Nga vleresimi paraprak i bere nga specialistet ne terren rezulton se grumbullimi i mbetjeve urbane dhe atyre te ndertimit neper vendet e caktuara ne kete Bashki eshte i manget. Ka grumbullime masive te ketyre mbetjeve ne ane te rrugeve, ne luginat e perrenjve dhe lumenjve, ne lendinat buze detit etj dhe gjendja e kazaneve te plehrave eshte e mjerueshme pothuajse kudo aty ku ka dhe aty nuk ka fare, gje qe sjell nje impakt negativ per turizmin dhe cilesine e jetes ne zone. Nje grumbullim i mire i mbetjeve eshte nje fillim i mbare per menaxhimin e tyre. Sidoqofte, menaxhimi i tyre duhet te ndaje *mbetjet urbane* nga ato *te ndertimit*. Te parat do te grumbullohen fillimisht ne stacionin transit (transferimi) ku pasi t'i nenshtrohen kompaktesimit (ngjeshjes) do te transportohen ne vendgrumbullimin e percaktuar (nga studimet e meparshme<sup>6</sup>), ne Bajkaj ne afersi te Delvines, ndersa mbetjet e ndertimit mund te propozohen ne vendin e percaktuar ne Himare. Nje vend i tille depozitimi afer qytetit nuk do te ishte i keshillueshem dhe do te ishte me mire qe Bashkia te percaktonte nje tjeter hapshire. Ne rastet kur stacioni tranzit i mbetjeve gjendet prane qendrave te banuara, ai mund te jete edhe i mbuluar.

<sup>6</sup> PAP/RAC – SOGREA: Plan Studimi i Zhvillimit te Integruar te Bregdetit– Raport Paraprak, TBU-HBA-P&P Joint Venture – Nëntor 2007, Plani per menaxhimin e mbeturinave ne qarkun Vlore-Projekti LIFE

## Sygjerime

1. Se pari, çdo fshat duhet të përcaktojë një ose disa **pika të grumbullimit** (në varesi të numrit të banorëve, p.sh. në Qeparo mjafton një pikë grumbullimi në hyrje të fshatit në zonën e parkimit, (po kështu edhe në Kudhës, Himarë-fshat, Pilur si dhe fshatrat në bregdet), të cilët duhet të vendosen në një hapësirë e cila mund të arrihet lehtë nga automjetet e kompanisë së pastrimit. Pika e grumbullimit duhet të ketë kazane me mbishkrime që të mundësojnë seleksionimin (grumbullim i diferencuar) e tyre sipas përberjes së tyre si ushqimore, leter, qelq, lende metalike dhe plastike. Ky seleksionim do të lehtësojë shumë procesin si dhe do të rrisë interesimin e kompanive të specializuara të përpunimit të mbetjeve urbane. Në fshatra banorët duhet patjetër t'i hedhin mbeturinat e tyre në vendet e caktuara dhe jo nëpër rrugicat e fshatit.
2. Se dyti, një tjetër domosdoshmëri është edhe **optimizmi i kohës** së largimit të këtyre mbetjeve duke eliminuar çlirimin e aromave të keqja në mjedis, tejmbushjen e kazaneve dhe vendgrumbullimeve me mbetje urbane. Kjo është e rëndësishme sidomos për zonat bregdetare ku gjatë sezonit të verës do të ishte me se e nevojshme që largimi i mbetjeve urbane të bëhet dy herë në ditë, njëherë pas drekës dhe njëherë në orët e vona të natës. Jashtë sezonit me përjashtim të qytetit të Himarës ku mbledhja e plehrave duhet të jetë e përditshme, në pjesën tjetër të bashkisë grumbullimi mund të bëhet edhe një herë në dy ose tre ditë.
3. Se treti, një **fushatë ndërgjegjesimi** është e nevojshme që të ndermerret nga ana e Bashkisë lidhur me mbetjet urbane. Kjo mund të bëhet përmes mediave lokale, nëpër shkollë, shpërndarje fletpalosjesh si edhe me fushatë ndërgjegjesimi nëpër fshatra. Kjo fushatë duhet të përfshijë jo vetëm të rriturit por edhe femijet si dhe jo vetëm familjarët por në mënyrë të veçantë pronarët e bareve dhe restoranteve, pasi këta të fundit gjatë sezonit të verës janë edhe ndër ndotesit më të mëdhenj. Pjesëmarrës në këtë fushatë duhet të jenë edhe pronarët e industrisë së zonës ku të përfshihen ata të industrisë së vajit, peshkimit, ndërtimit, transportit etj.
4. Se katërti, organizimi i **aksioneve vullnetare** nga ana e komunitetit në çdo fillim sezoni do të ishte një mënyrë e mirë për krijimin e një klime mireseardhjeje për pushuesit në këtë Bashki.
5. **Mbetjet e ndërtimit**: Mbetjet e ndërtimit konsiderohen si më pak të dëmshme për ekologjinë dhe shëndetin e njeriut por nga ana vizuale prania e tyre në ane të rrugëve apo pranë ndërtimeve dëmton peisazhin e zonës në teresi. Në bazë të ligjit Nr .9010, datë 13.2.2003 përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ndërtimit bëhet me riperdorim dhe groposje. Në rastin e Bashkisë Himarë, ku ndërtimi në vitet që vijnë mendohet se do të rritet në mënyrë të kontrolluar, Bashkia duhet të miratojë rregulloren e trajtimit të mbetjeve të ndërtimit që nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre. Zotëruarit të mbetjeve janë të detyruar në bazë të këtij ligji, që të respektojnë vendimet e Bashkisë, në rast të kundërt penalizohen nga ( 300 000 deri në 1 000 000 leke.)

## 4.2 Transportimi

Transportimi është momenti i dytë i rëndësishëm i menaxhimit të këtyre mbetjeve. Sigurisht që transporti duhet të bëhet me mjete dhe pajisje profesionale të cilat duhet të sigurohen nga Bashkia apo kompania e pastrimit. Problemi kryesor, veç pajisjes është edhe fakti se **shperndarja e banoreve** në zonë është jo e barabartë si nga ana gjeografike ashtu edhe gjatë muajve të vitit. Zona e qytetit të Himarës ka një numër më të madh banorësh ndërsa ato si Jal gjatë dimrit pothuajse nuk janë të banuara, por nga ana tjetër po këto qytete kanë me shumë banorë në sezonin e verës (Qershor-Shtator) se sa jashtë këtij sezoni (Tetor-Maj). Pra, skenari i transportimit të mbetjeve urbane ka dy pjesë (1) atë të sezonit veror dhe (2) jashtë sezonit. Në bazë të tabelës së mëposhtme edhe transporti i mbetjeve nga stacioni i perkohshëm për në vendgrumbullimin Bajkaj-t mund të ndryshojë në bazë të sasive të sezonit përkatës. Llogaritjet janë bazuar në të dhënat e studimit të BB<sup>1</sup> ku mesatarja e prodhimit të mbetjeve nga ana e një njeriu në Shqipëri është rreth 0,7kg/nj/dite. Gjatë sezonit të verës ku maksimumi i prodhimit të mbetjeve arrijnë në 35 ton në ditë. Me një kamion me tonazh 10 ton dhe një vëllim prej afro 10 m<sup>3</sup> do të mjaftonin 4 deri 5 transporte në ditë për të larguar nga stacioni i perkohshëm mbetjet urbane të grumbulluara. Jashtë sezonit kamioni mund të bëjë edhe 1 ose 2 rrugë në çdo ditë.

**Tabela 42: Tabela e perlogaritjeve të mbetjeve sipas sezonit**

| Periudha                                    | Banore/dite<br>Në Himarë<br>(bashki) | Mbetje<br>per<br>banore<br>ne dite<br>(kg/k/d) | Densiteti i<br>mbetjeve<br>pas<br>ngjeshjes<br>(ton/m <sup>3</sup> ) | Mbetje<br>per<br>banore ne<br>dite<br>(m <sup>3</sup> /k/d) | Total<br>mbetje<br>(ton/dite) | Vëllim<br>total |
|---|--------------------------------------|--|--|---|-------------------------------|-----------------|
| (1)Sezoni<br>veror<br>(qershor-<br>shtator) | 50 000<br>(parashikuar<br>2015)      | 0.7  | 0.8  | 0.000875  | 35                            | 43.75           |
| (2)Jashte<br>sezoni<br>(tetor-<br>maj)      | 15 000<br>(parashikuar<br>2015)      | 0.7  | 0.8  | 0.0003  | 12                            | 15              |

Për sa i përket **transportit të mbetjeve të ndertimit** ai duhet të sigurohet nga firmat e ndertimit, pasi ato duhen konsideruar si zotëues të këtyre mbetjeve. Transporti i tyre duhet të kryhet me automjete të cilat të jenë të mbuluara në mënyrë që të mos ketë mbetje që bien gjatë rrugës për në stacionin e perkohshëm apo në vendgrumbullim.


## 4.3 Depozitimi

Depozitimi i mbetjeve urbane siç u theksua më lart do të bëhet në vendgrumbullimin e Bajkaj-t. Ideja e një vendgrumbullimi në Vuno ( Sipas BB, Studimi Paraprak i Fizibilitetit dhe Plan Studimi i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri B.V. 2005 në Vuno parashikohet një vendgrumbullim), nuk do të sillte asgjë pozitive pasi sasitë janë të tilla që nuk e bëjnë të domosdoshme atë dhe distanca nga kjo Bashki në vendgrumbullimin e Bajkaj është relativisht e shkurtër (rreth 60 km).

Persa i perket depozitimit te mbetjeve te ndertimit mund te behet *prane guroveve* dhe atje te groposen apo te perpunohen ose Bashkia ne bashkepunim me Agjensine Rajonale te Mjedisit te caktoje nje *hapesire per groposje te veçante per mbetjet e ndertimit* qe mund te jete edhe prane stacionit te perkohshem (tranzitor). Depozitimi i tyre mbetet detyre e firmave te ndertimit. Ne vendin e groposjes shtrati i gropes duhet te vishet me materiale gjeo-sintetike per te shmangur ne kete menyre ndotjen e ujerave nentokesore.

#### 4.4 Trajtimi

Trajtimi i mbetjeve urbane ne vendgrumbullimin perkates mbetet detyre e organeve kompetente. Trajtimi i mbetjeve te ndertimit mund te behet prane guroveve ekzistuese qe nuk gjenden prane lumenjve dhe rruges automobilistike kombetare. Ne pergjithesi menaxhimi i mbetjeve jepet me sipermarrje duke nenkontraktuar kompanite private por edhe mund te kryhet drejtpersedrejt nga institucioni publik pergjegjes, ne rastin konkret Bashkia Himare. Gjithashtu, ndertimi dhe perdorimi i vendeve per groposjen e mbeturinave mund te realizohet nga sektori privat ose nepermjet nje kontrate te Partneritetit Publik e Privat.



**Figura 61:** Mbetje urbane ne perrua



**Figura 62:** Mbetje urbane dhe ndertimi ne ane te rruges



**Figura 63:** Stacioni i perkohshem i mbetjeve urbane



**Figura 64:** Pamje e stacionit te perkohshem te mbetjeve urbane



**Figura 65:** Stacion i perkohshem i mbuluar i mbetjeve urbane

### III. LISTA E PROJEKTEVE

| <b>Lista e Projekteve</b> |                          |   |   |
|---------------------------|--------------------------|---|---|
| <b>No.</b>                | <b>Lloji i Projektit</b> | <b>Emri i Projektit</b>   | <b>Financimi</b>  |
|                           | <b>Palasa</b>            |   |   |
| 1                         | Infrastruktura           | Zgjerimi i rrjetit ekzistues te furnizimit me uje dhe kanalizimeve per te mbuluar te gjithë zonen e popullsise / sigurimin e zgjidhjes se trajtimit te veçante, sipas rasteve individuale   | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 2                         | Infrastruktura           | Ndertimi i impiantit te trajtimit te ujerave te zeza (i) te veçante per Palasen ose (ii) impiant trajtimi te perbashket me Dhermiun   | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 3                         | Zhvillimi i Turizmit     | Rehabilitimi i kalldremevedhe paisjeve te shesheve qendrore   | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 4                         | Zhvillimi i Turizmit     | Programi i rehabilitimit te ndertimit te shtepive tradicionale te vjetra dhe stimulimin per riperdorimin e tyre si hotele B & B ( Shtrat dhe Mengjes )  | IPA, Programet Nderkufitare   |
|                           | <b>Dhermi dhe Gjilek</b> |   |   |
| 1                         | Infrastruktura           | Zgjerimi i rrjetit ekzistues te furnizimit me uje dhe kanalizimeve per te mbuluar te gjithë zonen e popullsise / sigurimin e zgjidhjes se trajtimit te veçante, sipas rasteve individuale   | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 2                         | Infrastruktura           | Ndertimi i impiantit te trajtimit te ujerave te zeza (i) te veçante per Palasen ose (ii) impiant trajtimi te perbashket me Dhermiun   | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 3                         | Infrastruktura           | Sigurimi i trajtimit te paisjeve lehtesuese per turistet ne afersi te plazhit ne Jaliskari dhe Perivolos (i) Tualete publike lidhur me impiantin e trajtimit te komunes, (ii) Impiante trajtimi kompakte te vecanta parafabrikate | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 4                         | Infrastruktura           | Sistemimi dhe organizimi i trafikut te automjeteve, parkimit dhe qarkullimit te kembesoreve ne zonen bregdetare te Jaliskarit dhe Perivolosit   |   |

| <b>Lista e Projekteve</b> |                          |   |   |
|---------------------------|--------------------------|---|---|
| <b>No.</b>                | <b>Lloji i Projektit</b> | <b>Emri i Projektit</b>   | <b>Financimi</b>  |
| 5                         | Infrastruktura           | Zhvillimi i rrjetit rrugor dytesor ne zonat e urbanizuara ne kohet e fundit te Dhermiut dhe Gjilek, nen rrugen kombetare                                      | Projekt i rrugeve rajonale i zbatuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit  |
| 6                         | Zhvillimi i Turizmit     | Rinovimi i kalldremeve, aksesit dhe paisjet e hapësirave publike te fshatit te Dhermiut   | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 7                         | Zhvillimi i Turizmit     | Programit i rehabilitimit dhe ndertimit te shtepive tradicionale ne Dhermi dhe stimulimin per riperdorimin e tyre si hotele B& B ( Shtrat dhe Mengjes )       | Projekti i Bankes Boterore  |
| 8                         | Zhvillimi i Turizmit     | Rehabilitimi i monumenteve kulturore ne Dhermi [Kishes Panayia Manastiri, Kisha Ipapandise, Shtepi e Lluk Petro Zhupes dhe Stavri, Kullat e Vretos dhe Kumis] | Projekti i Bankes Boterore, mundesuar nga Fondet e IPA-s              |
| 9                         | Zhvillimi i Turizmit     | Zhvillimi i sinjalistikes dhe sistemit te levizjes sipas gjurmeve qe lidh fshatin Dhermi me bregdetit dhe pergjate bregdetit                                  | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 10                        | Zhvillimi i Turizmit     | Rehabilitimi i gurores ekzistuese ne hyrje te Dhermiut  | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 11                        | Zhvillimi i Turizmit     | Permisimi i pamjes se Jaliskarit dhe Perivolos duke realizuar pamjen e unifikuar te kioskave sipas zonimit te propozuar                                       | IPA, Programet Nderkufitare/ Bashkia                                  |
| <b>Ilias</b>              |                          |   |   |
| 1                         | Infrastruktura           | Zgjerimi i rrjetit ekzistues te furnizimit me uje per te mbuluar te gjithe zonen e popullsise   | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 2                         | Infrastruktura           | Ndertimi i rrjetit te kolektorit te ri  | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 3                         | Infrastruktura           | Ndertimi i impiantit te trajtimit te ujerave te zeza (i) te vecante per Ilias, ose (ii) impiant trajtimi te perbashket me Vuno-ne                             | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 4                         | Infrastruktura           | Ndertimi i impiantit te trajtimit kompakte te parafabrikuara ose gropa  | IPA, Komponenti i zhvillimit  |



| <b>Lista e Projekteve</b> |                          |  |   |
|---------------------------|--------------------------|--|---|
| <b>No.</b>                | <b>Lloji i Projektit</b> | <b>Emri i Projektit</b>  | <b>Financimi</b>  |
|                           |                          | septike per shtepi te shkeputura   | rajonat, projekte te lidhura me mjedisin                              |
| 5                         | Zhvillimi i Turizmit     | Shttrim dhe rinovimin te sheshit qendror dhe ndertim shatervani ne zonen e qendres se fshatit.   | Bashkia   |
| 6                         | Zhvillimi i Turizmit     | Zhvillimi te sinjalistikes dhe te sistemit ecjes dhe levizjes sipas gjurmeve pergjate kanionit te Ngjipese dhe ne drejtim te keshtjelles para-historike te Iliasit             | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 7                         | Social Ekonomike         | Mbeshtetja e rivitalizimi i bujqesise tradicionale dhe aktivitetet e agro turizmit permes terheqjes se fondeve nga programet e BE-se dhe subvencionet                          | IPA, Programet Nderkufitare   |
|                           | <b>Vuno dhe Jali</b>     |  |   |
| 1                         | Infrastruktura           | Zgjerimi i rrjetit ekzistues te furnizimit me uje per te mbuluar gjithe zonen e popullates dhe permiresimin e administrimit te tij   | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 2                         | Infrastruktura           | Ndertimi i nje rrjeti te kolektorit te ri per zonen qendrore te banimit ne Jal   | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 3                         | Infrastruktura           | Ndertimi i impiantit te trajtimit te ujerave te zeza (i) te vecante per Vuno in ose (ii) impiant trajtimi te perbashket me Ilias   | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 4                         | Infrastruktura           | Ndertimi i impiantit te trajtimit kompakt te parafabrikuar ose gropa septike per shtepi te shkeputura  | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 5                         | Infrastruktura           | Ndertimi i faciliteteve per turistet ne plazhin e Jales (i) Tualete publike lidhur me impiantin e trajtimit te zones, (ii) impiante trajtimi kompakte te vecanta parafabrikate | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 6                         | Infrastruktura           | Ndertimi i rruges lidhese midis Jales dhe Livadhit   | Projekt i rrugeve rajonale i zbatuar nga Fondi                        |

| <b>Lista e Projekteve</b> |                          |  |  |
|---------------------------|--------------------------|--|--|
| <b>No.</b>                | <b>Lloji i Projektit</b> | <b>Emri i Projektit</b>  | <b>Financimi</b>   |
|                           |                          |  | Shqiptar i Zhvillimit  |
| 7                         | Zhvillimi i Turizmit     | Ndertimi i shetitores buze detitne Jale  | Bashkia  |
| 8                         | Zhvillimi i Turizmit     | Rinovimi dhe riparimin i kalldreveve dhe hapësirave publike të vjetra të Vunoit  | IPA, Programet Nderkufitare  |
| 9                         | Zhvillimi i Turizmit     | Program i rehabilitimit/riparimit të ndertimeve të vjetra tradicionale në Vuno dhe stimulimi për rivitalizimin e tyre si hotele B & B ( Shtrat dhe Mengjes             | IPA, Programet Nderkufitare  |
| 10                        | Zhvillimi i Turizmit     | Rehabilitimi i monumenteve kulturore të evidentuara [S. Spiridhoni, S. Mihali, Mesodhia, S. Sotiri Kishat, Kulla e Koka]   | Projekti i Bankes Boterore, mundësuar nga Fondet e IPA-s                         |
| 11                        | Zhvillimi i Turizmit     | Themelimi i një muzeu në Vuno duke paraqitur historinë e migrimit të fshatit gjatë gjithë shekullit të 20 si tërheqje për vizitorët                                    | IPA, Programet Nderkufitare  |
| 12                        | Socio-economik           | Mbeshtetja e rivitalizimit të bujqësisë tradicionale dhe aktivitetet e agroturizmit përmes tërheqjes së fondeve nga programet e BE-së dhe subvencionet                 | IPA, Komponenti i Zhvillimit Rajonal, projekte të lidhura me zhvillimin ekonomik |
| <b>Himara dhe Livadhi</b> |                          |  |  |
| 1                         | Infrastruktura           | Ndertimi i rrugës së unazës së Himarës sipas Planit Bashkiak   | Fondet Kombëtare   |
| 2                         | Infrastruktura           | Permisimi i portit ekzistues të Himarës për funksionimin e turizmit të bute, me kapacitet të përkohshëm për tragete, si dhe anijet e tjera me qasje rrugore të veçanta | Lloji i Projekteve të PPI-së   |
| 3                         | Infrastruktura           | Zgjerimi i rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë për të mbuluar gjithë zonën e popullatës dhe përmirësimin e administrimit të ujit                                    | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte të lidhura me mjedisin            |
| 4                         | Infrastruktura           | Ndertimi i rrjetit të ri të kolektorit, i lidhur me impiantin e trajtimit të Himarës, mbyllja e gropave septike  | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte të lidhura me mjedisin            |

| <b>Lista e Projekteve</b> |                          |   |   |
|---------------------------|--------------------------|---|---|
| <b>No.</b>                | <b>Lloji i Projektit</b> | <b>Emri i Projektit</b>   | <b>Financimi</b>  |
| 5                         | Infrastruktura           | Impiante trajtimi kompakte parafabrikate per shtepi te shkeputura   |   |
| 6                         | Infrastruktura           | Ndertimi i faciliteteve per turistet poshte kodres se Himares se vjeter (i) Tualete publike lidhur me impiantin e trajtimit te bashkiak, (ii) impiante trajtimi kompakte, te vecanta, parafabrikate |   |
| 7                         | Infrastruktura           | Menaxhimit te mbeturinave dhe trajtimi i vend groposjejeve kalimtare (i) te vecanta ose te perbashketa per te gjithë vendbanimet.Zbatimi i nje programi bashkiak te menaxhimit te mbeturinave       | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 8                         | Infrastruktura           | Zhvillimi i rrjetit te rrugeve dytesore ne qytetin e Himares per te lidhur lagjet e Stefanel, zonen e stadiumit , zonen e stacionit elektrik dhe Mihaili.   |   |
| 9                         | Infrastruktura           | Zhvillimi i nje qendres sportivete Bashkise ne zonen e stadiumit te Himares   | Llojet e projekteve te PPI-se   |
| 10                        | Infrastruktura           | Ndertimi i ures dhe permiresimi i aksesit te automjeteve te zonave te reja te planifikuara te banimit ne Livadhe dhe riparimin e rruges lidhese per ne Jal.   | Projekt rajonal i rrugeve i zbatuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit   |
| 11                        | Zhvillimi i Turizmit     | Zhvillimi/Ndertimi i nje shetiroreje buze Potamit si nje pol relaksus ne zonat e pushimit me ajer te paster   | Bashkia   |
| 12                        | Zhvillimi i Turizmit     | Zhvillimi i bregdetit te Spileas si nje zone per kembesore I lidhur me portin dhe zonen e parkimit te bashkise  | Bashkia   |
| 13                        | Zhvillimi i Turizmit     | Vazhdimi i rinovimit dhe rehabilitimit te punimeve ne Kalane e Himares me qellim per te inkurajuar organizimin e aktiviteteve kulturore ne oret e mbremjes  | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 14                        | Zhvillimi i Turizmit     | Krijimi i nje qendre per trajnime profesionale ne fushen e turizmit dhe te mikpritjes te organizuar ne Kalane e Himares   | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 15                        | Zhvillimi i Turizmit     | Zgjerimi i qendrave shendetesore, sipas studimeve ekzistuese  | Ministria e Shendetesise  |
| 16                        | Zhvillimi i Turizmit     | Zhvillimi i sinjalistikes dhe sistemit te levizjes sipas gjurmeve pergjate Kanionit te Himares duke lidhur Kalane   | IPA, Programet Nderkufitare   |

| <b>Lista e Projekteve</b> |                          |   |   |
|---------------------------|--------------------------|---|---|
| <b>No.</b>                | <b>Lloji i Projektit</b> | <b>Emri i Projektit</b>   | <b>Financimi</b>  |
|                           |                          | e Himares me Spilea dhe Livadhin  |   |
| 17                        | Zhvillimi i Turizmit     | Ngritja e nje muzeu historik ne kalane e Himares duke paraqitur historine dhe identitetin e zones   | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 18                        | Zhvillimi i Turizmit     | Rehabilitimi i zones se rrethuar te Shpelles se Spilese (Shpella Polifemit) si pike turistike per vizitoret   | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 19                        | Zhvillimi i Turizmit     | Rehabilitimi i monumenteve kulturore te shenuara ne gjendje te dobet ne Kalane Himara e Vjeter [ Te gjithë Shenjtoret, S. Maria, S. Gjergji dhe Kishat Baku, Shtepite e Llazani dhe Jorgji], si dhe Shtepia e Spiromilios.            | Projekti i Bankes Boterore, mundesuar nga Fondet e IPA-se             |
| 19                        | Zhvillimi i Turizmit     | Zhvillimi i nje sistemi orientues dhe informativ per vizitoret dhe ne lidhje me akomodimin, vizitat turistike etj ,me qender ne Spile dhe nje degene Jaliskari (qe ofron materiale promovuese, harta, info mbi vizitat turistike etj) | IPA, Programet Nderkufitare   |
| <b>Porto Palermo</b>      |                          |   |   |
| 1                         | Infrastruktura           | Ndertimi i rrjetit te kolektorit te ri per vendbanimet ekzistuese, ne afersi deri te gropave septike  | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 2                         | Infrastruktura           | Sigurimi i trajtimit te ujrave te zeza (i) impiant trajtimi kompakt i vecante i parafabrikuar (ii) rrjeti i kanalizime te impiantit te trajtimit te Himares ose te Qeparo-se  | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 3                         | Infrastruktura           | Impiante trajtimi kompakte parafabrikate ose grupa septike per shtepi te shkeputura   | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 4                         | Infrastruktura           | Zhvillimi i nje marine i lidhur me nje vendpushim (resort ) turistik potencial  | Llojet e projekteve te PPI-se   |
| 5                         | Zhvillimi i Turizmit     | Zhvillimi / Ndertimi i nje korsie biçiklete qe lidh Porto Palermon me Himaren dhe Qeparone  | IPA, Programet Nderkufitare   |

| <b>Lista e Projekteve</b> |                          |  |   |
|---------------------------|--------------------------|--|---|
| <b>No.</b>                | <b>Lloji i Projektit</b> | <b>Emri i Projektit</b>  | <b>Financimi</b>  |
| 6                         | Zhvillimi i Turizmit     | Zhvillimi i Kalase se Ali Pashes dhe zones perreth per te terhequr vizitoret me eventet kulturore dhe gastronomine.                                  | IPA, Programet Nderkufitare   |
|                           | <b>Pilur</b>             |  |   |
| 1                         | Infrastruktura           | Zgjerimi i rrjetit ekzistues te furnizimit me uje per te mbuluar gjithe zonen e popullates   | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin             |
| 2                         | Infrastruktura           | Lidhja me rrjetin e ardhshem te furnizimit me uje te Himares   | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin             |
| 3                         | Infrastruktura           | Ndertimi i rrjetit te kolektorit te ri, deri ne afersi te gropave septike  | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin             |
| 4                         | Infrastruktura           | Ndertimi i impiantit te trajtimit te ujerave te zeza, vetem per Pilurin  | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin             |
| 5                         | Infrastruktura           | Impiante trajtimi kompakte parafabrikate ose gropa septike per shtepi te shkeputura  | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte e lidhura me mjedisin              |
| 6                         | Infrastruktura           | Rikonstruksioni i rruges qe lidh Himaren dhe Pilurin, per te permbulushur standardet e sigurise.   | Projekt i rrugeve rajonale i zbatuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit              |
| 7                         | Zhvillimi i Turizmit     | Zhvillimi i nje qendre per produktet blegtorale per vizitoret ne Pilur   |   |
| 8                         | Zhvillimi i Turizmit     | Zhvillimi i sinjalistikes dhe sistemit qarkullues qe lidh Pilurin me Himaren e Vjeter.   | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 9                         | Social Ekonomike         | Mbeshtetje rivitalizimi te bujqesise tradicionale dhe aktivitetet e agro turizmit permes terheqjes se fondeve nga programet e BE-se dhe subvencionet | IPA, Komponenti i Zhvillimit Rajonal, projektet te lidhura me zhvillimin ekonomik |

| <b>Lista e Projekteve</b> |                          |  |   |
|---------------------------|--------------------------|--|---|
| <b>No.</b>                | <b>Lloji i Projektit</b> | <b>Emri i Projektit</b>  | <b>Financimi</b>  |
|                           | <b>Kudhes</b>            |  |   |
| 1                         | Infrastruktura           | Lidhja me rrjetin e ardhshem te furnizimit me uje te Himares   | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 2                         | Infrastruktura           | Ndertimi i rrjetit te kolektorit te ri per zonat e banimit me popullsi te dendur, deri ne afersi te gropave septike                                      | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 3                         | Infrastruktura           | Ndertimi i impiantit te trajtimit te ujerave te zeza (i) te vecante per Kudhes, ose (ii) impiant trajtimi te perbashket me Qeparone                      | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 4                         | Zhvillimi i Turizmit     | Rinovimi dhe riparimin e kalldremeve dhe hapësirave te vjeteruara publike  | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 5                         | Zhvillimi i Turizmit     | Programit i rehabilitimit/riparimit te shtepive tradicionale te vjetra te Kudhes dhe stimulimin per rivitalizimin e tyre si B & B ( Shtrat dhe Mengjes ) | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 6                         | Zhvillimi i Turizmit     | Zhvillimi i sinjalistikes dhe sistemit qarkullues, qe lidh Kudhesin me Qeparone e Vjeter dhe Pilurin   | IPA, Programet Nderkufitare   |
|                           | <b>Qeparo</b>            |  |   |
| 1                         | Infrastruktura           | Lidhja me rrjetin e ardhshem te furnizimit me uje te Himares   | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 2                         | Infrastruktura           | Ndertimi i rrjetit te kolektorit te ri per zonat e banimit me popullsi te dendur, deri ne afersi te gropave septike                                      | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 3                         | Infrastruktura           | Ndertimi i impiantit te trajtimit te ujerave te zeza (i) te vecante per Qeparo ose (ii) impiant trajtimi te perbashket me Kudhes                         | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 4                         | Infrastruktura           | Impiante trajtimi kompakte parafabrikate ose grupa septike per shtepi te shkeputura  | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te                     |

| <b>Lista e Projekteve</b> |                               |   |   |
|---------------------------|-------------------------------|---|---|
| <b>No.</b>                | <b>Lloji i Projektit</b>      | <b>Emri i Projektit</b>   | <b>Financimi</b>  |
|                           |                               |   | lidhura me mjedisin   |
| 5                         | Zhvillimi i Turizmit          | Rinovimi dhe riparimin e kalldreveve dhe ndricimit te tyre dhe hapësirave te vjetëruara publike ne fshatin e Qeparose   | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 6                         | Zhvillimi i Turizmit          | Programi i rehabilitimit te ndertimit te shtepive tradicionale te vjetra te Qeparose dhe stimulimin per rivitalizimin e tyre si hotele B&B ( Shtrat dhe Mengjes ) | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 7                         | Zhvillimi i Turizmit          | Rehabilitimi i monumenteve kulturore te pa mirembajtura (te evidentuara ne Qeparo e Vjeter [Kasheli, Shtepia e Gjika, Kulla e Kapitenit ]                         | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 8                         | Zhvillimi i Turizmit          | Zhvillimi i sinjalistikes dhe sistemit qarkullues, qe lidh Qeparone e vjeter me ate te Ri   | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 9                         | Zhvillimi i Turizmit          | Zhvillimi i nje shetitore buze Qeparoit te Ri per aktivitete te kohes se lire, ne vende te hapura dhe permiresimin e qasjeste plazhit                             | Bashkia   |
|                           | <b>Nderhyrje te Moderuara</b> |   |   |
| 1                         | Ngritja e kapaciteteve        | Permiresimi i kapaciteteve te bashkise ne hartimin e projekteve dhe zbatimin e tyre, terheqjen e financimeve te huaja,  | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 2                         | Ngritja e kapaciteteve        | Permiresimi i kapacitetit bashkiak per planifikimin urban dhe ne ekspertizen e GIS-it, sipas kerkesave te ligjit te planifikimit territorial                      | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |
| 3                         | Ngritja e kapaciteteve        | Perfshirja e stafit bashkiak ne trajnimin dhe transferimin e ekspertizes, si dhe programet e shkembimitte eksperiençave te mira nga Greqia dhe Italia             | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 4                         | Ngritja e kapaciteteve        | Krijimi i nje programi bashkiak per ndergjegjesimin mjedisor duke iu referuar si komunitetit lokal dhe vizitoreve   |   |

| <b>Lista e Projekteve</b> |                          |  |   |
|---------------------------|--------------------------|--|---|
| <b>No.</b>                | <b>Lloji i Projektit</b> | <b>Emri i Projektit</b>  | <b>Financimi</b>  |
| 5                         | Trajnime dhe ekspertiza  | Sigurimi i ekspertizes dhe mbeshtetjes per fermeret vendas ne lidhje me, metoda te reja te kultivimit dhe te perpunimit te ushqimit stimuluarne kthimin e emigranteve          | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 6                         | Trajnime dhe ekspertiza  | Programe trajnimi per sipermarresit vendas ne sektorin e turizmit dhe sherbimeve per menaxhim biznesi, marketing si dhe sjellja e pervojës se menaxhereve vendas te riadhesuar | IPA, Programet Nderkufitare   |
| 7                         | Trajnime dhe ekspertiza  | Program trajnimi per personelin ne hotelet vendase, kurse trajnimi per mikpritjen, gjuhe te huaja dhe IT   | IPA, Komponenti i zhvillimit rajonal, projekte te lidhura me mjedisin |



# 6 PJESEMARRJA PUBLIKE

Suksesi i Planit qendron ne perceptimin dhe shkrirjen e plote te aspiratave dhe kerkesave te popullates lokale duke qene i mire formuluar ne menyre qe te pranohet nga palët e interesuara lokale dhe operatorët ekonomik. Në këtë kontekst, një kërkesë specifike e Autoritetit Kontraktues që duhet të respektohet gjatë procesit të studimit është *sygjerimi i orientimeve te drejta të njësisë së qeverisjes vendore, në mënyrë që popullata e interesuar të përfshihet dhe të angazhohet në vendim-marrje sipasobjektivave te studimit* . Konsulenti për këtë arsye ka vendosur një theks të veçantë në këtë aspekt në metodologjinë dhe planin e punës siç është shpjeguar në propozimin teknike te paraqitur dhe perpunuar më me hollësi në këtë raport.

Pjesëmarrja publike është një komponent integral i projektit, i dizenuar për të inkurajuar një ndjenjë pronësie të përbashkët mes Bashkësisë dhe komunitetit lokal, perfshire ne Vizionin e propozuar për territorin e Bashkise. Për të arritur këtë, konsulenti luan rolin e ndërmjetësit duke ndihmuar popullatën lokale dhe palët e interesuara në paraqitjen, të kuptuarit të zonës duke shprehur aspiratat e tyre për zhvillimet e ardheshme, kjo ndihmon në përgatitjen e një plani që siguron pajtueshmërinë e tij në kontekstin lokal. Pjesëmarrja e publikut ishte strukturuar në katër komponente kryesore (a) Analizat e SWOT, (b) Paraqitja Publike e Vizionit të qytetit dhe Strategjia Territoriale, (c) Konsultimi për formulimin e Planit Strukturor, dhe (d) Prezantimi publik i draft Planit Lokal dhe Rregulloret e Planifikimit Lokal.

## I. ANALIZA SWOT

Gjatë kësaj faze të punës Konsulenti ka zhvilluar takime të vecanta me secilin përfaqësues lokal të lokaliteteve duke prezantuar qëllimin e studimit dhe për të terhequr direkt opinionin në lidhje me karakteristikat kryesore që formojnë identitetin e fshatit, problemet kryesore dhe sfidat me të cilat përballen banorët dhe pritshmeria ndaj Planit. Ky takim është zhvilluar nepermjet vizites se perbashket ne cdo fshat me qellim evidentimin- ne vend - vende te problemeve se bashku me kryepleqte dhe komunitetin. Këto diskutime ndihmuan në mënyrë të konsiderueshme për njohjen me identitetin shoqëror të secilit lokalitet. Një përshkrim të shkurtër të çështjeve kryesore që U evidentuan nga këto takime janë paraqitur në shtojcat B. Pjesëmarrja e publikut në këtë fazë u organizua nëpërmjet dy seminareve SWOT, që paraqiten si më poshtë.

**Përgatitja e seminarit SWOT** - SWOT (Pikat e Forta, Dobësitë, Mundësitë, dhe Rreziqet) është një mjet analitik i vendosur në praktikën e tanishme të planifikimit urban në një shkallë globale, në mënyrë që të hetojë dhe të përmbledhë gjendjen e tanishme të një Bashkie. Rezultatet e analizës SWOT kanë qenë të përfshira në hartimin e skenarëve alternativë dhe vizionit për zhvillimin e ardhshëm që do kapitalizojnë riparimin e dobësive dhe promovimin e mundësive dhe sigurimin nga rreziqet.

**Grupet e interesit lokale të Komitetit** - Konsulenti kërkoi të angazhohet aktivisht një grup pjesëmarrës i publikut, në bashkëpunim me Bashkinë e Himarës si përfaqësuesit më të përshatshëm nga komuniteti lokal për t'u përfshirë në seminar. Ky grup përbëhet nga Grupet e Interesit Lokale të Komitetit (GILK), të cilët janë nga një gamë e gjerë e njerëzve nga të gjitha sferat e jetës, duke përfshirë të dy kryetarët (njëri i zgjedhur kohët e fundit), Departamenti i Planifikimit Urban dhe departamenteve të tjera bashkiake, kryepleqet e vendbanimeve, ndërtuesit lokale, arkitektët etj..e

Projektimi i seminareve SWOT ishte parashikuar nga Konsulenti në një mënyrë që të ishte i orientuar drejt në aspektin e zhvillimit turistik. Duke pasur parasysh topografinë e larmishme dhe prirjet e zhvillimit të Bashkisë Himarë, Konsulenti vendosi të ndahet në dy seminare SWOT, bazuar në kategorizimin e gjerë të territorit të Bashkisë në zonat malore dhe atë bregdetare. Seminari i parë u përqëndrua në prezantimin e përgjithshëm të projektit dhe identifikimin e nevojave dhe problemeve të zonës së studimit. Seminari i dytë u përqëndrua mbi diskutimet dhe njohuritë e fituara në seminarin e parë, dhe u përqëndrua duke diskutuar për llojet dhe sfidat e zhvillimit të turizmit. Seminarët u zhvilluan në Himarë, më 19 dhe 20 Maj 2011.

Secili nga pjesëmarrësit nga GILK fillimisht ka marrë një Formular me Informacione Personale për të plotësuar gjatë seminarit. Seminari u nda më pas në dy raunde. Në raundin e parë, pjesëmarrësve u janë dhënë katër (4) forma të veçanta, duke iu referuar pikave të forta, dobësive, mundësive dhe rreziqeve. Çdo formular kishte një pyetje të thjeshtë: "Në një fjali, cilat janë anet e forta {apo dobësitë, mundësitë, rreziqet} e qytetit?" Pjesëmarrësve iu kërkua të shkruajnë së paku pesë (5) përgjigje për pyetjen e dhënë dhe më pas të theksojnë pesë tema në bazë të rëndësisë së tyre. Çdo pjesëmarrës u pyet për të plotësuar formularët për vendbanimet specifike /vendi

qe ata përfaqësojnë ose janë të lidhur. Konsulenti mbledhi formularët, përmbledhja e të dhënave nga të gjithë pjesëmarrësit dhe materialet u organizua në katër tabelat përmbledhese. Në pjesën e dytë, pjesëmarrësve iu kërkua të vlerësojnë rezultatet e përmbledhura për zonën malore apo bregdetare në tërësi. Secili prej tyre ka marrë njëzet (20) stickers, pesë për çdo katër tryeza (5X4 = 20 në total) dhe iu kërkua vlerësimi për rëndësinë, sipas rangut për secilën çështje duke vendosur stickers për çështjet e rëndësishme më të madhe sipas mendimeve të tyre. Përmes këtij procesi, pjesëmarrësit kishin mundësi të shprehin mendimin e tyre dhe të jepnin kontributin e dobishëm si për një zonë të caktuar dhe për gjithë Bashkinë.

Në përfundim, Konsulenti prezantoi rezultatet për pjesëmarrësit.




Figura 66: Rezultatet e seminarit SWOT 1






Figura 67: Procesi i SWOT 1

| TABELA PERMBLEDHËSE E ANEVE TE FORTA: |                                      | Ceshja e zgjedhur |
|---------------------------------------|--------------------------------------|-------------------|
|                                       | Anet e forta (STRENGTHS)             |                   |
| 1                                     | PANORAMA, RELIEVI - (KREJTESIA)      | 15                |
| 2                                     | NATURA E VEGJETI - CALESIAE DETIT    | 12                |
| 3                                     | POTENCALE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT  | 12                |
| 4                                     | KRIMA (TURIZEM - FAMILJAR)           | 12                |
| 5                                     | DENSITETI AKTUAL (MINIMALI NDERTIMI) | 12                |
| 6                                     | TABE. PËR ZHVILLIMIN                 | 13                |
| 7                                     |                                      |                   |
| 8                                     |                                      |                   |
| 9                                     |                                      |                   |
| 10                                    |                                      |                   |

| TABELA PERMBLEDHËSE E DOBESISE: |   | Ceshja e zgjedhur |
|---------------------------------|---|-------------------|
|                                 | Dobesite (WEAKNESSES)                           |                   |
| 1                               | MUNGESA E PLANIT URBANISOR - (NDERTIMI I MJEDE) |                   |
| 2                               | PROBLEMET E PROMISE                             |                   |
| 3                               | MANGESI PËR SHËRBIMEVE TË ORAJEN                |                   |
| 4                               | INFRASTRUKTURA (UTJEN, KANALIZIM)               |                   |
| 5                               | RELIEVI I THËRR                                 |                   |
| 6                               | MËBETJET URBANE                                 |                   |
| 7                               | NIVE MIRËMBALLET NATURA                         |                   |
| 8                               | TRANSPORTI URBAN (KËNDREH - MUNGESA)            |                   |
| 9                               |   |                   |
| 10                              |   |                   |

| TABELA PERMBLEDHËSE E MUNDËSIVE: |                                   | Ceshja e zgjedhur |
|----------------------------------|-----------------------------------|-------------------|
|                                  | Mundesite (OPPORTUNITIES)         |                   |
| 1                                | TURIZEMI KOMBETAR - (KREJTESIA)   | 7                 |
| 2                                | TURIZEMI NDET KOMBETAR            | 10                |
| 3                                | TURIZEMI ELITAR                   | 10                |
| 4                                | TIPIN E TURIZMIT - RESORT         | 9                 |
| 5                                | TIPIN E TURIZMIT - REZIDENCA/VILA | 10                |
| 6                                | HOTELERIA - DHËMJA PËR OJËR       | 5                 |
| 7                                | DENSITETI (SITUIMIN 4%)           | 5                 |
| 8                                | ??                                |                   |
| 9                                |                                   |                   |
| 10                               |                                   |                   |

| TABELA PERMBLEDHËSE E RREZIQEVE: |                                   | Ceshja e zgjedhur |
|----------------------------------|-----------------------------------|-------------------|
|                                  | Rreziqet (THREATS)                |                   |
| 1                                | NDERTIME PA STANDARTE, PA-KRATERE |                   |
| 2                                | ABUZIMI ME NATYREN                |                   |
| 3                                | MOSKUPATA E KONUMENTEVE           |                   |
| 4                                | MUNGESA E INVESTIMEVE             |                   |
| 5                                | MENAXHIMI I ECO VENËSË PËRSHË     |                   |
| 6                                | MIGRACIONI (BENËSHETI - DASHËM)   |                   |
| 7                                | MUNGESA E PLOTË E INFRASTRUKTURËS |                   |
| 8                                | NIVELI I SHËRBIMEVE (INFO-TORE)   |                   |
| 9                                | BLEGTORAT - UJËJENË               |                   |
| 10                               |                                   |                   |

Figura 68: Rezultatet e seminarit SWOT 2



Figura 69: Procesi i SWOT 2

## II. PREZANTIMI PUBLIK I VIZIONIT TE QYTETIT DHE STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TERRITORIAL

Element i rendesishem i pjesemarrjes se publikut ne kete projekt ishte prezantimi publik i Vizionit te Qytetit dhe Strategjise se Zhvillimit te Turizmit. Permes ketij prezantimi, Konsulenti ka pasur mundesine per te transmetuar qellimet dhe objektivat e nje koncepti te pergjithshem per zhvillimin e ardhshem te gjithe zones dhe te njesive te vecanta hapesine ne prani te grupeve te interesit, si dhe mbledhjen e informacioneve te dobishme prej tyre. Para prezantimit, takimet konsultative me autoritetet bashkiake kane pasur si qellim te pergjithshem te percaktojne udhezimet kryesore te Vizionit dhe te familjarizojne stafin bashkiak me permbajtjen dhe rolin e tij.

Prezantimi publik i Vizionit dhe Strategjia per Zhvillimin e Turizmit u mbajt me 15 Korrik 2011 ne ambientet e Bashkise. Ne kete prezantim moren pjese rreth tridhjte pjesemarrres banore te qytetit, zyrtare bashkiake, pale te interesuara lokale, perfaqesues te shoqerise civile, pronare te parcelave, ndertues, inxhinier, perfaqesues te OJQ-ve dhe mediave lokale, (Figura 70). Prezantimi u ndoq gjithashtu edhe nga Drejtori dhe Zevendes Drejtori i Agjencise Kombetare te Planifikimit te Territorit, per te siguruar koordinimin dhe konsultimin ne nivel kombetar ne perputhje me kerkesat e ligjit 10119/2009.



**Figura 70:** Paraqitja e Vizionit te Qytetit dhe e Strategjise per Zhvillimin e Turizmit



**Figura 71:** Paraqitja e Vizionit të Qytetit dhe e Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit

Prezantimi u hap nga Kryetari i Bashkisë, i cili paraqiti qëllimin dhe synimin e Studimit, i ndjekur nga një prezantim i fazave të përgjithshme të projektit, konceptit dhe strukturës së Vizionit si dhe nga strategjia e zhvillimit të territorit dhe turizmit me qëllimin dhe objektivat e saj. Gjatë prezantimit të paraqitjes së Vizionit, Konsulenti i dha rendesi çështjeve themelore të zhvillimit të turizmit, modeleve të paraqitura dhe llojeve kryesore të turizmit (turizmi masiv, turizmi konvencional, turizmi i qendrueshëm), u prezantua modeli i një turizmi të qendrueshëm si një alternativë zbatimi për Himarën dhe me pas u demonstruan skenaret alternative të zhvillimit të ardhshëm të turizmit. Konsulenti paraqiti vlerësimin e këtyre katër skenareve për 10-20 vitet e ardhshme. U diskutua reduktimi i zhvillimit informal të turizmit dhe zhvillimit intensiv të shtepive të dyta, si dhe rritjen e formave të buta të zhvillimit të turizmit masiv dhe turizmit të natyrës dhe kultures. Në fund u paraqit pasqyrimi hapësor i Vizionit, së bashku me përshkrimin e disa zonave të veçanta për çdo njësi hapësore.

Prezantimi pati sukses pasi arriti debatin direkt pyetje përgjigje duke marrë vlerësim realist të komunitetit lokal për çështjet kryesore në lidhje me zhvillimin e ardhshëm të Bashkisë. Pjesëmarrësit ishin veçanërisht të interesuar për të diskutuar arsyet për zhvillimin e turizmit në Himarë ka mbetur i dobët gjatë viteve të fundit dhe për të identifikuar pengesat e tilla si: mungesa e infrastrukturës apo faktorëve të tjerë. Çështjet e aksesit të vështirë, mungesës së promovimit, çështjet e pazgjidhura të pronës, si dhe u diskutua e analizua edhe fakti i produktit turistik që ofrohet aktualisht, i cili në fakt nuk është i specializuar ose tërheqës për tregjet potenciale, veçanërisht krahasuar me zonat përreth. Pjesëmarrësit e tjerë theksuan nevojën për të marrë parasysh të gjitha burimet kulturore dhe natyrore të zonës, duke u fokusuar veçanërisht në zonat malore dhe gjysme-malore.

Lista e plote e pjesëmarrësve është paraqitur në Shtojcën D.

### III. KONSULTIMI ME PUBLIKUN PER FORMULIMIN E PLANIT STRUKTURAL

Mendimet dhe sygjerimet e marra nga prezantimi publik u diskutuan me anetaret e ekipit të Planifikimit dhe zyrtareve bashkiake të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë dhe Shefi i Departamentit të Planifikimit Urban, komentet u vlerësuan dhe shërbyen si baze për formulimin e Planit të Përdorimit të Tokës. Përmbajtja e Planit me vone u përpunua nëpërmjet bashkëbisedimeve të mëvonshme të konsultimit me Bashkinë nga muaji Gusht deri në muajin Shtator, të cilat përfshijnë bashkëpunimin në çështjet e mëposhtme:

- **Konceptin e përgjithshëm për definicionin e Struktura të Përdorimit të Tokës** së bashku me logjikën e dispozitave rregullatore. Kjo përfshin shkëmbimin e ideve në dispozitat e Planit në lidhje me metodologjinë e zonimit, konceptin e mbrojtjes së peisazhit dhe drejtimet e zhvillimit të turizmit të ri dhe zonave të banimit me zhvillime të tjera. **Aspektet programatike të zhvillimit të turizmit të ardhshëm të Bashkisë së Himarës** lidhur me kapacitetin e shtreterve dhe shpërndarjen ndërmjet pjesëve të ndryshme të territorit dhe të formave të ndryshme të turizmit, në baze të parashikimeve ekonomike, popullore dhe trendet e pritshme.
- **Percaktimi i projekteve strategjike të infrastrukture** dhe mundësitë për financim dhe investim. Konsulenti ka përgatitur një listë të projekteve bazuar në Strategjinë e propozuar të Zhvillimit të Territorit dhe ka kryer një survey në nivel kombëtar në disa Ministri, ku kishte për qëllim lidhjen e projekteve të propozuara me mundësitë e burimeve të ndryshme të financimit. Konsulenti ka diskutuar rezultatet e këtij survey me Kryetarin e Bashkisë dhe Departamentin e Planifikimit dhe ka marrë sygjerime në lidhje me specifikimet dhe prioritizimin e projekteve të infrastrukture nga perspektiva lokale.
- **Perkufizimi i Zonave të Mbrojtjes së Mjedisit.** Ekspertët e mjedisit të Konsulentit janë konsultuar me Shefin e Departamentit të Tokës dhe Pyjeve, z. Andon Xani në lidhje me zonat e propozuara të mbrojtura sipas përcaktimeve të legjislativës mjedisore. Z. Xani propozoi këto zona që kanë nevojë për t'u mbrojtur: maja shkëmbore në Qeparonë e Siperme, Kanioni i Dhermiut, Kalaja e Ali Pashës në Porto Palermo dhe Shpella e Piratëve në Jaliskari.
- **Formulimi i Rregullave të Planifikimit Lokal.** Formulimi i rregullave të planifikimit lokal është kryer në koordinim me Kryetarin dhe Shefin e Departamentit të Planifikimit Urban të Bashkisë gjatë periudhës tetor dhe nëntor 2011. Ai përfshin i) formulimin e koncepteve të përshtatshme rregullative dhe aplikimin në pjesë të ndryshme të territorit, ii) hartimin e hartave të zonimit të hollësishme dhe ndarjen e rrjetit rrugor për të mbuluar të gjitha zonat ekzistuese të vendbanimeve dhe zonave të reja të zhvillimit, dhe iii) specifikimet e intensitetit të ndërtimit të përshtatshëm dhe karakterin e çdo zone.


## IV. PREZANTIMI PUBLIK I DRAFT PLANEVE DHE RREGULLOREVE

Pjesëmarrja e publikut u realizua me sukses në fazën finale të Planit, me proceset e prezantimit dhe diskutimit publike, sipas kërkesave të përcaktuara me Ligjin 10119, mbi Planifikimin Territorial.


**Njoftimi Publik**- Një njoftim publik u vendos në Bashki dy javë para prezantimit publik, në mënyrë që të informojë për procesin e planifikimit dhe të ftojë publikun dhe aktorët lokalë për të marrë pjesë në të. Njoftimi u vendos në vende të ndryshme në Himarë dhe në të gjitha vendbanimet kryesore. Për më tepër, Konsulenti vendosi dy njoftime në kater gazeta kombëtare (Shekulli, Panorama, Shqip, Gazeta Shqiptare) me qëllim që të informonte një audiencë më të gjerë si dhe palë të tjera të interesuara. Së fundi Bashkia përgatiti ftesat zyrtare për të ftuarit e nderit nga qeveria dhe përfaqësues të institucioneve të huaja në Shqipëri, duke përfshirë edhe ambasadat e huaja. Këto dokumente u shpërndanë paraprakisht për të siguruar kontributin në kohë nga të ftuarit.

**Prezantimi Publik** – Dy prezantime publike janë organizuar nga Konsulenti për paraqitjen e draft planeve dhe rregulloreve: Prezantimi i parë u zhvillua në fshatin e Dhërmiut, në 17 Nëntor 2011 dhe i dytë në Qytetin e Himarës në Hotelin Rapos më 18 Nëntor 2011. Prezantimet ndoqen një strukturë të ngjashme, të përbërë nga dy pjesë. Pjesa e parë që ishte e njejte në të dy seancat, përfshiu një prezantim të modelit të zhvillimit të turizmit të propozuar për Himarën dhe aplikimin e saj në pjesë të ndryshme të territorit. Konsulenti paraqiti shembuj të përshtatshëm për zhvillimin e turizmit, hartën e përdorimit të tokës për të gjithë territorin e bashkisë dhe të dhënat mbi kapacitetin e turizmit. Pjesa e dytë e prezantimit përfshiu shpjegimin e rregulloreve, paraqitjen e hartave të zonimit të hollësishme dhe dispozitat e propozuara për çdo zonë zhvillimi. Prezantimi i parë u përqëndrua në veçanti në zonat Palasë, Dhërmi, Vouno-Ilias, si dhe Jal, ndërsa paraqitja e dytë u përqëndrua në zonën e gjerë të Himarës, Livadhit, Porto Palermos, Pilurit, Kudhesit dhe Qeparoit. Të dy prezantimet u ndoqen nga një numër i madh njerëzish, kryesisht vendas mbi 80 pjesëmarrës në Dhërmi dhe rreth 100 pjesëmarrës në Himarë. Prezantimi në Himarë u ndoqe dhe nga Zëvendës Ambasadori i Ambasadës Greke. Publiku tregoi një pjesëmarrje aktive, të gjallë dhe me interes për përmbajtjen e planit dhe ndikimit të tij në zhvillimin e territorit. Hartat janë prezantuar publikisht në të gjitha seancat dhe u studiuan me kujdes nga audiencia. Konsulenti shpjegoi qartë kontekstin ligjor të ligjit të ri të Planifikimit të Territorit dhe statusin e Planit të Përgjithshëm Lokal, mbështetur në Planin e Zhvillimit të Bregdetit të Jugut dhe Rregulloreve Kombëtare të miratuara rishtazi, si dhe procesin formal të konsultimit publik, adaptimit dhe miratimit të planit.






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

THYMIO PAPANANNIS AND ASSOCIATES INC.  
spatial planning and design

QENDRA PER KERKIM DHE ZHVILLIM

### STUDIM PROJEKTIM I ZONES SE HIMARES ME PERPARESI ZHVILLIMIN E TURIZMIT

#### Njoftim Per Publikun

Ne kuader te projektit Studim Projektim I Zones se Himares me Perparesi Zhvillimin e Turizmit, Bashkia Himare, ka kontraktuar Konkorsiumin e Kompanive: "Thymio Papayannis & Associates Inc" dhe "Qendren per Kerkim dhe Zhvillim" per pregatitjen e Planit te Zhvillimit Urbanistik dhe Rregullores per Bashkin e Himares.

Ne kete kuader Konkorsiumi ne fjale ne vazhdim te procedurave per draftimin e ketij plani, ne bashkepunim te ngushte me Bashkine dhe grupet e interesit, ka planifikuar qe ne datat **17 Nentor, ora 11, ne Dhermi** te zhvillohen:

#### PREZANTIMI PUBLIK I DRAFT PLANIT TE PËRGJITHSHËM VENDOR TE BASHKISE HIMARE

Plani ka per qellim te percaktojte dhe rregulloje zhvillimet e ardheshme te Bashkise deri ne vitin 2022. Plani percakton perdorimin e ardhshem te tokes.parimet ku do te mbeshetet zhvillimi i cdo zone brenda territorit te Bashkise si dhe rregulloret qe jane te detyrueshme.

Te gjitha te interesuarit, profesioniste, punonjes te administrates, pronar e ndertues, si dhe cdo banor qe mendon qe mund te kontribojte me pjesmarren e tij, eshte i ftuar ne kete prezantim te hapur dhe te zgjeruar te Bashkise Himare.

Te bindur ne rendesine e ketij takimi dhe te vetdijshem ne rolin tuaj mendojme se pjesmarjja juaj do te kontribojte pozitivisht ne zhvillimin e metejshem te Planit te Zhvillimit Urban qe do ti sherbeje te sotmes dhe te ardhmes se Bashkine te Himares.

Per informacion te metejshem ju lutem kontaktoni Zj  
Rajmonda Zisi prane Zyres se Kryetarit te Bashkise Himare  
Tel ...

**Figura 72: Njoftimi Publik**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË

### OFFICIAL INVITATION

Honored Sir / Madam,

In the context of the Project: *Study of the Urban Plan of Himara and Priorities for Tourism Development*, the Mayor Jorgo Goro, in association with the contracted companies, "Thymio Papayannis & Associates Inc." and "Center for Research and Development" invite you to the:

#### PUBLIC PRESENTATION OF LOCAL GENERAL DRAFT PLAN OF HIMARA MUNICIPALITY

In this context, the companies in question, following the provided by the legal framework procedures for drafting the plan, in close collaboration with the Municipality and other stakeholders, have scheduled respectively for two presentations:

- on **November 17<sup>th</sup>**, at **11:00a.m. in Dhermi (at School)**; and
- on **November 18<sup>th</sup>**, at **11:00a.m. in Himara (at Rrapos Hotel)**

The plan aims to promote and regulate the development of the Municipality until 2022. It determines future land uses, the principles that will apply to the development of different areas within the territory of the Municipality, as well as mandatory regulations.

In this activity, all groups of interest of Himara Municipality are invited.  
We highly appreciate your participation as an important actor and supporter in the development of city policies and future community development.

For further information please contact Mrs. Rajmonda Zisi, Himara Municipality Mayer office  
Tel: **0695138974**




THYMIO PAPANANNIS AND ASSOCIATES INC. QENDRA PER KERKIM DHE ZHVILLIM

**Figura 73: Ftesa zyrtare per aktoret e perzgjedhur**



**Figura 74:** Prezantimi Publik ne Dhermi, 17-11-2011




**Figura 75:** Prezantimi Publik ne Himare, 18-11-2011

**Paraqitja Publike** Paraqitja Publike do të ndjekë prezantimin publik. Ai do të paraqesë hartat e printuara të Draft Planit Lokal dhe materialet shoqëruese, duke siguruar një përshkrim të detajuar të kodeve të zonimit dhe rregulloreve. Paraqitja do të behet në dy vendodhje, në Bashkinë e Himarë dhe në Shkollën e qytetit dhe do të zgjasë dy muaj, duke filluar nga fillimi i Dhjetorit. Kutitë e mendimeve/propozimeve do të vendosen pranë vend paraqitjes së planeve, në të cilën çdo qytetari, organizate apo institucioni do t'i jepet mundësi për paraqitjen e komenteve të tyre si dhe kundërshtimeve, me shkrim sipas një formulari të përcaktuar të komeneve.

**Komentet e përgjithshëm të publikut.** Komentet e marra nga paraqitja publike do të përfshihen më vonë në Plan, pas një konsultimi dhe procesit të vlerësimit ndërmjet Konsulentit dhe Departamentet të Planifikimit Urban të Bashkisë. Bashkia do të realizojë një dëgjim publik për të paraqitur përgjigjet për të gjitha komentet e marra dhe versionin përfundimtar të dokumenteve të planit. Kjo do të bëhet para dorëzimit të Planit për miratim në Këshillin Bashkiak.

**SHTOJCA A: STRUKTURA E EKIPIT DHE ORGANIZIMI**

**Organizimi i ekipit-** Ekipi Studimit i Konsulenti është formuar nga një grup shume disipline të ekspertëve Grekë dhe Shqiptarë të nivelit të lartë dhe te rinje me përvojë dhe eksperiencë për të mbuluar nevojat e projektit dhe për të siguruar një ekip të balancuar. Anëtarët e ekipit kanë punuar tashmë së bashku në projekte të ngjashme një fakt i cili siguron bashkëpunim të mirë ndërmjet tyre. Nje ilustrim i struktures se ekipit dhe organizimit eshte pershkruar ne (Figuren 76):



**Figura 76:** Struktura e Ekipit dhe Organizimi

| Perfaqesuesit e Bashkise, Struktura e Skuadres dhe Lista e Eksperteve |                              |  |  |
|---|------------------------------|--|--|
|   | Emri                         | Profession                                   | Position in Plan                                     |
| <b>Bashkia</b>  | <b>Jorgo Goro</b>            | Krye - Bashkiak                              |  |
|   | <b>Viron Zoto</b>            | Zv/Kryetar i Bashkise                        | Mbikqyres i Administrates                            |
|   | <b>Gentjian Stratoberdha</b> | Arkitekt                                     | Shef i Departamentit te Planifikimit Urban           |
|   | <b>Raimonda Zisi</b>         | Sekretare                                    | Person kontakti                                      |
| <b>TPA</b>  | <b>Dr. Thanos Pagonis</b>    | Planifikues Urban                            | Udheheqes Ekipi                                      |
|   | <b>Irini Tsakiropoulou</b>   | Planifikues Urban                            | Ekspert Rregullator, Keshilltare                     |
|   | <b>Dr. Aris Ikkos</b>        | Ekonomist                                    | Ekspert per Zhvillimin e Turizmit                    |
|   | <b>Ivy Nanopoulou</b>        | Arkitekt                                     | Arkitekt, Keshilltar                                 |
|   | <b>Panita Karamanea</b>      | Arkitekt Peisazhi                            | Arkitekt Peisazhi, Ekspert                           |
|   | <b>Konstantinos Zekkos</b>   | Planifikues Transporti dhe Inxhinier Trafiku | Planifikues Transporti dhe Inxhinier Trafiku Ekspert |
|   | <b>Thymio Dimopoulos</b>     | Planifikues Urban-Arkitekt                   | Planifikues Urban,, Ekspert                          |
|   | <b>Loukas Triantis</b>       | Planifikues Urban, Gjeograf                  | Planifikues Urban, Ekspert                           |
| <b>QKZH</b>   | <b>Mirlinda Rusi</b>         | Ekonomiste                                   | Ekonomiste Ekspert, Manaxhere Projekti               |
|   | <b>Dr. Halit Kamberi</b>     | Hidrolog                                     | Ekspert Sherbimesh (Ujit dhe Ujrave te Zeza)         |
|   | <b>Bexhet Chobani</b>        | Inxhinier Civil                              | Ekspert ne Infrastrukture                            |
|   | <b>Dr. Cerciz Dyrmishi</b>   | Gjeolog                                      | Ekspert Mjedisor                                     |
|   | <b>Dr. Emil Xhuvani</b>      | Biolog                                       | Ekspert Mjedisor                                     |
|   | <b>Ereda Xhumari</b>         | Asistente                                    | Asistente  |

**SHTOJCA B: LISTA PARAPRAKE E ÇËSHTJEVE TË REGJISTRUARA GJATË INTERVISTAVE TË MBAJTURA ME PËRFAQËSUESIT LOCAL**

| Emri             | Fshati        | Date       | Historia/identifikimi  | Problemet kryesore te raportuara   | Prirjet/potenciali   | E ardhmja  |
|------------------|---------------|------------|--|--|--|--|
